



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14 DHE 21 SHKURT 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. I 21. FEBRUARA 2013. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizmin,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonat ekonomike,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil,
13. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur edhe nga 19 deputetë, lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë,
14. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit,
15. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o turizmu,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o stranim investicijama,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o proizvodima izgradnje,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o Inspektoratu i nadgledanju tržišta,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o geografskim pokazateljima,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o opštoj sigurnosti proizvoda,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o ekonomskim zonama,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o robi oslobođene carine i carinske robe sa nula - tarifinih poreskih obaveza,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Agenciji za civilnu registraciju,
13. Parlamentarna debata prema zahtevu poslanika Bekim Haxhiu, podržan od 19 poslanika, u vezi stanja sporta na Kosovu,
14. Razmatranje predloga Odluke Vlade Republike Kosova o imenovanju članova Borda Kosovske agencije za privatizaciju,
15. Predlog Parlamentarne grupe PDK-a za zamenjivanje jednog člana u Komisiji za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutime në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Replika nuk ka.

Në seancën e fundit kemi filluar nga grupet më të vogla, tani fillojmë nga grupi më i madh. Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Njëra pre brengave të mia kryesore është sistemi i arsimit në vendin tonë.

Njëra prej barsolave më të përdorura në Kosovë, në llogari të klasës politike të të gjitha ngjyrave, të pasluftës po mendoj, tregon se si një politikan e ka mbaruar magjistraturën, e ka mbaruar edhe doktoraturën, e krejt në fund thotë që “ta kisha ditur që është kaq lehtë, e kisha kryer edhe shkollën e mesme”.

Këto 20 vjet, të nderuar kolegë deputetë, është shumëfishuar numri i doktorëve të shkencave dhe magistrave në vendin tonë. Mund të mos jem i saktë, por, sipas disa spekulimeve, thuhet se për një doktor shkence që e kishim në vitin 1999, tash i kemi tetë. Pra, vetëm pas luftës është tetëfishuar numri i doktorëve të shkencave.

Në vendin tonë kemi doktorë të shkencave që janë të papunë. Kjo nuk thotë shumë për tregun e vendit tonë, kjo nuk thotë shumë për Kosovën, sa thotë shumë për ata persona. Pra, të jesh doktor shkence dhe të jesh i papunë është niveli më i ulët i arsimimit të atij personi. Si do që të jetë, secili le ta gëzojë doktoraturën sipas punës që e ka bërë. Mirëpo, unë do të kërkoja, nisur edhe prej një rasti të freskët në Gjermani, ku dha dorëheqje ministrja e Arsimit për plagjiaturë, që edhe ne si Kuvend të fillonim të merreshim me raste të tilla. Pra, unë fillimisht do të kërkoja që ta formonim një komision, i cili do ta shikonte listën e personave publikë, që aktualisht janë nëpër pozita të larta publike, e që kanë doktoruar pas vitit 1991.

Pra, e kam një kërkesë prej Ministrisë së Arsimit, që na tregojë se sa persona publikë aktualisht kanë doktoruar prej vitit 1991 e tutje.

Mandej, duhej t'i shikonim rrugët ligjore që ne si Kuvend ta formonim një komision dhe të kërkonim ekspertizë ndërkombëtare që të gjitha ato tezat e doktoraturave, ato punimet

e doktoraturave t'i vlerësonim këtu dhe t'i shikonim se nëse ndonjëra prej tyre i plotëson kushtet që të quhet punim doktorature.

Pra, kjo është ajo që ne mund të bënim më së paku për vendin tonë. Të jesh doktor shkence dhe nëse punimi yt i doktoraturës nuk i plotëson ato kushte, atëherë kemi të bëjmë me krime të shumëfishta, kemi të bëjmë me falsifikim, kemi të bëjmë me blerje të tezës të doktoraturës, kemi të bëjmë me mashtrim të opinionit publik. Pra, është një numër i madh i krimeve që janë të gërshetuara brenda një krimi të vetëm.

Unë do të kërkoj në seancën e ardhshme nga Ministria e Arsimit që të na tregojë se sa doktorë të shkencave janë shumuar në Kosovën e pasluftës dhe prej vitit 1991, kohë kjo kur ka degraduar sistemi arsimor në Kosovë dhe mandej të precizojmë se sa doktorë të shkencave kemi në Qeveri, sa doktorë të shkencave kemi në Kuvend, sa doktorë të shkencave kemi nëpër institucionet tjera, e mandej t'i analizojmë me ato teza të doktoraturave dhe ato punime të doktoraturave.

Kisha kërkuar edhe mbështetjen tuaj në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën, në emër të Grupit.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Para disa ditësh u mbushën 13 vjet nga masakra ndaj qytetarëve shqiptarë që jetonin në veri të Mitrovicës.

Në shkurt, para 13 vjetësh, dhjetë shqiptarë, shumica prej tyre pleq, gra e fëmijë u ekzekutuan nga strukturat serbe, që njihen si Roja të Urës.

Ato sulme patën për pasojë edhe plagosjen e rëndë të 25 qytetarëve, keqtrajtimin fizik të qindra prej tyre, dëbimin e mbi 1 500 familjeve shqiptare vetëm gjatë muajit shkurt. Gjatë atyre ditëve, më të dashurit e tyre i humbën familjet Gjaka, Canhasi, Ajeti, Berisha, Voca, Rukeci, Sejdiu, Abrashi e Sokoli.

Me këto veprime, Serbia dëshmoi që politikat e saj të spastrimit etnik nuk kishin përfunduar në vitin 1999. Përndjekjet e shqiptarëve nuk përfunduan në atë vit, por vazhduan në mënyrë sistematike. Pra, si një krim kundër njerëzimit që po bëhet në mënyrë të heshtur. Por, këtë krim nuk po e hesht vetëm Serbia, po e heshtin edhe institucionet e Kosovës.

Këta qytetarë të pambrojtur shpresonin që pas përfundimit të luftës do të mund të gjenin mbrojtje diku, qoftë nga institucionet e Kosovës, nga KFOR-i apo UNMIK-u. Por, sipas dëshmitarëve okularë, këto masakra kanë ndodhur pikërisht para syve të pjesëtarëve të ushtrisë së KFOR-it.

Institucionet e Kosovës ndërkaq nuk ua siguruan atë të drejtë, e cila sot u takon edhe me Kushtetutë. Pra, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre themelore të njeriut.

Drejtësia ka dështuar t'i kapë dhe t'i dënojë autorët e kësaj masakre, e as nuk janë bërë përpjekje serioze që provat e mbledhura nga ajo natë e tmerrshme të shërbejnë për një hetim serioz, për të sjellë para drejtësisë autorët e krimit.

Kosova, megjithatë, duhet ta dijë që krimet si ky nuk parashkruhen kurrë. Spastrimi etnik që ka rezultuar edhe me masakrat e tilla nuk është krim që vjetërsohet. Është momenti i fundit që drejtësia ta kryejë detyrën e vet dhe të marrë veprime konform normave ligjore kushtetuese.

Është po ashtu momenti i fundit që kur institucionet tona flasin për liri të lëvizjes dhe integritet të veriut të vendit, të mendojnë edhe për mijëra familje shqiptare që u dëbuan me dhunë dhe që duhet të kthehen në shtëpitë e tyre, por edhe për shumë prej tyre që ende po e mbrojnë sovranitetin e integritetin territorial të Kosovës, përderisa institucionet tona nuk u sigurojnë as mbrojtje të jetës e pronës së tyre.

Por, të nderuar deputetë, liria e lëvizjes nuk po u mohohet vetëm qytetarëve që jetojnë në veri të vendit.

Të gjithë qytetarët e Kosovës edhe më tej do të privohen nga të drejtat e tyre themelore, pra e drejta për të lëvizur edhe jashtë vendit.

Kryeministri Thaçi pati premtuar që para 2-3 vjetësh, që më së largu në fund të vitit 2012, qytetarët e Kosovës do të kenë mundësi të lëvizin edhe jashtë vendit pa regjim të vizave.

Tani publikimi i raportit për liberalizim dëshmon se, jo vetëm që nuk është shënuar ndonjë hap përpara, por që ka edhe kthim prapa në këtë drejtim.

Këto kanë qenë vetëm detyra teknike, të nderuar deputetë, përderisa kryeministri Thaçi po provon të fshihet prapa deklaratave politike. Nuk është as faji i Spanjës, as i Sllovakisë, as i Greqisë, as i Qipros, as i Rumanisë, që Kosova nuk i ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me procesin e riatdhesimit, sigurinë e dokumenteve, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndërhyrjet politike në Gjyqësor dhe në Administrata publike, si kritere esenciale për të arritur sukses në procesin e liberalizimit të vizave.

Prandaj, në vend se të vazhdohet vetëm me politika deklarative dhe mediale në këtë proces, institucionet e Kosovës duhet t'i adresojnë urgjentisht kërkesat e paraqitura në këtë raport dhe të tregojnë përfundimisht njëherë e mirë se ka vullnet politik për ta çrrënjosur krimin e organizuar dhe korrupsionin. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave duhet lexuar në tri rrafshë: në raportin e Kosovës me sundimin e ligjit, së dyti raporti procesit të liberalizimit të vizave me dialogun politik që Kosova po e zhvillon me Serbinë dhe së treti raporti i Qeverisë së Kosovës në lidhje me qytetarët e saj për sa i përket këtij procesi.

E fillojmë me të parin, në raportin e Kosovës me sundimin e ligjit.

Sipas dokumentit të nxjerrë nga Komisioni Evropian, i cili është një skanim i gjendjes reale në Kosovë, sundimi i ligjit është brenga më e madhe për këtë shtet.

Në gjithë raportin, kryefjala është ‘sundimi i ligjit’. Gjyqësori nuk është i pavarur dhe i paanshëm, ka ndërhyrje politike, nuk ka transparencë në emërime gjyqtarësh dhe prokurorësh, Policia nuk bashkëpunon sa duhet me Prokurorinë, ‘luftojeni korrupsionin në drejtësi dhe në sistemin e prokurimit publik’, kërkohet specifikisht në rekomandime.

Pjesë e aferave korruptive janë edhe pasaportat biometrike, me të cilat pritej të udhëtohej pa viza. Kjo është konstatuar në raport. Krimi i organizuar është brenda institucioneve, gjithashtu konstatohet në raport. Komentet, pra, në këtë rast, janë të panevojshme.

Raporti i dytë, që duhet ta shqyrtojmë është procesi i liberalizimit të vizave me dialogun politik me Serbinë.

Mjafton ta bësh një analizë të deklaratave të kryeministrit për këtë. Nuk ka kohezion në këto deklarata. Fillimisht ka thënë se ky proces nuk është i lidhur me dialogun, më pas, pas lëshimit pe që bëri në dialog për disa elemente të sovranitetit shtetëror, tha se e bën këtë për shkak se Kosova do të përfitojë nga procesi i integriteteve evropiane, dhe se këtu përfshihet edhe liberalizimi.

Marrja e udhërrëfyesit për vizat u interpretua si shpërblim për dialogun. Ministrat po fluturonin, mburreshin për suksesin e madh, se ‘ja çfarë kemi marrë’. E çfarë kishin marrë? Shpërblimi ishte një dokument me 100 pyetje, i cili është dyfishi i pyetjeve që kanë marrë vendet tjera të rajonit. Cila pra është e vërteta? A po kushtëzohet Kosova nga Brukseli me këtë proces, që të lëshojë pe në dialog? Nëse po, atëherë përfundimisht nuk ia vlen, sepse Kosova po humb në të dyja anët, ndryshe nga Serbia, e cila është shpërblyer me marrjen e statusit të vendit kandidat dhe po shpërblehet edhe me lëshimin pe ose koncesionet e vazhdueshme që po bën Qeveria e Kosovës në dialog, madje tani edhe për veriun.

Së treti, është e rëndësishme ta dekonstruktojmë raportin e Qeverisë së Kosovës me qytetarët.

Në fushatën e fundit elektorale kryeministri ka premtuar udhëtim pa viza në Evropë për 15 muaj. Kur ky premtim dështoi, vazhdoi ta zgjasë afatin e premtimit. Tash më kur mori përgjigje negative nga Brukseli, i cili thotë se s’ka liberalizim të vizave pa e luftuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, në emër të Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Po vazhdon gjendja e njëjtë, për çdo 10 ditë e kemi nga një temë tepër të madhe në Kosovë, qoftë e brendshme, qoftë që vjen nga jashtë. E dini se e patëm një temë tepër të madhe, e cila po vazhdon me fatura të rrymës. Vetëm sa për qartësim, nuk ka ndodhur për herë të parë. Në tre muajt e fundit, KEK-u i ka futur në të ashtuquajturën ‘bllok-tarifë’ një numër të madh të konsumatorëve për shkak se është vonuar ta marrë gjendjen për një muaj, e muajin tjetër kanë kaluar në dyfish të pagesës.

E kemi raportin e Komisionit Evropian tani për liberalizim të vizave, i cili nuk po na bën mirë hiç, po na vonon të paktën edhe për një vit e gjysmë prej sot.

Po mendoj se është një temë tjetër, për të cilën Aleanca mendon se duhet të flasim sot. Është një çështje që ka të bëjë me ne, që ka të bëjë me Kuvendin e Kosovës.

Për vetëm pak më shumë se një muaj, diku katër herë është lëshuar salla e Kuvendit prej grupeve të ndryshme parlamentare. Është lëshuar edhe prej deputetëve të partive në pushtet, që është një farë absurdi i llojit të vet, është prish kuorumi në momentet kur ka pasur bindje se nuk ka vota të mjaftueshme për t’i votuar njerëzit e caktuar nëpër borde. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me opozitën. Edhe ne e kemi lëshuar sallën dy herë.

Mendoj që ka ardhur koha që ta shohim pak më ndryshe këtë temë, ta shohim se përgjegjësia për ta ruajtur fytyrën e Kuvendit, për ta ruajtur autoritetin e institucionit më të lartë në vend demokratik, për shtëpinë e demokracisë në Kosovë, është e ndarë 120 pjesë. Secili prej nesh duhet ta mbrojë, jo vetëm kryetari i Kuvendit.

Më duhet të ju them se ne si Aleancë besojmë se më nuk duhet të lëshohet salla kur nuk na pëlqen një individ, të cilin do ta votojmë, qoftë ai yni, ose i dikujt tjetër; qoftë i pushtetit, qoftë i opozitës.

Mendoj se nëse vazhdojmë kështu që kur nuk na pëlqejnë individët, pa ndonjë parim të qartë përtej individit, vazhdojmë ta lëshojmë Kuvendin, më duket se thjesht, po shprehem shumë popullorçe, po ia marrim fytyrën Kuvendit, po e degradojmë institucionin më të rëndësishëm të demokracisë në Kosovë.

Kjo është ajo që desha ta them në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Po ju lus: ta mbushim sallën, për shkak se kjo legjislaturë, po më duket se po do t’i shkaktojë dëm afatgjatë parlamentarizmit në Kosovë, meqë për çdo javë, një grup parlamentar, e aq më tepër, po e përsëris - aq më tepër, kur thashë se ndahet në 120 pjesë, atëherë këtë duhet ta ketë parasysh pushteti, partitë në pushtet. Lëshimi kaq i shpeshtë i sallës duket sikur e krijon ndjenjën që Kuvendi i Kosovës është institucion jo i rëndësishëm, është institucion i cili vetëm duhet t’i mbledhë votat dhe ta votojë dikë, ose të mos e votojë dikë në bord, na pëlqeu, apo nuk na pëlqeu. Është një thirrje dhe është një qëndrim: nuk lëshohet salla e

Kuvendit pse nuk na pëlqen një individ në bord. Mendoj se tani e tutje për këtë çështje duhet të kemi kujdes. Ka arsye tjera pse lëshohet salla, është demokraci, por është bërë praktikë e keqe, edhe një herë po ju them - sidomos prej pushtetit që lëshohet salla kur nuk na pëlqen një individ. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Poštovani predsedniče,
Uvaženi premijeru, Vladin kabinet,
Dame i gospodo, narodni poslanici,
16. februara 2013. godine navršava se 12. punih godina od kako izvršen teroristički napad na autobus "Niš Express", koji je prevezio putnike na relaciji Niš-Gračanica & Gračanica-Štrpce.

Tok 16. februara uobičajeno formirana kolona vozila na prelazu Merdare, koja je trebalo da stigne do svog odredišta, to jest do Gračanice, a potom i do Štrpca. Na čelu kolone bio je postavljen jedan transporter iz KFOR-a, kao i na začelu kolone, upravo iz razloga bezbednosti, kako bi putnici koji su bili u centralnom delu Srbije, mogli bezbedno da se vrate svojim kućama. Nažalost, i veliki transporteri nisu mogli da zaštite nevine živote, koji su izgubljeni tog dana. Nisu mogli da ih zaštite od zločinačkih planova bolelsnih humova, koji su izrežireli događaj koji možemo videti samo u scenama horor filmova.

Poštovani poslanici,
Biću toliko slobodna da samo na trenutak prenesem utiske nekih ljudi koji su bili očevidci događaja, koji opisuju događaj kao stravičan čin: "Ispred nas gledali smo autobus koji je poleteo u vazduh, koji se pretvorio u pečurku, sa svih strana leteli su delovi tela putnika koji su bili u autobusu, kao i delovi autobusa". Ovi su reči vozača Zorana Jovanovića, kao i Gradimira Krstića, koji su bili na autobusu na začelu kolone.

Poštovani predsedniče,
Poštovana gospodo poslanici,
Poštovani građani Kosova,
Tog dana je izgubljeno 12 života građana, a ranjeno 43 osobe. Ubijeni su i ranjeni samo iz razlog zato što su Srbi. Poštovani poslanici, pitam ja vas: Da li je to dovoljan razlog da neko izgubi život, izgubi sina, izgubi ćerku, brata ili sestru, oca ili majku, samo zato što je druge nacionalnosti, ili druge vere? Ja mislim da to nije razlog, i zato vas molim da upravo ne zaboravimo na ovakve zločine koji su se desili, i javno osudimo, i da ne zaboravimo žrtve tog terorističkog napada. I na kraju, zamolila bih sve nadležne organe u opštini Podujevo da izdaju potrebnu dozvolu kako bi se na tom mestu mogao podići spomenik nevinim žrtvama tog terorističkog čina, kako bi smo kao društvo ispunili obavezu i odali počast nevino stradalim žrtvama. Zahvaljujem!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Përshtëndetje për kryeministrin dhe Qeverinë,

Për të gjithë deputetët në këtë seancë,
Duke marrë parasysh gjendjen e qytetarëve, të cilët po përballen me faturat e KEK-të, unë do ta ngre një çështje sot këtu për këtë arsye.

KEK-u me vite të tëra është duke funksionuar si kompani me humbje dhe duke mbijetuar nga subvencionet, të cilat i janë dhënë nga shteti i Kosovës.

KEK-u nuk arriti të bëjë reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe si pasojë e menaxhimit të dobët përsëri i ndëshkon konsumatorët, derisa në asnjë masë nuk ndëshkohet menaxhmenti i KEK-ut, që është duke e udhëhequr për 5-6 vjet.

Pos kësaj, KEK-u nuk tregoi se është kompani e drejtuar nga konsumatorët, por në mënyrë të vrazhdë e shfrytëzoi pozitën monopolistike dhe ndëshkoi ata.

Në rast se i shohim humbjet e KEK-ut, ato janë diku 40% dhe njëkohësisht janë barrë e konsumatorëve.

Reduktimet e energjisë elektrike bëhen edhe për konsumatorët, të cilët e paguajnë energjinë elektrike, për arsye se fqinjët e tyre nuk e paguajnë. Që nga viti 2005 është skema A,B,C.

Dhe, në rast se KEK-u i ndëshkon konsumatorët e ndërgjegjshëm, të cilët e paguajnë energjinë elektrike dhe i barazon me konsumatorët, të cilët nuk e paguajnë, apo në mënyrën më të vrazhdë - e vjedhin energjinë elektrike, atëherë ku është përgjegjësia e kësaj kompanie.

Në rast se i shohim protestat, mund të themi se pakënaqësia e konsumatorëve ka arritur në pikën më të lartë. Jo për arsye të tyre, por për arsye të menaxhmentit, duke e ditur se kjo kompani është kompani publike dhe duhet ta ketë besimin te qytetarët e Kosovës. Nuk është çështja e fryrjes së faturave, por mund të themi se faturimi është bërë në mënyrë jo të saktë dhe leximi i orëve është bërë më herët, me qëllim që të ngarkohet konsumatori, i cili e paguan energjinë elektrike në mënyrë të rregullt.

Në rast se shohim çfarë ka arritur KEK-u në këto 5 vjet dhe sa e ka ndihmuar Qeveria në këtë periudhë, atëherë mund të themi se dikush duhet të japë përgjegjësi për arsye se qytetarët e Kosovës duhet të kenë besim në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës, e jo ajo t'i ndëshkojë konsumatorët, të cilët mundohen ta paguajnë energjinë.

Në rast se thuhet që çmimet janë arsye pse janë ngritur faturat e energjisë elektrike, mund të them se për 200 kilovatë energji elektrike në muaj, atëherë çmimi është 5,05 centë, prej 200 deri 600 është 7 centë, ndërsa për 600 kilovatë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Lajmërohuni kur të jeni në emër të grupit, kur ta merrni fjalën dhe regjia do ta ketë parasysh.

MYZEJENE SELMANI: Kryetarja flet në emër të Grupit, kryetar!
Dhe, kjo tregon se çka është duke bërë KEK-u për qytetarët dhe konsumatorët e vet.

Për arsye se sot e kemi edhe raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për situatën aktuale, kërkoj nga kryeministri, njëkohësisht edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, që të ndërmarrin masat e duhura, me qëllim që konsumatorët të kenë besim në KEK, për arsye se konsumatorët janë ata që e mbushin Buxhetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar i Kuvendit,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Kolege dhe kolegë deputetë,
Në mesin e personave me nevoja të veçanta në shoqërinë tonë është edhe komuniteti shurdhmemecëve, komunitet ky që ballafaqohet me vështirësi të theksuara në të gjitha sferat, përfshirë integrimin e tyre dhe përfilljen institucionale.

Si çdo komunitet tjetër, edhe shurdhmemecët janë mirë të organizuar në Shoqatën e Shurdhmemecëve të Kosovës, shoqatë kjo që ka për qëllim përfaqësimin e interesit të kësaj kategorie karshi institucioneve dhe aktorëve tjerë relevantë.

Puna dhe veprimtaria e kësaj shoqate në tërësi bazohet në vullnetin e këtij komuniteti dhe zemërgjerësinë e donatorëve.

Angazhimi dhe projektet e Shoqatës së Shurdhmemecëve të Kosovës ka rezultuar me të arritura konkrete në sensibilizimin e çështjes së shurdhmemecëve, por edhe në avancimin e të drejtave të tyre brenda mundësive, jo edhe aq të mëdha.

Kjo organizatë po arrin që të jetë pjesë e shoqërisë aktive nëpërmjet gjuhës së shenjave, gjuhë kjo e domosdoshme për këtë komunitet, e cila përdoret në të gjitha komunikimet formale dhe joformale ndërmjet pjesëtarëve të kësaj kategorie.

Në këtë kontest vlen të përmendet se si institucione jemi duke bërë pak për lehtësimin e komunikimit, apo informimit të kësaj shoqërie.

Vlen të përmendet se është i vetmi Televizioni Publik i Kosovës që e ofron një hapësirë programore prej 15 minutash, me ç'rast transmetimi i lajmeve njëkohësisht shoqërohet edhe nëpërmjet interpretimit të gjuhës së shenjave. Ndërsa askund tjetër nuk plasohet asnjë informacion në këtë gjuhë, si e vetmja formë nëpërmjet së cilës shurdhmemecët mund të kuptojnë dhe të komunikojnë me shoqërinë.

Unë, si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nevojat e kësaj kategorie, dua ta adresoj një kërkesë shumë modeste që ka ky komunitet. Ata kërkojnë që të paktën eventet e rëndësishme institucionale dhe politike, si seancat solemne të Kuvendit, të cilat transmetohen direkt në Televizionin Publik, dhe datat e shënuara

historike, siç është tash 5-vjetori i shpalljes së pavarësisë së Kosovës, të përcillen edhe me transmetimin nëpërmjet gjuhës së shenjave.

Duke e bërë këtë, ne si shoqëri dhe institucione do të vendosim një hap konkret me respektimin e të drejtave të tyre kushtetuese dhe në këtë mënyrë do ta ndihmonim integrimin e tyre të mëtutjeshëm brenda rrjedhave të shoqërisë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në një komunikatë të Zyrës së KEK-ut për Marrëdhënie me Publikun, më 6 shkurt 2013, ndër të tjera thuhet: “KEK-u i fton të gjithë konsumatorët e pakënaqur t’u drejtohen qendrave të konsumatorëve dhe të deponojnë çfarëdo ankese që kanë dhe Korporata i siguron se secila ankesë do të shqyrtohet deri në detaje”.

Kjo komunikatë e KEK-ut paraqet një veprim kamuflues, për të mos thënë mashtrues të kësaj korporate, që është ndërmarrë pas paraqitjes së pakënaqësisë së madhe të një numri të konsiderueshëm të konsumatorëve të KEK-ut për shkak të fryrjes së faturave të energjisë elektrike kohëve të fundit, në përgjithësi, dhe, në veçanti, të atyre për muajin janar të këtij viti.

Kjo gatishmëri e KEK-ut për t’i shqyrtuar ankesat e çdo konsumatori është treguar për shkak se zyrtarët e lartë të KEK-ut e ndiejnë veten fajtorë për mashtrimin që po u bëhet qytetarëve tanë në pikë të ditës.

Kjo vjedhje e qytetarëve kosovarë, edhe ashtu të varfër, është bërë me strategji dhe plan të caktuar. Kështu, KEK-u fillimisht e ka lansuar pilot-projektin e vet nëpërmjet disa njësorëve të rrymës, të cilët kinse nuk janë të harmonizuar me programet kompjuterike të faturimit, për ç’arsye disa pronarëve të banesave me sipërfaqe prej 70 deri 80 metra katror u është faturuar borxhi në lartësi madje edhe prej 500 deri në 700 euro.

Kur zyrtarët e KEK-ut e panë se për faturimet e tilla të larta Korporata nuk bartë asnjë konsekuencë penalo-juridike dhe gjyqësore, e as ndonjë hetim penal, atëherë Korporata startoi me metodën tjetër, me fryrjen e faturave për muajin janar.

Duke i fryrë faturat e një numri të madh të konsumatorëve, nga afro 400 mijë, sa janë gjithsej, një veprim i tillë megjithëse është mirë i planifikuar, sepse sipas një logjike nga mijëra konsumatorë të dëmtuar për shkak të mosbesimit në Gjyqësorin tonë dhe krijimit të vetëdijes, sipas së cilës ankesat dhe paditë nuk rezultojnë me efekte pozitive, vetëm një përqindje e vogël e të dëmtuarve do të ankohet në qendrat e konsumatorëve të KEK-ut dhe prej këtyre ankesave vetëm një përqindje e caktuar do të aprovohet. Domethënë, nga ky veprim mashtrues profiti për KEK-un do të jetë i madh, kurse buxheti familjar i qytetarit tonë, edhe ashtu të varfër, do të goditet seriozisht.

Prandaj, me qëllim të mbrojtjes së qytetarit tonë nga veprimet e tilla kriminale të njëjës nga korporatat më të korruptuara në vend, me qëllim të zbulimit dhe ndriçimit të së vërtetës të faturave të fryra, kërkoj nga Policia dhe Prokuroria jonë që t'i fillojnë hetimet penale për këtë rast konkret. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe profesor, edhe deputetë, por se janë kriminale apo nuk janë kriminale ne nuk e përcaktojmë. E përcaktojnë organet përkatëse. Duhet ta keni parasysh fjalorin! Nuk po e komentoj fjalimin, por fjalën, se është fjalë joparlamentare.

I fundit, në emër të Grupit, fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,

Edhe unë do të flas në lidhje me KEK-un, përkatësisht për faturat e KEK-ut, por prej një pikëvështrimi më ndryshe, e që unë mendoj, edhe në emër të Grupit Parlamentar, se kjo lidhet drejtpërdrejt edhe me privatizimin e Rrjetit të Distribucionit dhe të Furnizimit.

Sektorit të energjisë në Kosovë po i vijnë vërdallë zhvillime të çuditshme. Faturat e janarit e të dhjetorit janë indikator i më i qartë i së ardhmes së çmimit të energjisë elektrike. Këto fatura, po që se i heqim gabimet në lexim dhe shtimin e padrejtë dhe jologjik të konsumit të dhjetorit në faturën e janarit, respektivisht të konsumit të nëntorit në faturën e dhjetorit, janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shtrenjtimit të energjisë elektrike. Ky shtrenjtim është miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji nga 1 qershori i vitit 2012, pak a shumë në të njëjtën kohë, me shpalljen e konsorciumit “Limak- Çalik” si oferta më e mirë për privatizimin e Rrjetit të Distribucionit dhe Furnizimit. Dhe, tash, nga Zyra e Rregullatorit për Energji pritet të shqyrtohet dhe të miratohet një rritje tjetër prej 10%, në prill të këtij viti. Pra, pak kohë para se “Limak-Çalik” ta marrë përfundimisht nën menaxhim Këshillin Kosovar për Distribucion dhe Furnizim me Energji.

Energjia elektrike e shtrenjtë për konsumatorin është parajsja e kompanisë privatizuese në këtë sektor. E në kushte të monopolit privat në shpërndarje dhe furnizim, kjo bëhet domosdoshmëri. Rryma është shtrenjtuar për 45% në Shqipëri, pas privatizimit. Po ashtu, është shtrenjtuar në Maqedoni dhe në Mal të Zi.

Ministri Beqaj dhe apologjetët tjerë të këtij skandali të shitjes kanë tentuar disa herë të na bindin se këtu do të jetë ndryshe. Dhe vërtet, këtu qenka ndryshe! Në vendet tjera, që i përmenda më lart, shtrenjtimi ka ndodhur pas transferimit të pronës te kompania private, me kërkesën e saj. Madje, në disa raste në Shqipëri por edhe në Maqedoni ka pasur rezistencë të shtetit ndaj kërkesave të kompanisë private. Në Kosovë, kjo po ndodh para transferimit, dhe atë me kërkesë të kompanisë publike, për t'ia bartur pastaj frytet kompanisë private.

Asnjëherë në historikun e KEK-ut, si kompani publike, nuk ka pasur rritje kaq të shpeshta dhe kaq të madhe të çmimit të energjisë, gjë që do ta kishte ndihmuar këtë kompani. Rritja po bëhet vetëm atëherë kur po e pasuron kompaninë private.

Ndërkohë, 8 milionë euro janë duke u investuar në ndërrimin dhe digjitalizimin e njehsorëve pikërisht gjatë këtyre muajve.

Po investohen paratë publike në një kompani private. Po subvencionohet pra sektori i energjisë, tash kur po privatizohet. Një prej argumenteve kryesore të privatizimit është rritja e efikasitetit të kompanisë, e performansës së saj, në mënyrë që shteti të mos jetë i obliguar të derdhë fonde publike për të. Kjo, megjithatë, asnjëherë nuk po na del e vërtetë në Kosovë. Ne e subvencionuam për 6 vjet rresht “Ferronikelin”, pas privatizimit me energji të lirë. Ne ia mbrojtëm tregun “Sharr-Cemit” pikërisht pas privatizimit, për t’ia dhënë pozitën monopoliste në treg. Ne po e subvencionojmë KKDFE-në pikërisht në momentin e privatizimit.

Tash e 13 vjet, njëri prej problemeve kryesore në KEK ka qenë energjia e painkasuar, apo e vjedhur.

Njehsorët digjitalë do të kishin qenë një ndihmë jashtëzakonisht e madhe për ta përmirësuar këtë gjendje. Asnjëherë asnjë qeveri nuk e ndërmori këtë investim. Dhe, tash kur po privatizohet, po i investojnë 8 milionë euro. Kjo është logjika e kësaj Qeverie - shkatërrimi i publikes për privatizim dhe deri në privatizim. E pastaj i përdor të gjitha mjetet shtetërore, përfshirë paranë publike për ta ndihmuar të njëjtën ndërmarrje.

KRYETARI: Koha për deklaratimet e deputetëve jashtë rendit të ditës është shteruar. Fjalën e ka ministri Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sigurisht që janë jashtëzakonisht shqetësuese këto ditë diskutimet, të cilat kanë ndodhur për sistemin energjetik, një hap të cilin Qeveria e ka marrë me një përgjegjësi jashtëzakonisht të lartë - që të mos lejojë asnjë lloj tendence për manipulim, asnjë lloj manipulimi, asnjë mbingarkim, asnjë lëvizje të çmimit, i cili është jashtë rregullave dhe standardeve, të cilat i ka vënë ky Kuvend nëpërmjet Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.

Dhe, në këtë drejtim, Qeveria e ka marrë një vendim javën e kaluar për ta themeluar një komision mbikëqyrës, i cili përfshin të gjitha institucionet relevante prej Rregullatorit, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, e cila ka të bëjë me metrologjinë dhe bazhdarimin e orëve, Shoqatën e Konsumatorëve, Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorëve, KEK-un, të cilët janë në proces dhe nesër do të vijnë me një raport, të cilin do ta shohim se a ka pasur dhe cilat janë, dhe konform këtij raporti Qeveria do t’i ndërmarrë masat e duhura. Por, dua të ju them se nuk do të ishte e shëndetshme që këto aktivitete dhe këto deklarime të bëhen vetëm për arsye politike.

Unë i ftoj edhe një herë të gjithë qytetarët që kanë çfarëdolloj shqetësimi, të shkojnë dhe të argumentojnë dhe po ju garantoj që të gjitha gjërat do të trajtohen deri në minutën e fundit, deri në elementin e fundit ligjor për një proces të tillë.

Por, dua të them diçka më gjerë se kjo. Dua të ju them që subvencionimi është ulur në masë të madhe. Ne e kemi marrë subvencionimin me mbi 40 milionë euro për KEK-un dhe e kemi reduktuar në më pak se 10 milionë brenda këtij viti.

Ne e kemi marrë KEK-un, i cili ka pasur probleme të jashtëzakonshme me gjenerimin e energjisë elektrike, dhe kemi ardhur në masën kur gjeneron rrymë afro 100% dhe kapacitete të instaluar, të cilat nuk i ka pasur të themi në 20 vjetët e fundit dhe qytetarët e dinë këtë. E dinë se e kanë harruar zhurmën e gjeneratorëve në Kosovë, e dinë se kanë rrymë të mjaftueshme. E dinë se ka rrymë po u përgjigjet edhe standardeve të tyre. Dhe, strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës është që të ofrojë siguri të energjisë, energji të përbalueshme dhe energji e cila i respekton standardet mjedisore në Republikën e Kosovës.

Dhe dua të ju bëj me dije se në asnjë moment, asnjë vendim, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, nuk është në shërbim të asnjë lloji subvencionimi për distribucionin. Të gjitha këto janë tendenca për manipulime momentale politike, të cilat sigurisht janë të natyrshme në kontestin, edhe të funksionimit të Parlamentit.

Por, edhe një herë të jua sqaroj se çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike nuk i kontrollojnë Qeveria. Tarifat dhe blloqet tarifore, për të cilat po flitet me aq pompozitet në përditshmëri, rregullohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Kjo Zyrë e Rregullatorit të Energjisë i përgjigjet Kuvendit.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Nëse dëshironi ta kontrolloni çmimin e energjisë, komunikoni me Zyrën e Rregullatorit, sepse ajo ju përgjigjet juve, jo Qeverisë. Dhe, nuk mund të thoni që Qeveria po lejon, apo nuk po lejon. Çmimet e energjisë, përkatësisht tarifat e energjisë rregullohen nga Zyra e Rregullatorit, e Rregullatori rregullohet nga ju. Prandaj, çdo kërkesë që vjen për shtrenjtim të energjisë do të ishte mirë ta ftoni Rregullatorin dhe të merreni me të, e t'ia ndaloni nëse dëshiron që ta rrisë çmimin e energjisë. Pra, çmimi i energjisë elektrike në Kosovë nuk rregullohet nga Parlamenti, as nga Qeveria, as nga KEK-u, as nga Distribucioni, por rregullohet nga Rregullatori. Është tarifë e rregulluar, të cilën, ju deputetë të nderuar, e keni në duart tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Krasniqi!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Pasi jem në prag të 5-vjetorit të pavarësisë, nuk dëshiroj që ta prish këtë ambient festiv me komentimet e opinioneve të partive të ndryshme që u paraqitën këtu sa u përket çështjeve të ndryshme, por si do që të jetë ndiej obligim moral, qytetar, kushtetues, ligjor

dhe kombëtar që para qytetarëve të Republikës së Kosovës, para Kabinetit qeveritar dhe juve që t'i sqaroj disa gjëra, sidomos sa i përket procesit të liberalizimit të vizave.

E them me përgjegjësi të plotë edhe qytetare, edhe kushtetuese, edhe ligjore, edhe politike, edhe kombëtare, se shteti i Kosovës është në një nuancë shumë më të lartë të implementimit të kriterëve për liberalizimin e vizave se sa shumë vende tjera të rajonit.

Kam theksuar se problemi nuk qëndron në Prishtinë dhe se Kosova e ka merituar liberalizimin e vizave, jo për 15 muaj nga fushata e kaluar, por para dy vjetësh i ka implementuar kriteret demokratike.

Ju e dini se në kohën e Jugosllavisë, shqiptarët janë trajtuar si qytetarë të kategorisë së dytë. Për fat të keq, në Bruksel ka ende burokratë që i trajtojnë shqiptarët me nostalgjinë e Jugosllavisë apo të Titos, apo të Serbisë. Nga ai prizëm! Kjo është e vërtetë dhe e them me përgjegjësi të plotë, si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Diçka të tillë, që po e bëj publike, që e kam thënë edhe në takimet e mbyllura me zyrtarët e Brukselit, edhe atje, edhe në Prishtinë, e disa prej juve jeni edhe dëshmitarë.

Prandaj, e them se justifikimet e Brukselit janë të paqëndrueshme dhe të pajustificueshme për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. E theksoj: problemi i liberalizimit të vizave nuk qëndron në Prishtinë, por te qëndrimi i padrejtë politik, te mosuniteti i tyre sa i përket statusit politik për Kosovën. Ky është realiteti.

Tash mund të sillen kriterë e kriterë shtesë për ta justifikuar mosgatishmërinë e tyre për vendim, por ne do t'i kryejmë ato obligime, madje në afat rekord dhe i falënderojmë.

Në anën tjetër, dëshiroj të theksoj se shqiptarët në rajon e kanë fituar të drejtën e liberalizimit të vizave nëpërmjet shteteve të ndryshme. Edhe kjo krejt e padrejtë. Nuk janë 15 muaj këtu, por është një shekull i tërë i padrejtësive, jo me fajin tonë gjithashtu, dhe ju e dini shumë mirë. Është një proces historik ky. Por, në anën tjetër, gjithashtu duhet mendohet se nëse vonohet e vazhdon të sillet kështu Brukseli, atëherë shqiptarëve nuk u mbetet tjetër alternativë, veçse të akomodohen në Bashkimin Evropian më së miri dhe më së lehti si një shtet i vetëm.

Dhe, Brukseli, më në fund, duhet të sillet sipas asaj çka bëjmë, e jo sipas asaj se kush jemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Domethënë i kemi kryer deklaratimet jashtë rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë plenare janë parashtruar 16 pyetje parlamentare. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputete, e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Ministër, pse nuk është paguar paga për muajin qershor 2012, sipas kontratës së lidhur ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe stafit akademik të angazhuar për vitin shkollor 2011/2012 dhe pagat për vitin akademik 2012/2013 për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

E nderuara deputete Kadrijaj,

Hartimi i kontratave ka të bëjë me bashkëpunëtorët e jashtëm të Universitetit të Prishtinës. Menaxhmenti e ka gjetur ende si proces të pafilluar çështjen e hartimit të kontratave. Në ndërkohë, menaxhmenti i ri është marrë me një analizë për ta zvogëluar stafin e angazhuar dhe me një përlllogaritje të serishme të orëve me të cilat janë angazhuar gjatë këtij procesi është identifikuar se në disa raste ka pasur të angazhuar më shumë staf sesa kanë qenë nevojat reale të fakulteteve. Për shembull, vetëm në Fakultetin e Edukimit këtë vit kemi po thuaj rreth 50% më pak staf të angazhuar.

I tërë ky proces ka marrë kohë të gjatë deri në hartimin e kontratave të reja, të gjitha ato janë nënshkruar deri në gjysmën e dhjetorit. Prandaj, ky është ai defekti për të cilin ju flisni dhe besoj që tani është më i rregulluar.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Ministër, janë në pyetje kontratat që janë lidhur. Domethënë, të gjithë këta punëtorë akademikë kanë pasur kontrata. Janë gjithsej 700 punëtorë akademikë që kanë pasur këto kontrata, por pagat nuk u janë paguar për vitin akademik 2011/2012 dhe për 2012/2013. Nëse këto kontrata nuk u janë paguar për një muaj, janë diku afërsisht 300 mijë euro. Çfarë është bërë me ato të holla, sepse punëtorët kanë pasur kontrata dhe në bazë të planifikimit është dashur t'i marrin pagat, me të cilat u është lidhur kontrata.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar,

Unë ju thashë se ku është defekti i atyre kontratave, për të cilat ju keni bërë pyetje konkrete, ndërsa për këto gjëra do të marr informacion mundësisht nga Universiteti dhe pastaj do të ju përgjigjem edhe më saktësisht. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete Time Kadrijaj, përsëri pyetje për ministrin Ramë Buja.

TIME KADRIJAJ: Ministër, pyetjen paraprake e kam bërë gati para tri javësh, apo një muaji. Keni pasur kohë të mjaftueshme për të marrë informata nga Universiteti ose Ministria, të cilën ju e udhëhiqni, që sot të përgjigjeni se ku kanë mbetur ato të holla, të cilat nuk i janë paguar stafit akademik.

Pyetja e radhës: Pse të gjithë këtyre punëtorëve akademikë, kontratat nuk u lidhen në muajin tetor, kur edhe fillon procesi mësimor, por lidhen me 4-5 muaj vonesë? Ku është defekti? Në Administratën e Ministrisë suaj, apo ku?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar,

Unë thashë se përgjigjja është dhënë konform pyetjes që keni bërë dhe unë gjithsesi do t'i sjell informacionet dhe do t'i përmbush kërkesat tuaja për përgjigjen.

Ndërsa për pyetjen e dytë, kontratat janë nënshkruar deri në gjysmën e dhjetorit, andaj për të filluar me pagesën e stafit të angazhuar në dhjetor ka qenë e pamundur. I gjithë stafi i angazhuar për punën e kryer është paguar me pagën e janarit, pra për 4 muajt e kaluar. Po është arsye tjetër pse nuk janë bërë pagesat më herët ka qenë edhe mungesa e mjeteve nga buxheti i vitit të kaluar për t'i realizuar këto pagesa, ashtu siç është dashur.

Edhe në të kaluarën, profesorët e angazhuar me kontrata 9-mujore janë paguar në fund të mbarimit të semestrit veror për punën e tyre që e kanë kryer paraprakisht. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Ministër, meqenëse këtë seancë e përcjellin edhe këta punëtorë akademikë, të cilëve nuk u janë paguar këto paga, a është ky premtim se të gjitha ato do t'u paguan në periudhën vijuese?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar, unë thashë që është vetëm një procedurë që është zgjatur për arsyet që i përmenda, përndryshe ato janë pagat e tyre dhe duhet t'u realizohen.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Gjatë Javës së Gjelbër Ndërkombëtare në Berlin të Gjermanisë, pjesëmarrës në mesin e 83 ministrave të tjerë të bujqësisë dhe ushqimit ishit edhe ju i nderuar ministër i Bujqësisë. Është ngjarje kjo e cila vlerësohet të jetë më e madhja në botë sa i përket promovimit të ushqimit.

Pyetja është kjo: Ushqimi dhe produktet kosovare u prezantuan në këtë panair të madh botëror, andaj cilat janë rezultatet e pjesëmarrjes nga kjo ngjarje dhe cilat produkte kosovare zgjuan interesimin më të madh nga vizitorët?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Faleminderit për pyetjen!

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është bashkorganizatore e mbi 30 panairove lokale, regjionale dhe gjithëkombëtare që ndërlidhen me promovimin e produkteve bujqësore në Kosovë. Mirëpo, për të qenë konkurrues edhe në tregjet më të mëdha, ne po bëjmë përpjekje që ta mobilizojmë dhe ta mbështetim komunitetin e agrobiznesit, si dhe t'i prezantojmë produktet kosovare edhe nëpër organizime promovuese botërore, siç ishte, pra në muajin që lamë pas, Java e Gjelbër në Gjermani, ku në hapjen e saj, po edhe në punimet e Samitit të Ministrave, ishin pjesëmarrës 84 ministra të bujqësisë dhe të ushqimit nga mbarë bota.

Pjesëmarrja në këtë ngjarje, e cila vlerësohet si më e madhja në botë sa i përket promovimit të bujqësisë dhe ushqimit, Kosovës kjo i është mundësuar edhe falë përkrahjes financiare dhe bashkëpunimit që kemi pasur me USAID-in, i cili ka financuar gjithçka që është ndërlidhur me krijimin e mundësive që ne të arrijmë t'i promovojmë produktet kosovare, traditën tonë, bukuritë natyrore dhe kulturën.

Gjithashtu, në kuadër të kësaj jave, nëpërmjet një restoranti kosovar, të cilin e kemi kontraktuar paraprakisht me produkte tona gjithnjë, vizitorëve u është shërbyer edhe ushqimi kosovar dhe, përpos ekspozimit të prodhimeve dhe prezantimit të traditës dhe kulturës sonë të pasur, kemi përgatitur edhe materiale informuese, video dhe audio-materiale, libër fotografish me bukuritë tona natyrore. Ndërkaq investitorëve potencialë dhe mysafirëve të dalluar të pavijonit u janë dhuruar edhe pako me këto prodhime, si dhe përpjekje për ta rritur publicitetin.

Për çka të kufizimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me standardet e ushqimit, ne në këtë panair jemi fokusuar kryesisht në prezantimin e produkteve, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, të cilat janë më konkurruese dhe kanë kapacitete më të mëdha eksportuese në shtete të ndryshme, si dhe produkteve të tjera ushqimore, që edhe ashtu eksportohen në Gjermani, po edhe në shtete tjera të Bashkimit Evropian.

Kosova e ka pasur njërën nga pavijonet më të mira dhe më të frekuentuara, i cili edhe në ditën e parë është vizituar nga ministrja gjermane e Bujqësisë dhe nga kryebashkiaku i Berlinit.

Po ashtu, ne kemi marrë pjesë edhe në Samitin e Ministrave, ku është diskutuar tema bosht për investimet e përgjegjshme në bujqësi.

Gjithashtu, nga ajo që pastaj kemi marrë, pra si informacione, pasi ka përfunduar ky panair nga kompanitë tona, të cilat i kanë prezantuar produktet atje, sidomos vertarët tanë kanë pasur mundësi që të lidhin marrëveshje kontraktuale me disa nga distributorët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë, deputete?

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime ishte se cilat produkte kanë zgjuar interesim më të madh, në mënyrë që Ministria juaj në të ardhmen ta bëjë një strategji për rritjen dhe kultivimin e atyre produkteve dhe t'u krijojë mundësi bujqve tanë për eksportimin e këtyre produkteve jashtë Kosovës.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Natyrisht që ne këtë e kemi ditur edhe më herët për arsye se po mundohemi që prodhimtarinë tonë ta orientojmë nga kërkesat e tregut dhe jo vetëm të tregut të brendshëm, por edhe kah tregjet regjionale dhe ai evropian. Produktet që e zgjojnë më së shumti kërshërinë edhe të partnerëve ndërkombëtarë, të cilët janë në lidhje me prodhuesit dhe përpunuesit tanë, por edhe të investitorët potencialë, janë ato të hortikulturës, sidomos pra disa kultura bujqësore nga pemëtaria dhe perimtaria, por gjithashtu ka interesim të madh edhe për industrinë agropërpunuese, si dhe për produktet e ndryshme, verërat tona, të cilat, si e thashë edhe në pjesën e parë të përgjigjes, që jo vetëm që kanë zgjuar kërshërinë, por edhe janë konkretizuar me marrëveshje të reja, të kontraktuara me partnerët gjermanë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Në territorin e Kosovës, gjatë muajve nëntor-dhjetor 2012, janë testuar 20 mijë krerë gjedhe për sëmundjen infektive, TBC. Pas leximit të rezultateve, vetëm 8 krerë gjedhe kanë rezultuar pozitive në këtë sëmundje.

Në të shumtën e rasteve, kjo sëmundje ka karakter kronik. Ajo prek të gjitha speciet e kafshëve shtëpiake, bile mund të kalojë edhe te njeriu.

Prandaj, pyetja është kjo: Drejtoria për Shëndet dhe Mirëqenie të Kafshëve, në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë, a ka aplikuar masa mbrojtëse ndaj kësaj sëmundjeje dhe ndaj kafshëve të tjera si masë për parandalimin e saj?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit!

Faleminderit e nderuar deputete!

Të nderuar deputetë,

Edhe pse Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinës nuk funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, meqë çështja që keni ngritur ju është me interes të veçantë edhe për ne, nëpërmjet grupeve të ndryshme punuese dhe bashkëpunimit që kemi ne përpiqemi ta përcjellim nga afër edhe aplikimin e masave

mbrojtëse ndaj sëmundjeve të bagëtisë. Njëra ndër to, e përfshirë në programin vjetor kombëtar të kësaj agjencie, është ajo për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive dhe zoonotike të bagëtia, pra është e tuberkulozi të lopët qumështore.

Implementimi i masave mbrojtëse të lopët qumështore realizohet në mënyrë aktive në çdo vit, kurse gjedhet që rezultojnë të prekura nga kjo sëmundje asgjësohen, ndërsa fermerit i realizohet kompensimi material për gjedhet e eliminuara.

Përgjithësimi i kontrollit në mënyrë aktive të llojet e tjera të bagëtisë dhe fokusimi të gjedhet apo lopët qumështore, sipas informacioneve që kam, bëhet sepse ndjeshmëria e gjedhit ndaj kësaj sëmundjeje është shumë më e lartë dhe se numri gjedheve është shumë i lartë në krahasim me kafshët tjera shtëpiake.

Gjithashtu, përdorimi dhe konsumimi i produkteve dhe nënprodukteve me origjinë nga gjedhi është më i madh dhe po ashtu është marrë parasysh edhe shfrytëzimi për një kohë më të gjatë i gjedhit në prodhimtari, krahasuar me speciet tjera të kafshëve shtëpiake.

Mirëpo, të gjitha rastet e prekura me tuberkulozë, që raportohen nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, zyrtarët i trajtojnë dhe i marrin masat e menjëhershme për gjurmimin e kësaj sëmundjeje të të gjitha kafshët e pranishme në fermën e prekur nga kjo sëmundje. Pra, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, duke iu referuar rasteve të raportuara gjatë viteve dhe ekspertizave të ndryshme, vlerëson se përhapja e tuberkulozit nga kafshët tjera, përpos gjedhit, është shumë e ulët dhe për këtë nuk ushtron kontroll në mënyrë aktive të të gjitha kafshët sikur të gjedhi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Komuna ose regjioni i Dragashit e ka sektorin e blegtorisë më të zhvilluar. Prandaj, nëse keni informacione, si është gjendja në atë regjion?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Jo vetëm për regjionin e Dragashit, por besoj që përgjigjja vlen për të gjitha regjionet e vendit tonë. Unë e thashë dhe ajo ishte e përmbledhur në përgjigjen time, që të gjitha këto raste kanë të bëjnë me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, me të cilën ne kemi kontakte të vazhdueshme, edhe pse ata nuk i nënrendohen Ministrisë sonë. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputet, e ke fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

I nderuari zoti ministër,

Nga respekti që kam për ju si njeri dhe si ministër, kam kënaqësinë të jua parashtroj një pyetje. Nuk dua të bëhem pjesë e fushatës që është ngritur kundër jush, por unë i kam përgatitur dy pyetje.

Pyetja e parë: Në njërën nga seancat e kaluara, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, kam kërkuar veprime përkatëse për ta vlerësuar përmbajtjen e monografisë për Kosovën, e hartuar dhe e botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Meqenëse gjatë arsyetimit të këtij propozimi kam preferuar të rishikohen kapituj të veçantë, disa pjesë të kapitujve konkretë, që i kam nënvizuar atëherë, duke kërkuar që ekspertët e MASHT-it, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të debatojmë për arsyeshmërinë e propozimeve tona.

Pyetja: Pas propozimit tim, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, çfarë keni ndërmarrë dhe si ka funksionuar bashkëpunimi i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar deputet Krasniqi,

Të nderuar deputetë të tjerë të pranishëm në sallë,

Kolegë ministra,

I nderuar zoti kryetar,

Raportet tona me Akademinë e Shkencave janë shumë korrekte dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës është institucion më i lartë i shkencës dhe i arteve në Kosovë, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

Këshilli Kombëtar i Shkencës, në kuadër të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, që është në emërim e sipër, besoj në procedurë, po ashtu nga Kuvendi i Kosovës, është përgjegjës për botimet e asaj natyre, për të cilat ju flitni.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka qenë e konsultuar dhe as nuk është implikuar fare në këtë botim. Edhe ne, si gjithë lexuesit, tek pas daljes nga shtypi e kemi marrë në duar dhe e kemi konsultuar për aq sa kemi pasur mundësi dhe tanimë e dimë përmbajtjen dhe lëshimet e shumta shkencore që janë bërë në të. Por, me këtë çështje duhet të merret ai që e ka themeluar Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, pyetje shtesë?

HALIT KRASNIQI: Atëherë, kur e kam shtruar këtë çështje kemi pasur mirëkuptim që Ministria e Arsimit ta angazhojë një komision të specializuar dhe të përgatitur, gjithsesi edhe kompetent, për ta vlerësuar këtë botim. Nëse kjo çështje tani i adresohet Kuvendit, i

mbetet Kuvendit që ne bashkërisht ta trajtojmë në një seancë tjetër, kur do të përgatitemi dhe do të flasim konkretisht për përmbajtjen e kësaj monografie. Ministri ishte shumë korrekt. Faleminderit!

KRYETARI: E ke edhe një pyetje për ministrin Ramë Buja? Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Shumë i nderuar ministër,

Të lutem shumë për mirëkuptim!

Për arsye të veçanta dhe të përgjithshme, që i nënkuptojmë bashkërisht ne të dy, por ishte një pyetje që e kam formuluar kaherë dhe e kam administruar gjatë, para se të fillojë ndonjë fushatë ndaj juve personalisht dhe Ministrisë suaj.

Jo, nuk dua të keqkuptohem. Te ju e di që nuk keqkuptohemi, por te opinioni, te miqtë tanë, te shokët tanë dhe te të gjithë ata që na kanë votuar bashkërisht.

Në njërën nga seancat e kaluara kam ngrehur shqetësime për përmbajtjen e librave të historisë, në të gjitha nivelet e shkollimit. Nëse ka nevojë, do t'i sjell të gjithë librat me nënvizime për pjesë të caktuara, të cilat do të duhej të ndryshohen patjetër dhe gjithsesi, ndërsa këta libra të hiqen nga përdorimi dhe të ndalohet shitja e tyre nëpër librari.

Këtë shqetësim e kam ilustruar, duke sjellë në njërën nga seancat e këtij Parlamenti tri libra me fakte të pakontestueshme, me autorë joshqiptarë, të cilët do të duhej ta 'thimthonin' ndërgjegjen tonë dhe ta nxitnin kureshtjen e historianëve tanë, e sidomos të autorëve të librave shkollorë për lëndën e historisë.

I nderuar ministër, duke menduar se po shpreh edhe shqetësimet tuaja, të mësimdhënësve të lëndës së historisë dhe të gjithë prindërve të nxënësve, më imponohet pyetja: A keni ndërmarrë ndonjë veprim konkret për këto shqetësime, që janë ngrehur në opinionin tonë, por edhe në këtë Parlament?

KRYETARI: Ministër, shprehi edhe shqetësimet e Halitit...!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuari deputet Krasniqi,

Miratimi i Kornizës së Kurrikulës së re dhe kornizave bërthamë për tri nivelet, 1, 2 dhe 3, do të rezultojë me një proces shumë të rëndësishëm, që është procesi i rishikimit të botimit të teksteve të reja shkollore, jo vetëm të atyre të historisë.

Tekstet e reja do të hartohen në bazë të standardeve për hartimin e teksteve shkollore, që tanimë është bërë si botim i veçantë dhe është plasuar në opinion, si dhe rezultatet, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit gjatë mësimin në nivele të lëndëve të caktuara.

Këto tekste do t'i ndërtojnë te nxënësit qëndrimet, njohjet dhe konceptet, për t'i arritur kompetencat e parapara me Kornizën e Kurrikulës, sepse ajo është kornizë e kompetencave.

Këto kompetenca kanë për qëllim përgatitjen e nxënësve si qytetarë të përgjegjshëm, individë të shëndoshë, mendimtarë kreativë dhe kritikë. MASHT-i gjithashtu është në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë për përafrimin e kurrikulave të të dy shteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Ke pyetje shtesë?

HALIT KRASNIQI: Duke bërë një konkludim të kësaj që dëgjuam, do të lë të nënkuptohet edhe pyetja shtesë. Kur isha në Burgun e Goli-Otokut, m'i ndaluan librat në gjuhën shqipe, të cilat i kisha me vete nga Burgu i Pejës. Dhe, as nuk mi lëshuan librat që më vonë m'i dërgoi familja. Nga ky rast mora shkak të hyja në grevë urie, me një justifikim se, përveç bukës dhe ujit, ushqim shpirtëror për ne ishte edhe libri.

Në këtë kohë, kurrë nuk do të mund ta merrja me mend që unë do të kërkoja nga fëmijët e mi të mos mësojnë nga librat në gjuhën shqipe dhe të botuar nga shqiptarët, dhe atë për historinë tonë!

KRYETARI: Vazhdojmë. Ky ishte koment, nuk ishte pyetje shtesë. Deputetja Vjosa Osmani ka bërë dy pyetje, një për ministrin Agim Çeku. Deputete, e ke fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Zoti ministër,

Meqenëse jemi të vetëdijshëm që Qeveria momentalisht është duke e rishikuar sektorin strategjik të sigurisë dhe përkritazi me të edhe misionin e ri të FSK-së, është esenciale që Ministria e FSK-së të bashkëpunojë me Ministrinë e Punëve të Jashtme për të iniciuar traktate dypalëshe të mbrojtjes dhe sigurisë me shtetet e rajonit, të paktën. Traktate të tilla, qoftë sekrete apo të hapura për publikun, janë pjesë përbërëse e politikës së jashtme dhe asaj të sigurisë së një shteti.

Ratifikimi i traktateve të tilla, jo vetëm që e thellon partneritetin strategjik me një shtet të caktuar, por po ashtu mund t'i parandalojë pretendimet territoriale të shteteve tjera ndaj territorit të Republikës së Kosovës. Së paku këtë efekt e kanë në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Pyetja: A i keni propozuar Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhjen e traktateve bilaterale të mbrojtjes dhe sigurisë me ndonjë shtet konkret dhe a ka të arritura në këtë drejtim?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuari zoti kryetar,

Ministra, të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Osmani, faleminderit për pyetjen!

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është një ndër prioritetet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në këtë drejtim, ne kemi iniciuar dhe kemi arritur disa marrëveshje të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, gjithsej njëmbëdhjetë. Këto janë: marrëveshja për partneritetin shtetëror me Gardën Kombëtare të AIO-s, domethënë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mandej marrëveshje bashkëpunimi me Gjermaninë, me Britaninë e Madhe, me Holandën, Letoninë, Lituaninë, nga vendet evropiane, dhe marrëveshje për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Kroacinë, Turqinë. Janë në përfundim e sipër marrëveshjet me Italinë, Slloveninë dhe Hungarinë.

Të gjitha këto marrëveshje e kanë për natyrë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes në rrafshin e trajnimit, edukimit, shkëmbimit të përvojave, vizitat e ndërsjella dhe aktivitetet e ndryshme bilaterale. Dhe, e kanë për qëllim krijimin dhe thellimin e partneriteteve strategjike me vendet e caktuara.

Të gjitha këto marrëveshje janë lidhur në bazë të ligjit për marrëveshje ndërkombëtare, domethënë janë iniciuar nga Ministria për Forcën e Sigurisë dhe janë trajtuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, edhe e jona, edhe e shtetit përkatës, dhe pas marrjes së pëlqimit dhe autorizimit për t'u nënshkruar nga ministri, janë nënshkruar.

Republika e Kosovës gjithashtu ka lidhur marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të njohur si marrëveshja SOFA, Status of Force Agreement, domethënë për statusin e forcave të tyre në Kosovë.

Tani është në procedurë edhe marrëveshja për statusin e forcave me Shqipërinë. E kemi iniciuar si ministri, është marrë leja nga Ministria e Punëve të Jashtme, është proceduar në Qeveri dhe pritet të silltet edhe këtu në Parlament.

Sa u përket marrëveshjeve, të cilave ju u referoheni, për traktate për mbrojtje të vendit tonë, për dy arsye nuk kemi iniciuar marrëveshje të tilla.

E para është ngase ne e kemi këtu NATO-n, që nëpërmjet KFOR-it e ka detyrë, obligim, e mision që ta mbrojë Kosovën, apo të mos lejojë hyrjen e personave dhe të njëjstëve të uniformuara e të armatosura në Kosovë.

E dyta, siç thatë edhe ju, jemi duke e rishikuar tërë sektorin e sigurisë së Kosovës. Paralelisht me këtë rishikim në këtë proces është duke u projektuar edhe strategjia e sigurisë kombëtare dhe në këtë strategji do të përcaktohen edhe politikat e mbrojtjes dhe të sigurisë së Republikës së Kosovës. Kështu që ne e kemi NATO-n në Kosovë, ne kemi aspiratë të integrimi në NATO dhe artikulli 5, apo neni 5 i Traktatit Veriatlantik do të ofrojë dhe do të garantojë siguri edhe për Kosovën, por në radhë të parë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, pyetje shtesë?

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër,

Unë jam shumë e vetëdijshme për obligimin që e kanë shtetet anëtare të NATO-s sipas nenit 5, sipas të cilit sulmi ndaj një shteti anëtar konsiderohet si sulm ndaj të gjithëve.

Megjithatë, ka shumë shtete anëtare po të NATO-s, të cilat kanë traktate për partneritet strategjik në fushën e strategjisë dhe mbrojtjes, në aspektin bilateral. Dhe, kjo nënkupton që shtetet konkrete, me të cilat kemi marrëveshje bilaterale, ndërmarrin obligime që të të ndihmojnë në rast se ke probleme me shtetet tjera që kanë pretendime territoriale.

Unë e kuptoj që përderisa KFOR-i është në Kosovë, kjo çështje mund të konsiderohet e ndjeshme, megjithatë negocimi i traktateve të tilla, ka raste që njihen në marrëdhënie ndërkombëtare, që ka marrë vite të tëra.

Pra, pyetja shtesë: A e keni konsideruar që së paku me Shqipërinë të filloni negocimin e një traktati të tillë, sepse para një kohe ministri i Jashtëm i Shqipërisë ishte në vizitë në Kosovë dhe u...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI AGIM ÇEKU: Është e vërtetë që ka marrëveshje e traktate të tilla në botë. Kryesisht, nuk ka marrëveshje ndërmjet dy vendeve anëtare të NATO-s dhe këto marrëveshje kryesisht janë sekrete dhe janë të njohura sikur “bilateral ekzekutiv agreement”, apo marrëveshje ekzekutive të tilla.

Ne, jemi duke e nënshkruar me Shqipërinë SOFA-n, që do të thotë statusi i forcave të Republikës së Shqipërisë në Kosovë. Por, nuk e kemi iniciuar, sepse arsyet janë të tilla. Jemi duke i definuar politikat e mbrojtjes së sigurisë në këtë proces, e kemi NATO-n këtu dhe kemi aspiratë shumë të qartë që të anëtarësohemi në NATO. Por, mbetet që të diskutohet edhe kjo me ministrin e Punëve të Jashtme, apo në kuadër të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Vjosë Osmani, pyetje për ministrin Ferid Agani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse Asambleja Botërore e Shëndetësisë, si organi më i lartë i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, do ta mbajë takimin e 66-të të rregullt vjetor në maj të vitit 2013 dhe duke u nisur nga fati se ky është organi suprem vendimmarrës, i cili vendos me shumicë votash, në këtë rast 98, për anëtarësimin e një shteti të ri në këtë organizatë, pritet nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe ajo e jashtme të bëjnë koordinimin dhe lobimin e duhur për anëtarësim në këtë organizatë.

Koordinimi është veçanërisht i rëndësishëm me MPJ-në, Presidencën dhe Kabinetin e Kryeministrit dhe kontaktet janë të nevojshme me shtetet njohëse dhe ato jonjohëse, për

të kërkuar mbështetje për anëtarësim. Mungesa e një koordinimi të tillë e dëmton mundësinë që Kosova të aplikojë për anëtarësim në muajin prill, sepse, siç specifikohet në statutin e OBSH-së, kërkesa për të hyrë në rend dite duhet të dërgohet së paku 30 ditë para mbajtjes së Asamblesë Botërore të Shëndetësisë.

Pyetja: A e ka bërë Ministria e Shëndetësisë koordinimin e nevojshëm për anëtarësim në OBSH dhe a është kjo kohë e mjaftueshme për ta përgatitur tërë këtë proces? A është formuar ndonjë komision ndërministror ose ndërinstitutional, i cili do të merrej specifikisht me anëtarësimin në OBSH, e nëse po - cilat institucione janë të përfshira aty?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E nderuara zonja deputete,

Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Shëndetësisë ka qenë prioritet i lartë i angazhimeve të Ministrisë së Shëndetësisë në rrafshin ndërkombëtar në dy vjetët e fundit, së paku.

Vendimi që të mos aplikohet deri më tani ka qenë rezultat i analizave të përbashkëta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Aktualisht është formuar dhe funksionon Komisioni Ndërministror ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, që i koordinon punët me Kabinetin e Kryeministrit dhe Presidencën, në funksion të lobimit të duhur direkt dhe indirekt për anëtarësim në Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Ky lobim është realizuar edhe gjatë vitit 2011 dhe gjatë vitit 2012. Në këtë drejtim, unë kam pasur edhe vizitë zyrtare në selinë e Organizatës Botërore, në Kopenhagë, më 8 nëntor 2012.

Mendimi për aplikim në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në maj të këtij viti do të jetë sërish rezultat i analizave gjithëpërfshirëse për gjasat reale të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, si organizatë e parë e Kombeve të Bashkuara, ku do të anëtarësohej shteti ynë.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit! Deputetja Kimete Bytyçi, pyetje për ministrin Ferid Agani.

KIMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari zoti ministër,

Gjatë vizitës që i është bërë Spitalit të Prizrenit, përkatësisht Repartit të Gjinekologjisë, gjendja e nënave dhe fëmijëve është shumë e vështirë, meqë mungojnë hapësirat adekuate, të parapara me standardet ndërkombëtare.

Gjithashtu, jemi informuar se Reparti i Gjinekologjisë me kohë ka bërë kërkesë për zgjerimin e objektit.

E pyes ministrin e Shëndetësisë: A ka ndarë mjete financiare për zgjerimin e hapësirave të këtij objekti? Nëse po, atëherë kur do të fillojnë punimet?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara zonja deputete,

Është fakt se ky projekt i Spitalit në Prizren është dorëzuar në Ministrinë e Shëndetësisë për financim si investim kapital disa vjet me radhë.

Duke i parë mundësitë e kufizuara buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë, sidomos mundësinë e gjetjes së donatorit për realizimin e këtij projekti, Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet projektit mbështetës dhe Qeverisë së Luksemburgut, ka gjetur zgjidhje të përkohshme duke krijuar kushte për ndërtimin e objektit të ri të Neonatologjisë, si aneks i ndërtesës së Emergjencës. Kjo ka mundur që të ndahet ky repart nga hapësira e përbashkët, ku ka qenë përpara.

Me këtë ndërtim janë krijuar kushte optimale për foshnjat e porsalindura që kanë nevojë për trajtim dhe për përkujdesje intensive, e në anën tjetër janë përmirësuar kushtet për nënat, që kanë lindur me intervenime cezariene, pasi që në hapësirën e Neonatologjisë së vjetër është vendosur dhoma e përkujdesjes intensive për këtë qëllim.

Megjithatë, si prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë ngel ndërtimi i objektit të ri për Departamentin e Nënave dhe Fëmijëve. Ky prioritet vazhdon të ekzistojë. Jemi të përkushtuar që ta realizojmë sa më parë.

Të ju njoftoj se Spitali i Prizrenit për investime kapitale në vitin 2013 ka pasur 600 mijë euro, ndërsa në vitet 2014 dhe në vitin 2015 do të ketë nga 650 mijë euro. Kështu, këto do të jenë mjete me të cilat do të mund të fillohen aktivitetet në këtë drejtim.

KRAETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

KIMETE BYTYÇI: Zoti ministër,

Aneksi është ndërtuar prej një organizate të huaj dhe shërben vetëm për foshnja të porsalindura. Si është e mundur, zoti ministër, të dilni para opinionit dhe të jepni shumë fjalë miradije, ndërsa ju e veproni të kundërtën? Si është e mundur në këtë shekull të trajtohen nga dy lehona në një shtrat, sidomos në sezonin e verës ndodh që edhe nga tri lehona të jenë të vendosura në një shtrat?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete,

Unë thashë se ky objekt, si dhe shumë objekte tjera në spitalet tjera në rajone dhe shumë institucione tjera në nivele të ndryshme, filluar nga kujdesi parësor e deri te ai tretësor, paraqet dhe vazhdon të paraqesë prioritet të Ministrisë së Shëndetësisë.

Por, mundësitë e kufizuara buxhetore për realizimin e këtyre projekteve janë pengesë e vetme. Ne jemi duke punuar në krijimin e resurseve të nevojshme njerëzore për ofrimin e shërbimeve cilësore. Edhe në departamente të tilla shëndeti i nënës dhe fëmijës paraqet prioritet të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Për këtë, ne edhe e kemi paraparë që shërbimi i parë kombëtar, si pjesë e reformës të sistemit shëndetësor, të projektuar me Ligjin e ri të shëndetësisë, të jetë shërbimi kombëtar i Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë. Dhe, unë mendoj që në të ardhmen do të kemi gjithnjë e më shumë resurse në dispozicion.

Për momentin, Ministria e Shëndetësisë duhet të veprojë brenda mundësive buxhetore që i ka në dispozicion.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin, në fakt pyetje për kryeministrin, por kryeministri nuk është këtu. Pyetjen tjetër e ke për ministrin Bajram Rexhepi. Bëje cilën të duash.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ndërsa kryeministri është duke e bërë bashkimin kombëtar aty në kafene, pas Parlamentit, unë gjithsesi po e bëj pyetjen.

Më 11 korrik 2008, në Konferencën e Donatorëve për Kosovën në Bruksel, Kosovës iu premtuan 1,2 miliard euro nga shtete të ndryshme. Vetëm Komisioni Evropian ka dhënë 500 milionë euro, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës 400 milionë dollarë. Pra, këto ishin premtimet.

Është e qartë se pjesa më e madhe e këtyre parave u premtuan të jepen për vitet 2008 dhe 2009, mirëpo premtimi ka qenë që ndihma të vazhdonte edhe gjatë viteve të tjera. Një zyrtar i Qeverisë, para dy vjetësh ka thënë se janë shpenzuar rreth 70% e mjeteve në projekte të ndryshme, mirëpo publiku di shumë pak për këto projekte, ose aspak.

Prandaj, pyetja ime për kryeministrin: Cila është sasia e parave që Qeveria e Kosovës ka marrë nga shuma e premtuar dhe në cilët sektorë janë investuar këto para? A ka Qeveria e Kosovës një pasqyrë të qartë financiare, në lidhje me donacionet e premtuara në Bruksel?

KRYETARI: Vazhdoje pyetjen tjetër për ministrin Rexhepi?

ALMA LAMA: Në fund të muajit janar, dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës janë suspenduar nga detyra në lidhje me rastin e arrestimit të nëntë truprojave të shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Aleksandër Vulin. Si rezultat i hetimeve të përbashkëta, të kryera nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe EULEX-i, lidhur me ngjarjen që ka ndodhur më 7 janar 2013, dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës janë

suspenduar deri në përfundim të hetimeve, është thënë në komunikatën e Policisë. Arsyetimi është që këta kanë përdorur dhunë.

Preteksti i këtij suspendimi pra është se policët dyshohen se kanë përdorur forcë fizike, derisa serbët e arrestuar po mbaheshin në qendrën e ndalimit.

Prandaj, pyetja ime për ministrin Rexhepi: Arrestimi i personave të dyshimtë, që mund ta cenojnë rendin është në mandatin e Policisë, ndërkohë që nuk kemi parë argumente të qëndrueshme deri tani se është përdorur dhunë ndaj truprojave të zyrtarit serb. Pyetja është: Cilat janë shkeljet konkrete që kanë bërë këta policë dhe çfarë garancie mund të na japë ministri se suspendimi nuk është një veprim me prapavijë politike?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Lama,

Lidhur me vizitën në fjalë, më 7 janar 2013, njësia policore ka bërë përcjelljen e veturës, në të cilën ka qenë zoti Vulin, i shoqëruar nga dy persona, të cilët po ashtu kanë pasur autorizim nga Qeveria e Kosovës, nga momenti i hyrjes së tij në territorin e Republikës së Kosovës në drejtim të Graçanicës.

Gjatë gjithë përcjelljes së eskortës së veturës, në të cilën kanë qenë zoti Vulin me dy persona në veturë, njësia policore ka vërejtur se dy vetura me disa persona brenda në veturë kanë lëvizur mbrapa eskortës në fjalë.

Nisur nga situata e krijuar, njësia policore e angazhuar në detyrë konkrete ka arritur t'i ndalojë dhe të bëjë identifikimin e tyre. Pas intervistave preliminare, të bëra nga zyrtarët policorë, njëri nga personat e ndaluar i dyshuar e ka pranuar se ata janë në përcjellje të eskortës së zotit Vulin.

Sipas procedurave të autorizuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, veprimtaria e tyre nuk ishte e lejuar, pasi autoriteti i vetëm në sigurim të lëvizjes së zotit Vulin ishte Policia e Kosovës.

Pas përfundimit të veprimeve operative hetimore dhe në konsultim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ndaj të gjithëve është ngritur rasti nën dyshimin e bazuar për mospërfilljen e urdhrave të ligjshëm nga Ligji për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe rasti është proceduar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Ndërkohë, pas ankesave të bëra se ndaj tyre është ushtruar dhunë, përkatësisht se janë tejkaluar autorizimet policore, është iniciuar procedura hetimore. Si rezultat i hetimeve të kryera, EULEX-i dhe Inspektorati Policor i Kosovës, lidhur me ngjarjen e ndodhur më 7

janar 2013, dy pjesëtarët e Policisë së Kosovës janë rekomanduar të suspendohen deri në fund të hetimeve.

Për më tepër, Prokuroria e rastit nga misioni i EULEX-it ka kërkuar suspendimin edhe të nëntë zyrtarëve tjerë policorë, me pretekstin për tejkalimin e autorizimeve policore.

Inspektorati Policor i Kosovës ka refuzuar ta rekomandojë një masë të tillë, nisur nga fakti se nuk ka në dispozicion ndonjë provë materiale për përfshirjen e ndonjë zyrtari tjetër policor, përveç deklaratave të personave të arrestuar, të cilët ishin në përcjellje të zotit Vulin, e të cilët janë bazë e mjaftueshme për të rekomanduar suspendimin e tyre.

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama, pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Po. Në fakt, këto informacione që i dha ministri ne i dimë. Pra, janë të suspenduar. Po, pyetja ishte: Pse janë të suspenduar? A ka argumente të qëndrueshme që është përdorur dhunë?

Po e bëj këtë pyetje, sepse e kemi pasur rastin më përpara që policët e Kosovës kanë përdorur dhunë, për shembull edhe kundër deputetëve të Kuvendit të Kosovës, por nuk kemi dëgjuar se ka pasur suspendime. Domethënë, bëhet fjalë për standarde të dyfishta.

Arsyeja tjetër, se pse e drejtoj këtë pyetje është ngase e kam zhvilluar një vizitë në Mitrovicë dhe kam takuar disa nga policët e Policisë së Kosovës. Dhe, ajo që mund të ju them është që veprimi juaj ose veprimi i Ministrisë apo Inspektoratit i ka dekurajuar shumë policë, të cilët punojnë në kushte shumë të vështira dhe kanë dëshirë të përballen me problemet që shkaktojnë serbët në veri. Mirëpo, mesazhi i cili është përcjellë nga ky suspendim është tepër negativ dhe dekurajues.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhepi e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë edhe një herë them se hetimet kryesisht i ka bërë EULEX-i, për arsye se ata nuk kanë dashur të bashkëpunojnë me hetuesit tanë të Inspektoratit Policor. Kanë kërkuar të suspendohen të gjithë, por pa argumente nuk mund të suspendohen. Sa i përket asaj, vullnetit dhe dëshirës, mund të ju garantoj se gjithherë do të jem në mbrojtje të Policisë së Kosovës, nëse nuk e keqpërdorin pozitën e vet. Ndërsa, bisedat individuale me anëtarë të Policisë, më tepër janë në sferën politike.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Breca, pyetje për ministrin Agani. Zonja Breca e keni fjalën. Nuk është.

Atëherë deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Agani.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuari ministër,

Në listën esenciale të barnave bën pjesë edhe insulina, një bar ky për pacientët që vuajnë nga diabeti e janë të varur nga ky bar. Gjatë muajve të fundit, në shumicën e këtyre insulinave, që janë shpërndarë dhe janë të destinuara për klinikat në Kosovë, kanë rezultuar që janë të destinuara për tregun e Serbisë dhe janë me banderola serbe. Opinioni i medieve thotë se këto barëra janë kontrabanduar nga operatorët, që janë kontraktuar lidhur me këto furnizime.

Pyetja ime konkrete është: Si ministër dhe si Ministri e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, a keni nxjerrë ndonjë raport rreth kësaj çështjeje dhe si e keni trajtuar ju këtë çështje për ta parandaluar përdorimin e këtyre barërave?

KRYESUESI: Zoti Agani e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuara zonja deputete,

Bëhet fjalë për importin e 2 mijë njësive të produktit medicinal të insulinës “insuman” comb.25 solosta 100 njësi për ml., me numër serik 2/F-116/A, të destinuara për tregun serb dhe janë sjellë nga operatori ekonomik në Kosovë.

Sipas deklaratës së prodhuesit ndërkombëtar të kësaj insuline, gabimi qëndron në rrjetin shpërndarës ndërkombëtar të prodhuesit, pra nga depoja e tyre qendrore në Hungari, në mënyrë të gabueshme. Sipas deklaratës së tyre, në rrethana të një kërkesë emergjente, që ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë, është bërë paketimi i produktit medicinal, i cili ka qenë i dedikuar për tregun serb dhe është futur në dërgesat për tregun e Kosovës.

Hapat e parë që janë ndërmarrë kanë qenë tërheqja nga qarkullimi i produktit dhe sigurimi që produktet që janë përdorur nuk e kanë rrezikuar shëndetin publik të popullatës. Për këtë qëllim është kërkuar dhe është siguruar nga prodhuesi i ashtuquajtur “Data Loger”-i, pra instrumenti i cili shënon kushtet e ruajtjes dhe transportimit të produktit medicinal dhe deklarata, që këto produkte janë prodhuar konform standardeve ndërkombëtare.

Në ndërkohë, Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale dhe Njësia e Krimeve Ekonomike, ku është paraqitur rasti, është duke e hetuar importin e këtyre produkteve dhe do të ndërmerren të gjitha masat e duhura, përfshirë ato ndëshkimore. Menjëherë sot do të sqarohet se ku dhe kush e ka bërë këtë gabim. Për momentin, po rianalizohet rruga e importit dhe është duke u bërë analiza kualitative e produktit, pavarësisht deklaratave të operatorit ekonomik dhe prodhuesit ndërkombëtar.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Musliu?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit shumë zotëri ministër për sqarimet që i dhatë lidhur me identifikimin e këtyre insulinave, sepse, përveç shkeljeve ligjore, që janë bërë, ose rregulloreve të Ministrisë së Shëndetësisë, kjo ka rezultuar edhe me shqetësimin e shumë pacientëve, të cilët i kanë përdorur këto insulina gjatë një periudhe të caktuar para se të identifikohen që janë të dedikuara për shtetin serb.

Prandaj, ju falënderoj që opinionit ia ofruat një sqarim dhe që këto insulina nuk kanë asnjë ndërhyrje, ose thjesht janë insulina standard të tregut evropian dhe kërkesave të pacientëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Bakalli, pyetje për ministrin Agani.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Kardiokirurgjia në institucionet publike të Kosovës ende nuk ka arritur të jetësohet, ani pse përpjekjet për këtë kanë filluar që moti.

Premtimi nga Ministria e Shëndetësisë se ky projekt madhor për shëndetësinë kosovare do të realizohej me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, nuk u përmbush. Datën e fillimit të kardiokirurgjisë publike e spostuat për muajin shkurt, duke e ndërlidhur kështu me 5-vjetorin e pavarësisë së Kosovës.

Rëndësia e kardiokirurgjisë qëndron jo vetëm në faktin se si shtet i pavarur duhet të ofrojmë sa më shumë shërbime shëndetësore, e në mesin e tyre edhe shërbimet kardiokirurgjike, por edhe për një fakt tjetër - se shumë të sëmurë tanë kanë nevojë për këto ndërhyrje.

Këtë mund ta verifikoni lehtë, zoti ministër, vetëm nëse i analizoni listat e pacientëve, të cilët kërkojnë përkrahje financiare nga ministria juaj për t'i kryer këto ndërhyrje, qoftë jashtë vendit, qoftë në një institucion privat këtu në vend.

Pyetja ime për ju, ministër Agani: A do të fillojë së funksionuari Kardiokirurgjia në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nga shkurti i këtij viti dhe cilat janë sfidat e ministrisë, që e drejtoni ju, në këtë drejtim?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuara zonja deputete,

Kur thatë që moti ka filluar projekti i Kardiokirurgjisë, unë e di këtë mirë. Kanë qenë vitet e '80-ta, kur profesorët tanë kanë shkuar në specializime e subspecializime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur kemi qenë gati për të filluar shërbimet e Kardiokirurgjisë dhe këtu mund të shihet edhe se çka ka përjetuar shëndetësia kosovare në 20 vjetët e fundit. Në atë kohë janë bërë përgatitjet për Kardiokirurgji në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, por dihet mirë mandej se ç'ndodhi deri në vitin '99. E në periudhën pas vitit 2000 ka pasur ngecje të rënda.

Sa i përket kësaj, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është arritur që të krijohet hapësira adekuate teknike me një investim prej 700 mijë eurove të Ministrisë së Shëndetësisë. Mirëpo, pastaj, me vite të tëra, më shumë se katër vjet nuk ka arritur që të funksionalizohet ai shërbim.

Unë kam bërë përpjekje të jashtëzakonshme, së bashku me ministrinë, që ta funksionalizojmë këtë projekt madhor të shëndetësisë kosovare. Fillimisht, e kam themeluar bordin për zhvillimin dhe themelimin e shërbimit kardiokirurgjik, qysh në vitin 2011. E kemi themeluar shërbimin kardiokirurgjik me statut të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. E kemi organizuar këtë shërbim, i kemi zbatuar procedurat e rekrutimit të stafit dhe unë sot me kënaqësi them se stafi profesional i shërbimit kardiokirurgjik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës do të përbëhet nga 3 kardiokirurgë, 6 kardio-anesteziologë, 2 për patensionistë dhe staf të mesëm me përvojë ndërkombëtare. I gjithë ky staf kosovar, pra të gjithë ekspertë të Kosovës, të cilët punojnë momentalisht në sektorin privat, por kanë shprehur vullnet dhe dëshirë që të jenë të angazhuar edhe në sistemin publik për momentin.

E kemi funksionalizuar donacionin e Qeverisë italiane për themelimin dhe funksionalizimin e shërbimit të Kardiokirurgjisë në vlerë prej 1,8 milion euro, si pjesë e donacionit prej 3 milionë euro, donacionit të përgjithshëm për shëndetësinë kosovare. Prej këtyre 1,2 milion euro janë në konton e Ministrisë së Shëndetësisë.

Po ashtu, është zhvilluar aktivitetet për sigurimin e projektit për financimin e hibrid-sallës operative, nëpërmjet projektit të financuar nga Qeveria e Austrisë, projektit të huas së ashtuquajtur “huas e butë”, në vlerë prej 4,6 milionë euro, që është afër fillimit të realizimit, duke qenë se marrëveshja ndërshtetërore është ratifikuar në Kuvend të Kosovës.

Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet, që shërbimi kardiokirurgjik të fillojë. Është siguruar materiali harxhues dhe barnat e nevojshme në vlerë prej 150 mijë euro dhe pajisjet e domosdoshme për fillim të punës. Gjatë muajit mars planifikojmë tenderin me mjete të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Deputete, ke pyetje shtesë?

AURORA BAKALLI: Zoti ministër,

Ju nuk arritët të përgjigjeni në pyetjen time se a do të fillojë së funksionalizuari Kardiokirurgjia me rastin e 5-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Nëse po, e shpresoj se po, dhe uroj që të vazhdojë së jetuari, të mos jetë vetëm një simbolikë për hir të 5-vjetorit, sepse qëndrueshmëria e këtij sektori është e nevojshme, mbi të gjitha, për pacientët tanë.

Në këtë drejtim, më intereson sa procedura brenda një muaji mendoni të kryhen në Kardiokirurgjinë e re kosovare. Faleminderit!

KRYEUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zonja deputete!

Atë isha duke e thënë praktikisht. Do të thotë, janë bërë të gjitha përgatitjet që shërbimi kardiokirurgjik ta fillojë funksionimin gjatë muajit shkurt. Ne jemi në fazën e fundit të kompletimit të stafit dhe të materialit të domosdoshëm, të pajisjeve të domosdoshme.

Ideja është që javën që vjen, pra javën e parë pas festës së 5-vjetorit të pavarësisë së shtetit, t'i kemi intervenimet e para kardiokirurgjike në vend.

Nuk jemi të përkushtuar për veprime simbolike. Po të ishte ashtu, do të kishim hyrë në rreziqe me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së shtetit shqiptar. Jemi të përkushtuar për një fillim serioz dhe një fillim të qëndrueshëm, sepse është me rëndësi që ky shërbim të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë sistematike.

Planet janë që fillimisht në muajt e parë, derisa nuk kompletohet komplet shërbimi me ato mjete që i përmendët - donacioni i Qeverisë italiane, të ketë nga një intervenim gjatë javës, e pastaj ky numër të rritet, varësisht prej kapaciteteve profesionale, që do të vërtetohen.

Të them edhe se i gjithë ky projekt realizohet nën mbështetjen sistematike dhe të vazhdueshme të kolegëve kirurgë nga Republika e Italisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një pyetje e keni zonja Aurora.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues! Faleminderit, ministër!

Shpresoj që shumë shpejt të rritet ai numër në më shumë se një, sepse as për së afërmi nuk do t'i përmbushë kërkesat e pacientëve tanë.

Ndërsa, pyetja që kam tani ka të bëjë me Kardiologjinë Invazive, e cila tash e pesë vjet funksionon në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, edhe pse kohë pas kohe me ndërprerje disamujore, kryesisht si pasojë e mosfunksionimit të aparaturës.

Sidoqoftë, Kardiologjia Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, aktualisht në masën më të madhe është në nivelin diagnostik, ndërkohë që fare pak arrin ta përmbushë nivelin terapeutik.

Rreth 5 vjet të ekzistencës së kësaj fushe ishte dashur të shënonin përparim dhe rritje në këtë sektor, mirëpo tash për tash aty kryhen kryesisht vetëm koronarografite, me shumë pak stentime apo ndërhyrje.

Cilat janë, sipas jush, arsyet e kësaj ngecjeje dhe pse nuk po furnizohet Kardiologjia Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me material të mjaftueshëm për stentim koronar, pasi arsyetimet e shpeshta të profesionistëve janë se aty ka mungesë të materialit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, urdhëroni.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuara zonja deputete,

Temë e ndërlidhur me atë që e thashë më parë, me shërbimin kardiokirurgjik. Keni plotësisht të drejtë në konstatimin se këtu ka pasur vështirësi të theksuara. Unë jam duke e bërë një analizë të prokurimit të barnave dhe materialit harxhues gjatë vitit 2012. Dhe, analiza e parë po tregon se dobësitë qëndrojnë në të dyja anët e spektrit, si në Ministrinë e

Shëndetësisë, në procedurat e planifikimit të buxhetit të nevojshëm për procedura të ndryshme dhe për barna dhe për material harxhues, por po ashtu edhe në anën e institucioneve shëndetësore që bëjnë planifikime joadekuate, planifikime joprecize, planifikime të cilat rezultojnë me një diskoordinim të plotë ndërmjet zyrës së Departamentit të Farmacisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Prokurimit dhe institucioneve shëndetësore, që i porositin këto barna dhe këtë material harxhues.

Jemi duke i nxjerrë politikat e reja në këtë aspekt. Jemi duke punuar drejtpërdrejt me drejtorin e Qendrës Klinike Universitare dhe me ushtruesin e detyrës së drejtorit të Klinikës së Kardiologjisë që gjendjen përfundimisht ta kthejmë në gjendje të normales.

Sot, sipas informatave që kam, hapet tenderi në vlerë të përafërt prej rreth 200 mijë euro për blerjen e stentave dhe materialit përcjellës të nevojshëm për zbatimin e procedurave të Kardiologjisë Invazive dhe jam i bindur që me fillimin e përdorimit të këtyre produkteve medicinale do ta themelojmë një shërbim të ri funksional, i cili më nuk do të ketë ndërprerje në punën e tij dhe do të ketë mbështetje të fuqishme edhe nga shërbimi kardiokirurgjik, i cili tash po fillon në QKUK. Dhe, në këtë mënyrë do ta kompletojmë tërë spektrin e shërbimeve të nevojshme, që njerëzve t'u dalim në ndihmë, madje edhe në gjendje të infarktit akut të miokardit.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

ARURORA BAKALLI: Një koment më shumë. Ky është një lajm i mirë, sepse furnizimi me stenta dhe kryerja e procedurave në QKUK do t'i kursente, jo vetëm pacientët, por edhe ministrinë tuaj, e cila në masë shumë të madhe shpenzon para për kryerjen e këtyre procedurave në institucionet private. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka pyetje tjera. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 21, 24, 25 e 30 janar 2013 dhe më 11 shkurt 2013

Të pranishëm janë 65 deputetë. A ka dikush vërejtje? Nuk ka. Konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 21, 24, 25 e 30 janar 2013 dhe asaj më 11 shkurt 2013.

Zoti Beqiri, jeni lajmëruar për diçka? Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni kryesues!

Meqenëse po futemi në rend të ditës, unë vetëm më lejo ta them qëndrimin e Grupit tonë Parlamentar rreth rendit të ditës.

Për pikën e 14-të, qëndrimi ynë mbetet po ai që ka qenë, sepse nuk ka asnjë ndryshim nga kërkesa që ka qenë më herët. Ne nuk pranojmë, do të thotë nuk do të bëhemi pjesë e votimit, sepse nuk i pranojmë kandidatët e tillë, e kemi thënë disa herë, që janë politikë

dhe kur të vijë kjo në rend, meqë është futur në rend të ditës, ne e kuptojmë këtë, ne si grup parlamentar nuk do të marrim pjesë në votim, përkatësisht nuk do të jemi në sallë. Këtë sa për informimin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizmin

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj zotin Stavileci që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Më lejoni që para jush, përmbledhurazi ta paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për turizmin.

Arsyeshmëria për këtë projektligj është përmirësimi i infrastrukturës ligjore, që do të mundësonte krijimin e një ambienti më të favorshëm për funksionimin dhe zhvillimin e veprimeve turistike, në përputhshmëri me standardet bashkëkohore turistike.

Me këtë ligj rregullohen parimet për zhvillimin e turizmit, promovimin e tij, vendosjen dhe zhvillimin e standardeve të shërbimeve turistike, sistemin vlerësues, sistemin vullnetar të regjistrimit, si dhe krijimin e një kornize institucionale për zhvillimin e turizmit.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është të krijohen lehtësira për subjekte turistike, për arsye se me këtë projektligj hiqen licencat dhe të gjitha barrierat administrative. Veprimtaria e tyre turistike u njohet me regjistrimin e biznesit në Agjencinë për Regjistrimin e Biznesit të Kosovës.

Me këtë projektligj parashihet mbrojtja e plotë e konsumatorit në raport me agjencitë turistike, që parashihet në pakon turistike, programin dhe kontratën e udhëtimit të saj dhe ky projektligj përmban dispozita, të cilat janë në harmoni të plotë me direktivën e BE-së numër 90/314, për paketën e udhëtimit, paketën e pushimeve dhe atë turistike.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare dhe ajo e pajtueshmërisë nga ministritë përkatëse, si dhe është i harmonizuar me acquis communautaire të BE-së.

Në projektligj është paraparë të themelohet Këshilli i Turizmit të Kosovës, si organ këshillues për strukturën përkatëse të turizmit dhe për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Projektligji parasheh themelimin e sistemit vlerësues të akomodimeve dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të bashkëpunojë me Këshillin e Turizmit të Kosovës për ta zhvilluar një sistem vlerësimi për akomodimet në bazë të standardeve objektive të matshme në përputhje me një sistem vlerësimi ndërkombëtar, që është në dispozicion për të regjistruarit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë dhe me qëllim që nëpërmjet tij të mundësohet krijimi i një ambienti më të favorshëm për funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarive turistike dhe duke pasur parasysh që ai është draftuar në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, ju propozojmë që projektligji të miratohet në këtë seancë plenare nga ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 15 janar 2013 e ka shqyrtuar në parim dhe ka vlerësuar se Projektligji për turizmin i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, zonja Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kryeministër!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Projektligjin për turizmin.

Vlen të theksohet se deri më tani kjo fushë është mbuluar me ligjin që ka qenë në fuqi, Ligjin për turizëm dhe shërbime turistike. Mirëpo, ndryshimi i këtij ligji ka për qëllim rregullimin e kësaj fushe, duke e përafruar atë me legjislacionin e BE-së.

Nëpërmjet këtij projektligji bëhet lehtësimi për subjektet turistike për arsye se hiqen licencat dhe veprimtaria e tyre njihet me regjistrimin e biznesit, ashtu siç e ceku edhe ministri në ekspozën e tij.

Nëpërmjet këtij projektligji po ashtu bëhet mbrojtja e konsumatorit, e cila parashihet në paketën turistike. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për turizmin, kjo fushë do të rregullohet

sipas praktikave më të avancuara për turizmin, si dhe është i harmonizuar me ligjet tjera në fuqi dhe i përshtatur sipas rrethanave të Kosovës.

Ne si grup parlamentar e mbështetim në parim dhe i ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta mbështetin, kurse kontributin tonë do ta japim në fazën e amendamentimit në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

I nderuar kryeministër,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për turizmin me numër 04/L-176.

Projektligji për turizmin është i cilësisë shumë më të ulët se ligjet tjera, që i kemi pasur e që ndërlidhen me këtë çështje. Ai lëngon nga mungesa e definimit dhe e përkufizimit, si të domethënies, ashtu edhe të përgjegjësiave e kompetencave të secilit subjekt, që përfshihet në lëmin e turizmit.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka vërejtur se ky ligj në fakt nuk ka për qëllim valorizimin e vlerave turistike që i ka Kosova, por vetëm ndërtimin e raporteve ndërmjet organizatorëve, përkatësisht ndërmjetësuesve, përfaqësuesve të tyre, në njërën anë, dhe të konsumatorit, në anën tjetër.

Ndërkaq, në memorandumun shpjegues te opsioni i rekomandimeve thuhet: “Projektligji mundëson krijimin e një ambienti më të favorshëm për funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarive turistike”. Ndërkaq, këtu në asnjë vend nuk vërehet se si do të krijohet ky ambient i favorshëm, apo ndoshta hartuesi i këtij dokumenti e llogarit si ambient të favorshëm heqjen e licencave dhe faktin se shumëçka duhet të bëhet në mënyrë vullnetare.

Grupi Parlamentar i LDK-së më poshtë do t’i paraqesë disa vërejtje konkrete te përkufizimet.

Sipas pikës 1.19, fjala “turist” nënkupton vizitorin e udhëtimit, që përfshin një qëndrim gjatë natës. Ky përkufizim duhet të ndryshojë, meqenëse nuk është e qartë se ku duhet të qëndrojë ai gjatë natës dhe për sa kohë, ashtu që ai të cilësohet si turist. A mund të jetë turist ai që gjatë natës qëndron për 20 minuta? Ky është vetëm si një shembull.

Propozoj që të përkufizohet si vizitor, i cili qëndron në një ndalesë me destinacion turistik, së paku për një natë, apo të jetë një konsumator i shërbimeve turistike.

Në pikën 1.15, restorantin e përkufizon: “Objekt i cili ofron shërbimet e furnizimit me ushqim, ku qëllimi kryesor është shitja e ushqimit për konsum, jashtë ose brenda lokalit’”.

Restoranti nuk mund të quhet vetëm restorant për ushqim, por duhet t'i ketë edhe shërbimet tjera, siç janë pijet.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka shumë vërejtje edhe në nenet tjera, por ne do t'i shpalojmë dhe t'i bëjmë vërejtjet në komisionet punuese, ku do të jemi pjesëmarrës, dhe i ftoj deputetët që ta votojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

Jemi duke diskutuar Ligjin për turizmin.

Ky projektligj, siç e dini, është zhvendosur një herë nga një seancë e mëparshme me arsyetimin se ministria përkatëse, pra ajo për Tregti dhe Industri, nuk ka qenë këtu dhe nuk ka mundur të marrë pjesë në prezantimin e këtij ligji. Dhe, tash e kemi situatën e njëjtë, kur po e diskutojmë ligjin pa ministren.

Pra, mendoj që të gjithë tashmë e kanë kuptuar se sa e papërgjegjshme dhe joserioze është kjo Qeveri. Nuk ka nevojë të na e konfirmojnë në secilën seancë këtë papërgjegjësi të tyre.

Po vazhdoj për ligjin. Njëri ndër faktorët që ka ndikuar në ngecjen e zhvillimit të turizmit në Kosovë, në zhvillimin e pakontrolluar dhe stihik të tij, gjithsesi është mungesa e legjislacionit modern turistik. Pra, asnjë veprimtari ekonomike nuk mund të zhvillohet, sikur as subjektet e saj nuk mund të afarojnë me sukses, në qoftë se nuk e kanë kornizën institucionale, pra ligjet që e rregullojnë këtë çështje.

Mbi 5 mijë biznese nga lëmi i hotelerisë dhe disa qindra agjenci të udhëtarëve sot afarojnë nëpër Kosovë pa rregullativë përkatëse ligjore.

Legjislacioni turistik, si një përmbledhje ligjesh, aktesh nënligjore, kodesh dhe standardesh, që do ta rregullonin materien e veprimtarisë turistike dhe hoteliere akoma është shumë i mangët, për të mos thënë inekzistues.

Me plotësimin dhe rumbullakimin e kuadrit ligjor turistik do të sigurohet ndërtimi i një administrate publike të përgjegjshme në këtë lëmi, pastaj forcimi i institucioneve turistike dhe përmirësimi i kulturës qeverisëse.

Efikasiteti i administratës qendrore dhe lokale në fushën e turizmit, eliminimi i konflikteve të bartësve të funksioneve qendrore komunale, luftimi i korrupsionit dhe ndërlidhja e tij me krimin ekonomik, pastaj eliminimi i evazionit fiskal, pengimi i aktivitetit biznesor jolegal dhe zvogëlimi i ekonomisë joformale.

Rezultatet e vërtetimit tonë kanë nxjerrë në pah shumë mangësi të legjislacionit ekzistues, që e rregullon materien e turizmit dhe hotelerisë. Kuadri ligjor ekzistues është joadekuat me ekonominë e tregut dhe me iniciativën e lirë private.

Disa ligje dhe akte nënligjore duhet të nxirren, ndërkaq ekzistuesit duhet të përmirësohen. Me përmirësimin e kuadrit ligjor nënkuptojmë thjeshtësimin, reformimin dhe modernizimin e legjislacionit ekzistues.

Boshllëku ligjor, dobësia institucionale dhe niveli i ulët i zbatimit të ligjeve nxitin natyrisht lindjen dhe shtrirjen e gjerë të korrupsionit dhe krimit ekonomik. Prandaj, është urgjente që të sigurohen të gjitha resurset e nevojshme për hartimin e kornizës rregullative për këtë veprimtari ekonomike.

Një tjetër e metë, do të thosha një e metë e madhe, që e ka ky projektligj për turizmin, që na është servuar sot për t'u votuar është se ai nuk ka kurrfarë strukture sistematike, ngase lënda e ligjit nuk është e ndarë në kapituj sipas materies që rregullohet me ligj, për ndryshim nga ligji në fuqi, i vitit 2004.

Dispozitat ligjore janë sistemuar në projektligj sikur të ishin nxjerrë nga ndonjë kuti, pa kurrfarë lidhshmërie ndërmjet vetes.

Te neni 4, për shembull, projektligji i përcakton disa parime, ndër të cilat janë investimet në fushën e turizmit, ruajtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e ambientit, ndërsa në tekstin e projektligjit, prej 23 neneve, sa i përmban ky projektligj, me asnjë fjalë, e lëre më nen, nuk përmenden investimet në turizëm, pastaj ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe mbrojtja e ambientit.

Ky nen do të kishte kuptim nëse formulohet dhe integrohet me dispozita ligjore në tekstin e ligjit, si vijon: “Rregullimi i marrëdhënieve në fushën e turizmit bazohet në parimet e planifikimit dhe realizimit të politikës të zhvillimit të turizmit, zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, në zhvillimin ekonomik nacional e lokal dhe mbrojtjen e resurseve natyrore dhe kulturore, zhvillimin integral të turizmit dhe veprimtarive përcjellëse, si dhe faktorëve të zhvillimit të përgjithshëm ekonomikë dhe shoqërorë, ruajtjen e efikasitetit dhe përgjegjësisë në fushën e shfrytëzimit, administrimit, mbrojtjes dhe avancimit, përparimit të hapësirave turistike, sigurimin e standardeve unike për ushtrimin e shërbimeve në turizëm e tjera.

Te neni 5 i projektligjit, i cili flet për detyrat dhe përgjegjësitë e njësive përkatëse organizative për turizëm, duhet të përfshihet, ngase kjo çështje rregullohet me akt intern për organizimin e brendshëm të ministrisë dhe nuk ka pse të gjendet në projektligj.

Pastaj, me një organizim eventual të ri të Qeverisë, punët e turizmit mund t'i përkasin ndonjë ministrie tjetër, e jo Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Me ndryshimet, që eventualisht mund të ndodhin në Qeveri, punët e turizmit mund të jenë në kuadër të themi Ministrisë së Ekonomisë apo të Kulturës, ose Mbrojtjes së Ambientit e tjera. Andaj, zakonisht praktikohet të thuhet: organi kompetent i administratës shtetërore për punët e turizmit.

Po ashtu, Drejtoria për Turizëm dhe Hoteleri, e cila ka ekzistuar mbi 10 vjet, deri para disa muajsh, do të thosha, e cila ka pasur të punësuar, e ka pasur faqen e saj në internet, e

kështu me radhë, tani po shuhet. Dhe, askund nuk tregohet pse. Si mund të shuhet një departament për turizëm dhe pastaj të krijohet një njësi tjetër, e cila do t'i kishte disa prej këtyre kompetencave.

Me këtë projektligj, në nenet 9, 10, 11, 12 dhe 13, për herë të tretë parashihet të rregullohet materia e kategorizimit të objekteve hoteliere të akomodimit, hotelet, motelet, fshatrat turistike, pansionet e kështu me radhë. Kjo materie ka qenë e rregulluar detajisht me ligjin nr. 2004/16. Për veprimtarinë hoteliere dhe turistike të vitit 2004, me këtë ligj dhe me aktin nënligjor, udhëzimi administrativ numër 17/2010 për klasifikimin dhe kategorizimin e objekteve hoteliere, po ashtu kjo materie në mënyrë solide ka qenë e rregulluar.

Nuk shpjegohet këtu pse tentohet që për herë të tretë të rregullohet një çështje, që tashmë është e rregulluar. A është blerje e kohës për mospërbushjen e obligimeve të përcaktuara me ligjet që ishin në fuqi, apo mospërgjegjësi totale e kryerjes së punëve të përcaktuara me ligj.

Si do që të jetë, për shkak të mosfunksionalizimit dhe shkeljeve drastike të ligjeve në fuqi, Kosova është akoma vendi i vetëm në rajon, për të mos thënë në Evropë e botë, i cili ende nuk e ka asnjë objekt hotelier të akomodimit të kategorizuar.

Kosova nuk do të ketë objekte hoteliere të kategorizuara të akomodimit as në të ardhmen, ngase anëtarët e këshillit për licencim dhe kategorizim të objekteve hoteliere nuk i posedojnë njohuritë elementare profesionale për t'i kryer punët, që kanë të bëjnë me kategorizimin e objekteve hoteliere.

Çdo joprofesionalizëm dhe voluntarizëm në procesin e kategorizimit të objekteve hoteliere të akomodimit mund të jetë me pasoja të pariparueshme për perspektivën e turizmit të Kosovës, ndërsa turo-operatorët e huaj nuk do t'i pranojnë certifikatat kosovare për kategorizim. Dhe, kjo do të ishte propaganda më e dëmshme e mundshme për turizmin e Kosovës.

Dhe, ç'është akoma më zhgënjyese, me nenin 22 të Projektligjit për turizmin është paraparë shfuqizimi, pos të tjerash, edhe i udhëzimit administrativ numër 17/2010 për klasifikim dhe kategorizim. Ndërsa nxjerrja e po këtij akti nënligjor parashihet të bëhet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra te neni 21 i projektligjit. Në këtë mënyrë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë prej viti në vit, tash e dhjetë vjet po e shtyn afatin e kategorizimit të më shumë se 250 objekteve hoteliere të akomodimit. Se sa është e etshme Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në këtë rast për pushtet, për grumbullim të kompetencave në fushën e turizmit, e që nuk i përkasin flet insistimi i saj këmbëngulës për themelimin e këshillit për turizëm të Kosovës. Kjo është hera e tretë që kjo Ministri del me një propozim të tillë. Herën e parë ka qenë në vitin 2010 me rastin e shqyrtimi në Kuvendin e Kosovës të Ligjit për turizëm dhe shërbimet turistike. Herën e dytë ishte me rastin e shqyrtimit në këtë përbërje të Kuvendit, në vitin 2012. Në të dy rastet Kuvendi i Kosovës nuk e ka aprovuar propozimin për themelimin e Këshillit të Turizmit të Kosovës.

Themelimi i Këshillit të Turizmit të Kosovës, kështu i përcaktuar me nenin 20 të Projektligjit, ka për qëllim koncentrimin e të gjitha punëve dhe aktiviteteve në fushën e turizmit në Kosovë, në një ministri. Pra, në Ministrinë për Tregti dhe Industri, që përndryshe për nga natyra e punës dhe kompetencave u përkasin edhe organeve të tjera të administratës shtetërore, qofshin ato qendrore, komunale apo në nivel të destinacionit turistik, dhe sidomos të organizatave dhe shoqatave turistike që duhet të merren me përparimin e turizmit në Kosovë, të themeluara apo që duhet të themelohen në të ardhmen, çfarë i kanë edhe shtetet tjera me turizëm të zhvilluar, por edhe ato të rajonit për më shumë se 4-5 dekada, siç janë për shembull Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Shqipëria, i kanë këto organizata të themeluara tashmë.

Në asnjë shtet me turizëm të zhvilluar apo në shtetet që mëtojnë ta zhvillojnë turizmin, pra edhe në shtetet e rajonit, që i përmenda më lart, organi shtetëror kompetent për punët e turizmit nuk i kryen punët e Organizatës Kombëtare për Turizëm, shoqatave kombëtare, atyre lokale për përparimin e turizmit apo organizatave tjera joqeveritare të interesuara për avancimin e turizmit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore- turistike dhe të trashëgimisë kulturore.

Do të ishte shumë e arsyeshme që Ministria të hartonte, ndërsa Qeveria ta miratonte një program të organizimit të turizmit në Kosovë, me të cilin do të përcaktoheshin kompetencat e Qeverisë së Kosovës, në fushën e turizmit, kompetencat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe në mënyrë të veçantë fushë veprimtaria e Organizatës Turistike të Kosovës, shoqatave lokale, publike dhe shoqërore të interesit e tjera, çka edhe e ka pasur për detyrë ta bënte para 10 vjetëve se sa të merret me përvetësimin e kompetencave të organeve dhe organizatave turistike në Kosovë. Kosova, prapë po na del se është i vetmi vend në rajon, për të mos thënë në Evropë, që nuk ka një koncept, program të organizimit të turizmit në nivel qendror dhe atë lokal.

Dhe në fund, që është edhe më absurde, këtij projektligji i mungon një kaptinë e tërë që ka të bëjë me dispozitat ndëshkuese. Do të kishte qenë mirë që të na përgjigjet hartuesi dhe sponzorizuesi i këtij ligji, po të kishte qenë hartuesja këtu në këtë rast, që të na gjejë në botë një vend apo një ligj që rregullon materien e turizmit dhe hotelierisë e që në tekstin e tij nuk ka dispozita të veçanta ndëshkuese.

Teksti i ligjit në fuqi për turizmin dhe shërbimet turistike i cili me këtë projektligj po propozohet të shfuqizohet, i ka mbi 45 dispozita ligjore ndëshkuese.

Dhe, duke i pasur parasysh të gjitha këto vërejtje, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta votojë këtë ligj, për shkak se konsiderojmë që ky vetëm sa e bën edhe më të keqe gjendjen në turizëm se sa t’i ndihmojë avancimit të turizmit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Neziraj e ka fjalën në emër të AAK-së.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

Kryeministër dhe kolegë deputetë,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar këtë projektligj dhe besojmë se me ndryshimin e këtij projektligji nuk ka ndryshuar në esencë diçka më shumë, përkundrazi kanë ardhur edhe disa gabime tjera edhe në riformulim edhe në përmbajtje dhe shumëçka tjetër. Unë besoj se me ardhjen e ligjeve për ndryshim, duhet me të vërtetë të hiqen ato defektet që i ka pasur ligji dhe jo të vijë me defekte të reja.

Unë besoj që fusha e turizmit është një fushë që gjeneron edhe të ardhura, edhe punësim, prandaj duhet të rregullohet shumë më mirë se sa që është e rregulluar.

Unë do t'i përmend vetëm disa vërejtje të disa neneve në parim. Besoj se neni 1, është shumë i pakuptueshëm dhe duhet të riformulohet, mandej neni 3 paragrafi 1.3, unë veç po e lexoj: "Çdo veprimtari apo shërbim që ofrohet nga objekte të autorizuar në fushën e turizmit". Unë besoj që objekti nuk mund të bjerë kafe, në restorant, por duhet të thuhet subjekti. Dhe këso gabimesh ka në shumë nene. Mendoj se ministrja, që është mjaft profesionalisht e përgatitur, nuk bën të lëshojë këso gabime dhe po të ishte kështu do të kisha përmendur edhe shumë nene, por në mënyrë telegrafike do t'i përmend vetëm disa nene ku ka gabime të shumta dhe të tilla, siç janë: neni 3, neni 5, neni 7, neni 17, neni 18, neni 20 dhe shumëçka tjetër.

Pra, ne do ta përkrahim dhe votojmë në parim, por shpresojmë se Komisioni për Zhvillim Ekonomik do të ketë punë dhe së pari të merret me riformulim më të mirë të kësaj fushe, por edhe nëpër komisione tjera, që janë komisione kryesore, besoj se do të përmirësohet dhe ndihmojë në këtë fushë që të kemi rezultate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën kryetarja e Koalicionit Kosova e Re, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për turizëm dhe duke marrë parasysh se ky projektligj vjen për herë të dytë brenda këtij legjislacioni, mund të themi se projektligji i ka disa mangësi, por mund të përmirësohet brenda Komisionit Parlamentar dhe i jep mundësinë me infrastrukturë ligjore që të rregullohet, ndoshta jo në mënyrë definitive çështja e turizmit, mirëpo prapëseprapë të kemi një evidencë në çështjen e zhvillimit të turizmit për të cilën gjë i nevojitet Kosovës. Mirëpo, në aspektin total, Koalicioni për Kosovë të Re, të gjitha mundësitë e ndryshmeve teknike të cilat janë lëshuar në këtë projektligj do t'i draftojë brenda Komisionit Parlamentar dhe në tërësi Koalicioni për Kosovën e Re e përkrah projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga SLS, zonja Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine potpredsedniče!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je pažljivo razmotrila Nacrt zakona o turizmu. Takođe je grupa uočila određene propuste i nedostatke koje ima sam ovaj nacrt zakona. Samim učešćem u Komisiji i radnoj grupi daćemo konkretne predloge i primedbe koje imamo, a u načelu podržaćemo Nacrt zakona. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın Meclis başkanı!

Türizm Yasa Tasarısını grup olarak incelediğimizi ve Kosova ekonomisinin kalkınmasında ve türizm sektörü gelişiminde son derece önemli olduğunu görmekteyiz. Bu yasa tasarısı, türizm sektörünün bakanlığı ile işbirliği içerisinde bir düzene gireceği ve halkımızın türist sektöründen faydalanırk, herhangi bir şekilde madur duruma düşmemesi için gereken önlemlerin alındığını görüyoruz. Bakanlığın tüm öbjelerin kayıt altına alınması ve sunacakları hizmet kalitesinin control altına alınması Kosova türizm sektörü gelişiminde olanak yaratacaktır. Bununla yasa tasarısının birinci okunuşunu desteklemekteyiz ve gereken önerileri komisyona sunacağız. Sağolun

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fiks pas një viti, ne në Kuvendin e Kosovës, po diskutojmë sërish për Ligjin për turizmin dhe ky fakt tregon qartë se projektligjet apo plotësim-ndryshimet që po sillen këtu nga Qeveria, hartohen shpejt e shpejt, pa u analizuar sa duhet, prandaj edhe paraqitet nevoja e shpejtë për përmirësimi ne tyre.

Megjithatë, edhe ky projektligj si ai para tij, nuk lë përshtypjen e një ligji i cili trajton seriozisht strategjitë për zhvillimin e turizmit në Kosovë, ndërkohë që turizmi, padyshim se paraqet njërin ndër burimet kryesore potenciale të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Në përgjithësi, turizmi paraqet një ndër aspektet më të rëndësishme të ekonomisë në shtetet në zhvillim dhe kur vlerësohet ndikimi i turizmit në ekonomi, merren parasysh edhe turizmi vendor edhe ai ndërkombëtar. Turizmi siguron formën më stabile të fitimit për një shtet, madje më stabile se çdo ekonomi tjetër.

Edhe projektligji të cilin jemi duke e shqyrtuar tani shumë më tepër rregullon aspektin e shërbimeve turistike se sa që jep hapësirë për një bazë ligjore për krijimin e politikave të mirëfillta të zhvillimit të turizmit në Kosovë.

Nga ana tjetër në këtë projektligj në detaje përshkruhet paketa turistike dhe zë hapësirë të madhe në projektligj, ndërkohë që nga praktika e dimë se me këto paketa turistike edhe vendorët orientohen jashtë Kosovës për turizëm.

Ne si Lëvizje për Bashkim, propozojmë që me Ligjin për turizmin të parashihen forma konkrete që do të siguronin një bazë stabile buxhetore për investime në turizëm e posaçërisht në turizmin malor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kur flasim për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik duhet ta kemi të qartë se njëri ndër faktorët kryesor lehtësues dhe njëkohësisht edhe matës për këtë është zhvillimi i turizmit.

Që të ketë zhvillim të turizmit e kemi të domosdoshme që shteti të orientohet nga politikat mjedisore, nga planifikimi hapësinor, nga ruajtja e vlerave autoktone dhe nga koncepti i zhvillimit nga brenda.

Përderisa ruajtja e këtyre vlerave bëhet kusht për zhvillimin e turizmit, zhvillimi i turizmit njëherësh bëhet motiv për ruajtjen e këtyre vlerave. Pra, kemi një ndërlidhje të drejtpërdrejtë dhe të dyanshme të turizmit me zhvillimin e qëndrueshëm.

Politikat e orientuara nga zhvillimi i turizmit sjellin vetëdijësim tek qytetarët tanë në lidhje me mjedisin që i rrethon, i ndihmon ata të behën sa më të përgjegjshëm në shoqëri. Tërë fushatat vetëdijësuese që lidhen me mjedisin, me mirëmbajtjen e tij dhe natyrës në përgjithësi, me ruajtjen e trashëgimisë kulturore, me promovimin dhe ruajtjen e elementit autokton, realizohen më së miri nëpërmjet turizmit. Një monument kulture ruhet dhe mirëmbahet atëherë kur revitalizohet dhe nga ai burojnë të ardhura. Pra, qytetari me interes ë drejtpërdrejtë ekonomik bëhet shumë më i përgjegjshëm se sa thjesht nga një ligjërim për ruajtjen e monumentit si vlerë në vetvete. E njëjta gjë ndodh me mjedisin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij.

Në zonat e thella malore, ta zëmë në Bjeshkët e Rugovës, edhe ruajtja e natyrës, edhe e vlerave kulturore dhe krijimi i kushteve për qëndrimin e qytetarëve tanë në ato zona, lidhet me zhvillimin ekonomik, më që turizmi këtë e bën të qëndrueshëm. Natyrisht, mungesa e zhvillimit të qëndrueshëm, mungesa e zhvillimit të turizmit bën që qytetarët të shikojnë zhvillimin ekonomik nëpërmjet prerjes së pyjeve.

Deri tani, ideja për zhvillimin e kësaj fushe në vendin tonë mund të quhet se ka qenë dështim i plotë. Tentativat individuale dhe të pakoordinuara të investitorëve të mundshëm pa mbështetjen dhe organizimin e shtetit, kanë bërë që vetëm sa të degradohen edhe ato resurse turistike që kemi. Disa madje janë degraduar pothuaj në pa kthim për një kohë të gjatë, siç është rasti me Prevallën.

I tërë procesi i privatizimit pa kritere, i objekteve hoteliere, qoftë në zonat turistike, qoftë në ato urbane i ka dëmtuar madje edhe kushtet elementare për zhvillim të turizmit. Kosova, megjithatë kishte një bazë nga ku do të mund të fillohej, tani ajo është e degraduar dhe mbi të është bërë një mbindërtim i tërë i parregullsive, që i zë frymën këtij zhvillimi.

Kosovës, është e vërtetë që i mungon resursi të themi më tërheqës turistik që është resursi hidrografik, i mungon pra deti, por megjithatë, faktorët e tjerë natyror, elementi kulturor, historik, etnografik, e bëjnë atë tejet atraktiv në rajon.

Bjeshkët me skijimin dhe alpinizmin, monumentet e shumta, kultura autentike e të gjitha këto janë resurse të padiskutueshme. Ato duhet të shfrytëzohen, sepse përpos të ardhurave, të shfrytëzuarit edhe i mirëmban ato.

Rezultatet janë larg nga mundësitë që ofron vendi ynë. Mungesa e kuadrove dhe e dijes pikësëpari dhe i tërë procesit i menaxhimit për zgjidhjen e këtij problemi realisht mungon. Më këtë qasje e që e shohim edhe në këtë projektligj, Kosova rrezikon të mos bëjë as edhe një hap të duhur drejt këtij rristrukturimi dhe pozicionimi në tregun rajonal të turizmit.

Turizmi mbetet strategjik vetëm në deklarata, në fakt i mungon madje edhe një strategji e mirëfilltë dhe e definuar qartë. Po të kishim një të tillë nuk do të na përsëritej sërish projektligji i njëjtë.

Është e pamundur të presim vetëdijesim në lidhje me turizmin, kur mungon qasje serioze nga vetë institucionet. Niveli i dyshimtë i cilësisë së shërbimeve nuk ndodh vetvetiu. Nëse kemi mungesë të standardizimit dhe mungesë të aplikimit të normave ekologjike e që vijnë nga vetë institucionet, është e pamundur të pritët përmirësim i cilësisë vetvetiu.

Është e qartë se kërkesat e bëjnë më së miri përmirësimin , mirëpo niveli aktual kuantitativ i turistëve e bën të pamundur një gjë të tillë, prandaj kjo gjë duhet të iniciohet nga shteti e që lidhet me standardizimet. Kjo e tëra do të thotë që ballafaqim i institucioneve me problemin e që e bën këtë ballafaqim të domosdoshëm.

Për zhvillimin e turizmit në Kosovë është i domosdoshëm autenticiteti. Vlerat autentike në restaurimin , ndërtimin e identitetit e që është i dalluar e që e bën edhe më të thelluar dh ky fakt është pikërisht elementi kyç. Kjo zgjon asociimin e përparësisë në ofertën turistike që do të mund të jepte Kosova dhe kjo Kosovën e vendos në vetëdijen dhe agjendën e turistëve potencialë.

Është i domosdoshëm bashkëpunimi me Shqipërinë, e edhe vendet tjera në vendosjen e agjendave të përbashkëta turistike.

Turizmi ka nevojë për forcën e shtetit në vendosjen e rendit dhe ligjit, në rishqyrtimin e privatizimit të objekteve hoteliere, në rishqyrtim të shumë proceseve negative si degradimi i Prevallës, kjo e pengon përsëritjen e cila në këtë logjikë është shumë e mundshme të ndodhë edhe në vende tjera. Ka nevojë për forcën e shtetit në hartimin e planeve hapësinore në funksion të zhvillimit të turizmit e jo në funksion të pronave të stërshitura. Dhe ka nevojë për forcën e shtetit në funksion të përgatitjes së kuadrove profesionale në funksion të zhvillimit të turizmit.

Zhvillimi i turizmit njëjtë si zhvillimi ekonomik në përgjithësi lidhen me përgjegjësinë e institucionit shtetëror.

Duhet të kemi një organizatë që zhvillon turizmin, por kompetencat e saj nuk duhet lënë të përcaktohen me akte nënligjore, por të definuar në ligj pas diskutimeve të nevojshme.

Kjo organizatë nuk mund të jetë vetëm nën kompetencën e një Ministrie, pasi turizmi ka karakter ndërdisiplinar.

Roli kyç është ai i Qeverisë në përcaktimin e strategjisë dhe kjo duke i përfshirë në hartimin e kësaj strategjie të gjithë faktorët që ndërlidhën me zhvillimin e turizmit. Partneriteti ndërmjet faktorëve dhe nën udhëheqjen e qeverisë do të mund të prodhonte strategji të mirëfilltë e që sot i mungon turizmit.

Marrëdhënia e Qeverisë me organizatën e turizmit, si dhe ndërlidhja e autoriteteve komunale në këtë marrëdhënie e përcakton kushtin themelor për zhvillimin e turizmit.

Ta zëmë, pikërisht për mungesë të këtij koordinimi vjen, sërish pra edhe një herë, ky projektligj që nuk rregullon as 10 % të materies dhe për këtë nuk mund tash ta fajësojmë vetëm Ministrinë përkatëse, pasi ajo nuk mund as të ketë dijen e mjaftueshme dhe sigurisht që turizmin e shoh nga këndi më i ngushtë i saj, pra zgjidhja është në Qeveri.

Dhe, zgjidhja në fund është koordinimi i këtyre faktorëve dhe vullneti politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për turizëm përpos që duket të jetë një udhëzim administrativ, nuk lë të kuptohet në përshkrimin e tij se çka u nevojiten nga 200.000 euro për vit, që janë para të qytetarëve të varfër të Kosovës.

Ndoshta, këto para u duhen për regjistrimin vullnetar të subjekteve turistike apo për krijimin e Këshillit, neni 20, në dukje dhe në formalitet një bajat që rezulton të jetë nga mosatraktiviteti i politikave jokreative të udhëheqjes në Ministri.

Kemi parë që në vazhdimësi aty ku po ka dështime po themelohen këshilla.

Ky ligj nuk sjell asgjë të re përpos fjalëve të dhëna si definicione, si për shembull neni 15 - Çka është paketa turistike?

Ky ligj do të duhej të rregullonte çështje elementare të zhvillimit të turizmit dhe duhet të ketë objektiva të qarta për zhvillim ekonomik, e që në këtu të kemi diçka të tillë do të duhej të kemi politika të qarta zhvillimore, e që t'i kemi këto, dikush duhet t'i bëjë ato.

Në mungesë të njerëzve kompetentë kemi mungesë të politikave zhvillimore dhe si rezultat kemi ligj që me të vërtetë të shtyn të mendosh se pse e kanë marrë mundin ta sjellin në Kuvend.

Dhe krejt për fund, në të gjitha periudhat kohore dhe sidomos në periudhën e regjimit, qytetarët e Kosovës kanë pasur një ëndërr, që në momentin e parë, kur të bëhemi shtet, ne do të kemi mundësi të zhvillohemi ekonomikisht, pikërisht për shkak të pasurive të shumta natyrore që ka ky vend. Dhe në këto 12 vitet e fundit, në fakt, qeveritë jo kompetente e kanë mbytur këtë ëndërr të qytetarëve, e cila edhe sot, kur jemi pranë 5 vjetorit të festimit të Pavarësisë së Kosovës, në fakt po shihet që me këtë mënyrë të qeverisjes së vendit nuk do të bëhet asnjëherë realitet, dhe të gjitha ato pasuri natyrore, me të cilat jemi rritur dhe kemi shpresuar që do të futen në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie më të mirë të këtij vendi, në fakt po degradohen, po shkatërrohen dhe nuk po jep askush llogari për to. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë, a e dëshiron fjalën? Jo.

Atëherë, kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për turizmin. Në sallë janë 65 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 47 vota për, 11 vota kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për turizmin.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Stavileci, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

BLERAND STAVILECI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush ta paraqes Projektligjin për investimet e huaja.

Ligji numër 02/L-33 për investimet e huaja është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 21 nëntor 2005 dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare, numër 8, më 15 dhjetor 2006, mirëpo ky ligj nuk ka gjetur zbatueshmëri të plotë, prandaj edhe është paraqitur domosdoshmëria për ndryshimin e ligjit ekzistues.

Në ligjin numër 02/L-33 për investimet e huaja, UNMIK- u i ka prolonguar nenet e ligjit të kaluar që kanë të bëjnë me mbrojtje nga nacionalizimi dhe eksproprijimi dhe si rezultat

shumë investitorë janë frikësuar nga kjo pjesë dhe tash ndryshimet kryesore në projektligj janë bërë në këto nene.

Projektligji i ri rregullon në mënyrë eksplicite dhe më të qartë mbrojtjen nga nacionalizimi dhe eksproprijimi në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Ndryshimet e bëra në këtë projektligj janë bërë pas konsultimeve të shumta dhe të vazhdueshme në periudhën dyvjeçare dhe u janë përshtatur kërkesave të tyre vetëm e vetëm për ta bërë Kosovën vend më atraktiv për të tërhequr investime, duke mos tejkaluar kornizat ligjore të Bashkimit Evropian.

Me këto ndryshime Kosova, gjithashtu synon të renditet edhe më mirë në raportin e Bankës Botërore të bërit biznes ku vitin e kaluar jemi përmirësuar për 76 vende, duke bërë ndryshimin më të madh pozitiv.

Ligji i ri rregullon mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë në krahasim me ligjin aktual që rregullonte vetëm inkurajimin dhe nxitjen e investimeve të huaja.

Projektligji i ri i investimeve ofron trajtim të drejtë dhe të barabartë të investitorëve të huaj dhe të investimeve të tyre në Kosovë. Kosova, gjithashtu do t'u sigurojë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme.

Njëkohësisht, ky projektligj ofron garanci të nevojshme lidhur me mbrojtjen dhe mosdiskriminimin e investimeve të huaja.

Është me rëndësi që ky projektligj u ofron mbrojtje të plotë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, duke u ofruar siguri investitorëve se të drejtat e tyre, krahas legjislacionit vendor, do të mbrohen në përputhje me konventat ndërkombëtare në fushën e investimeve të huaja.

Projektligji rregullon promovimin e investimeve dhe për këtë arsye parasheh themelimin e Agjencisë për Zhvillimin dhe Promovimin e Sektorit Privat.

Agjencia është institucion në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe është përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e investimeve të huaja, mbështet zbatimin e politikave dhe programeve publike në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zhvillon politika lidhur me themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike.

Projektligji i ri në shumë nene parasheh riformulime të neneve në përputhje me zhvillimet e fundit legjislativë që kanë ndodhur në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj, në rrethana normale është dashur të propozohet si plotësim dhe ndryshim i ligjit ekzistues, për arsye se nuk i tejkalon 40% të ndryshimeve, por duke pasur parasysh se ligji aktual është i vjetër dhe në shumë raste i referohet edhe dispozitave të UNMIK-ut, është bërë ligj i ri dhe është harmonizuar me sistemin juridik të Kosovës dhe janë hequr dispozitat juridike të UNMIK-ut.

Projektligji është hartuar në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare, të marra edhe gjatë vizitave studimore dhe konsiderojmë se është në përputhshmëri me praktikën e mira ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin e BE-së.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë dhe me qëllim që t'u ofrohet mbrojtje investimeve të huaja dhe të krijohen kushte e lehtësira për tërheqjen e investimeve të huaja në Kosovë, duke pasur parasysh se ai është propozuar në përputhje me standardet e lartcekura, ju propozojmë që ta shqyrtoni e miratoni këtë projektligj në këtë seancë plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në radhë është kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur të datës 15 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për investimet e huaja dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së e ka fjalën zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Një diçka dihet dhe është shumë e rëndësishme se Kosova ka nevojë për investime të huaja mu si shkretia për ujë, kështu që ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, vlerësojmë se duhet ta miratojmë në parim këtë projektligj. I ftoj të gjithë kolegët deputetë ta mbështesin në parim dhe t'i hapet mundësi plotësimit dhe ndryshimit në mënyrën më të mirë të mundshme.

Është edhe arsyeja tjetër, siç e përmendi ministri në ekspozenë e vet. Ligji i cili momentalisht është në fuqi, është ligj i vitit 2005. Duhet të jemi të vetëdijshëm se nga 2005, e deri sot më 2013, Kosova ka ecur përpara prandaj është domosdoshmëri të ndryshohet dhe plotësohet edhe ky ligj.

Është e rëndësishme që nga ligjet tona të hiqen dispozitat e UNMIK-ut, ato dispozita të cilat e kanë ngulfatur zhvillimin ekonomik. Është shumë e rëndësishme që t'i tejkalojmë disa mëri dhe inate personale dhe të mendojmë pak më ndryshe e të japim secili kontributin e vet në ndërtimin e një infrastrukture më të mirë ligjore, përkatësisht kur jemi edhe te ky ligj.

Ky ligj rregullon mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë duke u ofruar investitorëve të huaj të drejta dhe garanci fundamentale dhe të ekzekutueshme që u japin siguri investitorëve të huaj dhe se investimet e tyre do të mbrohen dhe trajtohen në mënyrë të drejtë e në pajtim të plotë me sundimin e ligjit, standardeve, praktikave të pranura ndërkombëtare.

Vlen të përmendet edhe kjo po ashtu se ky projektligj është kthyer në fund të vitit të kaluar nga Kuvendi dhe i njëjti ka ardhur me të njëjtën përmbajtje dhe kjo le të mbetet në ndërgjegjen e sponsoruesit, përkatësisht ministres së Ministrisë së Tregtisë e Industrisë, unë mendoj që është dashur së paku të shtohet, të hiqet një presë një diçka për hir të respektimit të vetë vullnetit të deputetëve.

Por, sidoqoftë, po e përsëris prapë, ne si Grup Parlamentar do ta mbështetim në parim dhe do të punojmë maksimalisht gjatë fazës së amendamentimit të Komisionin Funksional. Pra, kërkoj nga ju kolegë deputetë që secili që ka vërejtje a sugjerime, le t'i drejtojë te Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, në mënyrë që bashkërisht ta bëjmë një ligj sa më të mirë, sepse është në të mirën e investimeve në Kosovë dhe në të mirën e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, e ka fjalën zonja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, faleminderit që paraqitët Ligjin për investime të huaja, që i takon domenit të zhvillimit ekonomik dhe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Mendojmë se Ligji për investimet e huaja është një ligj i domosdoshëm, sidomos për një vend çfarë është Kosova, e cila ballafaqohet me mungesën e madhe të zhvillimit ekonomik dhe këtë mund ta shohim në çdo raport ndërkombëtar i cili po vjen për Kosovën, përkundër asaj se ne e dimë, por edhe të tjerët po e shohin.

Ne patëm rast ta dëgjojmë kryeministrin, i cili në fillim foli për një konspiracion të Bashkimit Evropian kundër Kosovës, duke harruar t'i cekë përgjegjësitë e Kosovës dhe detyrat, të cilat Kosova nuk i ka kryer. Dhe, në këto raporte paraqitet edhe sundimi i ligjit dhe korrupsioni, i cili vazhdimisht po vazhdon të jetë në këto raporte dhe pikërisht kjo është ajo mbrojtja më e mirë e investimeve të huaja dhe inkurajim për investitorët e huaj të vijnë në Kosovë.

Gjithashtu edhe zhvillimi ekonomik nuk ka aq të bëjë me Bashkimin Evropian sa ka të bëjë me vullnetin dhe kapacitetet tona.

Sa i përket Ligjit për investimet e huaja, ky ligj për herë të parë erdhi në Kuvendin e Kosovës më 8 nëntor të vitit të kaluar, ku në shqyrtimin e parë është votuar kundër, sepse deputetët menduan që Kosova meriton një ligj më të mirë për investime të huaja, pasi të gjithë e dimë që kjo është një pikë shumë e rëndësishme, e cila po i mungon Kosovës.

Prandaj, si e tillë duhet të trajtohet me një seriozitet më të madh dhe me një përkushtim, por gjatë kësaj seance, me 8 nëntor janë dhënë edhe shumë rekomandime dhe kërkesa që Ministria ta plotësojë këtë ligj me rekomandimet e Kuvendit dhe ta sjellë përsëri në Kuvend.

Më 31 janar të këtij viti, ky ligj ishte përsëri në rend dite në shqyrtimin e parë, por u shty me kërkesën e ministres së Tregtisë dhe Industrisë e cila tha që nuk mund të shqyrtohet ky ligj pasi ajo nuk është këtu.

Prandaj, mendoj se ndoshta atëherë është dashur që t' u jepet juve, ministër i Bujqësisë, rastin që të bisedoni që të paraqitni këtë ligj dhe të mos vijë edhe një herë dhe të mos jetë e pranishme në Kuvend për ta paraqitur këtë ligj.

Ky ligj për investimet e huaja është kthyer në Kuvend me të njëjtat, ashtu si tha edhe kolegja ime e Komisionit, erdhi komplet i njëjtë, me pikë e presje, bile edhe me gabimet gramatikore të cilat i ka pasur në fillim, ato gabime të njëjta u përsëritën edhe në këtë ligj, pa asnjë ndryshim, pa asnjë rekomandim i cili doli më 8 nëntor nga ky Kuvend. Dhe me këtë qasje të Qeverisë, të Ministrisë apo të ministres dhe si të doni merreni, është një qasje komplet pa përgjegjësi, papërgjegjësi ndaj Kuvendit, pa respekt ndaj këtij Kuvendi, jo vetëm me pjesëmarrje, po edhe me ardhje të ligjit me të njëjtat gabime.

Prandaj, me këtë mungesë të respektit, ne nuk patëm ndonjë mundësi që të marrim pjesë në votimin e këtij ligji, përkundër dëshirës sonë që të kontribuojmë, Qeveria dhe Ministria nuk po na jep shansin që të votojmë për këtë ligj, prandaj ne jemi të detyruar, për shkak të këtij mosrespektimi, të votojmë kundër këtij ligji.

Shpresojmë se herëve tjera Qeveria do të ketë më tepër respekt ndaj këtij Kuvendi të cilit i përgjigjet dhe t'i respektojë rekomandimet të cilat vijnë prej këtij.

Grupi Parlamentar i LDK-së do të votojë kundër këtij ligji, sepse nuk na e dhënë mundësinë të votojmë për.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

U përmend disa herë këtu që ligjin që po e trajtojmë tash e kemi trajtuar vitin e kaluar dhe të njëjtin ia kemi kthyer Qeverisë. Pra, ky Kuvend ka votuar kundër këtij ligji për shkak

se nuk e ka parë që të jetë ligj as që i shërben çështjes për të cilën flet e aq më tepër që e dëmton, sipas mendimit tim, tej mase mundësinë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik për Kosovë. Dhe tash meqenëse po na kthehet ky ligj në të njëjtën formë dhe me të njëjtën përmbajtje, mendoj që kjo është një indikator se si e sheh Qeveria Kuvendin. Pra, Qeveria shpreson që ose disa deputetë do ta ndryshojnë mendjen karshi të njëjtës çështje, ose do të shtohet numri i atyre të cilët nuk kanë qenë kohën e votimit herën e kaluar, në mënyrë që të kalojë ligji.

Pra, shihet se nuk ka kurrfarë interesimi që të diskutojë për ta përmirësuar ligjin, por vetëm do ta shtyjë një lloj kryeneçësie në gabimet e saj dhe në këtë trajtim të padrejtë që po ia bën ekonomisë së Kosovës. Kjo flet shumë për këtë se sa është Qeveri e Kosovës dhe sa është, siç e përmendi edhe zonja Sahatqija, serioze karshi çështjeve me të cilat ballafaqohet Kosova.

Ligji për investimet e huaja, pra vetë titulli tregon që në njëfarë mënyre diçka nuk është në rregull këtu. Dhe duhet ta kemi parasysh që ky lloj ligji apo ky lloj terminologjie e ka një lloj historie të zhvillimit global. Pra, pse disa shtete kanë nxjerrë ligje për investime të huaja, e jo ta zëmë ligje për investime, tregon që ka qenë një lloj problemi në trajtimin e këtyre investimeve. Pra, ka qenë një problem kryesisht te ato shtete të cilat në hovin e vet të industrializimit kanë përdorur politika krejt tjera me ato që sot ia rekomandojnë pjesës tjetër të botës. Pra, janë politika, të cilat e kanë mbrojtur edhe investimin, edhe prodhimin e vendit dhe e kanë mbrojtur tregun e vendit në mënyrë që ekonomia e tyre të zhvillohet, të forcohet dhe pastaj për të kërkuar pra hapje të tregjeve tjera, në mënyrë që ky zhvillim ekonomik të mirëmbahet duke marrë edhe tregje tjera dhe mundësi tjera të investimeve, pra për ta investuar kapitalin e tyre, i cili në një moment të caktuar ka rezultuar të jetë i tepërt për mundësinë e absorbimit brenda vendit.

Dhe ky është pastaj historiku që e sjell Ligjin për investimet e huaja. Po flas për vendet ku kanë ligje të investimeve të huaja, po kjo natyrisht se i aplikohet edhe Kosovës. Pra, meqenëse Kosova është në një fazë të domosdosë së industrializimit dhe rritjes së prodhimit, dhe fuqizimit, forcimit të ekonomisë së vendit, atëherë ne po e ndjekim në rrugë e cila është e kundërt me atë që e kanë ndjekur vendet tjera edhe në momentin kur ato janë industrializuar dhe kur ato janë zhvilluar. Pra, po e ndjekim një rrugë të kundërt me atë që tashmë është dëshmuar e suksesshme për zhvillim ekonomik. Pra, po e ndjekim një rrugë qorre në të cilën nuk dimë se a do të ketë zhvillim ekonomik, për shkak se kemi dalë jashtë nga rruga e cila u ka sjell prosperitet ekonomik vendeve tjera. Kjo duhet të përmendet dhe veçanërisht duhet të përmendet me këtë rast, meqenëse po e diskutojmë Ligjin për investimet e huaja.

Një çështje e dytë, që shihet në këtë ligj të investimeve të huaja, është që përkundër disa frazave që thuhet se Kosova do t'u garantojë të drejta të barabarta, mundësi të barabarta investimeve të huaja e kështu me radhë me ato vendore, pastaj në krejt pjesën tjetër të ligjit, në fakt flitet vetëm për investime të huaja që e sheh se në fakt Kosova me këtë ligj obligohet t'u garantojë pozita privilegjuese investimeve të huaja. Pra, nuk flitet për investimet aktuale, për mundësinë e investimeve tjera vendore, por flitet përgjithësisht për investimet e huaja dhe nuk përmenden fare ata që tashmë kanë investuar. Pra, është

një lloj shprese që ndërtohet goxha të them ashtu edhe me një lloj doze të religjiozitetit në besim që për atë ndihmën që do të na vijë nga jashtë, duke e mohuar fare realitetin që e kemi brenda dhe mundësinë, potencialin e brendshëm për zhvillim ekonomik.

Dhe po e them që këtu se nuk ka në historinë e zhvillimit të ekonomive nëpër vende të ndryshme të botës, me përjashtim të ndonjë shteti që është më shumë përjashtim se sa rregull, ku vendi është zhvilluar si rrjedhojë e investimeve të huaja direkt. Investimet e huaja direkt vijnë një fazë të caktuar, janë të mirëseardhura dhe ato e ndihmojnë zhvillimin ekonomik, po në asnjë mënyrë nuk e nxisin zhvillimin ekonomik. Ndërkohë, që këtu në Kosovë po besohet disi sikur me magji që këto investime do të jenë ato që do ta shpëtojnë ekonominë e Kosovës dhe tash e sa kohë përpëlitemi dhe dëgjojmë për çdo ditë fraza të zyrtarëve të ndryshëm qeveritarë për investimet e huaja si ky shpëtim ‘mezianik’ nga jashtë, ndërkohë që asgjë nuk ndodh, për më tepër ato shkojnë duke rënë prej viti në vit dhe ekonomia e Kosovës përgjithësisht shkon duke u degraduar për shkak të këtij stagnimi që po na bën edhe më jo konkurrent me ekonomi tjera të vendit.

Dhe një çështje e tretë, që kisha dashur ta them këtu, është që për sa i përket ligjit, kur lexohen me vëmendje nene të caktuar të ligjit, shihet që në fakt Kosova po e vendos veten në një lloj nënshtrimi total ndaj investitorëve të huaj dhe ndaj investimit të huaj. Pra, institucionet e Kosovës me këtë ligj marrin obligime dhe në njëfarë mënyre e miratojnë, e themelojnë investimin e huaj si një lloj konstante e cila në asnjë mënyrë nuk duhet të ndryshojë, e pastaj çdo gjë tjetër është e ndryshueshme. Pra, çdo gjë tjetër është variabile - institucioni shtetëror, interesi publik, shteti në përgjithësi, qytetarët individualisht, të gjithë këta janë të ndryshueshëm dhe duhet që ta modifikojnë veten, mënyrën e funksionimit të vet për t’iu përshtatur konstantës që është investimi i huaj.

Për shembull, thuhet këtu në nenin 3 të paragrafit 2, ku flitet për atë se si Kosova nuk do të dëmtojë me asnjë veprim apo mosveprim të paarsyeshëm apo diskriminues veprimtarinë, menaxhimin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe largimin e një organizate të huaj investuese. Pra, me këtë thuhet që Kosova, që nënkupton institucionet publike të Kosovës, Qeveria dhe të tjerat nuk do ta dëmtojë me asnjë veprim apo mosveprim të paarsyeshëm dhe diskriminues veprimtarinë, e kështu me radhë, por do ta dëmtojë investimin e huaj. Çka i bie kjo? Kjo i bie se në rast që ka ndonjë kërkesë prej një investitori apo grup investitorësh të huaj për një çështje të caktuar në Kosovë dhe Qeveria merr vendim për ta trajtuar atë çështje, por jo saktësisht sipas kërkesës së investitorit të huaj, atëherë kjo i bie që me veprim Qeveria po e dëmton interesin e investitorit të huaj. Por, në rast se Qeveria e Kosovës vendosë të mos ketë fare për këtë çështje, pra kjo i bie që po e dëmton në mosveprim.

Pra, në njëfarë mënyre këtu jemi para një situatë, para një alternative e cila është e pa alternativë. Ose do ta dëgjomë kërkesën dhe do ta zbatojmë me përpikëri kërkesën e investitorit, ose do të dënohem, sidoqoftë pra do ta dënojmë veten nëpërmjet këtij ligji dhe kjo mendoj se është një kontroll jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe i dëmshëm që do t’i bëhet institucioneve publike të Kosovës nga interesi i investitorëve të huaj për të cilët duhet të themi jo të gjithë, janë të mirë dhe jo të gjithë mund të jenë të dobishëm për ekonominë e Kosovës.

Pastaj e kemi te përkufizimet një çështje tjetër që është në ligj dhe është goxha e çuditshme dhe goxha e shtrirë, të them ashtu, si fushëveprim - është te definicioni i investimit, pika 1.4, pra neni 2, pika 1.4.1 ku thuhet që investim nënkupton, pra në mes tjerash, edhe pasuri e paluajtshme apo e paluajtshme duke përfshirë të drejtën në të dhe mbi një pasuri të tillë siç është hipoteka, pengu, garancia, dhënia me qira, servituti e tjerë. Pra, edhe hipoteka, edhe pengu.

Kjo nënkupton që në fakt secila pronë private, qoftë ajo apartament apo shtëpi, e cila i takon një qytetari të Kosovës e i cili ka kredi në bankë, në bankë të huaj, gjasat janë shumë më të mëdha ta kenë atë kredi, sesa në bankat vendore, atëherë edhe kjo do të konsiderohet në njëfarë mënyre sikur investim i huaj për shkak se banka ka hipotekë mbi këtë shtëpi. E ne e dimë të gjithë se secili qytetar i Kosovës, i cili është i punësuar kudo këtu në Kosovë, e ka një kredi, kredi konsumuese, në të cilën në shumicën e rasteve jo në të gjitha, i kanë si hipotekë shtëpitë apo banesat e tyre. Pra, kjo i bie që në njëfarë mënyre një pjesë e konsiderueshme e pronës private të Kosovës të jetë po ashtu të definohet si një investim i huaj i cili i takon një banke apo tjetrës.

Po ashtu, te neni 4, te pika 2, thuhet që Kosova nuk do të diskriminojë në asnjë mënyrë investitorët e huaj në bazë të shtetësisë, origjinës, vendbanimit, vendit, themelimit apo afarizmit, kontrollit. Mendoj se kjo veçanërisht për rrethanat e Kosovës, por në përgjithësi është edhe e padrejtë edhe e dëmshme, për shkak se e dimë të gjithë se jo secili shtet, dhe jo secili investim, mund të jetë i dobishëm për Kosovën dhe nëse ne nuk bëjmë këso lloj diskriminimesh, pra të përzgjedhjes dhe përcaktimit të investitorëve, ku do të investojnë ata, si dhe për çka, atëherë do ta kemi një situatë në të cilën do t'ia japim tërësisht nën kontroll siç e thashë edhe më herët, investitorëve plotësisht sferën ekonomike të Kosovës dhe kështu do ta rrezikojmë mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e vendit.

Çështje tjera që kanë të bëjnë me këtë ligj, pra, është edhe kjo pika 7, të cilën e kam përmendur edhe herën e kaluar kur kam diskutuar për ligjin, që është te nacionalizimi. Pra, me këtë ligj Kosova, praktikisht ia mohon vetes të drejtën shtetërore dhe sovranë, që në raste të caktuara të nacionalizojë pronë, pavarësisht a është ajo investim i huaj apo i brendshëm, për shkak se ne e dimë të gjithë që në raste të caktuara shteti është i obliguar të nacionalizojë pronën dhe kjo bëhet për mirëqenien e shtetit dhe me këtë ligj, ne në fakt, nuk kemi të drejtë ta bëjmë këtë. Ka të drejtë të bëhet eksproprijimi nëpërmjet pagesës, por jo nacionalizimi. Për shembull, e kemi rastin konkret se edhe ky privatizimi i rrjetit të distribucionit do të konsiderohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zonja Kadaj-Bujupi!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës është në fakt krejt e pakuptimtë pse është sjell ky ligj si i tillë? Përpos zvogëlimit të përgjegjësisë të Agjencisë për Promovimin e Investimeve të Huaja, duke e sjell atë në nivel më të ulët nga Qeveria, është neni 22 i

Ligjit të vjetër, ku drejtori i Agjencisë i përgjigjet Qeverisë. Me Ligjin e ri kemi vetëm shprehjen, vepron në kuadër të Ministrisë. Pra, është vetëm ky ndryshim. Pra, kemi kërkesë për kontroll nga ana e MTI-s dhe zvogëlimin e interesit për investitorët duke i përqaftuar, siç thuhet, me përqaftimin e ariut.

Ndoshta MTI-a duhet të japë shpjegim më konkret, pse po e ndërron ligjin dhe çfarë qëndron prapa kësaj?

Heqja e Bordit këshillëdhënës, që është e kundërt me logjikën, me Ligjin për turizëm që e patëm pak më parë nga e njëjta Ministri, ku aty u themelua një këshill, domethënë bëhet fjalë te turizmi, tek investimet e huaja për çudi nuk paska nevojë bord me ministra.

Krejt ky ligj, të nderuar, është parafrazim i të vjetrit, përpos ato që ato u cekën më lartë, do të thotë dy fjali janë ndryshuar.

Ma merr mendja se ministrja po e përcjell programin ekonomik të Banjskos e nëse ky na qenka programi, atëherë investitorët që po i kërkon nëpër botë në emër të njohjes së Kosovës, paska për t' i mbajtur vetëm për vete dhe eventualisht për partinë e vet.

Ndërkohë që flasim për një kornizë legjislative, e cila po shihet që edhe pse brenda një viti kohor nuk ka pasur një avancim, por përkundrazi ka pasur një degradim, ajo çfarë ka ndodhur në realitet në Kosovë është se përvojat korruptive të investitorëve potencialë janë bërë publike në mediet me renome botërore dhe deri sa të vazhdohet kështu, Kosova nuk do të ketë dhe nuk mund të ketë, të nderuar kolegë deputetë, investime të huaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Faleminderit ministër për prezantimin e Projektligjit për investime të huaja. Duke marrë parasysh edhe deklarin e dy kolegeve të cilat janë brenda Komisionit, mund të themi se ligji ka ardhur po ai ligj identik i cili është kthyer në leximin e parë para një kohe, mirëpo mund të themi se këtu, në Kuvendin e Kosovës është bërë një praktikë e tillë nga ministrat që ligjet të cilat kthehen dhe strategjitë të vijnë në mënyrë identike prapë në Kuvend të Kosovës.

Mirëpo, duke marrë parasysh çështjen e Projektligjit për investime të huaja, është imazhi i Kosovës, i cili duhet të tregohet përpara investitorëve që ne jemi për investime të huaja dhe investimet e huaja të jenë në Kosovë të barabarta me investitorët kosovarë, të cilët duan të investojnë në Kosovë.

Edhe brenda mbledhjes së Komisionit parlamentar unë u kam bërë ftesë deputetëve që në mënyrë të hapur ta draftojmë një projektligj apo ta amendamentojmë këtë projektligj në mënyrën më të mirë të duhur, për arsye se në Kosovë duhet të mbrohen edhe investitorët e huaj edhe investitorët kosovarë.

Koalicioni për Kosovë të Re, e përkrah Projektligjin për investimet e huaja dhe shpresoj që do të kemi mbështetjen e të gjithë deputetëve në Komision Parlamentar që ta nxjerrim një projektligj ashtu si mendojmë në të mirë të investitorëve, sepse Kuvendi i Kosovës është vendi ku mund të ndryshohen dhe plotësohen projektligjet në tërësi dhe investitorët të cilët i preferon ministrja të vijnë në Kosovë, të vijnë për të gjithë qytetarët e Kosovës e jo vetëm për një subjekt politik.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga SLS, zoti Miletiq e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine potpredsedniče!

Nacrt zakona o stranim ulaganjima omogućava ozbiljne garancije svima koji žele da ulaže svoj novac na Kosovu. Garancije koje se ovim nacrtom zakona daju svim potencijalnim stranim investitorima neophodne su kako bi privukli što više kompanija koje treba da pokrenu privredu i ekonomiju u celini.

Naravno, za privlačenje investicija nisu dovoljne garancije koje se pružaju ovim nacrtom zakona već je neophodno pre svega postići punu političku i pravnu sigurnost i kreirati povoljnu atmosferu za biznis.

Nacrt zakona o stranim ulaganjima je pun jezičkih grešaka u verziji na srpskom jeziku. Mi smo kao Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke uradili analizu jezičkih grešaka i predali funkcionalnoj komisiji na usvajanje i očekujemo da naše jezičke primedbe budu uvažene bez obzira što nisu urađene od neke stručne službe već od nas poslanika. U načelu, podržaćemo ovaj zakon.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Është e qartë se Projektligji për investimet e huaja nuk ka pësuar ndryshime prej atëherë kur e kemi refuzuar në vitin e kaluar. Prandaj, unë mendoj që ky projektligj i pandryshuar e meriton një fjalim të pandryshuar nga ana ime.

Dihet se autorë të ndryshëm e kanë vënë në spikamë që 90% të investimeve të huaja në botë sot shkojnë në vende tashmë të zhvilluara dhe vetëm 10% në vende në zhvillim, siç quhen zakonisht vendet që në fakt janë të pazhvilluara.

Ulja e barrierave, ulja e ‘gardit’ nuk të bën atraktiv për investime, po për sulme, sepse në këtë mënyrë del joserioz dhe vetë fakti që disi përgjërohesh në mënyrë dëshpëruese për investime të huaja, të bën që të jesh atraktiv për korporata matrapaze, që s’merren me lëmin përkatës, por nisin pikërisht këtu tek ne duke eksperimentuar.

Tashmë jemi dëshmitarë që në Kosovë kemi investitorë të huaj, të cilët lëmin përkatës të zhvillimit të aktivitetit biznesor e bëjnë për herë të parë, pikërisht në Kosovë, për dallim prej asaj me çfarë merren tradicionalisht në vende të tjera e në të kaluarën e tyre.

Mendoj që ky zhvlerësim që ne ia bëjmë vetes sonë me këtë ligj, na bën të dyshimtë për kompanitë serioze dhe sigurisht që do t'i joshim veçse kompanitë e dyshimta.

Investimet e huaja duhet të jenë edhe çështje e politikës së jashtme. Ne nuk bën që t'i barazojmë të huajt, sepse ata neve nuk na trajtojnë njësoj. Në bazë të këtij projektligji që e kemi para vetes, investitorët nga Shqipëria dhe investitorët nga Serbia, janë të barabartë.

Duke qenë se kjo është tërësisht e padrejtë dhe shumë e dëmshme, mendoj që nuk do të duhej as të vinte ky projektligj para nesh, se lëre më ta votojmë e ta kalojmë atë.

Çdo investitor i huaj, kur ta lexojë këtë ligj do ta humbë respektin për Kosovën. Duke thënë: ejani investoni, sepse jemi shtet i dobët”, ne nuk do të fitojmë investitorë serioz, por investitorë plaçkitës që fitojnë tek ne.

Më duket shumë problematik neni 7, i cili flet për nacionalizimin, por në fakt nuk e definon se çka quajmë nacionalizim, ndërkohë që tregon qysh nuk do të zbatohet ai. Dhe, e kemi nenin 11, i cili i barazon luftën, konfliktet tjera të armatosura, revolucionin, kryengritjen, demonstratat, protestat, trazirat qytetare dhe aktet terroriste, duke thënë “apo ngjarje të tjera të ngjashme”.

Pra, i barazon që të gjitha këto në një mënyrë shumë absurde dhe të pakuptimtë, prandaj ky projektligj në fakt po mundohet që ta rregullojë edhe një situatë pas revolucionare. Pra, edhe kur të ketë transformime shumë të thella, këta kujdesen që edhe atëherë të vlejnë rregullat e normat e njëjta, gjë që është në kundërshtim me logjikën e gjërave. Domethënë, dihet që pala që humb në revolucion është tragjike, por le të mos e bëjmë edhe qesharake, sepse ajo nënkupton një transformim të thellë politik e socio-ekonomik, ku pikërisht nuk vlen ajo paraprakja, kështu që mendoj se kjo paraqet një lloj absurditeti tjetër të këtij projektligji.

Ne i kemi në alternativën qeverisëse të “Vetëvendosjes” katër objektiva programore lidhur me ndihmën e sektorit privat dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që mendojmë se janë substanciale, e që natyrisht janë në kontrast të thellë me këtë projektligj.

E para, është qasja në financim. Duhet të kemi krijimin e mekanizmave, të cilat e bëjnë financimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme më lehtë dhe më të lirë. Disa prej këtyre mekanizmave janë:

- Skema garantuese për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- Fondet investive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe
- Subvencionimi i kamatave për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që janë të integruara në zinxhirë të vlerës së sektorëve strategjikë e të tjera.

Objektivi i dytë është politika tatimore, është vendosja e politikave tatimore, të cilat janë në favor të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, drejt prodhimit dhe punësimit e për këtë gjë është një elaborim më i gjatë yni sa u përket politikave fiskale dhe monetare, që nuk mund ta shpalosim tash këtu.

Objektivi i tretë është administrata. Kemi nevojë për reformimin e administratës shtetërore, që u shërben ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në mënyrë që të sigurohet që evazioni fiskal të mos bartet tek ndëshkimet tatimore për ato ndërmarrje, që lejet dhe taksat komunale dhe qendrore të jenë të unifikuara dhe, në fund fare, që shërbimet që jepen nga administrata, të jenë në funksion të zhvillimit.

Dhe, e katërta është prokurimi qeveritar. Lëvizja “Vetëvendosje” e ka të qartë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe biznesi në përgjithësi, mund të përjashtohen nga çdo proces i shitjes tek sektori publik për arsye specifike. Rrjedhimisht, ndryshimi i Ligjit të prokurimit, në mënyrë që së pari të promovohen shërbimet, produktet vendore e për më shumë që ato që mund të prokurohen nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të mos prokurohen nga ndërmarrjet e mëdha vendore ose ndërkombëtare, duke krijuar potencialitet të rritjes për këto ndërmarrje.

Një çështje tjetër që dua ta theksoj është fakti se në kuadër të projektligjit që e kemi para nesh ekziston një dyfaqësh që thotë: “lista e përgjigjeve të dhëna nga grupet e interesit në Projektligjin për investimet e huaja”.

Dhe, ja cilat kanë qenë pyetjet: Çka mendoni për qëllimin dhe fushëveprimin e këtij projektligji?

Pyetja e dytë: Çka mendoni lidhur me mbrojtjen e investitorëve?

Pyetja e tretë: Çka mendoni lidhur me krijimin e lehtësirave për investimet e huaja?

Pyetja e katërt: Sa janë të nevojshme investimet e huaja në Kosovë?

Pyetja e pestë: Cili është opinionin juaj lidhur me trajtimin e investitorëve dhe investimet e tyre?

Pyetja e gjashtë: Çfarë mendoni lidhur me të drejtat që janë paraparë për investitorët e huaj në Kosovë?

Pyetja e shtatë: Çfarë mendoni lidhur me legjislacionin apo mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve të investimit?

Dhe, pyetja e tetë, e fundit: Çka mendoni lidhur me institucionin apo Agjencinë për Zhvillimin dhe Promovimin e Sektorit Privat, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e këtyre dispozitave?

Me këtë rast, 22 institucione e organe të ndryshme i kanë marrë, sipas Qeverisë, këto tetë pyetje, asnjëra prej tyre nuk e ka dhënë asnjë koment.

Dhe, shikoni cilët janë responentët: Oda Ekonomike e Kosovës, Aleanca Kosovare e Biznesit, Oda Ekonomike Amerikane, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, Avokati i Popullit, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, OJQ-ët - kështu në përgjithësi, OSBE-ja, Zyra Ligjore e EULEX-it, Instituti GAP, Instituti KIPRED, Doganat e Kosovës, USAID-i, GIZ-i, TIKA, Shoqata e Bankave, Agjencia Kosovare e Pronës, Inovation Center Kosovo, BSCK-ja, Banka Botërore, Instituti Riinvest dhe pesë AZHR-të.

Domethënë, 23 institucione, në këto tetë pyetje, asnjëra nuk e ka pasur asnjë koment. Kjo do të thotë se këto organe e këto institucione ose nuk kanë kurrfarë shpresash më në këtë Qeveri, ose me të vërtetë nuk e kanë shikuar fare, sepse çdo njeri me arsye të shëndoshë po ta lexojë këtë, i ka vërejtjet e shumta.

Së fundi desha të them se premisa e arsyetimit të këtij projektligji, të cilin ne tashmë e kemi refuzuar një herë, dhe sjellja e të njëjtit është arrogancë qeveritare, bazohet mbi shprehjen: “praktikat më të mira ndërkombëtare”.

Unë dua të pohoj para të gjithë deputetëve sot këtu që praktikat më të mira ndërkombëtare nuk ekzistojnë. Nuk mund të flasësh për të gjithë botën. Sot në botë ka konflikte, edhe të armatosura, ka gjakderdhje, mbi atë se cilat janë praktikat më të mira. E këtu duket që Qeveria jonë e paska zgjidhur këtë problem, prandaj, në vend se të jetë Ministri për Tregti e Industri, apo Ministri për Zhvillim Ekonomik, është mirë që të jenë ndërmjetësues paqësorë, që këtë të vërtetë sublimë që këta e paskan gjetur, se cila është praktika më e mirë ndërkombëtare, le të shkojnë në vatrat e krizës, nëpër konfliktet e ndryshme, dhe le t'i pajtojnë atje, sepse njerëzit po vriten kot së koti. Pra, këta e paskan gjetur të vërtetën e ekonomisë, dhe tash thonë: “praktikat më të mira ndërkombëtare”.

Praktikat më të mira dallojnë prej vendit në vend dhe dallojnë prej epoke në epokë. Kanë të bëjnë me kushtet dhe me stadin e zhvillimit socio-ekonomik. Nuk ekzistojnë praktikat më të mira ndërkombëtare, prandaj, kjo fjali që e paraqet arsyetimin bazik për investimet e huaja është tërësisht e pabazë edhe për bindjen time, tregon njëllë injorance të thellë nga Qeveria, përkatësisht nga Ministria që na e ka sjellë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për investime të huaja rregullon një fushë të caktuar, që ka të bëjë më tepër edhe me mbrojtjen e investitorëve të huaj dhe duke pasur parasysh kapacitetet e vogla investive të

bizneseve në Kosovë ky projektligj do të krijojë parakushte të mira për investorët e huaj. Joshja e investorëve të huaj për investime në Kosovë, nuk duhet të jetë prioritet vetëm i Qeverisë por do të duhej të ishte prioritet për të gjithë, për partitë në pozitë dhe opozitë.

Moskalimi në lexim të parë i këtij projektligji dhe refuzimi absurd i një pjese të opozitës që iu bë këtij projektligji me pretekst që gjoja ky projektligj është kundër investorëve vendorë, dëshmon se një pjesë e opozitës ka probleme thelbësore konceptuale në të kuptuarit të zhvillimit ekonomik dhe zhvillim të ekonomisë së lirë të tregut. Të deklarohet se investimet e huaja nuk gjenerojnë zhvillim, është absurd tjetër i llojit të vet, duke pasur parasysh se subjektet e caktuara politike u dërguan letra kërcënuese investorëve të huaj të mundshëm në Kosovë, duke ditur që edhe Qeveria e Serbisë në vazhdimësi kërcënon dhe tenton t'i shantazhojë investorët potencialë në Kosovë, të cilët janë të interesuar të investojnë në Kosovë, atëherë se sigurisht mbrojtja ligjore e investorëve të huaj është nevojë për t'i rritur investime të huaja në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të vendit dhe gjenerim të vendeve të punës.

Sa i përket nenit 11, pika 1 kur një investor i huaj pëson humbje apo dëmtim të investimeve në Kosovë, si rezultat i dhunës që është i lidhur me situatën e politike apo ekonomike, duke përfshirë këtu luftën, konflikte e armatosura, revolucionin, kryengritjen, demonstratat, trazirat qytetare e tjera, dhe ngarkesa që i vihet Qeverisë së Kosovës të investimet e huaja në rast të dëmtimeve si pasojë e fuqisë madhore, është në kundërshtim me parimet themelore të drejtësisë, e njohur nga drejta romake ku përgjegjësia ndaj palëve përjashtohet, nuk ekziston kur janë në pyetje dëmtimet nga fuqia madhore.

Zgjidhja më mirë për këtë problematikë do të ishte rritja apo forcimi i mekanizmit të sigurimeve, ku përgjegjësia do të bjerë mbi kompanitë e sigurimeve dhe me këtë do t'i hiqej përgjegjësia e drejtpërdrejtë nga Qeveria. Gjithashtu, kjo do të ndikonte në forcimin e tregut të sigurimeve në Kosovë, por besoj që kërcënimet dhe shantazhet që u janë bërë investorëve të huaj në koordinim, subjektet e caktuara në Kosovë dhe Qeveri e Serbisë, sidomos mos mbulimi i dëmeve nga kompanitë e sigurimeve në rast të protestave, trazirave apo konflikteve, ka detyruar apo ka bërë që Ministria të jete më e kujdesshme për t'i mbrojtur investorët e huaj duke iu krijuar atyre ambient më të sigurt për investimet në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Imri Ahmeti e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kryesisht dola këtu, e kishim ndërmend të flas prej ulëses, por shumë e hijshme kjo pamja në prapaskenë prapa meje, pa asnjë anëtarë të Qeverisë. Ko dëshmon më së miri se sa është e interesuar Qeveria për investime të jashtme, prandaj thashë ndoshta del një pamje e mirë prapa pa asnjë anëtarë të Kabinetit qeveritar.

Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuari kryesues i kësaj seance,

Investimet e huaja në Kosovë jo që nuk kanë shënuar rritje, por ato madje kanë një trend tepër negativ të rënies. A qëndron problemi te legjislacioni? Sigurisht që jo në masën për të pasur një trend kaq negativ të investimeve të huaja. Faktorët mund të jenë të shumët, por kryesorja është mos sundimi i ligjit dhe niveli i lartë i korrupsionit. A do të zgjidhet problemi nëse do ta kemi një ligj të veçantë vetëm për investitorët e huaj, mendoj që jo dhe tek e fundit a duhet të kemi kritere dhe standarde të dyfishta për trajtimin e investimeve? Sa do të ndikojë kjo në investitorët e brendshëm dhe çfarë reflektimesh do të sjellë tek investitorët e brendshëm? Tek e fundit a mos mund të jetë ky projektligj dhe ky ligj që pretendohet të bëhet një motiv për transformimin e investitorëve të brendshëm në investitorë të jashtëm dhe tek e fundit a është kjo në përputhje me parimet e ekonomisë së lirë dhe të konkurrencës?

Nga propozuesi i këtij projektligji është vlerësuar se duhet ta kemi një rregullativë të veçantë për investitorët e huaj, por nëse lexohet me kujdes ky projektligj pashmangshëm na del pyetja a na sjell ndryshime kualitative ky projektligj dhe cilat janë ato dispozita të këtij projektligji që mund të merren si inkurajuese për investitorët, në këtë rast për investitorët e huaj. Konsideroj se në këtë projektligj as propozuesi nuk paraqet diçka më konkrete përveç disa masave mbrojtëse.

Shikoni, projektligji në nenin 1, paraqet një qëllim mjaft ambicioz, mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë. Mirëpo, në fakt ky projektligj ka rregulluar vetëm çështjen e administrimit dhe të qeverisjes të bizneseve nga investitorët e huaj, por jo edhe rregulla në funksion të inkurajimit dhe të promovimit të investimeve siç parashihet në nenin 1 të këtij projektligji.

Para së gjithash, projektligji si në strukturë edhe në përmbajtje, nuk parasheh asnjë objektivë të përcaktuar sipas nenit 1, sepse në tërësi është shumë i paqartë, në disa raste mjaft kundërtënkës, mungojnë dispozitat për krijimin e rrethanave ligjore, inkurajuese dhe promovuese të investimeve, kurse në funksion të mbrojtjes përmban disa dispozita mjaft të paqarta si për organet dhe mandatin e tyre edhe për mjetet ligjore të mbrojtjes së investimeve të huaja. Pas përkufizimeve të ngjeshura, e shumë prej tyre të panevojshme, ndeshja e parë na vjen menjëherë në nenin 3 te trajtimi i përgjithshëm, ku kjo dispozitë paraqet një lloj parathënie për këtë fushë duke e përcaktuar Kosovën si subjekt të së drejtës. Një përcaktim i tillë për subjektivitetin shtetëror te dispozitat ligjore rregulluese, konsideroj se nuk duhet ndodhur, sepse në këtë rast nuk po hartojmë as marrëveshje, as konventë të shtetit të Kosovës me ndonjë partner tjetër shtetëror. Këtu do të duhej adresuar saktësisht përgjegjësinë e institucionit përgjegjës.

Neni 5 është shumë i paqartë dhe paraqet një rregullim ligjor në funksion të arritjes që qëllimit, nenit 3 të këtij projektligji. Kjo dispozitë nuk paraqet mekanizma të sigurisë dhe të mbrojtjes së investimeve të huaja, por i referohet kompensimit për shkelje të paspecifikuara. Sa mund të jenë inkurajuese për investitorët përballja e këtyre kompensimeve në vend të sigurimit se ekziston siguri ligjore për punë e pastaj mbrojtja adekuate dhe këtu shtrohet pyetja- a janë politika të mira shtetërore vetëm referencat në kompensime? Ku mbetet roli i shtetit për krijimin e mjedisit të sigurt dhe të favorshëm

për ushtrimin e biznesit? Sipas këtij rregullimi, konsideroj se investitorët seriozë nuk do ta vlerësojnë këtë mjedis të sigurt për investime, përveç nëse ekziston ndonjë motiv tjetër.

Në nenin 11, paraqitet një rregullim tepër abstrakt. Ky nen i referohet konfliktit të armatosur dhe trazirave të qytetarëve. Dyshoj se dikush do ta vlerësojë të mundshëm për zbatim e as më pak të vlerësohet serioz ndaj investitorit sepse këtu, kemi të bëjmë me disa rregulla, me disa forma të rregullimit që ndërlidhen e me fuqinë madhore, prandaj kjo dispozitë mendoj që duhet ndryshuar apo duhet hequr si tërësi. Gjithashtu, në nenin 13 përsëri kemi një ngatërrim dhe paqartësi me legjislacionin e vendit. Bazueshmëria e ligjeve të vendit është e detyrueshme dhe e natyrshme të mbështetemi në legjislacionin vendor, por e natyrshme është sikur vërtetë të kishte sundim të ligjit dhe siguri të plotë për zhvillimin dhe mbrojtjen e gjithë investitorëve dhe sikur të ishte kështu, sikur të kishte pra siguri për investitorët e brendshëm, atëherë nuk do të kishte nevojë fare për një ligj të veçantë për investitorët e jashtëm.

Neni 16 paraqet një rregull që përcakton një procedurë tepër burokratike dhe aspak të favorshme për investitorët. Pëlqimi i Kosovës për dorëzimin e një kontesti është i përgjithësuar dhe nuk dihen efektet e saj, kur jepet

ky pëlqim, në bazë të cila kriterëve dhe përfundimisht pse duhet të jepet ai pëlqim? Prandaj, kjo dispozitë është e paspecifikuar, tepër e përgjithësuar dhe si e tillë në tërësi e paqartë. Sidoqoftë, ky projektligj për mendimin tim paraqet një utopi në vetvete që në rastin më të mirë është përtej realitetit qeverisës në Kosovë. Sot vendi ynë po përballet me një sistem qeverisjeje të dobët, me një elitë politike të korruptuar ku skandalet dhe korrupsioni janë bërë rituale të përditshme dhe kjo është ajo që nuk i ndikon pozitivisht në imigjin e vendit tonë, të jetë atraktiv, por vetëm aprovimi i ligjeve gjithsesi nuk e rregullon këtë ambient.

Përfundimisht konsideroj se ky projektligj nuk i përmbush pritjet elementare për rregullimin e kësaj çështjeje. Si i tillë nuk ofron asnjë mundësi dhe asnjë rrethanë të favorshme për investitorët e huaj, pa ndryshimin e gjendjes faktike në vendin tonë. Prandaj, gjithsesi që e mbështes idenë që ky projektligj nuk është dashur fare të vijë kështu siç është dhe duhet t'i kthehet përsëri Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk di sa ka shumë rezon që ne të diskutojmë për një tekst, për një debat apo për një tekst të cilin e kemi diskutuar dy- tre muaj më parë, por problemi është mjaft serioz dhe unë do t'i them dy-tri fjalë duke u munduar që të mos e përsëris atë që e kam thënë në diskutimin e kaluar. Ndoshta duhet të mendohet te vet titulli i këtij ligji, por në përgjithësi edhe në terminologjinë tonë ekonomike e politike, një pjesë e aktorëve e përdorin termin: “investime të huaja”. Mendo se nuk do të duhej të bëhej fjalë për “investime të huaja”, por “investime nga bota e jashtme, investime nga partnerët e jashtëm”, sado që edhe në Shqipëri e përdorin shpesh investime të huaja, s’ do të thotë që e kanë mirë, sepse në

momentin që ato investime bëhen në Kosovë, ato fitojnë tretmanin e biznesit të Kosovës dhe bëhen, jetojnë në Kosovë, janë biznes i Kosovës. Dhe ky është pra problemi me kuptimin e këtyre investimeve dhe problemi me konceptin e këtij ligji. Ky ligj krijon një zonë, një rezervat të them ashtu të investitorëve të huaj dhe koncepti i tij ju thotë se ju do të keni këtu telashe, do t'ju rrezikohet pasuria, ligjet mund të ndryshojnë, dikush, Qeveria mund të veprojë apo mund të mos veprojë, të ju bëj dëme, por ju jeni të mbrojtur, gjithqysh jeni të mbrojtur e hajde, por probleme të tilla do të keni.

Koncepti është jo një koncept modern, koncepti është për një shtet që krijon incidente edhe tash investitorëve të huaj i krijon një zonë të veçantë për ta, duke veçuar prej komunitetit të biznesit vendor dhe i mbron ata, ky është koncept i gabuar edhe nuk do të ë rezultojë me rritje të investimeve. Ajo që kërkojnë investitorët e jashtëm, duhet të theksohet shumë thjeshtë, kërkojnë barazi të plotë në treg. Këtu është barazia ndërmjet investitorëve të huaj, por askund nuk është e qartë që investitorët e huaj dhe investitorët e vendit janë të barabartë. Në qoftë se janë të barabartë, atëherë vlejnë ligjet të gjitha, ajo që u nevojitet investitorëve të huaj është një procedurë që ata kur investojnë në Kosovë, që duhet ta ndjekin, duhet t'i rregullojmë këto për t'ju siguruar që jeni të barabartë me investitorët e jashtëm edhe tre, për t'ju siguruar pronën dhe transferin e profitit, kurrëgjë tjetër. Ne këtu kemi krijuar aq shumë dispozita dhe e kemi involvuar, domethënë shtetin tonë si pjesë e transaksionit me investitorët e jashtëm dhe kemi krijuar komplikime. Këtu, në qoftë se ky ligj aprovohet këtu, atëherë shteti ynë duhet ta ketë një sportel dhe do të jetë palë e kontesteve me investitorët e jashtëm. Prandaj mendoj se me të drejtë e kemi kthyer herën e parë, duhet ta kthejmë përsëri dhe duhet të bëhet një ligj më i thjeshtë, një ligj më i qartë, një ligj i cili nuk na nxjerr telashe te tilla.

Agjencia përsëri ka ardhur, na kemi kërkuar sqarim pse po bëhet ristrukturimi i Agjencisë, nuk kemi asnjë sqarim, asnjë ndryshim. Natyrisht që ristrukturimet munden të jenë të dobishme, por këtu në një nen është aq shumë konfuz, një herë flitet që është për sektor privat tani flitet që është për investitorë të jashtëm në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por investitorët e jashtëm nuk janë për ndërmarrje të vogla e të mesme, mund të jenë edhe për ndërmarrje të mëdha, mund të jenë edhe për infrastrukturë, mund të jenë edhe për gjithçka. Prandaj, një agjenci e specializuar që i nxit ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe një agjenci që e bënë promovim, bënë marketing, bënë publicitet për investime në botën e jashtme, janë dy funksione. Nuk po them se nuk mund të organizohen në një agjenci, por duhet një arsyetim pak më i mirë.

Prandaj duhet se për mua kjo është problematike dhe mendoj që edhe komisionet tona kur i kthejnë ligjet dhe vijnë në të njëjtin format, pa ndonjë ndryshim esencial, kisha apeluar te komisionet që t'i ndalin ato, të mos na i sjellin që të humbim kohë në debate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Është e qartë se Kosovës i duhen investimet jo vetëm të huajat, por edhe të brendshme, mirëpo është e paqartë dhe papranueshme që ne për herë të dytë kemi një projektligj i cili është krejtësisht i njëjtë me projektligjin që i është kthyer hartuesit nga ky Kuvend, nga ne deputetët. Do të thotë se neve nga ofrohen të njëjtat zgjidhje për të cilat më parë është refuzuar projektligji e kjo është sjellje e papërgjegjësi nga ana e sponsoruesit të këtij dokumenti dhe mosrespektimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës të cilët bien vendime në këtë vend. Ndërkaq, tash kemi të bëjmë me një dokument shumë të rëndësishëm për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit, si dhe për zhvillimin e proceseve integrale në rrafshin ndërkombëtar, madje ky ligj duhet të mundësojë që të hapen dyert për investimet nga jashtë të cilat janë duke rënë vazhdimisht. Është krejtësisht e kuptueshme që nëpërmjet investimeve, investorëve të huaj t'u jepet një përkrahje zhvillimit ekonomik, të krijohet një lidhje më e fortë me vendet prej nga vinë këta investitorë si dhe të bëhet transferi i teknologjive dhe tërë të arriturat e tjera shkencore.

Vetëm po përmend se sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2007, investimet e huaja ishin 440 milionë, në vitin 2011, 394 milionë, ndërsa deri në fund të shtatorit të vitit të kaluar, janë 178,5 milionë, domethënë po shihet se sa kanë rënë investimet e huaja. Mirëpo a mund të arrihet ky synim vetëm nëpërmjet një ligji i cili investitorin e huaj në Kosovë e bën të paprekshëm nga autoritetet vendore, kurse pronën e tij të pacenueshme. Kjo premtim një efekt të kufizuar, meqenëse kjo mbrojtje ligjore nuk i garantohet investitorit vendor, po ashtu vetëm ky ligj nuk e ndërton ambientin stabil, të qëndrueshëm dhe të sigurt për investime. Duhet edhe shumë ligje të tjera, e në rend të parë efikasitet më i madh i institucioneve tona.

Funksionimi i shtetit ligjor dhe eliminimi i korrupsionit brenda institucioneve shtetërore, për shkak të qasjes diskriminuese që i bëhet biznesit dhe investimit vendor, kjo atë e bën inferior në raport me investimet e huaja, ose do ta detyrojë biznesin vendor me çdo kusht që të sigurojë së paku 25% investime nga jashtë, me të vetmin qëllim që të hyjë në zonën e paprekshëm, përkatësisht në mbrojtjen e këtij ligji. Kur e them këtë, kam parasysh dy fakte: në nenin 2 të përkufizimit, pika 1.2 sqaron se investitori i huaj është secili person i huaj që bën një investim në Kosovë dhe në pikën 1.4 si investim, nënkupton çdo aset në pronësi nga një person i huaj në Kosovë, me qëllim të kryerjes së aktiviteteve të ligjshme komerciale.

Në dukje kjo, është krejtësisht në rregull dhe aspektet teorik, nuk ka si të përkufizohet ndryshe, por a mjafton që dikush vetëm të jetë shtetas i huaj dhe të bëjë në Kosovë një investim çfarëdo qoftë ai dhe të jetë i mbrojtur nga çdo veprim i mundshëm madje të jetë edhe më i fuqishëm se autoriteti shtetëror në Kosovë? Unë jam për një ekonomi të lirë dhe për një treg konkurrues, kundërshtoj secilin kushtëzim apo ndërhyrje të padrejtë të shtetit në ekonomi, në treg apo drejtpërdrejt në politikat e biznesit. Mirëpo, për të siguruar privilegje çfarë ofron ky ligj, atëherë duhet të caktohen disa limite, qoftë duke e saktësuar vëllimin e investimeve apo duke i orientuar ato në prodhimtarinë ku vlerësohet se ka më shumë nevojë apo të cilat garantojnë një qëndrueshmëri dhe stabilitet në procesin e zhvillimit ekonomik. Kjo nuk duhet të bëhet nëpërmjet diktateve, por duke bërë një dallim ndërmjet investitorit të fuqishëm dhe serioz, në raport me atë se nuk ka para e as ndonjë referencë të besueshme në vendin prej nga vjen apo nga ndonjë treg

tjetër. Ka edhe plotë vërejtje të tjera në këtë projektligj, por me këtë rast po veçoj vetëm ato që janë më kapitale.

Në nenin 3, pika 2 aty thuhet se çdo autoritet publik që shkel apo dështon të respektojë të drejtat dhe garancitë e siguruara për investitorët e huaj, do të jenë të detyruar të paguajnë kompensim, do të thotë që të paguajnë menjëherë kompensimin pa pasur paraprakisht asnjë procedurë apo formë të verifikimit se me fajin e kujt ka ndodhur rasti, së paku ky ligj kështu thotë.

Në nenin 6, stabiliteti i regjimit të investimeve. Sipas tij, Qeveria detyrohet ta kompensojë investitorin nëse bën ndryshime ligjore brenda 5 vjetësh, pas datës së bërjes së investimit dhe në ndonjë mënyrë si a i cenohet apo rrezikohet. Ky nen Qeverinë e sjell para situatës ku nuk guxoj të bëj asnjë ndërhyrje në ligj, pa pasur parasysh situatën e secilit investitor. Nëse duhet të jetë kështu, atëherë më mirë të thuhet se Qeveria nuk guxon të bëjë asnjë ndryshim në ligje për shkak se mund të jetë e gjobitur.

Në nenin 11, parasheh kompensimin e dëmit, nëse ka ndodhur si rezultat i dhunës që lidhen me situatën politike. Pse Qeveria duhet ta marrë këtë përgjegjësi e investitorët nuk i detyron që ta sigurojnë pasurinë dhe investimet e tyre që bëhen në Kosovë. Sigurimi i investimeve bëhet edhe në shtetet e huaja, jo t'i garantojë Qeveria dëmin e tyre.

Neni 21 nuk përkufizon qasjen çka është Agjencia për Zhvillimin dhe Promovimin e Sektorit Privat, ndërkaq këtu sërish autoriteti i pacenueshëm është Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë. Nga kjo unë synoj që në Kosovë të krijohet një ambient ku biznesi vendor nuk do të diskriminohet në raport me askënd dhe që Kosova nëpërmjet Ligjit për investime të huaja të mos shndërrohet në një vend ku bëhet shpëlarja e parasë apo ku vijnë shtetasit e huaj me qëllim që t'i shmangen tatimet nga vendet e veta.

Këto janë vetëm disa vërejtje, ka edhe shumë vërejtje të tjera dhe ftoj deputetët që mos ta votojnë Projektligjin për investimet e huaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në fillim të kësaj ekspozije lidhur me këtë draftligj edhe unë do të ndalesha në pjesën e listës së komenteve të dhëna nga hisedarët dhe institucionet ndërkombëtare të rëndësishme në Kosovë lidhur me këtë projektligj.

Në këtë listë nuk do të gjeni asgjë pos fjalës pa koment, gjë që të bën të mendosh se ky ligj qenka në tërësi i draftuar në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Unë do të isha pajtuar me këtë sikur të mos kujtoja parimin se një mostër nuk mund të jetë tamam për të gjithë, që do të thotë se ky ligj do të duhej përshtatur rrethanave ekonomike të Kosovës.

Gjithashtu duke pasur parasysh se ne jemi fillestar në ligj bërje gati që është e pamundur që një ligj të jetë i tillë që të mos ketë nevojë për asnjë koment.

Këtë e them për faktin që në shikim të parë të këtij ligji bie në sy një ofertë që vije në pakon e një sigurie maksimale për investitorët e huaj, pa analizuar paraprakisht faktin se kjo fushë shumë lehtë mund të bëhet subjekt i keqpërdorimeve nga investitorët e huaj dhe shtuar kësaj edhe faktin se struktura analitike dhe ekzekutive gjyqësore në Kosovë është e brishtë, atëherë lehtë mund të vijmë në përfundim se kjo mund të na krijojë situata të palakmueshme për buxhetin e Kosovës. Pastaj në nenin 6 që asnjë ligj rregullor apo akt tjetër ligjor, të mos aplikohet në mënyrë retroaktive në dëm të investitorëve të huaj. Kjo kërkon që çdo gjë dhe çdo skenar i mundshëm të jetë analizuar mirë e me kujdes, përndryshe druaj se këtu mund të na shfaqen situata të ndryshme që mund të sjellin kokëçarje të shumta. Si përfundim Kosova ka shumë fusha të cilat nuk i ka të rregulluara me ligj, gjë që rangon në grupin e vendeve më liberale në aspektin ekonomik, pikërisht për këtë arsye, pra në këtë mënyrë ajo paraqet një ekonomi liberale artificiale.

Rrjedhimisht, Lëvizja për Bashkim mendon se një ligj i këtillë nuk do të mjaftojë si pishtar i nxitjes së investimeve të huaja në Kosovë. Kosova ka resurse natyrore të shumta dhe resurse humane të lira, të cilat janë të përshtatshme për investitorët e huaj, por gjithashtu ka shumë pengesa tjera teknike për këto investime, siç është mungesa e energjisë elektrike dhe profileve të përshtatshme për angazhime në fusha të caktuara profitabile. Nisur nga gjithë kjo, ne si Lëvizje për Bashkim, mendojmë se të gjitha këto pengesa do të vazhdojnë të mbesin akute edhe pas hyrjes potenciale në fuqi të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë,

Meqenëse kjo është hera e dytë që po diskutojmë për këtë ligj dhe atë që e kam pasur ndërmend ta them brenda ligjit, e kam thënë herën e parë dhe ato janë dokumente që mund të shfrytëzohen në trajtimin e mëtejshëm të ligjit, ndërsa tash desha të them që ligji që e kemi përpara, që nga vetë titulli dhe po të shtrohet pyetja se një fushë kaq e rëndësishme siç është tërheqja e investimeve të jashtme, a dëshirojmë ne që të jemi atraktiv në atë drejtim dhe a dëshirojmë që t'i garantojmë investitorët, pavarësisht a janë ata me kapital të brendshëm apo me kapital jashtë Kosovës, s'do mend se secili do të ishte pajtuar.

Mirëpo, unë mendoj që ministrja e ka lëshuar një rast të mirë edhe herën e parë kur është diskutuar që ka munguar dhe ishte një shpresë kur javën e kaluar u shtynë ligjet ngase nuk kishte ministra dhe u pa e rëndësishme që të jetë ajo, por nuk paska qenë ashtu, ndërsa kur sot prapë e ka lëshuar një rast të mirë ministrja të bashkëbisedojë me deputetët, eventualisht mund të jetë një dilemë se këtë ambicie që po e ndërtojnë sot deputetët që ligji të jetë me ambicie më të fuqishme se sa një vendim të themi, dëshirojmë që investimet e jashtme të jenë të garantuara, nuk ka dilemë. Por, dilema e deputetëve në këtë rast është, a është e mjaftueshme dhe a po bëhet një mjaft që të

krijohen detyrime dhe përgjegjësi në mënyrë që ne, me një ligj të veçantë t'i inkurajojmë dhe t'i mbështetim investimet, qofshin ato të jashtme apo të brendshme dhe në këtë drejtim, unë mendoj, ndaj mendimet me deputetët që duke marrë parasysh edhe shumë ligje sektoriale, që mund ta pasuronin këtë pikë, kjo ambicie është shumë e vogël. Kjo ka qenë qëllimi pse është kthyer ligji jo pse ne nuk dëshirojmë që të jenë të garantuara investimet e jashtme, por i kemi dhënë një mundësi ministres, Ministrisë dhe Qeverisë që t'i ndërtojë ambiciet që prej asaj që quhet strategji e zhvillimit ekonomik deri te politikat sektoriale.

Vetë fakti se ka ardhur i njëjti ligj, kjo tregon që ministri dhe Ministria, Qeveria nuk ka ambicie përtej asaj që quhet aprovim në formë i një ligji që ka kërkuar Bashkimi Evropian, që është një standard që quhet garantimi i investimeve dhe këtu përfundon i gjithë tregimi.

Prandaj, unë mendoj se jo për të qenë kundër garantimit të investimeve, por për të dëshmuar se ky vend ka nevojë për një qartësim shumë më të fuqishëm të tërheqjes së investimeve dhe gjenerimit të zhvillimit ekonomik t'i thuhet jo dhe që përgjegjësia e Qeverisë dhe e ministrave të jetë shumë më e madhe në raport me publikun dhe në raport me deputetët, atëherë kur duhet t'i implementojnë politikat, të cilat çdo ditë i bëjnë publike nëpër tryeza edhe nëpër darka edhe nëpër ndeja edhe nëpër punëtori edhe më tutje dhe për paraqitje konferenciale.

Paraqitja në konferencë është e lehtë, por ndërtimi i ligjeve të cilët kryejnë obligimet dhe përgjegjësi dhe kontribuojnë fushës, shihet se është sfidë për Qeverinë dhe ministrin. Prandaj, duke e mbështetur plotësisht garantimin e investimeve, unë jam kundër që të aplikohet ky ligj, sepse ambiciet nuk i ka përtej një vendimi të thjeshtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është. Në sallë janë 72 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 42 vota kundër, 1 abstenim, 29 vota për, nuk miratohet projektligji dhe i kthehet Qeverisë. Faleminderit!

Tani do të bëjmë pauzë deri në orën 15:00.

Vazhdimi i mbledhjes, pasdite

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet e ndërtimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportet me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Bujqësisë, zotin Blerand Stavileci, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush ta prezantoj Projektligjin për produktet e ndërtimit. Njëra prej kërkesave të planit të veprimit të partneritetit evropian, është që në fushën e legjislacionit teknik të zhvillohen politika në frymën e qasjes së re kësaj kërkesë të BE-së, të cilën ne e konsiderojmë në radhë të parë si një obligim qeveritar ndaj zhvillimit konkurrues të Republikës së Kosovës, në trendët bashkëkohore të zhvillimit duke bërë përpjekje të implementojmë një varg ligjesh të fushës teknike mbi bazën e parimeve të qasjes së re.

Nevoja për plotësimin e ndryshimin e Ligjit për produktet e ndërtimit numër 02-L/14 dhe nxjerrjen e Projektligjit të ri për produktet ndërtimit, vjen nga kërkesat e reja të përcaktuara me Rregulloren e Parlamentit Evropian 305/2011 për materialet e ndërtimit e cila përcakton kushtet për vendosjen në dispozicion të tregut të produkteve të ndërtimit, duke vendosur rregulla të harmonizuara për kërkesat themelore dhe shënimin e produkteve të ndërtimit.

Kjo Rregullore shfuqizon direktivën 89/106 për produktet e ndërtimit, me të cilën është harmonizuar Ligji për produktet e ndërtimit nr. 02-L/14 që aktualisht është në fuqi. Andaj, që Republika e Kosovës të integrohet në tregun e unifikuar të Bashkimit Evropian, që është një hapësirë e gjerë ekonomike ku mallrat, shërbimet, kapitali dhe puna mund të qarkullojnë lirshëm, ka qenë i nevojshëm edhe hartimi i Projektligjit për produkte të ndërtimit, në pajtim me kërkesat e Rregullores së lartpërmendur. Kjo njëherësh është edhe në funksion të përmbushjeve të obligimeve për t'u asociuar në mekanizmat e BE-së dhe duke pretenduar për një qasje të mundshme në tregun unik të BE-së dhe për këtë industrisë kosovare e në veçanti industrisë së produkteve të ndërtimit i nevojitet infrastrukturë e nevojshme ligjore për të rritur performansën në procesin e plotësimit të kërkesave themelore që shtrojnë direktivat e BE-së e në veçanti ato të fushës së produkteve të ndërtimit me të cilat do të mundësohej që në treg dhe në objektet e ndërtimit, të vendosen vetëm produkte të ndërtimit të sigurta në funksion të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të përdoruesve të tyre.

Me këtë ligj përcaktohen kërkesat teknike për përdorimin e produkteve ndërtimore, vlerësimi i konformitetit të tyre si kusht për vendosje në treg, distribuim dhe shfrytëzim në masën që i plotësojnë kërkesat themelore për objektet e ndërtimit, zbatimi i procedurave administrative, të drejtat dhe detyrimet e organeve të administratës shtetërore, personave juridikë dhe atyre fizikë.

Ligji përcakton detyrimet që kanë prodhuesit, përfaqësuesit e autorizuar dhe distributorët e këtyre produkteve. Aprovimi i projektligjit me të cilin do të rregullohet tregu i brendshëm do të mundësonte eliminimin e barrierave tregtare, pastaj kontrollin dhe funksionimin efektiv të tregut, shmangien e krijimit të pengesave si dhe rritjen e

konkurrencës në treg. Duke ditur rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë, ju ftoj që ta miratoni. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e datës 15 janar 2013, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për produktet e ndërtimit dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe njëkohësisht i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për produktet e ndërtimit dhe e mbështet në parim. Kontributin tonë do ta japim në procedurat e mëtejshme. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim do ta mbështesë projektligjin, megjithatë kemi disa dilema, mos të themi vërejtje në kuptimin e disa neneve specifike. E para ka të bëjë me atë se neni 10.1 dhe neni 35, e parashohin të obliguar vendosjen e shenjës CE në produktet tona. Është e paqartë se si mund prodhuesit tanë ta vendosin një shenjë CE e cila paraqet konformitetin evropian. I kemi të paqartë thjesht obligimin e prodhuesve tanë që ta vendosin këtë shenjë përkundër asaj që në raste të caktuara mund të mos i plotësojnë këto kushte. Në anën tjetër, natyrisht që ne nuk jemi pjesë e Unionit Evropian që ta kemi të drejtën e vendosjes së kësaj shenje.

Në anën tjetër, neni 15.2 parasheh detyrimet e importuesve që të sigurojnë që vlerësimi dhe verifikimi i konformitetit është kryer nga prodhuesi. Është e pamundur, kolegë deputetë që një importues cilido që, që të marrë përsipër apo të garantojë se prodhuesi i caktuar ka siguruar konformitetin e nevojshëm për prodhimin e atij produkti. Tjetra, po ashtu që ka të bëjë me distributorët, është që diku distributorët duhet të sigurojnë që produkti kur kërkohet, mban shenjën CE sipas nenit 16.2, që prapë themi është e pamundur nga distributorët për shkak se shumicën e mallrave importojnë, që i bie që nëse

një produkt nuk e mban shenjë CE, nuk do të duhej të shpërndahej nëpër tregun e Kosovës.

Po ashtu kemi të bëjmë me nenin 48.2, kthimi i produktit i cili kërkon që një produkt të kthehet në punët e ndërtimit tek personi i cili e ka lëshuar deklaratën e konformitetit. Ne besojmë se shumë këto gjëra në praktikën e biznesit janë të pamundshme që të kryhen, megjithatë do të mundohemi që gjatë punës së Komisionit ta japim kontributin tonë, në mënyrë që të kemi sqarime për të gjitha këto vërejtjet tona dhe natyrisht ta kemi një ligj sa më cilësor. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetët të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Duke pasur parasysh që industria e materialeve ndërtimore është një industri që ka potencial goxha të madh të zhvillimit në Kosovë edhe pse nuk është ndoshta në nivelin që do të duhej të ishte, me këtë ligj për materialet ndërtimore dhe me këtë kërkesë për standardizim të këtyre produkteve, mendoj që po kryhet njëra anë e punës, pra veçanërisht të përdorimi ta zëmë dhe shënimi i produkteve me shkronjat CE apo me standardet evropiane të cilat natyrisht se do ta konfirmonin, them ashtu, cilësinë e produktit edhe standardizimin e këtij produkti, gjë që është mirë për prodhuesit vendor në rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në treg.

Mirëpo, në anën tjetër duhet ta kemi parasysh se kjo mund ta ketë edhe këtë efektin tjetër anësor i cili është i rrezikshëm pastaj edhe i dëmshëm për prodhimin vendor, meqenëse prodhuesit e vendit do ta kenë sigurisht më të vështirë që ta marrin këtë lloj certifikate dhe këtë lloj standardizimi duke i pasur parasysh rrethanat në të cilat është Kosova dhe duke pasur parasysh moskokëçarjen e Qeverisë për t’i ndihmuar këta prodhues. Pra, në njërin anë është i domosdoshëm standardizimi, por me këtë standardizim që po e bëjmë këtu në Kosovë, pa i ndihmuar njëkohësisht prodhuesit në mënyrë që ta ngrenë ata standardin, ndihmë kjo që do të duhej t’u vinte nga shteti, atëherë ka rrezik që t’ua garantojnë tregun e produkteve ndërtimore atyre mallrave që importohen nga jashtë duke i shkelur kështu prodhuesit e vendit, gjë që nuk duhet të ndodhë në asnjë mënyrë.

Për sa i përket ligjit dhe neneve të cilat janë në këtë ligj, unë kisha dashur të mos përsëriten tash edhe ato që u thanë, por vetëm ta ngre edhe një çështje te ky organi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, i cili përmendet në shumë nene dhe që e ka përgjegjësinë kryesore për ta vlerësuar konformitetin e këtyre produkteve, as në definicione po as pastaj në pjesët tjera të ligjit, nuk përcaktohet qartë se cili organ do të jetë. Përveç që thuhet Qeveria apo në këtë rast Ministria do ta autorizojë një organ të caktuar për ta kryer këtë punë, nuk përmenden se cilat kritere do të duhej t’i përmbushte një organ i tillë, a do të jetë ai organ shtetëror apo privat dhe çka në përgjithësi, çfarë kërkesash profesionale kërkohen nga një organ i tillë në mënyrë që të mund ta kryejë këtë punë. Pra, unë mendoj që kjo duhet të qartësohet diku në ligj për shkak se kjo pastaj i lë goxha shumë arbitraritetit të Ministrisë të vendosë se cili do të jetë ai organ dhe

rrjedhimisht e minon të them ashtu logjikën e ligjit dhe të standardizimit të produkteve ndërtimore. Kështu që Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë në parim këtë ligj, por me këto dy vërejtje të cilat janë shumë të rëndësishme dhe që duhet të merren parasysh. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do ta votojë në parim këtë projektligj. Mendoj se shumë prej asaj që është dashur të thuhet, u tha, po duket se ligji është marrë nga ndonjë prej vendeve të cilat rishtazi i janë bashkuar Unionit Evropian, ose që janë gati dhe janë përcjell edhe normat të cilat atje ekzistojnë duke mos e pasur parasysh se në Kosovë nuk ka institucione të cilat do të mund të bënin një standardizim për shkak se ne nuk kemi mbërri deri aty. Sidoqoftë, mendoj se ka mundësi që ligji të përmirësohet dhe është ligj që i duhet Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit ministër për prezantimin e projektligjit,
Koalicioni për Kosovën e Re, e ka shqyrtuar Projektligjin për produktet e ndërtimit dhe duke marr parasysh çështjen e kërkesave të cilat duhet të përdoren për këto produkte të ndërtimit, vlerësojmë se ligji duhet sot të kalojë leximin e parë, mirëpo disa çështje duhet të amendamentohen gjatë punës së Komisionit Parlamentar. Në përgjithësi Koalicioni për Kosovë të Re, e përkrah projektligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, e ka fjalën kryetari i Grupit, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

I Samostalna liberalna stranka je razmotrila Nacrt zakona o građevinskim proizvodima i ovaj zakon kao i većina zakona ima veliki broj jezičkih nepravilnosti. Mi ćemo kroz Funkcionalnu komisiju pokušati da otklonimo te nepravilnosti, ali u pojedinim članovima ovog zakona se čak tim greškama menja i suština. Mi ćemo u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Për diskutim është lajmëruar deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Sot po vërehet edhe një problem që është vërejtur edhe herën e kaluar, mungesa e ministres të Tregtisë dhe Industrisë dhe zëvendëskryeministre. U vërejt edhe në Ligjin për investimet e huaja dhe po vërehet edhe këtu dhe kjo është një mungesë serioziteti ndaj punës të cilën ata pretendojnë se duhet për të kaluar në Kuvend. Prandaj, unë deklaroj votën kundër dhe vota kundër është po ashtu për ministren. Faleminderit!

KRYETARI: Tani nuk ka të lajmëruar për diskutim. Të pranishëm janë 61 deputetë, por po ju njoftoj se kur janë nënshkruar në letra janë 109 apo 113 gjithsej. Me kartela janë 101, kurse deputetë janë 63. Shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë, tash.

Konstatohet se me 53 vota për, 2 kundër, 4 abstenime, Kuvendi miratoi Projektligjin për produktet e ndërtimit, do të thotë, në parim.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me amendamentet.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komision Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin Blerand Stavileci, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Edhe një herë të nderuar deputetë,

Arsyeja për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit është përmbushja a e objektivave në fushën e tregtisë ku janë vërejtur disa vështirësi sa i përket zbatimit të ligjit aktual, e cilat janë të domosdoshme të ndryshohen me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sistemit të mbikëqyrjes si parakusht për zbatimin e shumë udhëzimeve dhe standardeve teknike të BE-së.

Gjithashtu me ligjin aktual, koordinimi i punëve me institucionet relevante të cilat merren me mbikëqyrjen e tregut ka qenë shumë i mangët dhe për këtë në disa raste në praktikë janë hasur ndërhyrje të kompetencave të Inspektoratit të tregut me institucionet e tjera. Nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/L - 181 për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, është harmonizimi me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Rregulloren nr. 765/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për nxjerrjen e kërkesave për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut në lidhje me marketingun e produkteve.

Gjithashtu në raportin e fizibilitetit për Kosovën për vitin 2012, është cekur se duhet të ndryshohet Ligji aktual për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut. Rëndësia e Ligjit të Inspektoratit dhe mbikëqyrjes së tregut është e pakontestueshme në ekonominë e tregut, duke marrë parasysh se inspektorati është njëra nga shtyllat themelore të mbikëqyrjes së tregut, cilësisë, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit të një ekonomie të tregut fer dhe të drejtë. Projektligji ka për qëllim rregullimin e mbikëqyrjes së tregut, fuqizimin e

strukturës organizative të Inspektoratit të tregut, trajnimin dhe provimin profesional për inspektorët e tregut, informimin e publikut, verifikimin e produkteve si dhe bashkëpunimin me autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të vendeve të tjera. Edhe ky ligj është në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së dhe i harmonizuar me asquis communautaire.

Duke ditur rëndësinë e këtij projektligji në fushën e Inspektoratit dhe me qëllim që nëpërmjet tij të mundësohet krijimi i një ambienti më të favorshëm për mbikëqyrjen e tregut, ju ftoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni këtë projektligj në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit, fjalën e ka kryetari Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e rregullt e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut dhe ka vlerësuar se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores të Kuvendit dhe i rekomandojmë Kuvendit, gjegjësisht grupeve parlamentare dhe deputetëve që ta miratojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet ministër,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Ligjin për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut. Me këtë ligj, siç e përmendi edhe ministri, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorëve të tregut, kontrollimi i produkteve, masat kufizuese, informimi i publikut, kushtet dhe procedurat e dhënies së provimit profesional për inspektorët e tregut, në bashkëpunim me autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të vendeve të tjera, si dhe parashihet që një varg i akteve nënligjore të nxirren që të zbatohet ky ligj më mirë.

Ne si Grup Parlamentar i kemi analizuar, i kemi identifikuar vërejtjet në këtë draft, kontributin tonë do ta japim në fazën e amendamentimit dhe ju ftoj ta mbështesni edhe ju në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe LDK-ja në parim do ta votojë projektligjin, megjithëse i ka disa vërejtje serioze, posaçërisht ka të bëjë me nenin 10.a, që i referohet provimit profesional të paraparë për inspektorët e tregut. Ne besojmë se është një nen apo një provim profesional plotësisht i panevojshëm që të parashihet për inspektorë të tregut duke marrë parasysh se një praktikë

të tillë nuk e kemi as te inspektoratet tjera, kurse në anën tjetër thellë besojmë se performansa e çdo të punësuar apo shërbyesi civil duhet të jetë ajo në bazë të cilës matet puna e tij e jo provimi profesional të jetë arsye për matjen e performansës apo jo të një shërbyesi civil.

Në anën tjetër ka dispozita të themi të pakuptueshme posaçërisht neni 11.a, i cili ka të bëjë me, në raste se inspektori vetëm mund t'i marrë parasysh raportet dhe certifikatat e konformitetit të lëshuara nga trupat e autorizuara. Është e pakuptimtë që nëse Ministria autorizon një tru për vlerësim të konformitetit që Inspektorati të ketë diskrecion të plotë të themi t' i pranojë apo të mos i pranojë ato certifikata.

Po ashtu, neni 11, neni 25.3 ka të bëjë me pagesën e shpenzimeve në raste që është e përcaktuar me akte të veçanta që është një nen plotësisht i pakuptueshëm.

Në anën tjetër janë disa dispozita të panevojshme sikurse ajo që ka të bëjë me raportimin e kryeinspektorit ndaj ministrit e që besoj se rregullohet me akte interne si dhe informimi i publikut.

.. Në parim do ta votojmë projektligjin dhe gjatë punës në Komision do të mundohemi që thjeshtë t'i riparojmë apo t'i përmirësojmë çështjet e caktuara që u përmendën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" do të votojë për këtë ligj edhe për këtë plotësim ndryshim ligji dhe pastaj vërejtjet tona do t'i japim në Komision.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në parim këtë projektligj. Ato çka besoj u thanë edhe pak më herët dhe ne mendojmë se definitivisht ajo barabarësia mes inspektorëve në këtë rast edhe inspektorëve të tregut me inspektorët e fushave të tjera duhet të vendoset dhe të mos ketë ndryshueshmëri dhe megjithatë të gjitha vërejtjet dhe kontributin do t'i japim në Komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Duke marrë parasysh se edhe Ministria edhe ministrja duhet të standardizojnë ligjet në bazë të direktivave të BE-së.

Mund të themi se në nenin 10.a, ku zotëri Zharku ngriti këtë çështje, ndoshta ministrja gjatë kohës së amendamentimit të projektligjit do të na bëjë më të qartë çështjen e këtij trajnimi dhe provimi profesional, mirëpo në këtë rast votohen ligjet dhe jo ministrja se ministrja është trup politike.

Koalicioni për Kosovë të Re përkrah projektligjin dhe të gjitha vërejtjet do t'i japë në Komisionin Parlamentar.

KRYETARI: Nga "6+", nuk është lajmëruar askush. Nga SLS-ja, nuk është lajmëruar askush. Kemi dy deputetë të interesuar për diskutim. Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë do të diskutoj shumë shkurt dhe po besoj se grupet punuese dhe Komisioni Funkcional, do ta kenë parasysh të gjithë fushën të cilën e rregullon ky ligj zhvillohet në nivelin lokal dhe gjithmonë është mirë sa më tepër për të bartur kompetenca kah niveli lokal ku kishte për t'u menaxhuar më mirë se sa kjo formë. Eventualisht do ta kisha përshëndetur sikur ky ligj të kishte paraparë një tranzicion 2-3-vjeçar deri në fuqizimin e strukturave komunale.

Mund ta kuptoj që aspekti profesional, laboratorët dhe çështjet e tjera aftësimet, trajnimet të jenë në nivel qendror, ndërsa niveli qendror të bëjë monitorimin dhe mbështetjen, ndërsa gjithë fusha të rregullohet në nivelin lokal, sepse ka përvoja të tilla dhe do tregohet sigurisht më i suksesshëm.

Me këtë po e marrë vetëm një shembull, ne e kemi situatën dhe problematikën e naftës, sikur të ishte aplikuar tek ne që i dëmtuari ta padisë Ministrinë edhe shtetin për jokalitetin e naftës dhe dëmet që na shkaktohen, sigurisht se duhet menaxhuar pak më ndryshe .

Prandaj, duke i marrë këto përvoja, unë po shpresoj se Komisioni Funkcional, gjegjësisht grupet që do të punojnë, do ta rregullojnë ligjin asisoj që të jetë në monitorim të Ministrisë, në funksionim lokal dhe një tranzicion 2-3 vjeçar deri në fuqizim të strukturave lokale. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Një çështje që do të doja ta ngre ka të bëjë vetëm me këtë ligj, mirëpo edhe me ligje tjera, por po potencoj me Ligjin kur thuhet se ky ligj ka edhe implikime buxhetore dhe në praktikë do të jetë i pazbatueshëm.

Do të thotë kemi një numër të madh të ligjeve që në Kuvendin e Kosovës na vijnë ku deklaratat financiare paraqesin implikime të mëdha buxhetore dhe njëkohësisht paraqesin ato vërejtje të cilat nuk janë në kornizën afatmesme.

Kjo konsideroj se është në kundërshtim edhe me Rregulloren e Kuvendit, sepse ligjet e tilla vetëm po aprovohen në Kuvend, por nuk po implementohen në praktikë.

Në brendësi në këtij ligji një çështje shumë e rëndësishme që e thanë edhe parafolësit, por kisha kërkuar që gjatë leximit të dytë në kuadër të këtij Komisioni, të kihet parasysh se inspektorët e tregut duhet t'i gëzojnë benificionet sikurse inspektorët të tjerë, do të thotë, përpos pagës së rregullt të kenë edhe benificione të tjera për shkak të ngarkesës dhe punës të cilën e bëjnë në terren. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Shkojmë në votim. Të pranishëm janë 66 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 58 deputetë për, 2 kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershëm që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Të pranishëm janë 66 deputetë, prania fizike, 98 me prezencë elektronike.

Vazhdojmë pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin Blerand Stavileci, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, kryetar!

Fushëveprimtaria që përkufizohet me Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës nuk ka qenë më parë e rregulluar, prandaj me këtë projektligj plotësohet infrastruktura ligjore dhe sigurohet vazhdimi i forcimit të sistemit të mirëfilltës të mbrojtjes së të drejtave pronësore-industriale në Kosovë.

Konsiderojmë që miratimi i projektligjit në fjalë ka rëndësi ekonomike për Kosovën. Produktet vendore të cilat posedojnë cilësi të lartë për shkak se vijnë nga një rajon i caktuar do ta forcojnë pozitën e tyre në treg pasi t'i kenë mbrojtur të drejtat e tyre që rrjedhin nga ky ligj.

Në këtë mënyrë mbrohet reputacioni i produkteve të cilat rrjedhin si rezultat i pozitës gjeografike, aftësive tradicionale të një rajoni të caktuar.

Gjithsesi, eksportimi i këtyre produkteve luan rol të rëndësishëm në pasqyrimin dhe promovimin e prodhimeve vendore, njohurive tradicionale si dhe karakteristikave socio-ekonomike dhe intelektuale të vendit tonë.

Me këtë projektligj rregullohet nocioni i treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, mënyra e fitimit dhe mbrojtjes së produkteve dhe shërbimeve të cilat cilësohen si tregues gjeografikë apo emërtime të origjinës, kohëzgjatja e mbrojtjes, rregullat e përfaqësimit në këtë fushë, ashtu sikurse edhe dispozitat ndëshkuese në rastet e keqpërdorimit të këtyre të drejtave.

Projektligji në fjalë është bazuar në Rregulloren e Këshillit Evropian numër 510/2006 të 20 marsit 2006 mbi mbrojtjen e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimor.

Ndërsa, parimet bazë në kuadër të respektimit të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve gjeografike të vendeve tjera rrjedhin nga Konventa Ndërkombëtare e Parisit për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale.

Miratimi i këtij projektligji është gjithashtu përmbushje e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Progresit dhe studimi i fizibilitetit për vitin 2012.

Përfundimisht, duhet cekur se miratimi i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, është përmbushje e rekomandimeve të bëra nga Komisioni Evropian, plotësim i infrastrukturës ligjore, stimulim i mbrojtjes së produkteve vendore, promovim i ekonomisë kosovare dhe përgatitje për përmbushje të obligimeve ndërkombëtare.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Kërkoj nga ju që ta miratoni këtë projektligj dhe të sigurojmë mbrojtje për të gjitha produktet vendore të cilat konsiderohen si tregues gjeografikë dhe emërtime të origjinës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Treti dhe Industri, në mbledhjen e vet të rregullt të datës 22 janar e ka shqyrtuar këtë projektligj duke konsideruar se është ndër projektligjet e rëndësishme të kësaj fushe dhe një ligj po ashtu që na ka munguar. Komisioni në mënyrë unike e ka mbështetur këtë projektligj. Konsiderojmë se në bazë të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit i plotëson kushtet e parapara dhe i rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministra, deputetë,

Ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar ligjin në fjalë, përkundër disa vërejtjeve që i ka hasur në disa nene që kanë dykuptimësi, ne do ta mbështesim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në fazat e më tutjeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe vlerëson se ai paraqet një bazë të mjaftuar në mënyrën e fitimit dhe mbrojtjes së emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë të produkteve.

Po ashtu vlerësojmë se me këtë ligj krijohet siguri më e madhe për prodhuesit si dhe ngushtohet mundësia për manipulime apo keqpërdorime me emërtimin e origjinës dhe treguesit gjeografikë.

Duke pasur parasysh këtë, Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim përkrah këtë projektligj me shpresë se në procedurën e mëtutjeshme parlamentare do të eliminohen mangësitë dhe mund të jepen vërejtje, propozime që të kompletohet ky ligj.

Ky projektligj i cili është mjaft voluminoz definon qartë procedurat për marrjen apo për humbjen e një emri, ndonëse nuk mund t'i bëhen shumë vërejtje, në disa vende ka paqartësi dhe pasaktësi, të cilat mund t'i nxjerrin probleme në fazën e implementimit të tij.

Gjatë shqyrtimit në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës kemi evidentuar disa mangësi të cilat po i përmend në vazhdim.

Neni 10, homonimet e emërtimeve të origjinës apo treguesi gjeografikë, pika një i këtij neni ka një paqartësi, aty thuhet, citoj: “një emër plotësisht apo pjesërisht homonim me kuptim identik apo po thuaj se identik në të shkruar ose në të shqiptuar, me atë të emrit i cili është regjistruar sipas këtij ligji, regjistrohet duke pasur parasysh përdorimin vendor dhe tradicional si dhe rrezikun për shkaktim të konfuzionit”

Si mund të regjistrohet një emër kur është e qartë se ai mund të shkaktojë konfuzion dhe amulli në treg sa i përket një produkti të caktuar.

Ndërkaq pika 2, qartëson këtë çështje, por tash këto dy pika bien ndesh njëra me tjetrën. Aty thuhet, citoj: “përdorimi i homonimeve të bëhet ku ka dallim të mjaftueshëm në praktikë mes homonimit të posa regjistruar dhe emrit të regjistruar më pas duke pasur

parasysh trajtimin e prodhueseve në fjalë në mënyrë të barabartë dhe të mos çorientohet konsumatori”. Do të thotë se në pikën një pranohet rreziku për konfuzion, ndërsa pika 2 kërkon dallime të mjaftueshëm mes homonimeve.

Neni 13, marrëdhëniet në mes markave tregtare, emërimit të origjinës dhe treguesit gjeografikë.

Në pikën 2, të këtij neni thuhet se markat tregtare të regjistruara në kundërshtim me paragrafin e mësipërm do të shfuqizohen. Mirëpo, nga kush do të shfuqizohen nga Agjencia apo zyra kompetente, apo kjo çështje mund të kontestohet në gjykata?

Neni 27, verifikimi i pajtueshmërisë me ‘svigacionet’.

Në pikën 1 të këtij neni thuhet se autoritetet apo organet e autorizuar për verifikimin e pajtueshmërisë së produktit me dispozitat e ‘svigacionit’ duhet të jenë institucionet e autorizuar dhe të pranuar për verifikim të pajtueshmërisë së produkteve me dispozitat e ‘svigacionit’.

Ky nen nuk saktëson se cilat janë këto institucione, a janë të pavarura apo veprojnë si pjesë e një institucioni tjetër e as mënyrën se si funksionojnë ato?

Në nenin 74, kompetenca ekskluzive e gjykatës në seanca për kundërvajtje.

Pika 1, e këtij neni, Gjykata Kompetente për Kundërvajtje në Prishtinë ja jep të drejtën ekskluzive për të marrë vendim të shkallës së parë për rastet e kundërvajtjes ndaj markave tregtare.

Ne si Grup Parlamentar vlerësojmë se nuk ka arsye që këtë të drejtë ekskluzive ta ketë vetëm një gjykatë për dy arsye.

Në gjykatë duhet të kenë qasje të gjitha palët në kontest dhe autorizimi që vetëm një gjykatë të ketë të drejtë, mund të rrezikojë që ajo të ketë mbingarkesë me lëndë dhe në këtë mënyrë do të vonohen zgjedhjet e kontesteve.

Këto ishin disa vërejtje paraprake të Grupit Parlamentar të LDK-së në procedurat e mëtutjeshme parlamentare do të vazhdojmë ta vlerësojmë edhe analizojmë këto propozime tona të ligjit dhe me kohë do t’i paraqesim vërejtjet dhe sugjerimet në grupet punuese.

Dhe ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta përkrahin në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlament të Lëvizjes “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë në parim këtë ligj. Mendojmë që është një ligj goxha i mirë që e mbulon këtë çështje edhe është një çështje e rëndësishme, veçanërisht këtu për disa produkte të Kosovës, të cilat e kanë një lloj tradite edhe që kanë fituar një lloj kredibiliteti si produkte edhe për shkak se vijnë prej rajoneve të caktuara.

Unë vetëm një pyetje e kam më shumë se sa që po e ngre si çështje përveç këtyre vërejtjeve teknike që u thanë këtu.

Në ligj parashihet që personi fizik apo juridik do të ketë të drejtë natyrisht që të aplikojë për t’u mbrojtur emërtimi gjeografik i një produkti të caktuar edhe jashtë Kosovës, për shkak se këtu flitet vetëm për atë se çka do të bëjnë institucionet e Kosovës për produktet e Kosovës apo për ato që vijnë nga jashtë Kosovës.

Dhe këtu mendoj që është e domosdoshme ndihma e shtetit. Pra, ndoshta ministri mund të na përgjigjet edhe pse nuk i takon ndoshta fushës së tij, por ka lidhje edhe me resorin e tij se çfarë ndihme do t’u japë shteti produkteve të caktuara të Kosovës në mënyrë që ta kenë të mundur ta mbrojnë dhe ta regjistrojnë emërtimin e tyre në shtetet jashtë Kosovës, ku ato ose eksportohen ose kanë potencial të eksportohen për shkak se mendoj që kjo ka të bëjë edhe me një lloj kredibiliteti të imazhit të them ashtu të Kosovës apo prodhimeve të Kosovës që eksportohen jashtë, gjë që është shumë e rëndësishme që të mirëmbahet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e ka fjalën deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Ministra, kolegë deputetë,

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës përkrah në parim këtë projektligj. Besoj që i ka munguar këtij legjislacioni. Mirëpo, ky projektligj i ka disa të meta. Unë dua të veçoj kreun III, është shumë i pakuptueshëm dhe duhet të riformulohet. Gjithashtu edhe nenin 26 dhe nenin 22 dhe nuk është e caktuar qartë se kush nxjerr akte nënligjore dhe mosharmonizim me ligjin në fuqi me gjykatat. Këto janë disa nga vërejtjet që jep Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por në parim do ta përkrahim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funkcional dhe në komisionet kryesore ku do të kalojë ky projektligj.

Shpresojmë që është një prej projektligjeve që ka rëndësi për ekonominë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah Projektligjin për treguesit gjeografikë.

KRYETARI: Të lajmëruar nuk ka. Shkojmë me procedurën e votimit. Të pranishëm fizik 61 deputetë, me elektronikë 95. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 34 vota për, asnjë kundër, një abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për treguesit gjeografikë.

Mirë, dëgjoni dhe shikoni pak përpara, e keni aparaturën.

Edhe një herë. Votojmë tash!

Me 54 vota për, dy kundër, një abstenim, në votimin e dytë, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për treguesit gjeografikë.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin Blerand Stavileci, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Qëllimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve është që të sigurohet nivel i lartë i mbrojtjes së përdoruesve, përkatësisht konsumatorëve dhe të sigurohet qarkullimi i mallrave të konsumit në tregun e brendshëm.

Në bazë të dispozitave të këtij projektligji prodhuesit obligohen që t'i plasojnë në treg vetëm produkte të sigurta, distributorët obligohen që të veprojnë me kujdesin e duhur dhe në pajtim me kërkesat e përcaktuara të sigurisë, sidomos në rastet e dorëzimit apo mosdorëzimit të produkteve, për të cilat janë në dijeni ose është dashur të kenë dijeni, se nuk i plotësojnë këto kërkesa.

Në rast se prodhuesit ose distributorët janë në dijeni se çfarë rreziku potencial do të mund të paraqiste për konsumatorë një produkt i cili është plasuar në treg, janë të detyruar që për këtë t'i informojnë organet përgjegjëse inspektuese të cilat zbatojnë mbikëqyrjen e tregut.

Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet, pavarësisht mënyrës së tregtimit apo shitjes së tyre, përfshirë këtu shitjen elektronike dhe atë në distancë.

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen edhe për produktet, siguria e përgjithshme e të cilave nuk është rregulluar me akt të veçantë.

Me qëllim të plotësimit të kërkesave të përgjithshme që në treg të plasohen vetëm produkte të sigurta dhe të sigurohet nivel vërtet i lartë i mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve si dhe funksionim pa pengesë i tregut të brendshëm, organeve kompetente inspektuese u mundësohet të ndërmarrin masat e duhura, në bazë të dispozitave të cilat u janë drejtuar prodhuesve, përkatësisht distributorëve në kufijtë e veprimtarive të tyre, në veçanti distributorëve të cilët janë përgjegjës për shpërndarjen e parë të produkteve në Republikën e Kosovës dhe në drejtim të secilit person tjetër, me qëllim që të eliminohen rreziqet serioze të cilat mund t'i shkaktojnë një produkt i tillë.

Me qëllim të efikasitetit të zbatimit të këtij projektligji janë specifikuar edhe kompetencat e organeve përkatëse inspektuese. Kërkesat e përgjithshme të cilat dalin nga ky projektligj përcaktojnë qartë dhe saktë rezultatin e dëshiruar që duhet të arrihet në ngritjen e infrastrukturës së cilësisë dhe vendosjen e produkteve të sigurta në treg. Një rëndësi e veçantë është që projektligji i jep të drejtën publikut, për të qenë i informuar për produktet e rrezikshme dhe përmban dispozita, në bazë të cilave organet kompetente do t'u mundësojnë qytetarëve akses në informata, që kanë të bëjnë me ekzistimin e produkteve të rrezikshme në treg.

Njëri nga obligimet ndaj Bashkësisë Evropiane është ngritja dhe menaxhimi i sistemit për shkëmbimin e shpejtë të informacioneve për produktet të cilat paraqesin rreziqe serioze për konsumatorët, i ashtuquajtur i RAPEX.

Duke iu referuar dispozitave të Projektligjit për sigurinë e përgjithshme, do të miratohet Rregullorja për sistemin e shkëmbimit të informatave dhe njoftimin për produkte të cilat paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve.

Andaj, që Republika e Kosovës të integrohet në tregun e unifikuar të Bashkimit Evropian, i cili është një hapësirë e gjerë ekonomike, ku lirshëm qarkullojnë mallrat, shërbimet, kapitali dhe punëtorët, ka qenë e nevojshme ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, i cili është hartuar në pajtim me kërkesat e Direktivës 2001/95.

Duke pasur parasysh rëndësinë që paraqet ky projektligj, si dhe legjislacioni i saj për ngritjen e infrastrukturës së cilësisë, lëvizjen e lirë të mallrave, vendosjen në treg dhe

përdorimin e produkteve, pa rrezikuar jetën dhe shëndetin e përdoruesve, përkatësisht konsumatorëve, ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ministra, kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 29 janarit e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe ka vendosur që Kuvendit t'i rekomandojë aprovimin në parim, meqenëse konsiderohet që i plotëson të gjitha kushtet sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar, deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë.

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar ligjin në fjalë, e mbështet në parim. Vërejtjet tona, të cilat i kemi në nene të ndryshme të këtij draftligji, kontributin për këto do ta japim në Komisionin FunkSIONAL gjatë fazave të mëtutjeshme. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka fjalën deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Ky ligj për sigurinë e përgjithshme të produkteve, synon të rregullojë fushën e sigurisë së përgjithshme të produkteve dhe atë nis prej prodhimit, prej tregtimit, distribucionit të tyre, si dhe përdorimit.

Dhe, në ato vende ku siguria e përgjithshme e produkteve nuk është e rregulluar me ligj, në treg mund të gjenden produkte të cilat dëmtojnë pronën, shëndetin dhe jetën e qytetarëve.

Ky projektligj që e kemi marrë është i shoqëruar me memorandum dhe thuhet që është në përputhje me *acquis communautaire* dhe se ashtu si thotë në ligj, në memorandum, nuk janë vërejtur mospërputhje të mëdha ndërmjet versioneve në shqip dhe anglisht, gjë e cila duhet të shqyrtohet në Komision.

Deklarata financiare thotë që nuk do të ketë kosto buxhetore dhe se ky ligj do t'i shfrytëzojë ndarjet buxhetore sipas KASH-it, sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve 2013 dhe 2015.

Tabela me listën e përgjigjeve thotë se nuk ka ndonjë kundërshtim. Në këtë projektligj shohim që shumica e neneve nuk kanë tituj, që presim që ato me siguri janë përcjell nga titujt e ligjit bazë, ndonëse do të duhej që nenet, apo amendamentet të cilat janë propozuar të kishin titujt e tyre.

Në nenin 6 flitet për zgjerimin e kompetencave të inspektorëve të tregut, si verifikimi i karakteristikave, marrja e informatave dhe mostrave, shënimin dhe informimin mbi rrezikun për persona të caktuar, si dhe ndalimin e vendosjes në treg deri në masën e heqjes së mallit nga konsumatorët si masë e fundit dhe shkatërrimin e atij produkti, që mund të shkaktojë rrezik në përdorim.

Neni 6.2.6.3 është mjaft i paqartë dhe mendoj që do të ketë nevojë për një riformulim.

Neni 6.7 flet për mënyrën dhe afatet e paraqitjes së ankesës, në të cilën përsëri duhet të intervenohet, besoj.

Në nenin 6.9 paraqitet mundësia e aranzhimit të institucionit ose individit të kualifikuar, në rast të mungesës së ekspertizës profesionale, apo mungesës së njohjes së materies, gjë e cila hap mundësinë për shfrytëzimin apo për inkuadrimin edhe të bizneseve private, që mendoj që do të jetë lajm i mirë.

Në nenin 8a.1 flitet për kontrollin doganor të produkteve dhe ndalimin për tri ditë nëse ka dyshime për rrezikun serioz për shëndetin e konsumatorëve dhe informimit të Inspektoratit. Por, në paragrafin e ardhshëm ajo e lëshon atë produkt në qarkullim, në qoftë se Inspektorati nuk i përgjigjet kërkesës së doganës, e cila bie ndesh me fillimin e këtij neni, ku flitet për rrezikun serioz për shëndetin e konsumatorëve dhe mendoj, që në Komision do të duhet të shihet a është rreziku për shëndetin e konsumatorëve më i rëndësishëm, apo përgjigja me kohë e Inspektoratit.

Në nenin 9 flitet për gjoba prej 100 – 400 euro për persona fizikë, 200 – 600 për persona përgjegjës të personit juridik dhe 1 mijë deri në 3 mijë për personin juridik. Edhe këtu duhet të kemi parasysh se në qoftë se flitet për produkte të cilat mund të kenë një rrezik serioz për shëndetin e konsumatorëve, atëherë edhe ky nen do të duhej që të ishte konform mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve.

Në nenin 9.4 thuhet që gjobat nuk do të shqiptohen nëse prodhuesi ose shpërndarësi merr masa për plotësimin e kërkesave të sigurisë dhe bashkëpunimit me Inspektorat, që mendoj që është mirë.

Kemi edhe vërejtje tjera në nene tjera, të cilët mendojmë se mund të përmirësohen gjatë punës së Komisionit.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së do të votojë për këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Shumë shkurt edhe ne do ta votojmë këtë ligj, por dua ta përsëris edhe njëherë vërejtjen që e tha zonja Sahatqija për sa i përket gjobave, për shkak se duhet ta kemi parasysh që gjobat duhet të jenë në nivel me çështjen për të cilën po flasim. Pra, nëse thirremi në Ligjin për mbrojtjen apo për sigurinë e produkteve, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me shëndetin e qytetarëve apo edhe me ndonjë rrezikshmëri më të madhe në Kosovë, atëherë edhe gjobat duhet të jenë të këtij niveli, s'mund të shkojmë me gjoba shumë të vogla. Dhe, kjo puna e gjobave, se kam parë shpesh të diskutohet këtu, nuk duhet të kuptohet si një lloj zelli për ndëshkim ndaj biznesit, qoftë ai prodhues apo tregtar, por duhet të kuptohet si një masë parandaluese e shkeljes së ligjit e veçanërisht në këtë rast masë parandaluese e shaktimit të rrezikut apo dëmtimit të shëndetit të qytetarëve.

Prandaj, konsiderojmë që gjobat, duke u bazuar edhe në shkeljet, nivelin e shkeljeve duhet të jenë më të larta, për sa i përket kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë në parim këtë projektligj për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, por pa dashur të përsëris asgjë tjetër, vetëm po tentojmë të them se shëndeti i konsumatorit do të duhej që të jetë qëllimi ose detyra primare edhe në këtë plotësimin e ligjit, që po bëhet.

Nuk jemi të bindur që me këtë draft që është propozuar, si i tillë do ta arrijmë efektin ose do ta arrijmë qëllimin që e ka për shëndetin e konsumatorit. Do të thotë, nëse ky është qëllimi primar, atëherë do të duhet që gjatë punës në Komision, këto çështje të qartësohen, të detajohen dhe në të njëjtën kohë të marrin formën e mirë, për të pasur efekt.

Përndryshe, pas një kohe tepër të shkurtër, disamujshje prapë do të kemi plotësim-ndryshim të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, e ka fjalën kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji në favor të qytetarëve të Kosovës, Koalicioni për Kosovën e Re përkrah projektligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Të lajmëruar për diskutim nuk ka. Shkojmë në procedurën e votimit. Të pranishëm janë 70 deputetë, prania fizike, 96 elektronike. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Për kanë votuar 60 deputetë, kundër një, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonat ekonomike

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për zonat ekonomike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar edhe në lexim të dytë këtë projektligj.

Dëshiroj të shfrytëzoj rastin t'i falënderoj deputetët, grupin punues dhe të gjithë partnerët që kanë qenë me ne në amendamentimin dhe në gjithë punën edhe në dëgjimin publik dhe në të gjithë aktivitetet deri në këtë fazë. Dhe, po ashtu kërkoj nga Kuvendi që ta miratojë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë me votimin e amendamenteve.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9. *(Dëgjohet debat në sallë.)*

Mirë, 3 kundër, shumica janë për.

Amendamenti 10.

Një kundër, të tjerët pajtohen.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Deputeti Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, e ke fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Këtu kemi të bëjmë me nenin 14 të ligjit bazë, që flet për lehtësirat për bizneset që operojnë në kuadër të zonave ekonomike dhe që nënkupton nxjerrjen e akteve nënligjore.

Komisioni e ka ndryshuar ku thotë nga “ministria” zëvendësohet me “Qeveria”. Mua ma merr mendja që kanë bërë gabim, sepse Ministria është e autorizuar t’i nxjerrë aktet nënligjore në fushëveprimtarinë e vet e jo Qeveria komplet. Prandaj, duhet të mbetet ashtu, siç ka qenë në ligj.

KRYETARI: Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ka qenë kjo pjesë e debatit brenda Komisionit. Meqenëse, nuk është fjala vetëm për udhëzime administrative të ligjit, meqenëse është fjala për një koordinim të disa interesave edhe të pushtetit lokal edhe qendror, që del nganjëherë përtej mundësive të një Ministrie, e kemi lënë që Qeveria, në të shumtën e rasteve, Ministria do të jetë aktori ose vendimmarrësi kryesor, për këto çështje, por e kemi lënë mundësinë, që Qeveria kur ka diçka që duhet të koordinojë edhe me pushtetin lokal edhe me ministrinë tjera, t’u lihet kjo kompetencë.

Kjo nuk e zbehë aspak atë që thotë kolegu, veç i jep shansin edhe Qeverisë për raste të veçanta të jetë vendimmarrës ose të bëjë aktivitete shtesë, qoftë edhe dokumente rrjedhëse administrative. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë shkojmë në votim me elektronikë. Komisioni është që të mbetet kështu si është, nëse shkon, vazhdojmë votimin.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 48 vota për, 14 kundër dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka. Miratohet.

Amendamenti i fundit 27.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Pra, s'kemi tjera amendamente. E votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Të pranishëm janë 76 deputetë, prania fizike, kurse elektronike 95. Votojmë tash!

Me 61 vota për, 4 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për zonat ekonomike.

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet e Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve t'i arsyetojë amendamentet. Deputetja nuk është.

Atëherë, shkojmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

E tani e miratojmë ligjin në tërësi. 74 deputetë janë të pranishëm. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 67 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor me tarifë zero të tatimit doganor.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-ës, deputetin Ahmet Isufi, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me amendamente.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar dhe amendamentuar këtë ligj, prandaj kërkojmë vetëm votimin e amendamenteve.

KRYETARI: Të gjitha amendamentet janë të Komisionit FunkSIONAL. Janë gjithsej 14 amendamente.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

E tani i lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe e votojmë ligjin në tërësi.
Votojmë tash.

Të pranishëm janë 76 deputetë.

Për kanë votuar 66, kundër 3 dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Në radhë është pika e trembëdhjetë:

13. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur edhe nga 19 deputetë, lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë

Sipas kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur nga 19 deputetë të tjerë lidhur me gjendjen në sportin e Kosovës.

Deputeti Bekim Haxhiu, Vjollca Krasniqi dhe grupi i deputetëve nënshkruar, në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit kanë kërkuar debat parlamentar për gjendjen e sportit në Kosovë.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 8 shkurt 2013, ka vendosur që këtë pikë ta radhisë për mbledhjen e sotme plenare.

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar kërkoj që të bëjmë një ndërrim të pikave të rendit të ditës, debati mund të pres edhe për ndonjë seancë tjetër dhe kisha kërkuar që të kalojmë në pikën 14 në votimin e Bordit të AKP-ës, për shkak të rëndësisë që e ka votimi i këtij bordi.

Prandaj, i kisha lutur të gjithë deputetët për mirëkuptim dhe ta bëjmë këtë ndryshim të radhitjes së pikave të rendit të ditës.

KRYETARI: A do për ta hequr prej rendit të ditës, a qysh është puna?

ADEM GRABOVCI: E heqim për një seancë tjetër.

KRYETARI: Atëherë, le të deklarohet seanca. Kush është për kërkesën?

(Ndërhyrje)

Atëherë, shfave të grupeve po ua jap fjalën. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që së pari është miratuar rendi i ditës dhe është shumë e qartë. E para dhe e dyta, nuk mendoj që sportistët meritojnë të presin , qysh kanë pritur edhe 12 vjet e ndoshta të mos bëhet kurrë debat për ta, për gjendjen, për nevojat e tyre dhe ne jemi kundër që të shtyhet, por jemi të mbahet debati parlamentar.

KRYETARI: Nga “Vetëvendosja”, fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERY: Po ashtu kryetar, mendojmë se nuk është praktikë e mirë që duhet të instalojmë këtu në Kuvend që të ndryshohet rendi i ditës kurdo që t’i teket dikujt për cilën do pikë. Ne e nisëm debatin, deputeti që ka kërkuar debat ishte nisur rrugës drejt foltores, e u kërkuar që kjo pikë dhe ky debat të shtyhet për një seancë tjetër. Mendoj se Bordi i AKP-ës mund të presë edhe deri nesër. Pra, duhet të vazhdojmë me atë rend të ditës që e kemi. Pra, të edhe të vazhdojmë dhe debati kur të përfundojë, e kemi pikën për Bordin e AKP-ës dhe mund ta vazhdojmë seancën nesër, nuk është e domosdoshme ta përfundojmë sot. Faleminderit!

KRYETARI: Me nenin 50 të Rregullores së Kuvendit, një grup parlamentar ka të drejtë të kërkojë mocion për ta shtyrë një debat. Do të thotë kjo është me Rregullore dhe ekziston kjo mundësi. Por, po shkojmë tutje. Në emër të AAK- së, kryetari i Grupit Parlamentar, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne nuk po shohim ndonjë arsye për këtë punë dhe mendojmë se edhe sonte kemi kohë t'i kryejmë pikat e mbetura të rendit të ditës dhe kërkojmë që të kryhen pikat e rendit të ditës. Nuk po shohim arsye se diçka mund të ndryshojë deri nesër apo deri në javën tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!

Duke marrë parasysh se ministri për Kulturë nuk është i pranishëm këtu, do të ishte mirë që ai të ishte i pranishëm gjatë këtij debati, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah që kjo pikë të mbetet për një seancë tjetër, ndërsa të shqyrtohet propozim-vendimi i Qeverisë për Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

KRYETARI: Nëse i presim ministrat që të vijnë, duhet t'i shtyjme gjithmonë seancat. Në emër të SLS-së, fjalën e ka kryetari Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

I Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke se slaže sa predlogom predsednika Poslaničke grupe PDK, da se tačka 13 odloži za neku narednu sednicu. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuesi i mocionit, deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë sportistë dhe sportdashës sot i kanë drejtuar sytë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, për arsye se për herë të parë është radhitur në këtë seancë debati për sportin dhe sportistët, për gjendjen e sportit në Kosovë.

Unë do të pajtohem me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nëse ky debat do të ishte në seancën e radhës, pra të shtyhet për seancën e radhës, mirëpo jo të shkojë më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: E kemi mocionin dhe do të shkojmë në deklaram me elektronikë.

Kush është për kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike? Votojmë tash!

Në sallë janë të pranishëm 80 deputetë.

Me 40 vota për, 34 kundër dhe 2 abstenime shtyhet debati për seancën e radhës.

Tash është pika e katërmëdhjetë e rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ka qenë i radhitur në mbledhjen plenare me 6 dhjetor 2012, por është hequr nga rendi i ditës me arsyetimin se duhet të plotësohen CV-të, siç po thuhet, të kandidatëve të propozuar, ose biografite e kandidatëve të propozuar. Dhe është mirë të thuhet disa gjëra shqip, se shqip po flasim.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i ka shqyrtuar biografite e plotësuara të kandidatëve të propozuar për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Prej Qeverisë nuk kemi askënd që e arsyeton. Kryetari i Komisionit Funkcional, Zenun Pajaziti e ka fjalën, e pastaj është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ministra e kolegë deputetë,

Siç e dini Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, kohë më parë e ka trajtuar listën e propozimeve për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ky aprovim atëherë është përcjell në Kuvend me vërejtjen e disa deputetëve se duhet të plotësohet me shënime në biografite e tyre dhe atëherë seanca ka marrë vendim që të bëhet ky plotësim.

Dhe meqenëse javën që shkoi, i kemi marrë të plotësuara biografite e këtyre anëtarëve të propozuar, ne e kemi njoftuar Komisionin dhe është vendosur që procedura të përcillet në seancë.

Unë personalisht kërkoj që sa më shpejt të jetë e mundur Kuvendi t'i aprovojë, të miratojë, t'i zgjedhë dhe plotësojë këtë Bord të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Dhe siç e dini ka disa valë të privatizimit që presin kompletimin e Bordit që të zyrtarizohen e miratohen këto procese të cilat në rast vonese mund t'u shkaktojnë humbje jo vetëm agjencisë dhe fondit, por edhe atyre që kanë deponuar mjete të tyre për blerjen e pasurive të ndryshme. U rekomandoj deputetëve që ta votojnë këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm fizikë janë 80 deputetë, të pranishëm elektronikë 91. Ju lus që t'i hiqni kartelat e deputetëve që nuk janë të pranishëm.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, a e do dikush fjalën? Jo.

Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike? Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Asnjë arsye nuk ka pushuar nga ajo që e kemi thënë herën e kaluar dhe propozimi i sotëm është propozim për njerëz që janë politik, janë në organe realisht drejtuese në PDK, në këtë rast, dhe ne e kemi thënë qëndrimin tonë dhe nuk e di se a po i përcjell dikush edhe vërejtjet e Komisionit Evropian e që ka vërejtje që këtu, në këtë Kosovën tonë të dashur

dhe demokratike, po bëhen emërimet dhe zgjedhje të njerëzve që janë politikë e më së paku profesionalë.

Edhe kryeministri i vendit, këtu e ka thënë që unë s'do ta vazhdoj praktikën pikërisht për këtë bord që të jenë njerëz të politikës, dhe tash po bëhet e kundërta, prandaj Grupi Parlamentar i LDK-së nuk pranon të jetë pjesë e votimit të kandidatëve që përfaqësojnë partinë dhe jo profesionalizmin, me këtë rast, në këtë Bord të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Së këndejmi, ne nuk do të jemi pjesë e votimit dhe ne do ta lëshojmë seancën. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", kryetari i Grupit Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Kjo listë që na është risjellë në Kuvend, edhe pas vërejtjeve fillestare që i kemi pasur karshi këtyre emrave, konsiderojmë se është një shpërfaqje jashtëzakonisht brutale e kësaj arrogancë të Qeverisë me insistimin e saj jo vetëm për t'i kontrolluar këto agjenci që kishin dashur të jenë të pavarura dhe që janë nën Kuvendin e Republikës së Kosovës po edhe për t'i bërë këto plotësisht të vetat dhe për t'i drejtuar ashtu siç do. Pra, kemi jo vetëm përfaqësues partiakë, por lista që ka ardhur këtu është e përbërë edhe nga emrat që në biografitë e tyre shihet që s'e kanë as minimumin profesional për të shërbyer në një bord kaq të rëndësishëm, që po i thonë kaq i rëndësishëm për ekonominë e vendit dhe përgjithësisht për çështje të pronësisë shoqërore në Kosovë. Rrjedhimisht, ne nuk do të qëndrojmë në sallë për ta legjitimuar këtë tendencë të Qeverisë dhe konsiderojmë se kjo duhet të përfundojë njëherë e përgjithmonë që bordet e agjencive të pavarura shtetërore të jenë vërtet të pavarura e jo të jenë të kontrolluara nga partia në pushtet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, e ka fjalën kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot në mëngjes ne e bëmë një zotim se nuk do ta lëshojmë sallën për shkak se mund të na pëlqejë ose të mos na pëlqejë një kandidat ose disa kandidatë në bord dhe e kemi në plan që ta mbajmë këtë fjalë që e dhamë sot, dhe i lus grupet parlamentare që të provojnë ta bëjnë të njëjtën, dhe po na vjen keq çka po ndodh.

Dhe pjesa tjetër e asaj që dua të them është që gjithmonë ky bord ka qenë politik dhe gjithmonë po zgjidhet politik dhe ka një problem tepër të madh me ligjin këtu, për shkak se e votojmë në paketë Bordin, i votojmë të gjithë anëtarët përnjëherë për shkak se qeveritë i propozojnë këto borde dhe gjithmonë qeveritë i kanë propozuar njerëzit e vet, cilado që ka qenë.

Në të njëjtën kohë, po kërkohet që të jenë të paanshëm, të jenë të pavarur, që të jenë profesionist dhe do të thotë disi kursesi nuk po mund të vijmë në një pozitë që vërtet ajo kryefjala e ligjit për këtë bord që duhet të jetë jopolitik dhe i paanshëm të realizohet.

Mendojmë pra se jemi në rrugë të keqe me këtë ligj dhe sidoqoftë, Aleanca e mban të drejtën të votojë kundër. Ka deputetë të cilët mendojnë se nuk do të votojnë kundër për shkak se ka individë që vlejnë në këtë grumbull të anëtarëve të ardhshëm eventual të Bordit, mirëpo mendojmë se Kuvendi i Kosovës duhet të fillojë të mendojë t'i gjejë zgjidhje kësaj çështjeje për shkak se me të vërtetë është tepër problem për të vazhduar kështu. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Myzejeane Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re, domethënë tash është para aktit të kryer në lidhje me çështjen e vendimit të Qeverisë për Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe se edhe ambasadat e shteteve të Kuint-it i ndihmojnë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ne deri tani s'kemi arritur të kemi një bord të Agjencisë të Privatizimit.

KRYETARI: Edhe një herë, të kemi praninë fizike. Në emër të Grupit të SLS, Sasha Milosavljeviq e ka fjalën. Të pranishëm janë 57 deputetë. Nuk ka kuorum, ta dimë.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila predlog Vlade o imenovanju članova Borda i mi ćemo, ukoliko bude glasanja, podržati ovaj predlog i glasati za. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nga "6+", a është ndokush? Jo.

Ne nuk e kemi praninë fizike që të votojmë, sepse të pranishëm janë 55 deputetë, prandaj po e shtyjmë këtë për një seancë tjetër. Urdhëro, kryetar i Grupit të Partisë Demokratike, Adem Grabovci, por prania fizike mungon.

ADEM GRABOVCI: Kryetar, propozoj që ta bëjmë një pauzë, jo më të gjatë se 10 minuta.

KRYETARI: Nuk e kemi kuorumin dhe nuk besoj që brenda 10 minutave bëhet. Mirupafshim në seancën tjetër!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes më 21 shkurt 2013

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për pikat e mbetura nga seancat plenare, të filluara më 31 janar, 1 e 7 shkurt 2013, dhe ajo më 14 shkurt 2013.

Konstatoj se në sallë e kemi kuorumin e mjaftueshëm për të filluar me punë.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës:

- Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur edhe nga 19 deputetë, lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë

Kuvendi, në mbledhjen plenare, të mbajtur më 14 shkurt 2013, e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet në mbledhjen plenare të radhës.

Deputetët Bekim Haxhiu, Vjollca Krasniqi dhe grupi i deputetëve nënshkrues, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë.

E ftoj deputetin Bekim Haxhiu, ose Vjollca Krasniqi, që në emër të grupit të deputetëve nënshkrues, në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrin fjalën. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua të ju njoftoj se iniciativa për këtë debat parlamentar është e imja, bashkë me deputeten Vjollca Krasniqi, për çka e falënderoj atë dhe të gjithë deputetët, të cilët me nënshkrimet e tyre i dhënë mbështetje këtij debati parlamentar për sportin.

Gjithsesi i jam mirënjohës edhe falënderues edhe kryetarit të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit që e dhanë dritën e gjelbër për këtë debat parlamentar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Prej më shumë se dy dekadave, e mbi 13 vjet prej përfundimit të luftës, dhe 5 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, sporti kosovar vazhdon të mbetet i izoluar dhe i marginalizuar.

Ky debat parlamentar është ftuar me qëllim për të diskutuar për gjendjen në të cilën ndodhet sporti në Kosovë, për veprimet që duhet ndërmarrë për zhvillimin e tij dhe që Kuvendi i Kosovës me anë të këtij debati ta japë kontributin për thyerjen e izolimit shumëvjeçar të sportit kosovar.

Kërkesa që Kuvendi i Kosovës të debatojë dhe ta thotë fjalën e tij për sportin nuk është kërkesë vetëm e deputetëve të nënshkruar, ngase ajo u mbështet edhe nga deputetë të tjerë, të cilët nuk janë pjesëmarrës me nënshkrimet e tyre, por është kërkesë edhe e një spektri më të gjerë të sportistëve dhe sportdashësve kosovarë.

Gjithsesi, vendimi i fundit i FIFA-s dhe modalitetet e papranueshme politike që ajo ia ka vendosur Federatës së Futbollit të Kosovës për zhvillimin e ndeshjeve miqësore, e ka bërë të domosdoshme që Kuvendi i Kosovës ta thotë fjalën e tij për sportin e Kosovës, për izolimin që është duke i ndodhur atij, sepse këtë gjendje izolimi me prapavija politike nuk është duke e përjetuar vetëm Federata e Futbollit të Kosovës, por me probleme të njëjta janë duke u përballur shumica e federatave në vend, bashkë me Komitetin Olimpik, kërkesat e të cilëve për anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë po injorohen në vazhdimësi. Me këtë izolim që po i bëhet sportit kosovar po shkelen edhe konventat ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke e ditur përqindjen e madhe të rinisë që ka vendi ynë, sipas statistikave, ne e kemi popullatën më të re në Evropë. Prandaj, është më se e nevojshme ta ndërtojmë një platformë për zhvillimin e sportit dhe thyerjen e izolimit.

Duke e miratuar një pako ligjesh që do të ndikonin në zhvillimin e sportit dhe duke i vënë në lëvizje gjithë mekanizmat shtetërorë për thyerjen e izolimit që është duke i ndodhur sportit kosovar.

Deri më tani, sportistët kosovarë sa herë që iu dha mundësia, e prezantuan vendin e tyre me mjaft sukses. Po i shihni rezultatet dhe prezantimin që ia bënë Kosovës me futbollistët, si Xherdan Shaqiri e Granit Xhaka, Valon Behrami e Valdet Rama, Blerim Xhemajli e Lorik Cana, Armend Dallku e shumë futbollistë të tjerë; Majlinda Kelmendi e Nora Gjakova në xhudo, apo Haxhi Krasniqi në boks, duke mos i harruar mundësit dhe pingpongistët tanë, të cilët arritën ta prezantojnë vendin tonë në Azerbajxhanin e largët, por edhe deri në Rusi.

Kuvendi i Kosovës deri më tani nuk u ka kushtuar vëmendje këtyre ambasadorëve të shkëlqyeshëm të vendit tonë. Kosova ka plot ambasadorë të këtillë, por duhet t'u krijohen kushte për ta prezantuar vendin tonë në arenën ndërkombëtare.

Të nderuar kolegë,

Sportistët dhe sportdashësit, të gjithë ata të cilët deri më tani e mbajtën gjallë këtë segment në Kosovë, sporti në Kosovë deri më tani u mbajt gjallë falë entuziastëve të sportit, të cilët investuan në të me vite, pa e pasur asnjë benifit të vetëm nga ai. Këta entuziastë e ndanë kafshatën e fëmijëve të tyre për ta mbajtur gjallë sportin nën okupim, por edhe pas përfundimit të luftës.

Sportistët dhe sportdashësit deri më tani ishin të durueshëm. Ata e kuptuan se vendi ynë ka dalë nga lufta dhe ka prioritetet e tjera, si rindërtimin e vendit dhe zhvillimin e tij,

andaj edhe ishin të durueshëm, por tani ka ardhur edhe momenti për të menduar dhe për të punuar për ta.

Fillimisht të debatojmë për sportin, që ai ta zërë vendin e tij meritore në shoqërinë tonë dhe pastaj të ndërmerren hapa që do të ndikojnë në zhvillimin e tij, hapa që janë bërë deri më tani si në aspektin e ngritjes së infrastrukturës ligjore dhe të infrastrukturës sportive.

Me veprimet dhe vendimet tona si Kuvend mund të ndikojmë në zhvillimin e sportit. Ne duhet të veprojmë sot që nesër të mos jetë vonë për sportistët tanë, për fëmijët tanë.

Ministria e Sportit kohëve të fundit e ka ndihmuar mjaft Komitetin Olimpik, federatat dhe klubet, si dhe ka ndarë buxhet për riparim të infrastrukturës sportive. Por, për të depërtuar dhe për të arritur rezultate kulmore në arenën ndërkombëtare, ndihmat nga Ministria nuk janë të mjaftueshme. Nuk mund të pretendojmë se me sportin, që mbahet gjallë nga donacionet, të jemi konkurrues në arenën ndërkombëtare. Andaj, ne duhet të veprojmë duke e ndërtuar një platformë për zhvillimin e sportit dhe thyerjen e izolimit dhe ndërkombëtarizimin e tij.

Në kuadër të këtij debati ne kemi propozuar disa rekomandime, të cilat pres që bashkërisht t'i avancojmë dhe t'i votojmë, duke ndërtuar kështu një platformë zhvillimore për sportin.

Përveç rekomandimeve të cekura, mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet t'u dërgojë shkresë zyrtare të gjitha shteteve që e kanë njohur Republikën e Kosovës, që ato të ndikojnë te përfaqësuesit e federatave të tyre për mbështetje dhe pranimin e sportit kosovar.

Dhe, në kuadër të kësaj, është e nevojshme që të formohet një komitet shtetëror për zhvillimin e sportit dhe ndërkombëtarizimin e tij.

Gjithsesi, kolegë të nderuar, mijëra sportistë dhe sportdashës të Kosovës sot i kanë sytë dhe veshët e drejtuar nga ju, nga Kuvendi i Kosovës dhe presin kontributin tuaj, duke besuar në rekomandimet e këtij debati.

Unë do të ndalem vetëm në tri nga rekomandimet e propozuara, të cilat kanë të bëjnë me hartimin e Ligjit për sponzorizim dhe këtë e arsyetoj me faktin se mijëra e mijëra donatorë e sponsorë investojnë në klubet në Kosovë, mirëpo asnjë beneficion nuk e kanë nga kjo.

Pastaj, Ligji për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre, mendoj se është më se i nevojshëm. Ju e dini gjendjen e infrastrukturave të objekteve sportive në Kosovë dhe absolutisht nuk është bërë diçka në këtë drejtim, e është më se e nevojshme që kjo çështje të rregullohet nëpërmjet ligjit.

Dhe, Ligji kundër huliganizmit dhe për luftimin e dukurive tjera negative në sport. Po e marrë një shembull, që me dhjetëra herë ka ndodhur që ndeshjet sportive të ndërpriten

nga persona të papërgjegjshëm, të cilët janë ndaluar nga Policia, e pas 15 minutave të njëjtit, të cilët e kanë ndërprerë një aktivitet sportiv, ke mundur t'i takosh edhe nëpër kafene. Dëshirohet që kjo çështje të rregullohet me ligj.

Besoj që të gjithë ju deputetë, kolegë të nderuar, do ta jepni kontributin tuaj që këto rekomandime të plotësohen dhe pastaj të votohen nga ju. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Qeveria nuk kemi të paraqitur. Nga kryetarët e grupeve parlamentare, në emër të Partisë Demokratike e do dikush fjalën? Jo. Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuar kryetar i Parlamentit,
Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo pikë, e iniciuar nga unë dhe kolegu Haxhiu, ishte paraparë të mbahej në javën e kaluar, mirëpo me kërkesë të deputetit Grabovci u shty për këtë javë, e edhe sot e ndërroi rendin e ditës me kërkesën e tij, prandaj nuk më befason shumë fakti që besoj se Grabovcit nuk i intereson shumë kjo çështje. Ai ka preokupime të tjera. Mirëpo, ajo që më befason dhe është jokorrekte dhe joserioze është nga ministri i Sportit, i cili nuk ishte i pranishëm as javën e kaluar, edhe pse ishte në objektin e Kuvendit, e nuk është as sot. Kjo është injoruese për sportistët e vendit.

Në këtë foltore rrallëherë është trajtuar njëra nga brengat e shoqërisë sonë, në veçanti rinisë, siç është sporti. Nuk e di pse ky segment aq vital nuk ka trajtim më serioz dhe më fundamental, kur dihet se në Kosovë ka një numër imponant aktivistësh, mijëra të rinj dhe të reja i zhvillojnë aktivitetet e tyre në mënyrë të organizuar.

Janë diku afro 30 federata të ndara në dy grupe të sporteve olimpike dhe joolimpike, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe e zhvillojnë sportin ndër ne dhe diku afro 350 klube të sporteve të ndryshme, ndërsa ne ngurojmë dhe hezitojmë të merremi me çështjet e tyre.

Në dukje, një numër bukur i madh i sportistëve, por kthyer në përqindje në raport me numrin e popullatës është shumë i ulët, krahasuar me shtetet evropiane. Këtë pyetje do t'ia bëja zotit ministër, mirëpo ai nuk gjendet këtu:

Sipas statistikave të Departamentit të Sportit, numri i klubeve po vjen duke u zvogëluar, e pse po ndodh një gjë e tillë?

Andaj, përqindja e popullatës sonë që merret me sport është 1%, ndërsa shtetet evropiane e kanë diku 30-35 deri në 40%.

Ky debat sot le të shërbejë që ne si deputetë të zgjedhur edhe me votën e tyre ta japim kontributin tonë me ide, rekomandime dhe vendime.

Për të mos shprushur shumë nëpër vite, do të flasim sot për sotmen dhe të ardhmen e sportit, në përgjithësi.

Sa shpenzojmë ne si Republikë e Kosovës për zhvillimin dhe avancimin e sportit, edhe pse kjo shumë e rritur ndër vite, por pa u ndjerë tek protagonistët e kësaj fushe.

Federatat e sportit janë në varësi të plotë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo shumë e mjeteve, sado e vogël që është, duhet t'u jepet në menaxhim apo në administrim në fillim të vitit, varësisht nga kriteret dhe programet që ofrojnë ato, e jo të veprojnë si deri më tani - që duhet gjithsesi të kesh raportet të mira me zyrtarët e sportit, raporte miqësore apo politike, e disa nga zyrtarët e Departamentit të Sportit bëhen më ministra se vetë ministri.

Sa punëtorë sportivë paguhen nga Buxheti i Kosovës? Përveç atyre që punojnë në ministri, nga komunat paguhet nga një zyrtar i sportit, dhe këta menaxhojnë me shuma shumë simbolike, të ndara për këtë segment.

Andaj, mendoj që duhet të miratohet Ligji për sponsorim, i cili nuk do të krijojë mrekulli, por sidoqoftë, ata që i menaxhojnë dhe i financojnë klubet, të kenë motiv për një gjë të tillë.

Sipas kësaj, firmat duhet që të jenë shumë të fuqishme ekonomikisht, me fitime milionëshe, për të lënë gjurmë në sport. Në fund të fundit, fuqia ekonomike e përcakton shkallën e zhvillimit të shoqërisë dhe sportit në këtë rast.

Por, meqenëse kemi ekonomi të dobët, mbështetja nga bizneset po vjen duke u zbehur dita-ditës dhe njëkohësisht edhe shuarja e shumë talenteve sportivë, apo gjetja e rrugëve për të shkuar jashtë vendit, siç është rasti i fundit i xhudistëve, të cilat me deklaratat e tyre pretendojnë të garojnë për ndonjë vend tjetër.

Infrastruktura sportive është shumë e dobët, në përgjithësi, si e terreneve të hapura, ashtu edhe të atyre të mbyllura.

Një problem tjetër që e përcjell sportin është definimi i pronësisë së objekteve sportive, gjë që kërkon zgjidhje ligjore.

Pallati i Rinisë dhe Sportit, në qendër të Prishtinës, i cili shfrytëzohet pa asnjë kompensim nga klubet, jo vetëm ato të kryeqytetit, që nga viti 2006 ka mbetur pa status të definuar, apo me status pezull, peng i Ligjit për kryeqytetin. Andaj, ky objekt duhet të hiqet nga administrimi i AKP-së dhe t'i kthehet Komunës së Prishtinës, në mënyrë që të investohet në të dhe të funksionalizohet në tërësi.

Stadiumi i KEK-ut në Obiliq - toka ka qenë në ish-pronësi të ish-PIK-ut, objektet e KEK-ut, toka e Komunës së Obiliqit, ndërsa ajo menaxhohet nga AKP-ja, pra në të janë të involvuara katër subjekte.

Kemi dëgjuar propozime se objektet sportive duhet t'u jepen klubeve, apo të jenë në partneritet publiko-privat.

Shembujt në region tregojnë se një opzion shumë konstruktiv do të ishte dhënia me koncesion e objekteve sportive për afat 25 deri 30 vjet, nën kushtet e përcaktuara mirë dhe qartë.

Është e kuptueshme se shumica e komunave nuk mund t'i menaxhojnë dhe mirëmbajnë këto objekte sportive, prandaj duhet zgjedhur opsione të volitshme për klubet, sponsorët, gjithnjë me parimin e palëkundur, të mos ndërrohet destinimi i tyre.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sportin është miratuar pak më shumë se një vit më parë. Pyetja ime është: Sa akte nënligjore ka nxjerrë ministria; a e kanë bërë kategorizimin e sporteve; mbështetjen e përhershme financiare të fituesve të lojërave olimpike; kampionatet botërore dhe evropiane dhe a do të ketë ky ligj fuqi retroaktive për fitues të tillë, sepse kemi fitues të medaljeve olimpike edhe në të kaluarën.

T'i përsëritësh frazat aq shumë të theksuara mbi rolin e sportit për një shtet dhe për shoqërinë, në përgjithësi, është bërë rutinë e përditshmërisë sonë sa herë që flitet për ndërkombëtarizimin, imazhin shtetëror dhe ndikimin e tij ndërkombëtar.

Kosova është rast unik në botë, përkundër të gjitha parimeve universale që i propagandon sporti, thyhen pikërisht ato, duke i shërbyer politikës dhe politikanëve të shteteve tashmë të njohura me ndikim diskriminues dhe izolues dhe në dëm të pjesës më vitale e më të re të popullsisë evropiane, edhe pse e njohur nga më shumë se gjysma e botës.

Jua përkujtoj se arsyetimi i vetëm i këtyre institucioneve vendimmarrëse sportive është fakti se Kosova nuk është në OKB. Keqpërdoret një element i pastër politik në dëm të sportit.

Rasti më drastik është ai i Federatës së Futbollit të Kosovës. Kushti i UEFA-s, federata mund të aplikojë për pranim nëse shteti është i pranuar nga OKB - është shumë politik. Çka nëse Kosova nuk dëshiron të jetë në OKB, siç ishin më parë Zvicra, Austria e të tjera. Do të thotë kjo se në Kosovë nuk mund të luhet futboll. Në fund të fundit, OKB-ja nuk pranon shtete, por afron anëtarësim politik.

Futbolli në Kosovë luhet nga viti 1919, ndërsa klubet e para u formuan menjëherë më pas. KF "Prishtina" është formuar në vitin 1922, para mbi 90 vjetësh. FFK-ja është formuar më 1946, ndërsa më 1948 është bashkëthemeluese e Federatës së Futbollit të Jugosllavisë në atë kohë dhe me të drejta plotësisht të barabarta dhe indirekt e pranuar në UEFA dhe FIFA.

Dëmi që i shkakton Kosovës në aspektin sportiv është shumë i madh, izolim shumëvjeçar i paparë, diskriminim i rinisë i femrave, pa e përmendur faktin se lojtarët nga Kosova luajnë anëmbanë Evropës për përfaqësuese të tjera.

Sportistët, punëtorët sportivë, sponsorët, por edhe fansat sportivë janë skajshmërisht të deprimuar dhe të lodhur me këtë gjendje diskriminimi.

Ndonëse ka pasur tentime të institucioneve të Kosovës për ta ndihmuar Komitetin Olimpik dhe federatat sportive për ndërkombëtarizim, përkatësisht pranim të institucioneve respektive, një strategji institucionale që nuk ka pasur dhe nuk ka.

Nuk mjafton vetëm një shkresë apo një dokument për të ndikuar, por çdo çështjeje duhet t'i shkohet deri në fund, duke siguruar përkrahjen e atyre që nevojiten në vendin dhe momentin e caktuar. Shpresoj që më pas kjo gjë do të ndodhë.

Nga kryeministri i Shqipërisë është lansuar ideja për unifikimin e ligës kombëtare.

Kjo temë është aktualisht mjaft e diskutuar në Kosovë dhe në Shqipëri, por edhe në vende të tjera, sepse i tejkalon kufijtë e sportit dhe hynë në sferën politike.

Natyrisht, ekzaltimi pas kësaj të josh dhe të bën shumë për vete, sepse cilësia, interesi, emocioni, investimi dhe gjithçka që lidhet me futbollin cilësor, larmia, tifozllëku e entuziazmi do të rriteshin.

A është e gatshme Shqipëria dhe Federata Shqiptare e Futbollit ta sakrifikojë pozitën e saj dhe t'i shkojë deri në fund kësaj ideje, apo është vetëm politikë ditore.

Prandaj, pyetja ime për ministrin do të ishte: “A kanë pasur ministrinë homologe takim ndërmjet tyre për këtë gjë, edhe pse, sipas informacionit të fundit, e kanë pasur një takim për organizimin e një lige kombëtare, që do të përfshinte klube të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë, të Malit të Zi, mirëpo nuk e kemi ndonjë vendim, apo ndonjë informatë zyrtare.

Mendoj që sot kjo do të shërbejë që institucionet e Kosovës t'i kushtojnë rëndësi më të madhe këtij segmenti shoqëror. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Ne mendojmë që problemi më i madh i sportit është vetë Qeveria. Për 11 vjet, sa Kosova ka Qeveri e Parlament, sporti asnjëherë nuk ka qenë as prioritet, e as ndër prioritetet e kësaj Qeverie. Për ta vërtetuar këtë, është organizuar ky debat i sotëm, i pari që i kushtohet sportit.

Në Parlament është folur për sportin vetëm kur është dashur të diskutohet Ligji për sportin, por asnjëherë për problemet të cilat e përcjellin atë.

Sporti rëndom është konsideruar si diçka e dorës së dytë. Vetë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është llogaritur si ministri e parëndësishme nga kushdo që e ka udhëhequr Qeverinë, e sporti brenda kësaj ministrie edhe më pak i rëndësishëm.

Se sa është serioz ministri në punën e tij, këtë po e tregon sot edhe me mospraninë e tij në debat.

Kemi pasur madje ministra, të cilët nuk e kanë ditur se kush është kampion i futbollit në Kosovës, e që është sporti më masiv në vend. Sa i përket ndërkombëtarizimit të sportit, është menduar që sporti do të ndërkombëtarizohet shpejt pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, mirëpo doli e kundërta.

Shumë procese vetëm sa janë kthyer prapa. Sot, Kosova i ka 10 federata të ndërkombëtarizuara, 5 me të drejta të plota e 5 më të drejta të kufizuara, por situata në ato federata nuk dallon shumë nga ato që nuk janë të ndërkombëtarizuara. Edhe ato janë në situatë të mjerë.

Procesi i ndërkombëtarizimit është i lidhur ngushtë me njohjen e shtetësisë së Kosovës. Shumë federata botërore e kanë kusht kryesor në statutin e tyre që federata që aplikon për pranim duhet të vijë nga një shtet i njohur nga OKB-ja. E Kosova nuk është e njohur, e për pasojë po e vuan edhe izolimin në sport.

Kur bëhet fjalë për infrastrukturën, Kosova e ka trashëguar një infrastrukturë të vjetër. Ka palestra, por nuk ka ngrohje në to. Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit, pa ndonjë plan të mirëfilltë, ka nisur ndërtimin e disa palestrave të vogla nëpër qyteza, disa që kanë nisur edhe para tete vjetëve, si ajo në Klinë, e cila ende nuk ka përfunduar; ajo në Podujevë, e cila ka përfunduar; por është ndërtuar mbrapsht. Tifozët duhet të qëndrojnë prapa koshave, e disa të tjera nuk i plotësojnë as standardet minimale.

Problemi kryesor nuk është ndërtimi i palestrave sportive, por është nisja e menjëhershme, që vazhdimisht buxhetit të sportit ia ka marrë pjesën më të madhe. Për ironi, sot në ato qytete ku ka palestra nuk ka zhvillim të sportit, nuk ka masivizim.

Problem edhe më i madh paraqitet në infrastrukturën e futbollit. Tashmë ka nisur një projekt për ndërtimin e gjashtë fushave ndihmëse nëpër 6 qendra të Kosovës, por duhet ta kuptojmë se Kosova i ka gati 60 klube të futbollit, që prapë është fatkeqësi, meqë pas luftës i kishte rreth 120. Pra, gjysma e tyre, apo edhe më shumë janë shuar në mungesë të mbështetjes nga shteti dhe të një plani për zhvillimin e tij.

Mandej, shteti i Kosovës nuk ndan asnjë cent në formë page, apo burse për sportistët e vet.

E, Kosova i numëron në gishta sportistët e merituar dhe sportistët e së ardhmes.

Nuk ka pensione për sportistët e merituar, si Aziz Salihu e Mehmet Bogujevci, dhe ndonjë tjetër, por nuk ka as bursa për sportistët si Majlinda Kelmendi e Nora Gjakova.

Ne sot të gjithë mburremi me sukseset e tyre. Të gjithë politikanët vrapojnë për t'i takuar pas ndonjë sukcesi, por sportistët si ata, në vendet tjera ndihmohen ndryshe, me bursa mujore të rregullta. Këto dy sportiste, që tashmë janë kandidate potenciale për t'u

kualifikuar në Olimpiadën e Brazilit, për shkak të mospërkrahjes institucionale do të jenë të detyruara që të heqin dorë nga përfaqësimi i Kosovës, duke e përfaqësuar kështu ndonjërin nga shtetet që tashmë u kanë bërë ofertë.

Ka tetë sezone që klubet e hendbollit dalin në Evropë për ta përfaqësuar Kosovën, por nuk kanë treguar ndonjë sukses. Prapë nuk është faji i klubeve, por i shtetit.

Si shpjegohet që sot një skuadre, e marrim shembull atë të hendbollit “Prishtina”, t’i ndahen vetëm 3 000 euro, ndërkohë që brenda saj funksionojnë pesë ekipe: dy të seniorëve, juniorëve, kadetëve e pionierëve. Kjo shumë nuk është e mjaftueshme as për shpenzimet brenda klubeve, e lëre më të mendohet për dalje jashtë shtetit.

Mirëpo, me gjithë këto peripeci, klubet e hendbollit janë të detyruara që të marrin pjesë për t’iu shmangur dënimit të Federatës Evropiane me ndalesë prej 3 vjetësh për mospjesëmarrje në këto gara.

Klubet e sportistëve gjithnjë e më shumë po lihen pas dore, jo vetëm nga shteti, por edhe nga bizneset, meqë kjo nuk po kompensohet në fund, e që do duhej të bëhej nëpërmjet lehtësirave fiskale, të cilat normalisht se duhet të rregullohen nga shteti.

Pra, gjendja e sportit në Kosovë asnjëherë s’ka qenë më e keqe. Superliga e futbollit llogaritet që thith më së shumti mjete, por aty paga mesatare e futbollistëve nuk kalon më shumë se 200 euro dhe atë 2-3 herë në vit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Mendoj se nëse Kuvendi i Kosovës për herë të parë debaton për sportin në Kosovë, është dashur të jetë ministri. Duhet konstatuar që është e papërgjegjshme për shkak se ka një portofolio tepër të saktë, nuk e ka një nëndepartament, por është ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Do të kishte qenë jashtëzakonisht në rregull që ai të jetë këtu dhe është shumë keq që nuk është.

Çështja tjetër me të cilin duhet nisur është - çka është debati? A është debati për sportin në Kosovë, apo për ndërkombëtarizimin e sportit të Kosovë? E di që janë të lidhura këto ndërmjet veti, por nëse duam të punojmë diçka, nëse duam me të vërtetë ta bëjmë një punë në lidhje me sportin, duhet t’i ndajmë. Ne nuk kemi problem esencial me ndërkombëtarizimin e sportit. Ne kemi problem esencial me sportin në Kosovë. Kemi problem esencial me atë se sa të rinj me të vërtetë merren me aktivitete sportive.

Për mendimin tim, aktiviteti sportiv më i madh në Kosovë janë bastorja, basti dhe komentet nëpër portale. Këto janë aktivitetet sportive të të rinjve tanë.

Ndërsa nëse dikush do të merrej seriozisht dhe ta shohë se sa të rinj me të vërtetë merren me një sport për rekreacion, mendoj se do të dilte diçka e tmerrshme.

Për ta lidhur pak ndërkombëtarizimin, edhe atë se çka me të vërtetë po themi ne për sport, do të ju thosha me bindje të plotë që nëse me ndonjë mrekulli, çfarëdo qoftë ajo, nesër në mëngjes FIFA na pranon, brenda muajit do të na përjashtonte. Edhe po ju tregoj pse. Do të na përjashtonte për shkak se kryetarët e komunave dhe politikanët i udhëheqin klubet, klubet e futbollit, ta marrim shembull. Të gjithë tifozët dhe të gjithë lojtarët e dinë që kur kanë ndonjë telashe, dy kryetarët e komunave takohen ndërmjet vetes nëse e kanë një ndeshje javën e ardhshme dhe merren vesh çfarë të bëjnë.

Stadiumet tona janë të ndërtuara në fillim të viteve të '70-ta, ose më herët, dhe janë të njëjta. Nuk kanë ndryshua diçka. Diku janë dhënë donacion disa ulëse dhe janë prishur përsëri.

Klubet tona financohen çuditshëm, askush nuk e di qysh. Disa mjete ua japin komunat prapë për t'i subvencionuar, se u duhen tifozët për vota; disa tjerë i marrin disa firma, i menaxhojnë nga 3-4 muaj, i sjellin ato mjete, kush e di si, ndoshta diçka edhe shpërlajnë dhe, në fund të fundit, e lëshojnë klubin. Po ju them edhe një herë: nëse flasim për ndërkombëtarizim, nëse do të na pranojnë, brenda muajit do të na përjashtojnë për shkak se nuk e kemi materien. Gjendja e sportit nuk është problem për shkak se nuk jemi në FIFA, apo në UEFA.

Gjithë bota e di që vendet të cilat prodhojnë sportistë kulmorë, në cilindo që të jetë ai sport, qoftë sport individual, qoftë sport kolektiv, e bëjnë këtë për shkak të dy arsyeve të vetme.

E para arsye dhe kryesorja është se e kanë masivizuar atë sport, se shumë të rinj merren me atë sport dhe kur ka shumë të rinj që merren me sport, është e pamundur të mos dalin talente.

Dhe, e dyta, është infrastruktura. Për të arritur diçka, sporti duhet të masivizohet. E tani ne po flasim për gjithfarë problemesh, që nuk na kanë pranuar, çfarë kanë bërë, çfarë po na bëjnë, si janë diskriminuar sportistët kosovarë, por ne në Kosovë nuk kemi sportistë. Ata sportistë që i kemi janë aq të paktë në numër, sa ne nuk mund të flasim për sport. Për sport flitet ku për ta nxjerrë një ekip futbollit prej 11 futbollistëve në terren duhet pasur diku nga 30 ose 40 mijë që luajnë për çdo ditë. Kështu, ndryshe nuk bën.

Në të njëjtën kohë, kur flasim për mjetet që jepen, po ju tregoj kështu: prapë të gjithë e dimë, nuk po e zbuloj akullin - sportistë kulmorë në shumicën e sporteve janë në vitet e 20-ta të moshës së vet. Domethënë, diku prej 18,19 deri në moshën 30-vjeçare. Dhe nëse një i ri, një fëmijë 10-vjeçar, nis të stërvitet me kujdes, me shumë e shumë shokë e shoqe të veta, edhe bëjnë garë, për një 10-vjeçar mund të prodhojmë kampion në çfarëdo sporti. Nëse me të vërtetë punohet, nuk po flasim për 100 vjet, po flasim për një 10-vjeçar, ndoshta edhe më pak, që mund të prodhojmë kampion.

Tani ne duhet ta shohim sa terrene, për shembull, të tenisit janë ndërtuar në Kosovë; sa terrene të basketbollit ekzistojnë nëpër lagje, jo vetëm palestrat e ftohta, ku rrjedh uji. Po pajtohem me ato që u thanë më përpara. A po investojmë diçka që të rinjtë, në vend të

bastores, të provojnë të vënë bast duke luajtur vetë. Nuk i kemi këto. Edhe krejt temat tjera janë goxha problematike.

Fundi i fundit, dua ta përfundoj, se po më duket që debati është i gjerë, shumë i qëlluar, i nderuari deputet Haxhiu, por i gjerë dhe mendoj se duhet ta kufizojmë, për të ardhur deri te temat konkrete të sportit.

Edhe sporti është sundim i ligjit, e sundimi i ligjit është në njëfarë forme besë. Ne merrem vesh që nuk e godasim njëri-tjetrin në këmbë, e nëse e bëjmë këtë e marrim një karton. Po nëse të gjithë e thyejmë ligjin, nëse të gjithë e thyejmë atë besë, nuk mund të ketë sport.

Nuk ka sport normal aty ku rrihen referët. Le ta harrojmë këtë temë. Nuk ka! Nuk ka sport normal aty ku kryetarët e komunave dhe politikanët tjerë ndërhyjnë drejtpërdrejt nganjëherë edhe në lojë, në ndeshje. Nuk mund të ketë. Harrojini këto tema. Përpos investimeve, përpos infrastrukturës, përpos masivizimit, duhet pasur kujdes se a po merremi vesh që këto janë rregullat, apo punojmë pa rregulla hiç, kush të donë çka të donë le të bëjë. Është esencialisht drejtpërdrejt e lidhur me atë se çfarë ne besojmë që është sundimi i ligjit. Çka është ligji, çka është rregulla? Nëse e kemi vënë një rregull bashkë, a duam ta respektojmë atë rregull?

Po më duket që, përpos elementeve të drejtpërdrejta konkrete në sport, nuk po duket se me të vërtetë ka interes masiv në Kosovë, që ka një numër optimal të njerëzve, qoftë në politikë, qoftë në jetën tjetër, që me të vërtetë e kanë këtë punë. Po flasim se po u duhen votat, po flasim se po kanë qejf ta shohin dikë duke fituar, ose duke humbur. Disa të tjerë po duan t'i bëjnë do para nëpërmjet asaj pune, por nuk e kemi përnjëmend. Nuk e kemi përnjëmend, edhe askush nuk e ka përnjëmend. Edhe njerëzit që mendojnë që janë krejt ndryshe prej të tjerëve, po më duket që nuk e kanë bash përnjëmend këtë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e përshëndetim debatin e sotëm për gjendjen e sportit në Kosovë, gjendja e të cilit nuk është e kënaqshme.

Jemi të izoluar dhe të marginalizuar. Ne si Grup Parlamentar i përkrahim rekomandimet e propozuara nga parashtruesit e debatit.

Konsideroj që Kuvendi duhet të jetë më i zëshëm dhe veprues në përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Duhet sa më parë të miratohet Ligji për sponzorimin, i cili edhe nga vetë federatat konsiderohet si çelës i zgjidhjes së shumë problemeve.

Gjithashtu, Kuvendi dhe Qeveria në takime ndërkombëtare duhet ta diskutojnë problematikën e sportit kosovar.

Ne e mbështetim Ministrinë e Sportit në përpjekjet për përmirësimin e gjendjes dhe për ndërkombëtarizimin e sportit, por si shoqëri duhet të punojmë më shumë në këtë drejtim.

Shoqëria kosovare ka potencial njerëzor për ta kultivuar sportin. Ne kemi shumë talente, të cilët do ta përfaqësonin Kosovën në mënyrë të shkëlqyeshme. Prandaj, të punojmë së bashku që t'ua mundësojmë këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarët e grupeve i kanë shteruar diskutimet. Është radha e zotit Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

E di që ka shumë çështje që e preokupojnë shoqërinë tonë dhe që janë jashtëzakonisht të rëndësishme, por edhe gjendja e sportit në Kosovë meriton të debatohet.

Në këtë rast dua t'i them disa gjëra, duke shpresuar se ky debat nuk do jetë vetëm për konsum politik në emër të sportit, si për shumë çështje tjera që kanë ndodhur jo rrallë, por me shpresë se do të ndikojë për të mirën e sportit me të vërtetë.

Të gjithë jemi të bindur se gjendja e sportit nuk është e mirë dhe kjo natyrisht si rezultat i shumë faktorëve. Njëri nga problemet kyç, që u tha edhe nga kolegët tjerë, është izolimi i sportit në Kosovë, domethënë mbetja jashtë arenës ndërkombëtare, pastaj infrastruktura tejet e papërshtatshme që as për së afërmi nuk i përmbush kërkesat. Mungesa e disa ligjeve natyrisht ka lënë të paplotësuara shumë zbrazëti të krijuara dhe të akumuluar vite me radhë në sportin në Kosovë.

Problem tjetër, të cilin e kam përmendur edhe më parë në një rast në Kuvend, është dhuna dhe oliganizmi i shfrenuar në stadiumet tona sportive, ku nuk janë ndërmarrë masat e duhura ligjore deri më tani.

Është tepër me rëndësi depolitizimi sa më i madh i sportit dhe krijimi i hapësirës sa më të favorshme që sportin ta udhëheqin sa më shumë profesionistët e sportit, sepse që nga paslufta sporti në Kosovë ka qenë mjaft i rënduar nga politizimet, duke e përdorur deri në atë nivel sa ia kanë humbur edhe spektaklin, edhe emocionin që na ofron.

Këto janë disa nga çështjet, ku fokusimi ynë do të duhej të jetë shumë i madh.

Ne duhet të ndihemi përgjegjës si institucione nëse nuk arrijmë ta ofrojmë tërë atë potencial që është i mundshëm për të rinjtë tanë që e duan sportin dhe e kanë ëndërr të bëhen sportistë profesionistë.

Aktivitetet sportive në forma aktive apo pasive përfshijnë një numër të madh të qytetarëve të vendit tonë, të cilët për nga mosha janë shumica të rinj. Sa prej tyre do të

mund ta aprovonin ta realizonin ëndrrën e tyre për të kërkuar rezultate në sporte të ndryshme.

Sa talente të ne ende nuk mund të provohen as të shfaqen, në mungesë të hapësirës e kushteve për t'u prezantuar.

Institucionet duhet të jenë në funksion të shfrytëzimit të të gjitha alternativave, në radhë të parë të atyre politike, për ta bartur mesazhin e sportit edhe jashtë kufijve të Kosovës, që sa më shpejt të gjitha federatat sportive të jenë pjesë e arenës ndërkombëtare, pasi është e qartë që prapavija është politike, e ndërlidhur me vetë pozicionin e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Ndërkombëtarizimi i sportit është tepër i rëndësishëm. Të gjithë jemi të bindur se sportistët janë ambasadorë të shkëlqyeshëm të një vendi.

Sporti është njëra nga mundësitë e arta që ta promovojë dhe ta krijojë imazhin më të mirë për vendin, çfarë satisfaksioni krijojnë për vendet e tyre sportistët e mëdhenj botërorë sot në botë.

Prandaj, kësaj çështje duhet t'i përkushtohemi me seriozitetin maksimal për të gjetur rrugët dhe alternativat që sa më shpejt të imponohemi në arenën ndërkombëtare.

Sa i përket infrastrukturës, viti që e lamë pas e ka shënuar një progres, kur Qeveria ka ndërmarrë disa hapa konkretë për përmirësimin e infrastrukturës sportive në disa pjesë të Kosovës. Duhet të vazhdohet me ritëm edhe më të madh, sepse nevojat janë jashtëzakonisht të mëdha.

Duhet të zgjidhet institucionalisht statusi i sportistëve të mëdhenj, që të trajtohen dinjitetshëm nga vendi ynë. Kjo do të ishte e rëndësishme. Sa herë e kam parë në televizionet tona sportistin Aziz Salihun duke kërkuar ndihmë. Unë nuk e di si e ka gjendjen, por ne duhet t'i bëjmë veprimet e duhura që sportistët tanë të mëdhenj në të gjitha llojet e sporteve të trajtohen dinjitetshëm nga institucionet e shtetit tonë, të mos mbeten zëri në mbrojtje i vetvetes.

Krahas marrjes së përgjegjësisë nga të gjitha nivelet institucionale, duhet të ndërmerren veprimet e duhura edhe në të gjitha federatat sportive për ta parë funksionimin e tyre sa a ka monopol brenda tyre, burokraci, nepotizëm e anarki, apo gjithçka është transparente dhe duke shkuar si është më së miri, për çka unë personalisht fare nuk besoj.

Të ndërmerren këta hapa me të vetmin qëllim, që të ketë sa më tepër transparencë dhe organizim të mirëfilltë të sportit në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë do të rritej cilësia në shumë lloje të sportit, ku sportistët do të trajtoheshin dinjitetshëm, profesionalisht e financiarisht.

Kështu do të rivalizonim denjësisht me vendet e rajonit, e natyrisht edhe sukseset nuk do të mungonin. E them këtë me bindje të plotë, sepse edhe në këtë situatë, në nivelin e tillë, me probleme të mëdha, kemi sportistë që na bëjnë të ndihemi krenarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Gjendja e sportit në Kosovë është mjaft e pafavorshme për zhvillimin e talenteve të rinj.

Fushat e futbollit dhe të sporteve të tjera në Kosovë janë jashtë standardeve. Klubet kalojnë nëpër situata të vështira, duke shpresuar gjithnjë se një ditë infrastruktura do të përmirësohet.

Nuk ka vullnet të fortë ose mungon iniciativa për të investuar më shumë edhe nga institucionet komunale dhe qendrore, edhe nga individët dhe kompanitë private.

Në ballinën e Ministrisë së Kulturës dhe Sportit të Kosovës thuhet që infrastruktura sportive është kushti themelor për përmirësimin e kualitetit të aktiviteteve sportive, si dhe për ngritjen e sportit në nivelin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare. Por, me këtë nivel të vogël të investimeve janë larg për t'u arritur këto objektiva.

Ne e kemi rininë më të re në Evropë, e cila në vazhdimësi bënë përpjekje dhe tentativa për ta thyer izolimin shumëvjeçar. Shembujt e sportistëve të talentuar nga Kosova, siç janë Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, me një përkrahje shumë të vogël materiale, jo vetëm për to, por edhe për shumë sportist të tjerë, na bëjnë të kuptojmë se kemi talente, të cilëve nuk po ju kushtojmë vëmendje sa duhet për t'u krijuar kushte materiale për t'u zhvilluar.

Sikur Xherdan Shaqiri të rritej në këtë ambient dhe në këto kushte, ky talent i madh i futbollit dhe plot të tjerë si ky që u larguan nga Kosova për shkak të gjendjes ekonomike dhe politike, nuk jemi të sigurt se do ta kishte suksesin që e ka tani. A thua edhe sa talente të këtillë janë në mesin e të rinjve kosovarë, të cilëve ndoshta nuk do t'u krijohet asnjëherë mundësia që një ditë ta shprehin talentin e tyre dhe të garojnë në garat ndërkombëtare.

Mendoj se ka ardhur momenti për një organizim më të mirin institucional, për investime në shkollat e ndryshme të sportit, në mënyrë që t'i jepet hapësirë zhvillimit të talenteve të rinj, që ata një ditë të jenë krenaria jonë, që ata një ditë ta përfaqësojnë shtetin tonë, që ata një ditë jenë të barabartë me të rinjtë e mbarë botës.

Prandaj, nisur nga kjo, fuqimisht e përkrah çdo iniciativë institucionale për përmirësimin e gjendjes së sportit në Kosovë, që sportistët të mos e krijojnë bindjen se kjo shoqëri nuk kujdeset për të rinjtë që i sjellin medalje këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nuk ka dilemë që sporti, si një sferë e rëndësishme e shoqërisë sonë, aktualisht është duke u përballur me një sërë sfidash dhe vështirësish. Rrjedhimisht, vetë aktivitetet sportive në të gjitha dimensionet e tyre ndodhen në një gjendje të mjerë, pa perspektivë dhe me mundësi të limituara të zhvillimit.

Ky pozicion i palakueshëm i sportit pa dyshim se kushtëzohet nga një sërë faktorësh. Që nga izolimi ndërkombëtar, që është duke e përjetuar sporti ynë, mungesa e përkrahjes institucionale nga Qeveria, vështirësitë financiare, mungesa e kushteve për trajnim adekuat, mungesa e infrastrukturës adekuate ligjore e sportive, e deri te dhuna në terrene sportive, që shpeshherë i tjetërsojnë ndeshjet sportive në gara kompetitive në arenë të huliganizmit me pasoja serioze për jetën njerëzore, si për sportistët, ashtu edhe për spektatorët, si dhe për sportdashësit.

Madje, sa i përket ndërkombëtarizimit të sportit, mund të thuhet se nëse disa federata sportive kanë lëvizur pak në drejtim të duhur gjatë këtyre viteve të fundit, për disa të tjera mund të thuhet se kanë shënuar edhe hapa mbrapa, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë.

Kështu, bie fjala, Përfaqësuesja e Kosovës kishte luajtur para shpalljes së pavarësisë në disa ndeshje miqësore, ndërsa tani FFK-ja duhet të marrë leje nga Serbia për të luajtur ndeshje miqësore në Kosovë. Ky të paktën është vendimi i FIFA-s.

Në këtë kontest, problem tjetër i veçantë mbetet edhe statusi i sportistëve, përkatësisht i sportistëve elitare, i atyre që dikur kanë pasur sukses në të kaluarën, e po ashtu i tyre që kanë potencial për të ardhmen. Këtyre mungesave u shtohet pa dyshim edhe deficit i madh i ekspertëve kompetentë për sport, siç janë administratorët sportivë, trajnerët, gjyqtarët e të tjerë.

Pasqyrën e kësaj gjendjeje të pashpresë sot më mirë se asgjë tjetër e tregon edhe gatishmëria e dy sportistëve më të dalluara të vendit, si bie fjala Majdina Kelmendi e Nora Gjakova, edhe për t'u larguar nga Kosova.

Në këtë rrafsh, si pasojë e mosmbështetjes institucionale, në gjendje më të rëndë ndodhen edhe ato ekipe, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e sportit, frymën që mbartin dhe kulturën e disiplinës që e prezantojnë, por që nuk krijojnë përfitime të çastit, si bie fjala klubi atletik në Roganë të Kamenicës.

Përgjithësisht, ky dështim strukturor ka bërë që sot sporti të gjendet në një nivel të papërshtatshëm, as me gjendjen në kontinent, e as me nivelin e zhvillimit në rajonin tonë.

Pa dyshim se një pjesë e kësaj gjendjeje rrjedh edhe për shkak të trashëgimisë diskriminuese që Kosova dikur ka pasur në të kaluarën, kur kanë munguar investimet, veçanërisht në infrastrukturën sportive.

Kështu, si pasojë e kësaj gjendjeje, në Kosovë sot shumë pak njerëz merren me sport.

Gjykuar sipas statistikave aktuale, në vendin tonë sot më pak se 1% e popullsisë merret me sport dhe nuk ka dilemë se kjo shifër është tepër e ulët, kur kihet parasysh fakti se në vendet e BE-së me sport merren 35% - 40% e popullsisë.

Fushat, palestrat, pistat e pishinat apo terrenet e tjera sportive që do të duhej të ekzistonin nëpër lagjet e qyteteve e nëpër fshatra, nuk ekzistojnë. Ato që kanë ekzistuar dikur, pjesërisht e kanë ndryshuar destinacionin, e mbi to janë ndërtuar banesa apo objekte biznesi. Të reja përgjithësisht nuk janë ndërtuar, e as nuk janë planifikuar.

Fëmijët, të rinjtë dhe të gjithë ata që kanë dëshirë të praktikojnë sport janë të detyruar të shkojnë në ambiente private kundrejt pagesës, por edhe këto ambiente nuk janë cilësore përgjithësisht dhe nuk ofrojnë standarde të domosdoshme për zhvillimin e një sporti cilësor.

Edukimi fizik nëpër shkolla, edhe pse është i detyrueshëm, ka vend për përmirësime, ka nevojë për investime me çka do t'i mundësohej brezit të ri një rritje e shëndetshme, e që njëkohësisht do të mundësonte identifikimin dhe rritjen e talentëve.

Ndërkaq, ashtu si në çdo sferë tjetër, ku pushteti i ka shtrirë tentakulat e tij, me këtë rast edhe federatat sportive nuk kanë mbetur immune ndaj kësaj tendence për kontroll politik. Kështu, shpeshherë, këto entitete organizative sportiste janë shndërruar në arena për përplasje politike dhe në këtë mënyrë janë privuar nga funksioni i tyre bazik për të shërbyer si rregullator, promovues e zhvillues të sportit në shoqëri.

Madje, edhe përpjekjet për të krijuar kampionate të përbashkëta me Shqipërinë kanë mbetur vetëm në nivelin e propagandës politike, por pa bërë asnjë hap konkret ligjor sa u përket mundësive për jetësimin e kësaj ideje, sidomos kur dihet se përveç dëshirës emocionale, ky projekt mbart edhe logjikën e racionalitetit funksional.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto fakte të lartcekura, si dhe në koherencë me programin tonë alternativ qeverisës, konsiderojmë se sporti si aktivitet i përditshëm e i domosdoshëm duhet të bëhet i arritshëm nëpërmjet investimeve në infrastrukturë për të gjithë qytetarët, të kultivohet e të nxiten lloje sa më të ndryshme të sportit, duke e vendosur theksin te parimet dhe vlerat e amatorizmit angazhues, e jo te konkurrenca përjashtuese.

Sporti si aktivitet garues të zhvillohet në mënyrë të balancuar, duke rritur talentet vendore në shkolla e në institucione vendore, e jo duke u bazuar vetëm tek efektet e marketingut global - ardhja e sportistëve të huaj.

Në nivelin e përfaqësimit kombëtar, si synim përfundimtar mbetet krijimi i përfaqësueseve të përbashkëta me sportistë shqiptarë nga Shqipëria e Kosova, po ashtu të ligave profesionale të përbashkëta. Këto do të ishin më dinjitoze, si në përfaqësim, ashtu edhe në rezultate.

Për këtë arsye, politika qeverisëse do të fokusohet në ndërtimin dhe zhvillimin e skemave për plotësimin e këtij qëllimi.

Duke e ditur se sporti garues njihet dy shfaqjet e veta, atë amatore dhe atë profesionale, në një shoqëri e në një shtet të shëndetshëm të dyja duhet ta marrin rëndësinë respektive, e të mos lihen pas dore.

Sportet janë të organizuara në federata dhe në shoqata profesionale dhe amatore. Fatkeqësisht, këto entitete sot janë të varura prej pushtetit, siç janë shumë pjesë të tjera të jetës publike në Kosovë. Federatat dhe shoqatat amatore do të mund të jenë rajonale dhe kombëtare. Federatat profesionale do të jenë kombëtare, ato do ta shtrijnë aktivitetin e tyre rregullator mbi gjithë Kosovën dhe do të nxiten ta shohin si partner prioritar federatën analoge në Shqipëri.

Në këtë aspekt, vlen të veçohet sidomos bashkëpunimi ndërmjet federatave të Kosovës dhe Shqipërisë dhe ato ndërkombëtare për ndërtimin e një akademie sportive dhe të një kompleksi olimpiq në Kosovë.

Kështu, ky organizim i kampionateve të përbashkëta në Shqipëri e në Kosovë do ta krijonte hapësirën garuese e kompetitive, si dhe do të sillte më shumë interes nga investitorët dhe sportdashësit, në mënyrë që të ketë rritje përgjegjësish dhe nivel cilësor sportiv në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj që i keni lexuar rekomandimet, prandaj është mirë t'i përmbaheni temës. Fjalën e ka zonja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Mendoj se është debat i shumë qëlluar, sepse sporti pas lufte vërtet është në një situatë shumë të rëndë.

Sot po më vjen keq që kur po debatohet për gjendjen e sportit në Kosovë, ministri aktual nuk e ka marrë mundin bile të jetë i pranishëm fizikisht dhe të dëgjojë atë çfarë po flitet për sportin në Kosovë.

Edhe sportistët tanë duhet përgëzuar për angazhimin dhe vullnetin për ta prezantuar veten, por edhe Kosovën, edhe në këto kushte pa përkrahje financiare. Ata, në një formë, janë bërë ambasadorë të Kosovës nëpër botë.

Komuna e Deçanit e ka një histori të bujshme të sportit, në përgjithësi. Moti para lufte, sidomos në vitet e '80-ta, sporti deçanas ishte ngritur në piedestalin më të lartë, sidomos hendbolli, duke qenë si djep i këtij sporti të Kosovës.

Hendbolli, si për femra, ashtu edhe për meshkuj, ka bërë gara në rangjet më të larta të ligave të Kosovës.

Gjithashtu, edhe futboli ka qenë shumë aktiv në komunën e Deçanit. Kanë funksionuar tri klube, klubi futbollistik “Deçani”, “Besa” dhe “Juniku”.

Po ashtu, edhe volejboli ka qenë shumë i zhvilluar dhe ka bërë gara në ligë. Mirëpo, në atë kohë, kushtet kanë qenë pak më të mira, ngase këto klube sportive janë sponsorizuar.

Me të përfunduar lufta u aktivizuan disa klube sportive, por për shkaqe financiare ato së shpejti u shuan.

Momentalisht në komunën tonë janë aktive 5 klube sportive, por të cilat janë në gjendje të vështirë financiare, e këto janë: klubi i hendbollit “Deçani” për meshkuj, që garon në Superligë; klubi i hendbollit “Deçani” për femra, liga e parë; klubi i futbollit “Deçani”, liga e parë; klubi i futbollit “Besa”, Irzniq, liga e dytë; Klubi i Shahut, liga e parë.

Është cekur më lart se gjendja në sport edhe në komunën tonë është alarmante. Andej, ne sot apelojmë nga këtu dhe njëkohësisht i përkrahim edhe rekomandimet nga ky debat që të ndihmohet sporti, qoftë në komuna, por edhe në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Si shumica dërmuese e sektorëve në Kosovë, edhe sporti është në gjendje shumë të rëndë.

Fakti se rezultatet e mira kosovare në arenën ndërkombëtare janë minimale, meqë ne mund të identifikohemi me vetëm një sportiste të vetme të suksesshme, flet mjaft se sa të varfër jemi në këtë fushë.

Për ndokënd kjo temë mund të duket e vogël dhe e parëndësishme karshi problemeve të mëdha, me të cilat përballlet Kosova. Por, të mos harrojmë se sportistët gjithmonë e kanë pasur epitetin e ambasadorëve më të mirë të një vendi dhe ne vërtet kemi shumë nevojë për ambasadorë të denjë të Kosovës.

Sportistëve kosovarë dhe punëtorëve të sportit nuk po u krijohen kushte të mira për të punuar dhe për të arritur që ta zhvillojnë sportin e tyre.

Sportistët dhe punëtorët kosovarë të sportit nuk e kanë përkrahjen e duhur financiare nga shteti, madje edhe dy xhudistet tani më të afirmuara në skenën ndërkombëtare, Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova, ditë më parë kanë paralajmëruar se janë duke i konsideruar seriozisht ofertat që kanë nga shtetet tjera për të garuar me ngjyrat e tyre për arsye se nuk janë të kënaqura me përkrahjen që u bëhet në Kosovë.

Kur nuk përkrahen sportistët kulmorë, mund ta marrim me mend se si e kanë gjendjen sportistë të tjerë. Pothuaj se çdo gjë mbetet në vullnetin e tyre dhe në dashurinë që e kanë për sportin.

Palestra dhe terrene sportive nuk janë në gjendje të mirë, gjë që pa dyshim shkakton vështirësi për sportistët. Por, gjendja jo e mirë e palestrave bën që edhe numri i spektatorëve nëpër ato të mos jetë i madh dhe gjithë kjo shkakton një hark vicioz, që e përkeqëson edhe më shumë situatën.

Në anën tjetër, sportistët tanë dikur kanë qenë edhe fitues të medaljeve olimpike, gjë që dëshmon se potenciali njerëzor ekziston, por nuk është duke u 'jutilizuar' si duhet.

Element tjetër i rëndësishëm për ngritjen e nivelit të sportit është edhe konkurrenca.

Sportistët tanë në masën më të madhe janë të privuar nga mundësia për garim në skenën ndërkombëtare. Dhe duke qenë të izoluar vetëm brenda konkurrencës kosovare, mundësia për prodhim të sportistëve kulmorë është shumë e vogël. Kjo dhe jo vetëm është arsyeja se pse ne si Lëvizje për Bashkim në vazhdimësi kemi bërë thirrje për krijimin e ligave të përbashkëta me Shqipërinë. Në këtë drejtim, vërtet ka disa iniciativa, por ende të parealizuara.

Investimi në sport e ka edhe rëndësinë tjetër të dimensionit social, e që ka të bëjë me ndërtimin e një rinie të shëndoshë nga aspekti fizik e mendor.

Orientimi i rinisë në sport ndikon në largimin e saj nga shprehjet e këqija. Ndërkaq edhe studimet kanë dëshmuar se të rinjtë që merren me sport kanë më pak gjasa të pinë duhan, apo të përdorin substanca narkotike.

Propozimet tona si Lëvizje për Bashkim për ta përmirësuar gjendjen në sportin në Kosovë, përpos atyre që janë përmendur më herët, janë këto: Të bëhen përpjekjet për krijimin e ligave të përbashkëta Kosovë - Shqipëri në të gjitha disiplinat sportive; të bëhen programe që mundësojnë kyçjen masive të nxënësve dhe të rinjve në sport. Shpresojmë që propozimet tona do të merren parasysh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj se është jashtëzakonisht mirë që në Kuvendin e Kosovës ka ardhur një nismë e tillë dhe, meqë edhe jam nënshkruese e kësaj nisme, e kërkoja fjalën.

Unë dëgjova këtu se u tha që është keq që ministri mungon. Edhe unë pajtohem që është keq meqë po diskutohet për sportin, do të duhej që ministri të ndodhej këtu. Megjithatë, më lejoni që ta përmend para opinionit, sepse të gjithë jemi të informuar se ministri Krasniqi është duke u kthyer nga Gjermania, ku i ka marrë edhe artefaktet arkeologjike të Kosovës, të cilat do t'i kthehen Muzeut të Kosovës, dhe mendoj se kjo është njëra ndër

arsyet që ministri nuk ndodhet këtu, e jo që ai nuk do të duhej të ishte sot, në një seancë e tillë kur po diskutohet për njëren prej çështjeve, që është e rëndësishme për sportistët kosovarë.

Mendoj se janë shumë faktorë, të cilët po ndikojnë që gjendja e sportit kosovar të mos jetë në nivelin e duhur. Kjo është mbetja jashtë arenës ndërkombëtare, zbrazësitë e shumta ligjore, pastaj mungesa e infrastrukturës sportive. Këtë gjendje vetëm sa po e rëndojnë edhe më shumë, por nuk do të duhej që të lihen anash edhe sukseset e shumë sportistëve tanë në garat ndërkombëtare, përkundër pengesave të shumta politike, meqë Serbia dhe Rusia e kanë një fuqi të madhe në Komitetin Olimpik dhe në federatat e sporteve të njohura, siç janë futbolli dhe basketbolli.

Prandaj, mendoj se ka pasur një angazhim edhe të ministrit të Sportit për t'i përkrahur sportistët, të cilët kanë qenë ambasadorë të mirë në arenën ndërkombëtare të Kosovës. Megjithatë, unë mendoj që duhet të merren parasysh rekomandimet që do të dalin nga ky debat, i bërë me nismën e deputetit Haxhiu dhe të deputetes së LDK-së - Vjollcës - dhe shpresoj që këto rekomandime të ndikojnë sadopak që të lehtësohet gjendja, edhe ashtu e rënduar e sportit kosovar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mosprania e Qeverisë është tregues i moskujdesit që ka, apo i kujdesit që ka realisht në sektorin e sportit dhe të sportistëve në Republikën tonë. Ministri ka shkuar t'i marrë 7 artefakte në Gjermani, të gjetura nga autoritetet gjermane, dhe është mirë që po merret me kthimin e koleksionit dhe artefakteve në Kosovë, por këtu mungon Komiteti Olimpik, mungojnë federatat e sporteve, siç e dëgjues së paku, dhe Departamenti i Sportit, si autoritet që merret në emër të Qeverisë me zhvillimin e politikave të sportit.

Atëherë, pa humbur shumë kohë, më lejoni të filloj nga pjesa e fundit, sepse Kosovës sot i mungon politika e qartë për sportet shkollore. Sportet shkollore apo aplikimi i politikave të sportit në shkolla, në të gjitha nivelet, e kanë kthyer Kosovën prapa shumë vite në mungesë të mbështetjes financiare, qartësimi ligjor dhe ndërhyrjes së ministrive relevante, në mënyrë që sporti të zhvillohet që nga institucionet fillore, shkollat e mesme dhe nivelet tjera profesionale dhe të krijohet baza e parë e zhvillimit të sportit.

Nën dy, trajtimi i Komitetit Olimpik të Kosovës dhe statusi i tij sot tregon qartë që përderisa ne e konsiderojmë vetëm si një shoqatë e sportistëve dhe e sporteve olimpike, do të jetë e pamjaftueshme që ky komitet të përfaqësohet në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Është e pamundur që kryetari i tij, zoti Hasani, megjithëse mund të shpallet hero i sportit dhe të gjitha federatat sportive, në vartësi, që përfshijnë edhe sportet paraolimpike, edhe sportet joolimpike, ta mbërrijnë rezultatin e duhur dhe të domosdoshëm, për të cilin Kosova sot ka nevojë, qoftë ai i përfaqësimit, qoftë ai i lobimit, apo qoftë edhe i mbështetjes në gjykatat e arbitrazhit, ku Kosova nuk ka arritur ta dërgojë asnjë rast, apo të fitojë, çfarë ka qenë rasti i Federatës të Basketbollit, e cila ka

arritur ta dërgojë rastin në Gjykatën e Arbitrazhit, por nuk ka pasur buxhet apo mjete buxhetore të nevojshme që i kërkojnë rregullat e kësaj gjykate, sepse në disa raste ne mund ta fitojmë nëpërmjet Gjykatës së Arbitrazhit të drejtën tonë që të jemi anëtar i këtyre federatave.

Natyrisht që sportistët e sotëm që u përmendën me emër janë për t'u krenuar, por të mos harrojmë se ne e kemi një gjeneratë të tërë të njerëzve që kanë sjellë në Kosovë medalje olimpike dhe medalje ndërkombëtare, e që sot janë plakur, apo i takojnë gjeneratës së mesme dhe gjeneratës së vjetër, që nuk janë aktiv në sport, marrin pjesë si politikëbërës në sport mbi baza vullnetare, por që njihen të harruar nga kjo shoqëri. Është fjala edhe për Aziz Salihun, është fjala edhe për Mehmet Bogujevcin, është fjala edhe për Agim Latifin, Ismet Hazirin dhe shumë medalistë dhe njerëz që kanë qenë krenaria e sportit, por që sot janë anash dhe nuk kanë asnjë lloj mbështetjeje.

Në çdo vend, treguesi real është se çdo medalist ndërkombëtar dhe olimpiq e ka statusin e rregulluar. Përderisa Komiteti Olimpik Ndërkombëtar nuk e ka pranuar Kosovën dhe nuk ia jap benificionet, nuk ua njeh privilegjet e këtyre sportistëve, është shumë e besueshme që në Kosovë nuk ka zgjidhje të drejtë, që Ministria e Sportit t'ua bëjë zgjidhjen e përkohshme apo kalimtare, përderisa ne nuk pranojemi anëtar i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Këta kanë mbetur të harruar dhe është pak premtuese dhe shumë pak e besueshme që medalistët e sotëm dhe ata që sot po punojnë shumë për sportin, siç është Majlinda Kelmendi dhe klubi i saj, të besojnë që nesër si medalist i Kosovës do të kenë trajtim në këtë shoqëri. Të gjithë sportistët po kërkojnë shtet të dytë, atdhe të dytë, për t'u përfaqësuar, dhe ikja e njerëzve, e sportistëve, nuk dallon, sikur që nuk dallon ikja e shumë njerëzve në sektorët tjerë.

Më lejoni që përveç falënderimit për të gjithë ata mijëra sportistë që e kanë mbajtur sportin gjallë në kushtet më të rënda, të mos harrojmë ta falënderojmë biznesin dhe biznesmenët në Kosovë, të cilët para luftës, me mjetet e tyre buxhetore, e kanë mbajtur sportin gjallë, duke besuar se një ditë shteti do të ketë mundësi t'i mbajë. Edhe sot Ligji për sponsorimet nuk është aprovuar. Ligji për sponsorimet nuk ka kaluar, që e njeh këtë të drejtë sikur çdo vend tjetër - që çdo biznesi, i cili kontribuon drejtpërdrejt në sport, në zhvillimin e sportit dhe në klubet sportive, t'i njihet e drejta e zbritjes në përqindje të caktuar në tatimin në fitim. Ajo mund të jetë 2%, mund të jetë 10%, çfarë ka qenë e propozuar, sepse nuk i jap kurrfarë impakti negativ Buxhetit të Kosovës. Kjo duhet të zgjidhet në të mirë të zhvillimit të sportit, e jo në të mirë të vetëm të një pale.

Nëse u njihet kjo e drejtë dhe nëse me urgjencë e me prioritet sponsorohet ky ligj, atëherë bie përgjegjësia financiare e Qeverisë ndaj zhvillimit të sportit dhe autoritet që merret me tatime janë ata që garantojnë që të mos lejojnë abuzime, sepse ka qenë frika e ish-ministrit të Financave se mund të ketë abuzim. Pse ne duhet të dyshojmë gjithmonë se ata njerëz që kanë dhënë miliona bashkërisht për zhvillimin e sportit paskan interes të abuzojnë me buxhetin e sportit. Nuk kanë kurrfarë interesi. Ata kanë nevojë që 10% e

tatimit në fitim t'u njihet, ndërsa 90% vazhdojnë ta paguajnë kontributin e vet në Buxhetin e Kosovës.

Kjo është imediate për t'i dhënë drejtim më të mirë sportit dhe për ta stimuluar sportin në Republikën tonë, në përgjithësi. Më lejoni që të ju them, unë jam për kompetencat dhe statutin e Komitetit Olimpik të Kosovës si organizatë, e cila e merr përgjegjësinë, apo Qeveria e ndan përgjegjësinë për zhvillimin e sportit. Komiteti Olimpik, sipas shembullit të disa shteteve të zhvilluara, është komitet i cili bën, zhvillon dhe zbaton politika të sportit në emër të qeverive, në të cilin hyjnë të gjitha federatat, të gjitha shoqatat dhe të gjitha organizatat sportive dhe Qeveria merr për obligim pjesërisht ta buxhetojë atë, duke ia njohur këtë të drejtë, por duke mos ndërhyrë në politikat zgjedhore dhe në politikat sportive. Kjo zgjidhje i përshtatet Kosovës, ky model është më adekuat për Kosovën dhe e rregullon çështjen edhe të financimit, edhe të politikave sportive, por edhe të zbatimit të këtyre kalendarëve dhe angazhimeve që sportistët duhet t'i kenë domosdoshmërisht.

Më lejoni të rikapituloj me dy kërkesa që besoj sponsoruesit e këtij debati, që e kanë bërë sot, i kanë të domosdoshme. Nën një, që statusi medalistëve të zgjidhet në mënyrë urgjente, t'i rekomandojmë Qeverisë, sepse, mos harroni, nëse nuk gaboj, nëse nuk ka ndryshuar, janë 7 sportistët që kanë medale ndërkombëtare, që duhet rregulluar. Për 7 njerëz po flasim, nuk po flasim për 70, as për 7 000. 7 medalistë që duhet ta kenë në mënyrë urgjente të rregulluar statusin dhe duhet t'ua rregullojmë të gjithë sportistëve që po garojnë ta fitojnë të drejtë në përfaqësimit të Kosovës në gara olimpike, siç është rasti me Majlinda Kelmendin. Duhet gjetur rrugën që ata të mos pengohen në ecje.

Të mos harrojmë që sportet e shkathtësisë, siç janë boksi, mundja e karateja janë sporte që kanë sjellë më së shumti medalje në Kosovën e pasluftës dhe në Kosovën e paraluftës. Këto sporte duhet të kenë një prioritet karshi sporteve tjera. Natyrisht që sportet kolektive, edhe hendbolli, edhe futbollit, edhe basketbolli, janë sporte në të cilat Kosova ka talent dhe po dëshmon, jo vetëm brenda, por edhe jashtë. Nuk guxojmë ta lënë në harresë dhe pa kujdes edhe më tutje, sepse njerëzit kanë filluar të ikin dhe kanë filluar të mos jenë pjesë e aktiviteteve sportive.

Nën dy, unë rekomandoj që seanca të kërkojë nga Qeveria që ta determinojë qartë rolin e Komitetit Olimpik. Të mos e lërë këtë status që e ka sot. Komiteti Olimpik i Kosovës dhe federatat e sporteve duhen të jenë dhe t'i marrin përgjegjësitë e Qeverisë në politikën e sporteve. Duhet ta njohin një status, të rregullohet kjo çështje në mënyrë urgjente dhe ta buxhetojnë, në mënyrë që këta të kenë mundësi të punojnë më shumë.

Në anën tjetër, unë mendoj që një grup i deputetëve është i domosdoshëm të qëndrojnë afër tyre, afër sportit, e jo vetëm 2-3 deputetë që sot janë anëtarë të komiteteve olimpike dhe të federatave, por në formë lotimi një grup jo formal i deputetëve mund t'u qëndrojnë afër më shumë sportistëve dhe mund të kërkojë apo të bëjë presion në Qeveri që këto politika t'i qartësojë dhe t'i buxhetojë, ç'është më e rëndësishme, sepse nuk ka rrugë tjetër.

Unë i falënderoj dy sponsoruesit që sot e kanë sjellë këtë çështje dhe për herë të parë ky Kuvend po debaton për një sektor që është po aq i madh sa është sektori i arsimit, i shëndetësisë dhe sektorët...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Petar Miletiq.)

KRYESUESI: Hvala! Reč ima poslanik Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zori kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë fillimisht do të ndalem shumë shkurt dhe i përkrah rekomandimet dhe atë që e tha shefi i Grupit të Aleancës, por do ta prek një çështje që tërthorazi e preku edhe deputeti Lutfi Haziri - sportin në shkollë. Unë besoj që edhe shkollat që tani po ndërtohen janë duke u ndërtuar pa palestra sportive, pa një perspektivë për sportet shkollore, sepse aty lindin talente. Nëse themi që shkollat para 20 vjetëve janë ndërtuar pa një palestër, edhe tani janë duke u ndërtuar pa palestra sportive, ku të rinjtë tanë mund ta zhvillojnë talentin.

Në shumë vende perëndimore, nxënësit nuk mund të regjistrohen në klasën e nëntë ose të dhjetë nëse nuk dinë not ose ndonjë sport tjetër, ndërsa ne më shumë kemi të rinj nëpër kafiteri sesa kemi nëpër palestra sportive dhe nëpër vendet tjera për arsye se nuk ka infrastrukturë. Prandaj, sporteve shkollore duhet t'u kushtohet një rëndësi e madhe për arsye se aty është numri më i madh i të rinjve dhe do t'i kisha lutur të gjitha institucionet për sportistat kulmore, që po themi se janë ambasadorë më të mirë të sportit, siç janë Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova, që u përmendën nga shumë deputetë. Unë dua ta përmend me krenari se ato vijnë po nga qyteti i Pejës, duhet të bëhet më shumë për ato dy sportiste të qëndrojnë në Kosovë, sepse kohëve të fundit ato kanë bërë më shumë si ambasadore dhe e kanë popullarizuar shtetin e Kosovës. Faleminderit!

KRESUESI: Hvala! Reč ima Ganimete Musliju.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fillimisht më lejoni që ta përshëndes iniciativën e dy deputetëve që sot debatojnë për sportin në Kuvend, zotëri Bekim Haxhiu dhe Vjollca Krasniqi.

Më vjen mirë që sot si Kuvend po debatohet për sportin. Sporti është një segment shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit dhe si i tillë sigurisht që e meriton edhe një trajtim nga ne si deputetë të këtij Parlamenti. Dua t'i përshëndes të gjitha ato që u thanë nga kolegët e mi deputetë, qoftë nga pozita, qoftë nga opozita, dhe unë nuk mund assesi ta tejkaloj radhën pa bërë një vështrim paksa më pozitiv dhe t'i nxjerr disa detaje ose të arritura të sportit të Republikës së Kosovës gjatë këtyre viteve të fundit. Unë nuk mundem ta tejkaloj radhën pa e përgëzuar ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në veçanti ministrin Memli Krasniqi për punën e bërë gjatë këtij mandati prej se ai e ka marrë detyrën si ministër për Kulturë, Rini dhe Sport.

Të arriturat e kësaj ministrie tashmë janë të ditura. Madje ato janë të prekshme, janë evidente dhe për to flitet në gjithë komunitetin e sportit. Sigurisht që nuk do të mund t'i përmbledh të gjitha, por do të mundohem t'i përmend disa me rëndësi, siç janë ndryshimet pozitive në infrastrukturën ligjore, avancimi i politikave programore, mbështetja për Komitetin Olimpik dhe federatat, mbështetja për sportistët cilësorë, siç ishte rasti i mbështetjes së vazhdueshme për Majlinda Kelmendin, e cila edhe sot është përmendur nga shumë parafolësi të mi.

Gjithashtu investimet në infrastrukturë, siç janë: renovimi i fushave të futbollit; ndërtimi i poligoneve shkollore; nxjerrja e donacioneve nga Komisioni Evropian për ndërtimin e 6 fushave sintetike të futbollit, që ju them sinjerisht, ndoshta unë nuk marr shumë vesh nga futbollit, por kam dëgjuar nga zyrtarë dhe analistë të futbollit tek thonë në mjetet e informimit që kjo është e arritura më e madhe e pasluftës në futbollin e Kosovës. Vazhdimi i punimeve nëpër shumë palestra, në mesin e tyre edhe renovimi i palestrës studentore "1 Tetori", e shumë investime e bashkë-investime, siç është rasti i qendrës multifunksionale në Mitrovicë e të tjera, deri te rasti i fundit, që ishte mundësimi i sjelljes së mjeteve të një stadiumi suedez në shërbim të stadioneve kosovare. Po ashtu, ne jemi të informuar për telashet që i ka Komiteti Olimpik i Kosovës dhe federatat sportive drejt ndërkombëtarizimit të interferimit politik nga jashtë e kështu me radhë, por megjithatë gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe disa pranime federatash gjithashtu, siç ishte rastin me fushat sintetike, edhe për këtë çështje, edhe Komiteti Olimpik, e po ashtu edhe federatat, e kanë falënderuar publikisht Ministrinë e Sportit, gjë që lë të kuptohet vetë për angazhimin që e ka bërë kjo Ministri për këtë fushë.

Ka shumëçka të flitet për të arriturat e sportit gjatë këtyre dy vjetëve dhe sinjerisht do të doja të flisja gjatë, sepse ka aq shumë gjëra dhe ndryshime pozitive, sa do të më duhej të flas shumë. Andaj nuk do të dëshiroj që të jua marrë kohën kolegëve të mi deputetë, që besoj se kanë gatishmëri dhe angazhim që të kontribuojnë në këtë debat sot. Por, të nderuar të pranishëm, të nderuar kolegë deputetë, më lejoni të marr vetëm edhe një shembull si të arritur të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Vitin e kaluar, për herë të parë është licencuar Federata e sportit shkollos dhe për herë të parë në Kosovën e pasluftës janë organizuar garat sportive shkollore në nivel komunash dhe po ashtu në nivel qendror, në të cilat kanë marrë pjesë hiç më pak se 20 komuna, e kjo mund të konsiderohet dhe duhet përshëndetur si një sukses i kësaj Ministrie. Të gjithë e dimë që të rinjtë e Kosovës, përveç nevojave të shumta që kanë, më shumë se kur kanë nevojë të merren me aktivitete sportive dhe pikërisht investimet në këtë fushë do të mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve sportive, zhvillimin e talenteve të reja dhe mbrojtjen nga dukuritë negative, siç e përmendi më herët edhe parafolësja ime, zonja Bakalli.

Andaj, të nderuar deputetë, meqë të rinjtë janë shihen si perspektivë e këtij vendi dhe kontribuuesit më të mëdhenj për stabilitetin e vendit, unë dua ta përgëzoj Ministrinë e Kulturës dhe ta inkurajoj që të vazhdojë me përkushtim edhe më të madh që të ofrojë mundësi për sportistët dhe për të gjithë sportdashësit e Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Demolli!

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, të cilët nuk jeni të pranishëm këtu, e sidomos ndihet mungesa e ministrit të Sportit, sepse po debatohet për një çështje shumë të rëndësishme për rininë dhe sportin kosovar.

Të nderuar sportistë të Kosovës,

Fjalën time në këtë debat parlamentar lidhur me sportin në Kosovë do ta filloj duke shtruar tri pyetje tejet të rëndësishme për këtë aktivitet tejet të dobishëm për rininë dhe shoqërinë kosovare në përgjithësi:

Nën një, cila është gjendja dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet sporti në Kosovë pas pavarësimit të tij?

Nën dy, sa është i përkrahur sporti nga Qeveria e Kosovës?

Nën tre, cilat janë masat që duhet ndërmarrë për ta ndihmuar sportin kosovar?

Kur flitet për gjendjen e sportit kosovar, atëherë gjithsesi duhet theksuar se pikërisht sporti dhe arsimi janë dy prej segmenteve të para që janë ndarë dhe pavarësuar nga sporti, respektivisht arsimi i organizuar dhe i mbikëqyrur nga ish-pushteti serbosllav. Në rrethanat e veprimit paralel, që domethënë në periudhën e viteve të '90-ta, kur sportistët kosovarë i kishte dëbuar regjimi serb prej objekteve, palestrave dhe stadiumeve publiko-shtetërore, ndonëse sportistët kosovarë e zhvillonin veprimtarinë e tyre nëpër fusha, lëndina dhe në terrenet e improvizuara, pra në kushte të mjerueshme, vullnetin dhe dëshirën për sport ua mbante në jetë shpresa se kur Kosova do të pavarësohej, shteti i Kosovës do t'i trajtojë me një përkushtim dhe qasje shumë më serioze.

Por, ja që tani po bëhen 14 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë, kurse sporti kosovar edhe më tutje ballafaqohet me probleme të shumta elementare, siç është mungesa e infrastrukturës së nevojshme dhe atë duke filluar nga lokalet e federatave, të cilat nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për ta zhvilluar aktivitetin e tyre. Thujse të gjitha federatat dhe Komiteti Olimpik veprojnë në një objekt të vetëm, i cili është ndërtuar në vitet e '70-ta. Por, në gjendje më të mirë nuk janë as sportistët, klubet dhe përfaqësueset nacionale, shumica e të cilave zhvillojnë aktivitete në stadiume dhe fusha të dëmtuara, apo në palestra, të cilave mungojnë kushtet elementare, si ngrohja, zhveshtoret, banjat dhe pajisjet elementare sportive.

Sportin kosovar, për dallim prej atij të vendeve në regjion, e mundon edhe një problem tjetër, sepse me përjashtim të disa federatave, numri më i madh i federatave, përfshirë këtu edhe dy më të mëdhatë, që e tubojnë numrin më të madh të sportistëve kosovarë, pra fjala është për federatën e futbollit dhe atë të basketbollit, janë të izoluara në planin ndërkombëtar, që do të thotë se numrit më të madh të sportistëve, klubeve dhe përzgjedhjeve nacionale kosovare nuk u lejohet që të marrin pjesë në garat ndërkombëtare, gjë që paraqet një ndëshkim të padrejtë nga asociacionet ndërkombëtare,

që po ua bëjnë tani më gati një çerek shekulli, apo thënë ndryshe 3-4 gjeneratave të sportistëve kosovarë, në radhë të parë për shkak të faktorëve dhe motiveve që nuk kanë fare të bëjnë me sportin, e ato janë shkaqet politike.

Kjo gjendje e vështirë e sportit kosovar është e rënduar edhe më shumë për shkak të përkrahjes financiare jo të mjaftueshme nga Qeveria kosovare, Qeveria, sepse në njëfarë mënyre, me rastin e planifikimit dhe ndarjes së buxhetit, e anashkalon sportin dhe sportistët, apo thënë më mirë i neglizhon, duke mos e pasur konsideratën që e meritojnë sportistët dhe punëtorët sportivë, jo vetëm për shkak të së kaluarës, të tashmes, por edhe për shkak të rëndësisë së madhe që sporti ka për të ardhmen e shoqërisë kosovare, sepse është e ditur që sporti dhe aktiviteti sportiv i largojnë të rinjtë nga droga, alkooli, rruga, bredhja dhe krimi, që do të thotë ndihmojnë në formimin e një rinie të shëndoshë, e pa rini të shëndoshë nuk mund të llogaritim as në krijimin e shtetit të fortë.

Kur them se sporti nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë, apo është neglizhuar nga Qeveria dhe nuk është përkrahur financiarisht në mënyrë të kënaqshme, kam parasysh të dhënat e projektbuxhetit për vitin 2013, sipas të cilit Qeveria e Kosovës për Ministrinë e Sportit dhe Kulturës për këtë vit ka planifikuar 19 milionë euro, prej tyre 7,9 milionë euro janë paraparë për investime kapitale për sport, që krahasuar me 621 milionë, sa janë paraparë në përgjithësi për investime kapitale, paraqet vetëm diç më pak se 1,3%. Pra, të investosh me vetëm 1,3% në sport në një vend me moshë mesatare të popullsisë 22,2 vjet dhe me afro 70% të popullatës nën moshën 30-vjeçare, sipas mendimit tim, jo që është një neglizhim, por është një politikë tej mase e gabuar e kësaj Qeverie, sepse pa përkrahje financiare nuk ka kushte të mira sportive, e pa kushte nuk ka interesim për sport dhe pa sport nuk do të kemi as rini të shëndoshë.

Duke pasur parasysh atë që theksova më lart, unë mendoj që shteti dhe shoqëria kosovare, në përgjithësi, duhet të ndërmarrin një numër të konsiderueshëm të masave, të cilat do të ndikonin në përmirësimin e kushteve për aktivitetet sportive, me çka edhe do të kishim masivizimin e rinisë kosovare në veprimtarinë sportive.

Kështu, në radhë të parë, propozoj që Qeveria e Kosovës, gjatë projektimit të buxhetit për vitin 2014, të planifikoj dyfishimin e buxhetit për sport në raport me buxhetin për sportin për vitin 2013. Si masë e dytë, që Qeveria duhet ta ndërmarrë është që në bisedimet me palën serbe të kërkojë nga Serbia dhe nga ndërmjetësuesit ndërkombëtarë që politika ta heqë ndikimin e vet nga sporti. Pra, të bëhet presion ndaj palës serbe që ajo në formë të shkruar të pajtohet që nga ky vit e tutje nuk do të bëjë kurrfarë pengese për anëtarësimin e federatave kosovare dhe të Komitetit Olimpik kosovar në asociacionet përkatëse ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, sporti kosovar do të dilte nga izolimi mbi 20-vjeçar, sportistëve kosovarë do t'u mundësohej që të marrin pjesë në garat ndërkombëtare, si dhe do t'u mundësohej që federatat dhe klubet kosovare të përfitonin nga fondet për zhvillimin e sporteve në vendet e pazhvilluara, e që për shkak të mosanëtarësimit aktualisht nuk po mund t'i realizojnë përfitimet e theksuara. Si masë të tretë, propozoj që Qeveria kosovare ta përpilojë draftligjin për sponsorim dhe t'ia paraqesë Kuvendit me dispozitat e të cilit

do të parashiheshin lehtësime të caktuara tatimore dhe doganore për të gjitha ndërmarrjet që japin donacione dhe i përkrahin financiarisht klubet dhe sportistët kosovarë.

Ligji i tillë duhet të përmbajë dispozita me të cilat parashihen benificione të caktuara edhe për të gjithë ata donatorë, numri i të cilëve nuk ka qenë i vogël, e të cilët madje edhe e kanë shkrirë pasurinë e tyre për ta përkrahur financiarisht sportin dhe për ta mbajtur në jetë atë. E shfrytëzoj rastin që nga kjo foltore e këtij Kuvendi të nderuar, si një ish-punëtor sportiv, që në emër të sportistëve, klubeve, punëtorëve sportivë dhe rinisë kosovare, që të gjitha ndërmarrjeve, firmave private, personave juridikë dhe fizikë, të cilët financiarisht dhe në forma tjera materiale e kanë përkrahur dhe mbajtur në jetë sportin kosovar që nga viti 1990 e deri me sot, t'u bëj një falënderim të madh.

Si masë të radhës e propozoj ngritjen e interesimit dhe përkushtimit të organeve të rendit lidhur me organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve sportive, me çka do të parandaloheshin sjelljet dhe veprimet e dhunshme në sport, si dhe do të krijoheshin kushtet që edhe familjarët, si të rinjtë, ashtu edhe të moshuarit, të mund t'i përcjellin ndeshjet sportive. Krejtësisht në fund, propozoj që Qeveria e Kosovës ta sajorë rregullativën ligjore me të cilën në njërin anë ish-sportistët e dalluar, siç janë ish-olimpistët, ndër ta edhe boksieri i njohur Aziz Salihu, pastaj fituesit e medaljeve të kampionateve evropiane dhe botërore, ndër ta edhe boksieri Mehmet Bogujevci, do ta gëzonin një përkrahje financiare shtetërore, e në anën tjetër edhe talentet aktuale, siç janë Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova e të tjerë do të përkraheshin financiarisht në mënyrë që të ndalen e të garojnë nën flamurin e kombit dhe të shtetit tonë, e jo të largohen në drejtim të ndonjë vendi të caktuar për të garuar nën flamurin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Me gjithë mungesën e arsyeshme të Qeverisë ose pjesëtarëve të tjerë të saj që të marrin pjesë në këtë debat, sepse sporti nuk i takon vetëm Ministrisë së Sporteve dhe të Kulturës, por interferon edhe me ministrinë tjera, mendoj që në këto debate të jenë si sugjerim për tjera herë, që para se të fillojnë, ne si deputetë të kemi materiale informuese lidhur me situatën se çka është duke u bërë dhe mandej ta fillojmë debatin mbi bazën e atyre fakteve, të cilat ne i kemi.

Unë e përkrah një debat të tillë, i cili është jashtëzakonisht i nevojshëm në arsyeshmërinë e kësaj dhe mendoj që në pikën 2, ku kërkohet si arsyeshmëri që për herë të parë sot Kuvendi i Republikës së Kosovës, me iniciativën e deputetit Haxhiu dhe zonjës Vjollca, e kemi një debat në interes të fëmijëve tanë, në interes së ardhmërisë sonë. Unë them është në interes të fëmijëve tanë, sepse vetëm mendja e shëndoshë rri në trup të shëndoshë. Prandaj, ne duhet ta kuptojmë këtë çështje, që është me rëndësi të fillohet nga një kënd tjetër, jo nga këndi të cilin ne jemi duke e parë, se këtu në arsyeshmëri paraqitësit e debatit më shumë janë fokusuar për federatën, për internacionalizimin e sportit e të gjitha tjerat, por unë mendoj që nëse nuk kemi politika të mirëfillta nga fëmijët shkollorë nëpër shkolla, sepse sot është një krizë globale në tërë botën, prandaj varshmëria nga të

qëndruarit ulur shkakton deformitetet të mëdha, qoftë nga obeziteti, qoftë nga deformimet në kurriz, e të gjitha me radhë dhe mendoj që problemi fillon nga organizimi komunal.

E marrim shembull Komunën e Prishtinës. Sot në Komunën e Prishtinës është...

(Reagim: Zotëri kryetar, a do t'i ulësh disa prej këtyre njerëzve, apo të fillojmë...?!)

...është koncentruar popullatë e madhe, e cila e ka një numër shumë të madh të fëmijëve në edukimin parashkollor dhe shkollor dhe po të thuhet se kemi shembull pozitiv që këta fëmijë kanë rekreacione të mjaftueshme dhe nga disa statistika del që mbi 80% te tyre nuk dinë ta ngasin biçikletën, ose mbi 70% nuk dinë not. Cilat janë obligimet? Nuk janë vetëm të Ministrisë së Kulturës, por janë edhe të organizimit komunal. Ne jemi të vetëdijshëm, meqë në çdo aktivitet politik, kur kërkohen votat nga popullata, premtohet që ne do t'i përkushtohemi kësaj për fëmijët tanë, prandaj Komuna e Prishtinës është dashur të jetë shembull për komunat tjera. E marr këtë shembull, sepse unë kam jetuar në Tiranë, dhe në një kohë ajo që mbushur nga barakat, derisa erdhi Edi Rama dhe e dha një shembull të mirë pozitiv për ndërtim të gjitha komunave tjera nëpër Republikën e Shqipërisë. Ato e morën Tiranën si shembull pozitiv.

Në Prishtinë nuk di çka të marrësh shembull pozitiv, prandaj mendoj që adresimet duhet të jenë të fokusuara në organizimin shkollor nëpër shkolla. Shkollat sot kanë kërkesa që të bëhet nga një fushë e sportit jashtë, por palestrat brenda nuk janë askund, e të cilat janë shumë të rëndësishme, sidomos në shkollat e mesme. Këto janë masa, të cilat sot duhet të ndërmerren me vëmendje të veçantë, me përkushtim të madh dhe të cilat krijojnë nga kjo grup të madh të nxënësve, i cili është i nevojshëm edhe për popullatën, si formë preventive për shëndetin e tyre, që mandej ta kemi edhe mundësinë e nxjerrjes së cilësisë së sportistëve, të cilët do të tregojnë edhe kualitete të tilla.

Problemi tjetër këtu, mendoj që edhe Fakulteti i Edukatës Fizike duhet ta luajë një rol shumë të rëndësishëm në politikëbërjen, por edhe në pjesëmarrjen aktive të organizimit të jetës së edukatës fizike dhe e cila përfundon mandej në konceptin e sportit si definicion. Unë propozoj, meqë para disa ditësh kemi pasur privatizimin e qendrës së Brezovicës, që edhe në atë fushë të privatizimit, ai që do ta privatizojë ta ketë një kompleks sportiv të detyrueshëm në investim, i cili do të shfrytëzohet në mënyrë të organizuar për 12 muajt e vitit nga të gjitha gjeneratat, të cilat janë të nevojshme. Po ashtu, qendrat rekreative dhe sportive në Bogaj të stimulohen, qoftë me donatorë, ose me investimet publiko-private, të cilat do të kishin edhe zhvillim ekonomik, edhe zhvillim fizik dhe të shëndetit të popullatës dhe të fëmijëve tanë.

Po ashtu, në Shalë të Bajgores mund të jetë një kontingjent i tillë, ku ne mund t'i kombinojmë tri pozicionet brenda Republikës së Kosovës dhe të mos dalim, siç po dëgjojmë 'ishin në stërvitje atje, ishin këtu', kur ne kemi mundësi që nga investimet që hyjnë mund t'i ndalim në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, në pikën e rekomandimeve, jam plotësisht dakord që Ligji për sponsorim të vijë në Parlament, e derisa ne nuk kemi një ligj të tillë të sponsorimit, mendoj që Qeveria e

Republikës së Kosovës, po ashtu edhe fondet e Republikës së Kosovës, nuk mund të jenë të mjaftueshme. Ne shohim sponsorime nga shtetet në shtete, të cilat i sponzorojnë dhe në atë mënyrë do të fillojmë. Do të kemi edhe kualitet tjetër të përzgjedhjes, po ashtu edhe Ligjin për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre.

Propozoj po ashtu që të krijohet një grup nga deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, i cili do të jetë një grup ndërmjet monitorimit të federatës dhe të Ministrisë për Sport dhe Kulturë, për të nxjerrë sa më shumë të gjetura në sukses ose propozime, të cilat do të lehtësonin dhe do ta zhvillonin sportin në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, replikë

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar!

Është shumë e rëndësishme që të flitet për sportin, pa asnjë dyshim, por e vërteta është ndryshe nga ajo që e tha zoti Shaip. Nuk qëndrojnë këto dhe diskutimi i tij është tërësisht politik dhe më së paku sportiv, ose për sportin. Unë vetëm dua t'ia rikujtoj se është mirë t'i marrë të dhënat në Komunën e Prishtinës, t'i tregohet se vetëm në vitin 2012 janë bërë 15 terrene sportive nëpër lagje të ndryshme. Nëse nuk e di, është mirë t'i marrë këto. Për këtë vit është paraparë shtegu i atletikës në Gërmi, është paraparë të fillojë pishinas olimpike në Gërmi, është paraparë gjithashtu renovimi i pishinës aktuale. E po i them gjithashtu se edhe nja 90 klube sportive diku janë ndihmuar financiarisht nga Komuna e Prishtinës vetëm në vitin e kaluar. Dhe, po i them, le të dalë dikush nga Qeveria, edhe ky vetë le të tregojë se çka ka ndihmuar Qeveria ose Ministria përkatëse për komunën e Prishtinës. Prandaj, ne mund të flasim e të bëjmë politikë për poenë politike edhe në sport, domethënë ky, por këto janë të paqëndrueshme dhe absolutisht jo e vërtetë. Nuk ka gati lagje në Prishtinë që nuk ka fushë të sportit, duke përfshirë prej veriut aje, Kodrës së Trimave, dhe në pjesët tjera. Po ashtu, po ua përmend edhe qendrën rinore që është bërë në Bregun e Diellit me 400 metra katror. Këto janë rezultate që nuk është mirë të mohohen, por edhe nuk mund t'i mohosh për shkak se në Prishtinë nuk je dhe sigurisht nuk mund të jesh në qeverisje. Ky është halli i këtij dhe është mirë të na tregojë për komunat tjera, por ajo që është kryesore për Prishtinë le të na tregojë çka ka ndihmuar Qeveria, përkatësisht Ministria përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë zoti Muja. Një minutë!

SHAIP MUJA: Unë nuk kisha dëshirë ta marrë si çështje politike zoti Beqiri, por këta janë mësuar që të kamuflojnë, sepse 13 vjet e kanë e kanë menaxhimin e Prishtinës dhe unë po i them zotit Beqiri se unë e kam djalin kampion në krol 50 metrash dhe ka fituar në një trajnim, në një pishinë në periferi të Prishtinës, dhe në urimet personale që më janë bërë, unë nuk jam gëzuar, por jam mërzhitur, sepse kryetari i Komunës dhe kryetarët tjerë nuk kanë krijuar asnjë kusht, i cili mund të nxjerr kualitete të tilla. Po ashtu, në vitin 2010, kur ne e shohim që suficiti me 17 milionë euro po ashtu i mbetet Komunës të Prishtinës dhe them unë pse të mos ndërtojmë për sport, ose për çështje tjera sociale, por t'i kthehen Qeverisë. Kjo tregon se ndodh keqmenaxhim. Prandaj, këtu nuk kemi nevojë që t'i politizojmë paaftësitë dhe dështimet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Ok, po e shkel Rregulloren me vetëdije. Zoti Beqiri e ka një minutë shtesë, me të drejtë që të reagojë edhe Shaipi.

ISMET BEQIRI: Unë veç dua t'i them zotit Muja që informatat i ka të gabueshme. Edhe një herë po them, jo 13 vjet, por edhe shumë 13-sha do të shkojnë dhe mund ta shohë në ëndërr Prishtinën. Po i them po ashtu se këto që po i thotë janë të paqëndrueshme. Ti mund të kesh buxhet edhe të mos e shpenzosh është më mirë se sa të keqpërdoret, ashtu siç ndodh në Qeverinë tonë në fund të vitit. Ne të gjithë e dimë këtë, asnjë cent nuk i është kthyer Buxhetit të Kosovës. Ato janë të hyra vetjake dhe të gjithë e dimë se ky është manipulim i tij që mjetet vetjake ke të drejtë t'i bartësh dhe nuk të humbin, por është e rëndësishme që ato mjete të destinohen atje ku duhet dhe sipas procedurave. Prandaj, nuk qëndron kjo që e tha edhe është absolutisht një shpifje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja, një minutë.

SHAIP MUJA: Unë e kuptoj zotin Beqiri dhe unë nuk ju dëshiroj qytetarëve të Republikës së Kosovës të shohin ëndrra, sipas dëshirës të zotit Beqiri dhe udhëheqjes së Komunës së Prishtinës, sepse këto ëndrra janë që nuk duan t'i shohin. Prandaj, spekulimet me fondet, nga të dhënat zyrtare, unë i di sponsorimet nga Qeveria me shtesë për Komunën e Prishtinës sa janë bërë dhe paaftësinë për të planifikuar në fushën e sportit. Prandaj, këto janë vetëm qasje për votim, edhe për spekulim të ëndrrave, të cilat qytetarëve të Republikës së Kosovës u them të mos i shohin, sepse nuk i çojnë askund. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Këta të dytë që folën, meritojnë t'u kthehet përgjigje, por po t'u kthehet, duhet vazhduar edhe 5 herë me replika, prandaj nuk dua replikë. Nuk është mirë që paratë që i ke të mos dish t'i harxhosh, por nuk është mirë edhe të vidhen. Asnjëra nuk është mirë. Kaq! Tash ju e shfrytëzoni, por unë nuk ju thashë juve.

Zoteni kryesues!

Çështja e diskutimit të sportit sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës është mirë që të diskutohet nga të gjitha aspektet, por mundësisht edhe të krijohet pasqyrë e vërtetë dhe dalje, sepse situata është shumë e rëndë. Meqë nuk është diskutuar shpeshherë, natyrisht ky është një regjistër i 100 mijë temave rreth sportit, që kanë të bëjnë me edukimin, kanë të bëjnë me sportin masiv, kanë të bëjnë me sportin profesional dhe me atë që quhet sport përfaqësues, që këtu nganjëherë quhet edhe 'ambasador i vendit - përfaqësues'. Pra, janë nivele të natyrave të ndryshme. Nëse mendojmë për sportin masiv, atëherë kemi të bëjmë me kultivimin e tij, së pari në nivelet shkollare, që kapin moshën deri në shkolla të mesme, sepse universitetet kudo kanë nivel tjetër organizimi.

Pra, ajo që dikur quhej fizkulturë - kulturë fizike, më në fund është quajtur edukatë fizike, është problemi a mund të funksionojë realisht në shkolla përtej teorisë. Ky është problem

i Ministrisë së Arsimit, i Ministrisë së Kulturës që merret me sportin dhe gjithmonë i ministrive që kanë para - i Ministrisë për Financa.

Unë dëgjova këtu dhe mu duket njeriu më real zoti Demolli, i cili na dha shifra. Nëse kemi vetëm 1 milion e 300 mijë brenda një viti për investime në sport, ajo është shumë simbolike. Kudo që t'i ndajnë në Kosovë veç 1 milion e 300 mijë për një vit janë pak. Pra, shteti, në këtë rasat Qeveria, nuk ka para për investime në infrastrukturë. Dhe, këtë duhet ta konstatojmë. Nëse duam përmirësim, duhet të ndahen më shumë para.

Ne e kemi një histori të dhimbshme 20-vjeçare rreth punës të organizimeve të sportit, qoftë si sport profesional elitë, që ne po e synojmë me fjalime, qoftë atij që është amator i dashuruesve. Pra, i atyre që e bëjnë profesion dhe i atyre që e dashurojnë. E para ka të bëjë me atë spartanizmin, - kulturën e trupit, kurse e dyta ka të bëjë me atinizmin, ta quajmë kështu kulturën e mendjes, që filozofët e kanë bashkuar në atë thënien, e që e tha një koleg - 'mendja e shëndoshë në trupin e shëndoshë'. E tash, a kemi ne organizim për sport për amatorë edhe për profesionistë? Për asnjërin! Ne e kemi trashëguar një tip organizimesh që shkojnë sipas degëve të sportit. E, çfarë kemi bërë? Kurrëgjë, përveç ndërrimit të emrave, dikur u thoshin 'lidhje', tash u thonë 'federata'. E njëjta gjë. Funksionalisht nuk ka ndërruar gjë.

Tutje, kemi dhjetë vjet prej kur është organizuar si sport t'i themi qartë politik, sepse është organizuar në livadhe e në ara. Unë ju garantoj që për 10 vjet, Kupa e Kosovës është ruajtur, por është luajtur në livadhet e Dumniceës, që quhen "Livadhet e Selimit", dhe ky njeri i rrihte të bijtë që po e humbnin kohën duke luajtur futboll, por për Kosovën e lëshonte livadhin. Kjo është ajo që unë dua të them - të kemi kujdes çka është përfaqësimi politik. Pse? Sepse edhe sot po kalojmë me një hark prej përfaqësimit politik - në profesional. Po, sporti është përfaqësim i fortë politik, veçse atëherë duhet ta luajmë lojën e organizimit politik të vërtetë. Çka do të ë thotë kjo? Do të thotë se sot Kosova duhet të luftojë që organizatat e saj sportive të hyjnë në organizatat ndërkombëtare. Jo një ditë të thonë 'duam të jemi shtet, të hyjmë në UEFA', e të nesërmen të thonë 'jo nuk jemi, se duam ligë nacionale'. E këto të dyja nuk funksionojnë mirë, miqtë e mi të mirë. Nuk ecin. E ky konfuzion është krijuar edhe në muajin e fundit.

Nuk mund në të njëjtën kohë ta luash shtetin, dhe në të njëjtën kohë ta luash nacionin. Janë dy sende. Edhe në sport, ose luftojmë të hyjmë në të gjitha organizatat si Kosovë, ose themi jo nuk luftojmë që të hyjmë, por krijojmë masa të përkohshme, ose kalimtare. Këto duhet të sqarohen, sepse nuk janë njësoj.

Tutje, ligat që i kemi ne, për të hyrë tash kjo që po them është sport nacional dhe përfaqësues, a ka objekte Kosova? Jo. Kosova nuk e ka ende asnjë stadium që pranon një ekip i klasës së parë evropiane të vijë për të luajtur një miqësore. Nuk e ka asnjë. Për të bërë gara të forta evropiane dhe rajonale duhen kushte, kushte materiale, para së gjithash. Ato e prodhojnë edhe kualitetin, nëse flasim për rezultate. Po nuk ke shans, se nuk po të jep mundësi që të ndërtohet as ndeshje miqësore për shkak të kushteve. Prandaj, ne na degjenerojnë edhe kampionatet e Kosovës. Ekziston një kampionat futbollit. Për futboll edhe këtu u fol shumë se të gjithë dimë për të dhe është loja më popullore. Po çka fiton

kampioni i Kosovës, pos sdrës me fqinjë - komunat tjera, çka fiton një ditë më vonë. Asgjë. Sepse nuk bën konkurrencë tutje. Ky është problemi ynë. Nëse krijojmë kampion, ku shkon ai tutje, ku është motivimi, çka merr ai, çka fiton ekipi, çka fitojnë lojtarët?

Po të jetë i organizuar në institucione ndërkombëtare, kualitetin që e prodhon në një sport, e bën të konkurrueshëm, e bën vlerë. Nuk po i përdor fjalët..., por edhe ajo pse jo. E shet. E shet shtrenjtë. Çka ka shitur shtrenjtë kualitet Kosova?

Lini ju ato pallavrat ‘filani e fisteku, ambasador’. Cana i ri është i biri Canës së vjetër, zotërinj! Është djali i babait. Kosova nuk ka financuar. Dallku i ri është i biri i Dallkut të vjetër. Ata që janë më të vjetër, e dinë çfarë po them unë.

Çfarë ke prodhuar brenda që e ke eksportuar si vlerë sportive? Këtu është çështja. Kosova e organizuar të krijojë kushte, të krijohen vlera. Unë fola për futbollin se e dinë të gjithë, por s’është sporti veç futboll. Është noti, është atletika, janë sportet tjera të vogla, që janë shumë më të përshtatshme që të rritet rrjeti, të bëhet një rrjet i gjerë për ta prodhuar majën. Kështu që, pa investime nga shteti, të planifikuara, pa ligjin e sponsorimeve të vërteta, ku merren përgjegjësitë e atij që jep para, se askush nuk derdh para kot, se nuk i fiton lehtë, ai do t’i bëjë edhe vlerë, nuk ka mundësit të ndërrohet kjo gjendje.

Dhe me flluskula kalimthi, që janë të bukura si ide, janë anticipuese nacionale, nuk është mirë të merremi. Kini kujdes! Unë jam i interesuar. Janë dy ekipe të Kosovës në futboll që tentojnë të hyjnë në atë që quhet ligë nacionale - “Trepça” dhe “Prishtina”, që janë më të organizuarat, që kanë fuqi t’i kenë dy ekipe - një për Kosovë, një për “pazar”, ta quajmë ashtu. Po pyetni ju shefat e tyre, a mund të regjistrohen në Shqipëri? Mos më pyetni mua, pyetni ata. Legalisht a regjistrohen, apo është një ndjellje e bukur, të cilën e pengon norma ligjore.

Këto janë probleme që nuk është mirë t’i kalojmë me një fjalim. As Kuvendi, as kurrkush. Sporti duhet të institucionalizohet. Pa investime në sport, nuk ka sukses. Investimet duhet bërë për ditën e sotme, edhe ato private, edhe shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Me qëllim po tentoj të fokusohem te gjendja në futbollin e Kosovës për shkak se po pres që të ketë fokuse në sporte veç e veç, në mënyrë që ta shohim se vërtet ku është gjendja, e më duhet të konstatoj se gjendja në futbollin e Kosovës është dhe vazhdon të jetë shumë e keqe dhe në vend që të ketë përparime, realisht ka pasur ngecje, për të mos thënë edhe më shumë - se ka pasur shumë hapa prapa.

Nëse e bëjmë një krahasim vetëm të organizimit të garave para luftës, pra gjatë periudhës së okupimit, dhe që nga paslufta e deri më sot, elementin e parë që mund ta konstatojmë

së bashku është se shikueshmëria dhe interesimi për futbollin në Kosovë është zvogëluar, ka rënë shumë dukshëm.

Kjo është vërtet për të të ardhur keq, për shkak se tek e fundit futbollistët dhe ata që vërtet janë sportdashës nuk e kanë barrën kryesore të fajit për këtë, por besoj se dalëngadalë do t'i fokusojmë dhe do të shohim se cilat vërtet janë ato shtyllat e fajësisë dhe pse gjendja e futbollit ka rënë në këtë situatë.

Struktura e Federatës së Futbollit të Kosovës, me disa përjashtime, sepse ka disa që janë profesionistë, vërtet është stërvjetëruar. E kur po them stërvjetëruar, po i them tri elemente: në administratën e FFK-së, në komisionet e ndryshme të garave dhe në veçanti te delegatët dhe vëzhguesit e ndeshjeve të futbollit.

Është tepër e qartë dhe po e them këtë pas një varg konsultimesh që i kam pasur me futbollistë aktivë dhe ish-futbollistët se FFK-ja në shumë raste quhet ent për punë sociale. Kështu e quajnë futbollistët dhe ish-futbollistët, sepse delegimi i vëzhguesve bëhet në mënyrë joprofesionale dhe vetëm sa për të marrë mëditje.

Ka edhe shumë raste tjera, kur vëzhgues e delegatë janë familjarë të udhëheqësve të strukturave të Federatës, që kurrë as nuk janë marrë me futboll, as nuk kanë lidhje se çfarë është futboli, por delegohen vetëm sa për të marrë mëditje.

Po më e keqja, të nderuar deputetë e të nderuar kolegë, është fakti se në këto vitet e fundit, sidomos politika e politikanët janë përzier jashtëzakonisht shumë edhe në nivel të Federatës.

Duhet ta qartësojmë një element - Ministria, që i bie ministri ose ministrja që është figurë politike, mund t'i udhëheqë politikën e sportit, por ne duhet t'ua lëmë profesionistëve t'i udhëheqin federatat dhe jo që politikanët të futen tash në federata dhe të mundohen të ndikojnë ose të veprojnë brenda federatave.

Thjesht, si është e mundur që një njeri njëkohësisht të merret me 4-5 punë, të gjitha prej të cilave kërkojnë angazhim me orar të plotë tërë ditën edhe po ashtu, të jetë edhe në udhëheqje të Federatës së Futbollit? Cili është realisht, motivi? Unë besoj që motivi është përfitimi. Përfitimi, qoftë personal, qoftë politik, për të ndikuar te tifozët, te klubet e tifozëve për ndonjë votë ose në çështje të tilla. Po, përfitimi është përfitim dhe qëllimi i tij mbetet vetëm përfitim.

Nga ana tjetër ne e shohim, se rrjedha e kampionateve të futbollit, në shumicën e rasteve, ka parregullsi: kurdisjet e ndeshjeve, fitoret e ekipeve me ndihmën e referëve, ndërhyrjet e shumta në përcaktimin e fituesve nga njerëzit që udhëheqin futbollin, që udhëheqin Federatën, janë disa prej shkaktarëve pse gjendja në futbollin në Kosovë ka ra këtu. Dhe, këtë duhet ta themi hapur, nëse kemi debat duhet ta themi hapur për këtë situatë.

Edhe në superligën e Kosovës shumë raste të kurdisjeve të ndeshjeve, por më e keqja është se edhe në ligën e juniorëve, pra të rinjve ka kurdisje të ndeshjeve. Aty ku do të

duhej të jetë shpresa e futbollit, ku të rinjtë ia nisin të përgatiten që të jenë profesionale në futboll, aty fillohet qysh prej asaj moshe të bëhen kurdisjet dhe kjo, normalisht se i dekurajon futbollistët e rinj, ose ata që do të duhej të merren profesionalisht me futbollin.

U thanë edhe këtu disa elemente edhe pak më herët, infrastruktura në terrenet sportive edhe përreth tyre është katastrofale, ka tepër pak investim, nuk është bërë realisht, aq sa ka mundur të bëhet dhe aq sa duhet. Kërkimin e fondeve nëse buxheti i Kosovës nuk mund të ndajë më shumë buxhet, mund të mbahen edhe kërkime të fondeve të ndryshme. Ne, realisht nuk e kemi asnjë stadium që i plotëson kushtet për një zhvillim të ndeshjes ndërkombëtare.

Edhe këtu, mendoj që udhëheqja e strukturave të Federatës, qofshin ata politikanë, ose jo, kanë mund të bëjnë shumë më shumë, po kanë dështuar dhe duhet të japin përgjigje, të paktën publike, pse nuk kanë bërë deri më tash.

Të gjitha këto kanë të bëjnë me lëshimet edhe dështimet e brendshme në organizimin e Federatës. Nëse ia shtojmë kësaj edhe aspektin e nevojës që të ndërkombëtarizohet futbollin në Kosovë, e shohim se vërtet gjendja është në kulmin e dështimit dhe në kulmin e të keqes.

Më lejoni t'i jap disa propozime që kisha dashur të jenë pjesë e konkluzioneve të këtij debati. Mendoj se debati ka qenë i nevojshëm dhe hajde ta bëjmë konkluzionin e parë, që Kuvendi i Kosovës konkludon që të bëhet depolitizimi i Federatës së Futbollit në Kosovë, nuk duhet të ketë as politikanë, as deputetë në udhëheqje të Federatës së Futbollit në Kosovë, pra, të largohen menjëherë. Hajde që Kuvendi ta marrë një konkluzion, që t'i largojmë politikanët nga Federata, sepse kjo nuk i mundëson udhëheqjen e Federatës vetëm nga profesionistët.

Elementi tjetër, reformimi i nevojshëm i Federatës.

Rekomandimi tjetër, krijimi i komisioneve të garave të jetë i pavarur, me njerëz profesionistë, të pandikuar nga vendimet tjera.

Rekomandimi i katërt, ashpërsimi i vendimeve dhe marrja e vendimeve konform rregulloreve, që do të përmirësojë mbarëvajtjen e garave, dhe

Rekomandimi i pestë, trajnimi i njerëzve të rinj në moshë, duke filluar prej trajnerëve, referëve dhe vëzhguesve. Pra t'i japim hapësirë të rinjve në moshë në aspektin e trajnerëve, referëve dhe vëzhguesve. Po e përsëris edhe njëherë, nëse vërtet u tha pak më herët se ky debat është me rëndësi dhe me interes për fëmijët tanë. Nëse vërtet duam të shohim ngritje, konkretisht të futbollit dhe Federatës së Futbollit, hajde ta bëjmë rekomandimin e parë, që të tërhiqen të gjithë politikanët, të cilët janë në udhëheqje të Federatës së Futbollit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Todoroviq e ka fjalën.

BOBAN TODOROVIĆ: Zahvljujem gospodine predsedavajući!

Kao što svi znamo, sport je u dosta teškoj situaciji na Kosovu. Međutim u opštini Gračanica, voljom i znanjem ljudi koji rade na poboljšavanju sporta i razvoju fizičke kulture, urađeno je dosta i sada moram da navedem nekoliko primera, gde je opština Gračanica od svog formiranja 2009. godine, izuzetno dosta doprinela u sportu.

Urađen je sportski kompleks Brnješ, gde je urađen teren za odbojku, teren za košarku, teren za mali fudbal, teren za veliki fudbal, sa hiljadu sedećih mesta, imamo dva terena za tenis.

Obnovljeno je i dosta sportskih terena u školama, radi se sportska hala u Lapljem Selu zatvorenog tipa, koja će da služi za tenis. Gradi se sportska hala pod potkroviteljstvom Evropske Komisije sa 2 hiljade sedećih mesta, gde je opština Gračanica obezbedila plac i prateću infrastrukturu.

U opštini Gračanica omladina se bavi dosta različitim vrstom sporta, međutim mogu da navedem školu fudbala, gde imamo oko 150 omladinaca od kojih je 130 dečaka, 20 devojčica. Sa ponosom mogu da kažem da učestvoju ova škola na različitim takmičenjima, odnosno turnirima što na Kosovu tako i u regionu.

Isto tako mogu da navedem činjenicu da iz ove škole dosta omladinaca je krenulo da se bavi profesionalno sportom, što u Srbiji za profesionalne klubove, što i u regionu. Imamo izuzetno dobru školu tenisa, gde imamo i turnir koji se održava na tom sportskom kompleksu Brnješ. Svake godine "Gračanica open", znači od 15.09. gde učestvuju sve škole tenisa sa Kosova, u različitim kategorijama i muške i ženske kategorije i sa ponosom mogu da kažem da je Anita Jovanović druga na ženskoj teniskoj ranglisti na Kosovu.

Kao što se vidi i iz iznetog, u opštini Gračanica postoji veoma različita i razvijena infrastruktura i veliki broj klubova u svim kategorijama i svim uzrastima, gde postoje zavidni rezultati, a najveći uspeh i rezultat jeste zdrav život mladih i poruka da sport nema granice i da ne poznaje bilo koje podele.

Ovom prilikom, želim da pozdravim i Ministarstvo. Sva ministarstva koja mogu da doprinesu poboljšanju sporta na našoj teritoriji i naše prijatelje iz Evrope i sveta, molio bih da pomognu, da dođu kod nas u opštini Gračanica da vide kakvu smo infrastrukturu uradili, da nam daju još veći doprinos, da možemo još bolje da radimo. Naravno, da i na svim delovima Kosova pomognu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ministrat!

Të nderuar deputetë,

Siç e dini kjo pikë e rendit të ditës nuk ishte në agjendë dhe unë nuk kisha idenë për t'u përgatitur, por më inspiruan diskutuesit e mëparshëm, të gjithë nga pak dhe natyrisht, se

pastaj filluan të gudulisen këmbët dhe duke u provokuar nga talenti sportiv, thashë t'i them dy fjalë patjetër, edhe ndokujt mund t'i shkaktoj kollitje nga të qeshurat.

Në historinë e pellazgëve, paraardhësve të ilirëve dhe tek ilirët, dihet që i është kushtuar kujdes i veçantë sportit. Nuk dua të bëj histori, por do të ndalem në fakte që i kanë nënvizuar historianët dhe autorët joshqiptarë 230 vjet para Krishtit, në pushtimet drejt Egjeut, nga ushtarët e Perandorisë së Agronit dhe Teutës, kryesisht nga komandanti Skerdiliati, që është i njohur për pushtimet e tij të suksesshme, nuk kishte vetëm shkathtësitë njerëzore, pa vitalitetin sportiv. Para se t'i fuste në betejë, ky komandant e praktikonte kohë të gjatë ushtrimin e ushtarëve të tyre në disiplina të ndryshme sportive.

Natyrisht, se sukseset e tij drejt Egjeut pastaj nuk munguan. Liburnia, që njihet një anije e shpejtë, nga më të shpejtat e kohës së Ilirisë, nuk ishte se ishte vetëm përsosje e mjeshtërisë së zdrukthëtarëve e mjeshtërive të drurit dhe ishte natyrisht, shpejtësia e saj edhe rezultat i shkathtësive sportive të ushtarëve të ilirëve të asaj kohe.

Dhe, në gjithë historinë e Mbretërisë së Agronit dhe Teutës, i është kushtuar jashtëzakonisht kujdes i veçantë sportit edhe si pjesë e suksesit, natyrisht në mbretërinë e tyre ka qenë.

Gjithashtu, edhe në kohën e albanëve i kushtohet kujdes i veçantë, por asnjëherë deri tani nuk mund të themi edhe në kohë të më vonë, që është bërë ndonjë punë institucionale. Gjithashtu, për 25 vjet të dominimit të Skënderbeut, nuk ka qenë vetëm shpata e tij dhe e ushtarëve të tij dhe as kuajt, madje më të lodhur kanë qenë në territor, nuk kanë qenë të shkathtë, por kanë qenë shkathtësitë fizike, të cilat natyrisht se kishin ardhur edhe si rezultat i jetës së tyre nëpër malësi dhe bio-klimës, që ata e jetonin atëherë, por ishte edhe si rezultat i ushtrimeve në reparte të rregullta dhe të gjitha disiplinat e kohës i kishte praktikuar Skënderbeu, së bashku me komandantët e tij.

Gjithashtu, ne mund të ndalemi edhe në kohët e kaçakëve, kur ka qenë anarki totale, aty ishte luajtur gurapesh, ishte luajtur edhe “guxhas” edhe “peta” edhe “shtaga” gjithfarë, por gjithmonë shkathtësitë bujare në qitje. Goditja edhe me shkopinj ka qenë një nga stërvitjet e ushtarëve të asaj kohe, por këto disiplina nuk janë ruajtur.

Natyrisht, se shkathtësitë e këtij vendi në sport vijnë e shquhen në gjeneratën tonë. Kjo gjeneratë jona, siç e dimë ka filluar me topa leshi edhe me vegla arkaike deri në kohën moderne, të cilën pastaj e praktikojmë dhe përjetojmë kënaqësitë e sporteve të organizuara në ekipe të kohës.

Ju e dini çfarë kënaqësish na dhuronin boksierët e Prishtinës. Të gjithë atë mllëf, të gjithë atë urrejtje që ne nuk mund ta manifestonim në ambientet ku jetonim i kënaqim përmes ekraneve televizive, nëpërmjet Nazif Gashit, Mehmet Bogujevcit, Xhevdet Pecit, të madhit Aziz Salihu e të tjerë boksierë që mund t'ju hy borxh, që në kohën time më kanë kënaqur. Gjithashtu, edhe një varg, një plejadë futbollistësh e basketbollistësh e hendbollistësh të kësaj kohe, na kanë kënaqur neve duke zhvilluar lojëra, të cilat vërtet

kanë qenë imponante dhe në garat e atëhershme kanë shkuar deri në konkurrencën më të fortë.

Meqenëse, atëherë referët ishin arbitri jo shumë parimor dhe jo shumë objektiv, vetëm në boks mund të korrigjoheshin këto padrejtësi, sepse aty dominonte shkathtësia e bujare e talenteve tanë boksierë. Gjithashtu, edhe mundja dhe karateja kanë qenë sporte të këtij vendi, që e kanë karakterizuar me shkathtësi fizike dhe me talente të papërshkrueshme, që gjithnjë nuk janë kurorëzuar me sukseset e mundshme.

Gjithashtu, do të veçoja një shembull shumë tipik, stërnipi im Dardan Morina është kampion i trefishtë në kik-boks dhe tai-boks, në dy versionet më afirmative dhe tri herë kampion bote, nuk do të ishte bërë në Kosovë ashtu siç nuk është bërë baba i tij nipi im, që ka qenë edhe më talent dhe ka ushtruar karate në Prishtinë dhe as daja i tyre, që edhe unë kam pasur talent dhe nuk kam mundur të afirmohem si sportist, sepse s'kam pasur kushte absolutisht, as në futboll, që ndonjëherë e merrja topin prej shtëpisë deri në shkollë duke mos e lëshuar në tokë fare.

Kështu, shumë talent kanë vdekur dhe janë shuar. Shumë mundësi afirmative të këtij vendi përmes sportit na kanë ikur, por tani të nderuar deputetë, të nderuar sportdashës, të nderuar institucionalist përgjegjës të sportit, nuk duhet t'i lëmë të veniten sportistët tanë, të cilët i shohim përditë duke shkëlqyer gjenet tona në Evropë dhe janë nga talentet më të kërkuar dhe më të vlerësuar. Secili nga ata, siç e bëri një parafolës i nderuar këtu, po të jetonin në Kosovë do të ngelnin sikur ne këtu, politikanë ose pehlivanë të ndryshëm, që mund t'i tipizonim me format tona dhe me zhargonin tonë.

Prandaj, për këtë arsye, edhe pse ky debat i ngjan një monologu, jam shumë i bindur që autoritetet e Qeverisë do do ta kthejnë vëmendjen nga sporti dhe do t'i kushtojnë rëndësi më të madhe. Unë u inspirova nga një debat që ishte këtu. Nuk do të ndalem pse suficitit prej 18 milionëve në komunë të Prishtinës, nuk është shfrytëzuar më mirë, do ta lë në një rast tjetër. Të paktën, talent sportiv ka pasur mjaftë dhe hapësira për të investuar në sport ka pasur mjaft. Askund nuk do të ishin kontestuar dhe askund nuk do të ishin kundërshtuar, por kjo le të mbetet në një debat tjetër dhe në një rast tjetër, sepse aty edhe investimet kapitale të tjera ka pasur nevojë Prishtina.

Do të kthehem në Malishevën time, ku talentet e saj shquhen në karate, në not, në futboll, në hendboll, në volejboll dhe të gjitha këto disiplina, në nivel të Kosovës kanë korrë suksese nga më të ndryshmet, njihen talent nga këto fusha. Rasti i fundit, që më brengos dhe dua ta bëj publike, është rasti i futbollisteve nga Malisheva, që kanë qenë të ftuara vitin e kaluar në Suedi, në një pjesëmarrje imponante prej 71 shteteve dhe asnjë cent, as Qeveria jonë, as një Qeveri ku me ditë çfarë, nuk ka dhënë kontribute për të shkuar ato vajza, ato vajzusha, se kanë qenë shumë të reja, për ta afirmuar jo vetëm futbollin e femrave të Kosovës, jo vetëm sportin e femrave të Kosovës, por edhe emrin e këtij shteti të ri në krijim.

Nga prania e femrave të Kosovës, në atë garë, në atë eveniment, është tërhequr Serbia, sepse s'ka dashur të jetë pjesëmarrëse ku garon edhe shteti i ri i Kosovës, të cilin ajo e lufton në mënyra të ndryshme dhe nuk e pranon haptazi dhe botërisht.

Përkujdesje insistive do të duhej të kishte çdo komunë dhe natyrisht se këtu përgjegjësinë më të madhe e mban ministri i Kulturës dhe i Sporteve. Ne e dimë që ai është një djalë i ri me talentet e tij, natyrisht edhe në sport duhet t'i ketë pasur talentet, si ne të gjithë të tjerët, por nuk mjafton vetëm kjo krenari as e tij dhe as jona në talente. Tash tipar dallues i krenarisë së secilit zyrtar duhet të jetë angazhimi permanent për të afirmuar sportin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Ky debat është mirëpritur, secili ka fjalën e vet. Neve që po na leni kah fundi, sigurisht që po na bie të përsërisim diçka, megjithatë janë të veçantat në fjalët tona. Dhe unë në këtë rast do të përqendrohem në këtë, që ndër rekomandime të shtohet edhe ajo që asnjë shkollë të mos ndërtohet pa qenë salla sportive dhe kjo ka mundësi të bëhet me investime të disa ministrive në bashkëpjesëmarrje edhe me komunën. Pra, kjo e lehtëson këtë çështje, ngase nga një studim që është parë për çështje devijonte të rinjve edhe huliganizmin rreth shkollave, është parë se më së tepërmi kanë ndodhur këto raste nga orët e humbura të edukatës fizike e për këtë janë kujdesur me të madhe edhe kafeteritë që janë përreth.

Prandaj, do të ishte mirë që të mos humbet kjo orë edhe të mos ndërtohet asnjë shkollë, pa e pasur edhe sallën e edukatës fizike, që do ta mbronte me të madhe edhe shëndetin e nxënësve, kur kihet parasysh se ata për çdo ditë bartin një barrë të rëndë të librave me krejt ato pajisje tjera, që ia kërkon shkolla e që nuk ka mundësi për t'ia lehtësuar në atë drejtim.

Tjetra, mendoj që duhet të korrigjohen politika investive. Ne, nga ajo që e kemi marrë më herët një raport për investimet dhe punët e mbetura, që duhet të vazhdojnë, janë që 9 palestra sportive janë të filluara, ka një dekadë dhe ato i ka dëmtuar koha me të madhe dhe në vend se të investojmë aty ku kemi mbetur të vazhdojmë me investime, ne duhet të kthehemi prapa dhe t'i eliminojmë dëmet, që i ka shkaktuar koha dhe pastaj të ecim më tutje.

Prandaj, do të ishte shumë punë më racionale, që të rregullohet një terren sportiv, qoftë palestër apo formë tjetër, por jo në çdo fushatë zgjedhore të vihet nga një gurthemel i një apo dy-tri palestrave. Andaj, mendoj se në këtë drejtim duhet të fokusohemi shumë më shumë, aq më tepër që është shtuar buxheti në këtë drejtim.

Në fund, nuk mund të kaloj pa i falënderuar biznese të shumta që edhe para luftës e kanë mbajtur me të madhe sportin, disa fillojnë të investojnë në atë drejtim, por legjislacioni në këtë drejtim Ligji për sponzorime e tjera, do të ndihmonin që kjo gjë të lehtësohet dhe të

jepet një mirënjohje për këtë. Mendoj që këto që thash, mund të kenë vendin edhe në rekomandimet e përgjithshme, duke i përkrahur ato që u thanë në fillim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, predsedavajući!

Dame i gospodo poslanici,

Uvaženi članovi Vlade,

Ja sam se javio po ovoj tački iz razloga veoma uznemirujućeg odnosa i stanja sporta u opštini Dragaš. Hteo sam da kroz šalu kažem da je najrazvijenija, najrazvijeniji sport u opštini Dragaš gledanje utakmica preko televizije i mogu vam reći da se samo na tome završava sport u opštini Dragaš.

Spomenuću da opština Dragaš je u prošlosti imala veoma respektabilne timove u futbolu zajednički tim fudbalski je Graničar, koji je imao veoma zavidne rezultate, zatim fudbalski klubovi u selu Plav i Brezna u opojskom delu opštine Dragaš. Takođe rvački klub, zatim šahovski klub i tako dalje.

Svi ti sportovi su jednostavno zamrli u poslednje vreme, samom činjenicom da nije bilo ni dobre volje, ni ulaganja u sport i infrastrukturu u opštini Dragaš. Zato ne bih želeo da dužim, nego jednostavno da pošaljem jednu poruku, da je svako ulaganje u sport, u infrastrukturu znači u stadione, objekte veoma poželjno, gde bi se mladi okupljali, više družili, ostavili bi možda neke „poruke“ i naravno, time bi označili zdraviji i bolji život.

Takođe, želim da kažem da ne postoji nijedna zatvorena sala, gde bi mladi mogli tokom zimskog perioda da se bave sportom. Postoji jedna već oronula sala, koja postoji već 40 godina u srednjoj školi u Dragašu, koja ne zadovoljava potrebe svih onih koji bi želeli da se bave sportom.

Dakle, da ne dužim, ponovo ću da zatražim od nadležnih institucija da naprave jedan plan razvoja i tog regiona, što se tiče sporta. Mislili smo da ima dovoljno kapaciteta, mislim da ima dovoljno mladih koji bi želeli da uđu u ovaj proces, a sve to zarad bolje sutra. Hvala vam još jednom!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zonja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më vjen mirë që sot po diskutohet për sportin dhe që interesimi i deputetëve është shumë i madh për të diskutuar. Që nga paslufta sporti në Kosovë është lënë anash për faktin se një vend i dalë nga lufta ka pasur nevojë më imediate, apo ndoshta nga neglizhenca e atyre që kanë udhëhequr vendin pas lufte.

Mirëpo, mendoj se kurrë nuk është vonë për të diskutuar për sportin dhe mendoj që kjo kohë ka ardhur tani.

Në këto vitet e fundit, Qeveria, konkretisht Ministria përkatëse ka bërë shumë në rregullimin e infrastrukturës ligjore. Po ashtu, ka bërë shumë investime në stadione apo terrene të ndryshme sportive. Të rinjtë e Kosovës dita-ditës po reflektojnë se janë ambasadorë të vërtetë të vendit të tyre. Neve na mbetet që këta ambasadorë t'i përkrahim dhe t'i motivojmë në zhvillimin e talentit të tyre. Edhe sot e kësaj dite sporti në Kosovë burim të rëndësishëm e ka mbështetjen e sponsorëve, të cilët janë treguar shumë zemërgjerë, për çka ne u jemi mirënjohës.

Në këtë rast, dua të përmend suksesin e klubit volejbollistik KV "Drenica&Rukolli", i cili klub ishte kampion në vitin 2010-2011 dhe fitues i kupës së Kosovës, ndërsa në konkurrencën e juniorëve vazhdon të jetë kampion që tri vjet me radhë.

Kjo dëshmon se rinia jonë ka kapacitetet të mjaftueshme dhe energji pozitive për ta shtyrë vendin drejt sukseseve të reja. E dimë që na mbetet shumë për të punuar, që t'i plotësojmë nevojat e sportistëve në Kosovë, por asnjëherë nuk guxojmë të mohojmë të arriturat që ka shënuar sporti i Kosovës, që nga shtetbërja e me theks të veçantë këto dy vjetët e fundit.

Prandaj, e shfrytëzoj rastin që të inkurajoj ministrin Krasniqi, i cili sot me arsye nuk ndodhej këtu prej fillimit, ndërsa tani ka ardhur, dhe të vazhdojë përkrahjen për avancimin e politikave drejt ndërkombëtarizimit të sportit kosovar. Me këtë rast u bëj thirrje të gjithë sportistëve të spikatur kosovarë, të cilët sot luajnë në skuadrat botërore, të shfrytëzojnë mundësitë e tyre dhe të llojnë për ndërkombëtarizimin e sportit kosovar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj se u thanë edhe nga parafolësit. E përgëzoj një debat të tillë, sa i përket fushës së sportit në përgjithësi, kur dihet që në krahasim me sektorët tjerë, që janë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Departamenti i Sportit ose sporti në përgjithësi do të thotë, edhe nga aspekti buxhetor dhe po ashtu, edhe nga investimet që janë duke u bërë, ndoshta çalon pak në krahasim me departamentet tjera.

Gjatë këtyre vjetëve, flas për dymbëdhjetë vjetëshin e fundit, ka munguar infrastrukturë fizike e objekteve, por edhe infrastruktura ligjore, rrjedhimisht ka munguar edhe sistemi i financimit nga shteti po flas në krahasim me ministrinë tjera, të cilat u ndahet buxhet, Ministria e Kulturës në këtë dhjetëvjetëshin e fundit thotë ka pasur një buxhet më të limituar, në krahasim me kërkesat, të cilat u janë drejtuar këtij institucioni ose më mirë të them institucion shumë i rëndësishëm, ku ka të bëjë me pjesën më vitale të qytetarëve të Kosovës, që është rini dhe që në krahasim me vendet e rajonit, kjo popullatë, do të thotë është popullata më e re në Evropë.

Sporti i Kosovës nuk kishte parakushte për t'i joshur sponsorët dhe donacionet serioze. Klubet sportive trashëguan infrastrukturë të dëmtuar të fushave dhe palestrave, një pjesë e tyre vazhdon ende të vuajë mungesën e investimeve kapitale. Në shumë stadione dhe palestra janë bërë investime të pjesshme, porse asnjëra nuk i plotëson ende kushtet e aktiviteteve të rëndësishme, do të thotë, ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës gjatë këtyre dhjetë vjetëve ka mbështetur ndërtimin e disa objekteve sportive, kryesisht për nevojat e komunitetit në nivel lokal. Sporti është ndihmuar pak nga komuniteti ndërkombëtar, kur flitet që shumë organizata ndërkombëtare në këtë dhjetëvjetësh kanë sjell donacione të ndryshme, por krahasuar me sasinë e pranisë së organizatave të tyre në Kosovë, për sportin nuk është bërë sa duhet dhe nuk janë dhënë mjete për të investuar, qoftë në politikat sportive, qoftë edhe në investimet ose në infrastrukturën e sportit. Objektet sportive ende janë në formë publike, kryesisht të komunave me ndonjë përjashtim, sektori privat nuk ka arritur të sfidojë ofertën publike me investimet në infrastrukturën e sportit.

Prandaj, në një shoqëri që ka përqindje të madhe të popullatës së varfër dhe ekonomi të pazhvilluar është vështirë të priten rezultate nga anëtarësimi, biletat, donacionet dhe sponsorët e vegjël. Investimet në sport nuk janë stimulues, të mos mungojnë lehtësimet fiskale për organizatat sportive. Këtu flitet për Ligjin për sponsorime, i cili është iniciuar pikërisht nga debatuesit, që ka të bëjë do të thotë, ky ligj për sponsorime që nga viti 2008 është përgatitur dhe dërguar në Qeveri, njëkohësisht është dërguar në Ministrinë e MEF-it dhe për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore, do të thotë ky ligj është kthyer dhe e njëjta situatë ka ndodhë edhe gjatë vitit 2010 dhe më sa kam informacione edhe ministri tash zoti Krasniqi, ka përcjell këtë ligj në Ministrinë e MEF-it, mirëpo për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore, ky ligj prapë nuk po gjen mundësinë e aprovimit në Qeveri që të sillet në Parlament.

Ne jemi dëshmitarë të shumë ligjeve, që në këtë Parlament ka pasur ligje që janë sjell me implikime të mëdha buxhetore, të cilat nuk kanë qenë në korniza afatmesme, janë aprovuar dhe implementimi i tyre fillon të bëhet diku kah viti 2015 apo 2016, prandaj, ky ligj do t'i ndihmonte shumë sportistët, do të ndihmonte edhe Ministrinë e Kulturës, që në kuadër të miratimit të këtij ligji, do t'i kishte ndihmuar shumë sportistët për të zhvilluar aktivitetet dhe njëkohësisht për t'u dhënë një hapësirë më të mirë.

Pra, sporti ende nuk ka mjaftë para, në krahasim me totalin e Buxhetit, që aprovohet në Parlament, pra fjala është edhe për këtë vit, lehtësimet janë minimale dhe ato fatkeqësisht, nuk janë përfshirë ende në ligj. Klubet që kanë ambicie për të qenë profesionale shpesh bien viktimë e subjekteve që nuk kanë qëndrueshmëri financiare, të cilat për nevojat e politikës ditore shfrytëzojnë imazhin e sportit.

Objektet e sportit ka kohë që nuk përputhen me planifikime urbanistike. Ndërtimet sipas modelit ad hoc dhe të motivuara nga propaganda politike nuk do të mund të arrijë funksionalitetin e nevojshëm. Po ashtu, shumica e objekteve janë të vjetruara dhe nuk plotësojnë kërkesat e tashme teknologjike.

Infrastruktura aktuale në Kosovë e ndërtuar në këto 40 vjetët e fundit është një model i infrastrukturës së pranuar për kohë të shkuara, pra jo në harmoni me arkitekturën e tashme dhe kërkesat ndërkombëtare.

U thanë edhe nga shumë parafolës këtu dhe nga njohës të fushës së sportit e të cilët kanë kontribuar për sportin në përgjithësi, unë kërkoj, meqë edhe ministri është këtu prezent, ndoshta praktika e dhënies së buxhetit për federatat e sportit, do të ishte mirë që ky buxhet, dihet që Departamenti i Sportit e ka një buxhet të planifikuar para se të vijë në Parlament dhe para se të aprovohet.

Por, konsideroj që federatat e sportit duhet, që këtë buxhet ta kenë në fillim të vitit, për shkak se do t'i jepet një mundësi e mirë e bërjes së aktiviteteve përgjatë tërë vitit, do të thotë, në fillim të vitit deri në përfundim të vitit. Mendoj që do të ishte mirë, që kjo praktikë patjetër të zbatohet dhe po ashtu Ligjit për sponsorime ministri t'i vejë prioritet, që sa më shpejtë ta sjell në Qeveri dhe njëkohësisht në Parlament, për t'i mundësuar një aktivitet dhe një hapësirë më të mirë të gjithë sportistëve dhe po ashtu, shtatë medalistëve, të cilët u përmendën këtu nga ana e kolegut deputetit Lutfi Haziri, do të ishte mirë që t'u jepen benificionet përkatëse nga shteti, duke u nxjerrë nga rregulloret të cilat kanë të bëjnë me ligjin e sportin në përgjithësi.

Dhe po ashtu, një kërkesë të cilën e kisha është edhe strategjia e zhvillimit të sportit të Republikës së Kosovës 2011 – 2016, strategji e cila është përgatitur nga Komiteti Olimpik, është përgatitur nga përfaqësues të federatave, po ashtu edhe nga Departamenti i Sportit, kisha kërkuar nga ana e ministrit, që në këtë rast këtë strategji, nëse ka mangësi të modifikohet dhe po ashtu, të shkojë në Qeveri, të aprovohet dhe njëkohësisht të silltet edhe në Parlament, sepse do të hapë mundësi të mira për sportistët në përgjithësi nga të gjitha kategoritë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Është risi, është mirë që në Kuvend të Kosovës është nxjerrë ky debat, është për t'iu falënderuar kolegëve deputetë, që kanë kërkuar që sot të ketë debat për sportin.

Besoj që përveç atyre që ishin shumë të përgjithësuara, në disa raste edhe politike, ka shumëçka çka të merret edhe nga ato që u deklaruan nga deputetët edhe nga ajo që mund të jetë si konstatim i një gatishmërie të gjithëve për të ndihmuar gjeneratën e re, për të ndihmuar sportin, jo vetëm në masivizimin e tij, por edhe në ndërkombëtarizimin e tij.

Pati çështje të ndryshme nga ato më teknike që u debatuan këtu dhe për konceptin e zhvillimit në këtë fushë. Mendoj që marrë në tërësi ka progres në të gjitha aspektet edhe cilësinë e organizimit të sportit edhe në atë që quhet masivizim, organizimi edhe nëpër shkolla e deri te sportet cilësore dhe kjo është dëshmuar edhe me arritjen e rezultateve olimpike. Dhe, mbetet shumë për t'u bërë.

Po ashtu edhe me konceptin për sportin ka ndryshime. Ju e dini që s'ka pasur asnjë lidhshmëri nga ajo që ka qenë pjesë e edukimit me atë që është zhvilluar në terren me sportin dhe tash kemi edhe si koncept, kemi edhe një në universitetin tonë publik, një ndryshim, Fakulteti i Kulturës Fizike tashmë është Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit dhe po ashtu, në disa universitete private ka fakultete të sportit. Pra, është një lidhshmëri nga ajo që është në terren me pjesën e edukimit.

Më lejoni të bëj kompliment për ministrin, në aspektin e ndërkombëtarizimit. Ka diçka që edhe s'kam mund ta përcjell në ndërkohë, po ajo që është për t'u admiruar është një angazhim i plotë i ministrit në mbështetje të federatave në ndërkombëtarizimin e sportit. Kam informata, që ministri dhe kabineti i tij nga zyrat e tyre kanë kontaktuar federatat ndërkombëtare, si mbështetje federatave tona për lidhjet, për ndërkombëtarizimin, për pranimin dhe kjo është për t'u admiruar. Zoti Ministër, besoj që ke parasysh edhe nga ato që kemi dëgjuar nga ti edhe më herët, që duhet të ngrihen kapacitetet e këtyre federatave, t'u ndihmohet që këto të ecin vetë, të ketë cilësi, të mbështeten edhe Komiteti Olimpik edhe federatat që këto të pavarura të punojnë në ndërkombëtarizimin, sepse nuk mund të jetë përherë logjistikë dhe po ashtu, janë edhe kriteret, ju e dini që federatat ndërkombëtare kërkojnë që sa më pak shteti të jetë i involvuar në këto federata.

Por, si do që të jetë, në kohën në të cilën jemi, mbështetja e Ministrisë dhe e ministrit është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Mendoj që mund të jap ndonjë ide, pa dashur ta mbiçmoj, këtë po e them nga përvoja ime, në një aspekt masivizimin e sportit e në sportin masiv, mendoj që Ministria përkatëse duhet të bashkëpunojë më shumë me disa ministri, me Ministrinë e Arsimit dhe me pushtetin lokal, në mënyrë që të gjendet alternativa, format e përbashkëta, që aktivitetet sportive të jenë pjesë e shkollave, pjesë e komunitetit, pjesë e pushtetit lokal, pjesë e Ministrisë, e tjerë, në mënyrë që të ketë më shumë brumë për sporte cilësore. Dhe, po ashtu në këtë drejtim, të bashkëpunohet edhe për infrastrukturën.

Më lejoni të them, dikush një deputet e tha këtu që nuk është mirë vetëm për fushata zgjedhore të ketë gurthemele për infrastrukturën, pajtohem plotësisht. Vetëm shikoni në cilin vit, në cilën kohë ka pasur inaugurim të disa terreneve sportive, të cilat ende nuk po përfundohen. Pra, duhet pasur një plan të saktë, të qartë, i cili duhet të kryhet me buxhetin e parashikuar dhe mos të vihet në pozicion, që për disa vjet me radhë të mos mund të përfundohen ato terrene sportive. Pra, shikoni në cilën kohë ato terrene sportive janë nisur, pra janë nisur pa asnjë plan, pa asnjë planifikim, pa asnjë politikë të qartë për zhvillimin e infrastrukturës.

Kur jemi te infrastruktura, mendoj që të gjithë kanë interes, Ministria me politikën e saj, pushtetet lokale, e tjerë dhe mendoj që ka progres edhe në këtë drejtim, ka interesim edhe në mungesë të legjislacionit, ka interesim edhe të atyre që janë biznese private të investojnë pak a shumë në këtë edhe kanë investuar diku-diku. Po, nuk mund të flasim për infrastrukturën e të mos na kujtohet një intervistë e para dy vjetësh e shefit të operacioneve të Komisionit Evropian në Prishtinë, ku thotë, ku kritikon komunën e Prishtinës, për humbjen e disa milionë investimeve, për investimin rehabilitimin e Pallatit

të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, si objekti i vetëm multi-sportiv, që e kemi në Kosovë dhe si objekti që do të mundësonte jo vetëm masivizimin, shfrytëzimin e këtij pallati për shumicën e federatave për aktivitete sportive, po edhe për ngritjen e mundësive për sporte cilësore, aty ku ne kemi nevojë më shumë.

Mendoj që në aspektin tjetër, që po ashtu Ministria duhet të rrisë investimet në sportet cilësore. Ju e dini të gjithë, që kemi disa rezultate më të mira. Ndoshta, duhet të mendohet se si të bëhen investimet në infrastrukturë, të balancohen me idenë që në sezonin e ardhshëm olimpik, krahas fuqizimit të federatave dhe Komitetit Olimpik, të fuqizohet po ashtu edhe financimi i sporteve cilësore. Ndoshta, të mendohet më shumë për sportet individuale, ku janë pak më lirë dhe aty ku ne konsiderojmë që mund të kemi edhe rezultate më të shpejta.

Po ashtu, ministri e din që kemi edhe disa kritere, që janë prej federatave ndërkombëtare, asociacioneve ndërkombëtare sportive, që duhet t'i ndjekim. Krahas infrastrukturës janë edhe arritja e kuotave; rezultatet e sportistëve; është dopingu që është një problem serioz; janë kriteret, të cilat edhe pse ne nuk monitorohemi tash, duhet t'i kemi parasysh; kurdisjet e lojërave, që po ashtu u thanë edhe këtu; dhe kriteret tjera, për të cilat ne duhet të përgatitemi gradualisht, për të hyrë në sportin ndërkombëtar.

Duke përfunduar, kërkoj po ashtu edhe njëherë një gatishmëri të gjithëve, që përveç kësaj që kemi deklaruar, ta bëjmë në terren aty ku jemi, disa prej nesh jemi pjesë edhe e menaxhmentit në disa stadione, në disa federata, në disa klube, e tjerë. Mendoj që të gjithë bashkërisht, aty ku janë mund ta japin kontributin e tyre dhe po ashtu, këto që ne i kemi të prezantuara si rekomandime, që janë mjaftë të përgjithësuara, të cilat unë i mbështes, mendoj që mund të kontribuojmë më shumë për sportin dhe sportistët në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqiri, replikë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Zoti nënkryetar,

Singerisht po më vjen keq, por po jam i detyruar të reagoj, kur po thuhet të pavërtetat.

Të gjithë e dimë edhe opinionin e di, që statusi i Pallatit të Rinisë dhe i asaj hapësire është i padefinuar, edhe pse me të gjitha dokumentet ajo hapësirë dhe ai pallat i takon komunës së Prishtinës. Dhe, ne e dimë, për projektin të cilin foli parafolësi, kërkesa ka qenë, këtë e dimë të gjithë, tjetër është që nuk dëshirojmë opinionin t'ia themi kështu drejt, por është tentim për të manipuluar, qëllimi ka qenë që të rrënohet Pallati i Rinisë. Kjo është e vërtetë, është projekti dhe të rrënohet për t'u bërë diçka tjetër, por kjo është qesharake dhe unë mendoj, që komuna e Prishtinës ka vepruar shumë drejt që s'ka lejuar të rrënohet diçka që është edhe identiteti i qytetit të Prishtinës. Dhe, absolutisht nuk qëndron, mjetet kanë shkuar tjetërkund për arsyen e thjeshtë se komuna nuk ka pranuar të bëjë diçka që realisht e dëmton pronën e komunës dhe kjo është e vërteta e atyre 18 milionëve famozë, që po përmenden ka disa herë edhe më herët.

Prandaj, nuk qëndron kjo, nuk janë humbur për fajin e komunës, por për fajin e atyre që kanë dashur t'ia marrin edhe atë pronë komunës, siç po dëshirojnë edhe tash e tutje dhe tash sa kohë nuk është zgjidhur statusi i Pallatit të Rinisë , të Kulturës dhe Sportit në Prishtinë.

Kjo është e vërteta dhe të mos flasim për shifrat, të cilat absolutisht nuk e kanë pasur qëllimin e mirë. Unë kështu mendoj dhe është vlerësuar nga komuna, sepse qëllimi ka qenë që të rrënohet diçka që është ndërtuar, në vend që të sanohet ai pallat, i cili edhe mund të jetë shumë funksional, por nuk ka gatishmëri.

Me Ligjin për Prishtinën, kjo do të rregullohej, por s'ka gatishmëri që të rregullohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër- replikë, zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Kryetar,

Nuk përmenda as shuma të milionëve, e përmenda një intervistë të shefit të operacioneve të Komisionit Evropian, dy vjet më parë, i cili e ka dhënë në detaje, e ka shpjeguar mosgatishmërinë e Prishtinës për të thithur investimet dhe gatishmërinë e Bashkimit Evropian, për të investuar në një institucion, në një objekt i cili është shumë i rëndësishëm për rininë dhe për sportistët.

Në anën tjetër, ka edhe shumë objekte tjera në Kosovë, që statuset e tyre të nuk janë të definuar mirë, mirëpo është investuar në to dhe sot shfrytëzohen për të mirën e institucioneve të ndryshme dhe të qytetarëve të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga reagimi dhe diskutimet, po e shoh që ka nevojë ndoshta të diskutohet për komunën e Prishtinës, por për të ardhmen po e lëmë. Fjalën e ka deputetja Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Para se të filloj diskutimin unë e kam një vërejtje. Me të vërtetë është e mjerueshme pse deputetët nuk i qasen problemit të Pallatit të Rinisë ashtu si duhet, por gjithmonë shkojnë kah ana politike, për përfitime politike. Dhe, unë mendoj me të vërtetë që politika nuk ka vend në sport.

Gjendja e sportit në Kosovë është aty ku është edhe vet shteti. Sporti si një prej ambasadorëve kryesorë të një shteti, duhet të jetë në një piedestal, e posaçërisht për një shtet sikur Kosova, që i mungon prezantimi dhe njohjet e duhura.

Sporti në Kosovë dita-ditës po e humb rolin e tij, e që është të emancipojë rininë; t'i edukojë dhe t'i disiplinojë ata. Arsyt kryesore janë mënyra e trajtimit të sportistëve tanë; mënyra e vlerësimit të karrierës së tyre; mungesa e ligjit për të siguruar kontrata dhe

dëmshpërblime; mungesa e ligjit, i cili do të jetë i leverdishëm edhe për investitorët dhe shumë mungesa e mangësi tjera.

Një prej çështjeve, që vlen të diskutohet këtu është çështja e ndërkombëtarizimit të sportit, si një prej problemeve kryesore.

Mosinteresimi i rinisë për t'u marrë me sport, por edhe ngurrimi i investitorëve për të investuar vjen prej asaj se kjo Qeveri ka mbetur mbrapa jo vetëm me njohje të shtetit, por ka mbetur shumë mbrapa me tentimin për t'i lëvizur barrierat ligjore, të cilat e kanë shndërruar sportin në një geto.

Në Kosovë për shumicën e sporteve përdoret zhargoni se në Kosovë luajnë mëhalla me mëhallë, pra, këtu luhen sportet vetëm në nivel kombëtar. Sportistët tanë janë të privuar nga ndjenja e përfaqësimit të shtetit në arenën ndërkombëtare e kjo në mënyrë indirekte luan rol më së shumti në stagnimin dhe mosngritjen e nivelit të sportistëve, ngase ata nuk mund të garojnë dhe të matin me shtetet tjera.

Një pyetje shumë me rëndësi, pra një çështje që i përket ndërkombëtarizimit të sportit kosovar, ish dashur të vihet edhe në tavolinën e bisedimeve me Serbinë, sepse shteti serb është një prej pengesave kryesore të ndërkombëtarizimit të sportit në Kosovë.

Çështja e infrastrukturës sportive dhe mangësitë në ligj, është një çështje prapë që vlen të diskutohet shumë. Mungesa e infrastrukturës sportive është problem më vete dhe në vete gërsheton problematikën e marrjes me sport të rinisë sonë, si dhe socializmin e rinisë e cila nuk ka tjetër rrugëdalje, përveç diskotekave dhe kafiterive, si opsion.

Nëse dëshironi të vlerësoni një shtet, atëherë shikoni rininë e atij shteti. Rinia jonë, një shumicë dërmuese është sot në kafene ose duke pirë duhan e alkool, ose duke përdorë narkotikë, apo duke u marrë me diçka që me siguri nuk është më e shëndetshme se të merren me sport.

Mungojnë palestrat, fushat, parqet sportive, shtigjet e atletikës, kushtet e ngrohjes për sporte që garojnë në palestra të mbyllura e që ky kusht është themelor për ta.

Investimet në sport janë të vogla, sepse investitorëve iu merret gjithçka në këmbim të pothuajse asgjëje. Kthimet e investimit janë të barabarta me zero, përveç një emri i cili ju del në treg, ata nuk kanë benificione tjera nga shteti. Kjo bën që investitorët, edhe pse ka shumë prej tyre që janë sportdashës dhe janë të vetëdijsëm për gjendjen e sportit, hezitojnë të investojnë, duke marrë parasysh që shteti nuk i liron ata nga taksat apo ndonjë benificion tjetër. Këtë rast e shfrytëzoj t'i falënderoj të gjithë investitorët që mundohen dhe që besojnë shumë më shumë se kjo Qeveri në sportistët tanë duke dhënë mjete për sport, vetëm e vetëm që të mos shuhet dhe të vazhdojë të jetojë.

Duke marr parasysh që karriera e një sportisti është e shkurtër, atyre duhet që t'ju sigurohen që gjatë karrierës së tyre të jenë në gjendje të përfitojnë të ardhura për të siguruar jetën e tyre.

Sipas kësaj, duhet të vihet në diskutim caktimi i një kufiri të minimumit të pagave të sportistëve vendorë, duhet të llogarisim sa kushton dita dhe nevojat e një sportisti dhe sipas kësaj të caktohet një kufi i të ardhurave. Në këtë mënyrë do ta përcaktonim automatikisht nivelin dhe përcaktimin midis nivelit amator, semi-profesionist dhe profesionist.

Mungesë tjetër është edhe mangësia e ligjit për t'i shpërblyer sportistët më meritore me të ardhura që do të ishin të mjaftueshme për një jetë të dinjitetshme.

Lufta kundër huliganizmit në sport dhe rreth sportit është një dukuri, për fat të keq, që është e pranishme tek ne dhe është në rritje nëpër objektet tona sportive ekzistuese. Kjo dukuri, përveç që është e shëmtuar dhe e rrezikshme për rininë tonë, është edhe e dëmshme për imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Me ligjin e ri nuk është paraparë mënyra e as instrumentet e luftës kundër huliganizmit në sport, por as dënimi me masa ligjore. Andaj, duhet të konsultohen zgjidhjet që kanë bërë shtetet me një traditë të gjatë të luftimit kundër këtyre dukurive. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë,

Pra, u tha mjaft dhe u konstatuan ngecjet që kemi në fushën e sportit, duke filluar që nga edukata dhe kultura fizike, që nga familja tek fazat parashkollore, fillore dhe të mesme, ku krijohet ajo baza e rëndësisë së edukimit fizik, pastaj organizimi i talenteve nëpër klubet dhe marrja me sport deri te rezultatet kulmore në sport, internacionalizimi i sportit, infrastruktura në sport, pra të gjitha këto.

Shihet që është një nevojë e madhe dhe deri tani Kosova me kapacitetet që ka nuk ka arritur që në këto fusha të shënojë një progres të mëtijmë. Por, ajo që është brengosëse është jo pse ne me një buxhet, që me të drejtë, të gjithë e cilësojnë se është një buxhet i mundësive, jo i dëshirave dhe nevojave që ka Kosova, pastaj gjendja e keqe në biznes, që kudo është një stimul, është një zhvillim i sportit nëpërmjet kësaj.

Vërtet jemi në një udhëkryq dhe ndoshta, ajo e para që ishte dashur të bëjë Kosova, së paku që ta ketë të qartë se cila do të jetë rruga, cili është koncepti, cila është strategjia që në të ardhmen do të kishte mundur të bëjë ndryshime.

Ju e shihni, se edhe ato pak aktivitete sportive ndodhin me halla të zbrazëta, me stadione të zbrazëta. Do të thotë, ne nuk e kemi as interesimin e madh, sepse nuk sepse nuk ka vetëdijesim të madh se sa është i dobishëm sporti, qoftë si aftësim fizik dhe psikomotorik, po ashtu, edhe si një argëtim.

Ndërsa, ku unë prita sot një përkushtim më të madh të deputetëve, shoh se sikur edhe më herët, shihet se kur e kemi temën “lisat”, disa tentojnë që ta zhvendosin temën kah “plisat”, siç thotë populli. Dhe, pastaj kur fillojmë ne të bisedojmë për “plisat”, të njëjtit

kthehen dhe flasin për “lisat”. Unë do të kisha ftuar një ditë që Parlamenti me të drejtë ta debatojë Ligjin për Prishtinën dhe ta kuptojë se çka ka ndodhur me atë ligj. Ai ligj i ka kaluar procedurat e Qeverisë dhe ka qenë i miratuar bashkë me pretendimin e komunës së Prishtinës në Pallatin e Rinisë. Por, në udhëtimin e ligjit nga Qeveria deri në Parlament, që është nonsens absurdi, ligji ka pësuar ndryshime dhe, askush kurrë nuk ka dhënë përgjigje, se çka ka ndodhur, si mund një ligj i aprovuar në Qeveri pa vërejtje, të vijë në Parlament dhe të ketë ndryshime?

Faza e dytë ka qenë, ai ligj ka humbur fare, prandaj, disa tentime, që po dëshirojnë të ndërrojnë tema nga “lisa” në “plisa”, unë i thërras një ditë që ta bëjmë temë Ligjin për Prishtinën dhe do ta kuptojmë.

Ndërsa tani, unë po kthehem te tema e “lisave”, për “plisat” flasim një herë tjetër.

Vërtet është diskutabile dhe është dilemë e madhe, cilat do të jenë konkluzionet sot? A kemi bërë debat për përfitime, për t’iu thënë sportistëve “na plasi zemra për juve”, apo nga kjo seancë do të ketë konkluzione, që do të ketë obligime dhe përgjegjësi, që të shihen se cilët do të jenë hapat, që të qartësohet kjo?

Nëse ne nuk kemi ligj për sponsorime, kemi biznese që nuk kanë aftësi që të investojnë në sport, kemi buxhet dhe të pamjaftueshëm që ta mbulojnë sportin, kemi talente që deri në moshën 15-vjeçare themi është një talent, ndërsa atë fare nuk e përgatisim, që ndoshta një treg, ndoshta klubet e pasura çfarë kanë shkuar dhe kanë gjetur një Mesi atje, do të kishim mundur që t’i zbulojmë dhe t’i trajtojmë talentet e Kosovës.

Prandaj unë duke përshëndetur temën, duke përshëndetur përpjekjen dhe përkushtimin e deputetëve, thërras edhe njëherë që kjo temë kaq e gjerë ka qenë e pamundur që sot të thellohet, sepse tema është shumë e gjerë, që sot të kemi konkluzione me obligime, që shumë shpejt ne të fillojmë t’i qasemi temës së sportit dalëngadalë, që nga edukimi, kultura, masivizimi, organizimi i sportistëve, organizimi i klubeve, federatave, rezultatet kulminante dhe infrastruktura. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Këtu u fol shumë dhe u debatuan shumë tema. Unë besoj, se në përmbledhjen përfundimtare, e cila do të jepet këtu, do të kihet parasysh këto elemente që u diskutuan këtu, sa i përket temave të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërkombëtarizimin e sportit të Kosovës, që është një problem edhe politik edhe ndërkombëtar. Dhe, besoj se duhet të ketë organizim më të madh për të gjithë ne, sepse është një problem politik dhe duhet bashkërisht të shohim, se si ta gjejmë zgjidhjen.

Organizimi i brendshëm i sportit, ky është një problem i cili është problem që duhet ta zgjidhë Ministria përkatëse. Dhe, janë dy probleme tjera thelbësore, të cilat janë infrastruktura fizike dhe infrastruktura ligjore.

Infrastruktura fizike sportive në Kosovë nuk është e kënaqshme, ndërsa infrastruktura ligjore, po ashtu nuk është në interes të sportit, sepse sponsorimet dhe subvencionimet e sportit nuk janë të rregulluara mirë dhe këto janë probleme shumë të mëdha për sportin e Kosovës.

Mirëpo, një problem tjetër që u vërejt këtu sot, unë definitivisht po e marr si sinjal të hyrjes në fushatë parazgjedhore për zgjedhjet lokale, sepse pat bisedime dhe diskutime të koncentruar të deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës, për sa i përket nivelit të sportit dhe ambienteve të sportit në komunën e Prishtinës, që është një ide e mirë për të diskutuar. Dhe, unë jam i mendimit që ne duhet ta diskutojmë këtë çështje edhe në nivel lokal dhe të shohim se çka ka bërë komuna e Prishtinës dhe komunat tjera për sportin.

Mirëpo, në të njëjtën kohë u diskutua për një objekt fizik specifik, që është Pallati i Rinisë dhe i sporteve dhe pati referenca se në mungesë të vullnetit të komunës së Prishtinës, për të realizuar një projekt të veçantë. Unë këtu po ju sjell ndërmend, të nderuar kolegë deputetë, disa çështje.

Çështja primare apo qëllimi primar, i cili është ndërmarrë dhe i cili është shndërruar në veprim ka qenë Projektligji për qytetin e Prishtinës, që është një projektligj i kategorisë kushtetuese dhe mosaprovimi i tij është vazhdimësi e një shkeljeje kushtetuese. Projektligj, i cili ka katër vjet që rri në Qeveri dhe në këtë projektligj është paraparë zgjidhja e statusit të këtij objekti, që është objekti i ashtuquajtur Pallati i Rinisë.

Dhe, ky status është paraparë në propozim-ligj, që objekti të jetë menaxhim dhe administrim të komunës së Prishtinës. Këtu u diskutua për disa çështje. Një projekt që na paska pas ardhur prej Bashkimit Evropian për të investuar në komunën e Prishtinës, apo për të investuar në Pallatin e rinisë, unë po i sqaroj parafolësit këtu, bashkërisht jo një nga një, se janë disa probleme.

Problemi i parë është se Komuna e Prishtinës nuk administron dhe nuk menaxhon me Pallatin e rinisë dhe të sporteve.

Problemi i dytë, referenca në projektin e Bashkimit Evropian është i pasaktë, sepse personi i cili ka folur në media dhe paska thënë, që komuna e Prishtinës nuk është e gatshme, që të investojë në Pallatin e Rinisë është shkarkuar dhe është larguar nga misioni në Kosovë, pikërisht për këtë shkelje që e ka bërë.

Elementi i tretë, projekti i cili është propozuar te komuna e Prishtinës dhe komuna e Prishtinës nuk e ka dhënë lejen urbanistike, po flasim për leje urbanistike, jo leje të investimit në Pallatin e Rinisë, leje urbanistike, e cila parashihte rrënimin e Pallatit të Rinisë dhe ndërtimin në vend të Pallatit të Rinisë, një parkingu nëntokësor dhe mbi parking të ndërtoheshin disa salla sportive dhe sipër ambiente banimi.

Komuna e Prishtinës nuk e ka dhënë pëlqimin dhe ka bërë mirë që nuk e ka dhënë, sepse pa marrë parasysh se është një objekt i ndërtuar në kohën e realizmit socialist, është një objekt me të cilin identifikohet qyteti i Prishtinës dhe një objekt, i cili mund të

shndërrohet në objekt multi-funksional. Dhe, po ashtu duhet t'i kemi parasysh disa elemente tjera, se administratori i pallatit edhe 13 vjet pas lufte nuk ka arritur që të lirojë Pallatin e Sportit dhe të Rinisë nga uzurpatorët. Dhe, sot aty ka uzurpatorë, që në emër të strukturave dhe në emër të individëve kanë uzurpuar objektet, hapësira të caktuara në objekt dhe kanë benificione edhe personale prej këtyre hapësirave.

Prandaj, mendoj se është normale që të hyjmë në një fushatë zgjedhore, parazgjedhore lokale dhe të diskutohet edhe për komunën e Prishtinës, për përparësitë dhe dobësitë e komunës së Prishtinës, por nuk është normale që të abuzohet dhe të shpifet dhe të jepen informacione të pasakta.

Prandaj, mendoj se debati për sportin është i rëndësishëm, mirëpo të fokusohemi tek sporti dhe te interesi i qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj që debati është në përfundim. Tani do të jetë fjala e ministrit dhe e deputetit Bekim Haxhiu, po unë mendoj se debatit i ka munguar edhe një kërkesë.

Realisht, Qeveria e Kosovës, ministrinë duhet t'i fuzionojë. Unë jam i bindur që Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport nuk ka nevojë t'i harxhojë mjetet për rininë, për kulturën dhe sportin.

Kjo ministri duhet të funksionojë me drejtori në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe të hollat që ndahen për kulturë, duhet t'i shkojnë kulturës se kultura duhet t'i menaxhojë mjetet e veta. Sporti duhet t'i menaxhojë të vetat dhe rinia të vetat dhe kështu mendoj që ekzistojnë mundësi shumë më reale për t'u ndihmuar këtyre trupave që duhet në sistemin e ri t'i menaxhojnë me mjetet në buxhetet që i jep Qeveria e Kosovës.

(Ndërhyrje)

Jo, fjala është kryer. Fjalën e ka ministri për Kulturë, Rini dhe Sport. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar zoti Kryetar!

Nënkryetarë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni fillimisht t'ju kërkoj ndjesë për mungesën në pjesën e parë, siç besoj jeni informuar për shkak të ardhjes ime nga Berlioni, ku patëm rastin dhe të ju them edhe nderin që të marrim për herë të parë pjesë në historinë e Kosovës, të kthejmë një pjesë të pasurisë tonë të vlefshme të trashëgimisë kulturore, pra 7 artefakte nga Gjermania, të cilat, shfrytëzoj rastin t'ju ftoj që nesër nëse keni kohë nga ora 14:00 të vini e t'i shihni në prezantimin zyrtar që do të bëhet në Muzeun e Kosovës.

Më lejoni të filloj fjalën për sa i përket diskutimit të sotëm. Me sa mbaj mend, ky është, realisht debati i parë që Kuvendi i Kosovës, zhvillon për gjendjen e sportit në Kosovë, madje është fakt që edhe pyetje parlamentare ka pasur jo shpesh, për të mos thënë vetëm një herë dhe sot kur e kemi në rend dite, e shoh si një shenjë të gjithë këtyre ndryshimeve të ndjeshme që kanë ndodhur në këtë sektor, ani pse padyshim gjendja mbetet e vështirë.

Dua t'ju falënderoj për iniciativën, veçanërisht deputetët iniciues dhe për gatishmërinë që keni për të diskutuar për sportin, por shpresoj jo vetëm kaq, por që edhe nga pozicioni juaj të ndihmoni që të ketë zhvillime edhe më pozitive dhe më të shpejta në këtë drejtim.

Më lejoni, të nderuar deputetë, që ta nis fjalën time pikërisht tek ajo që është thelbi i iniciativës për debat, tek izolimi i sportit të Kosovës.

Besoj se pajtohemi të gjithë që kjo që po i ndodh sportit dhe sportistëve të Kosovës tash e 20 vjet është një padrejtësi e madhe, një shkelje e të drejtave njerëzore mbi të gjitha, sepse ne s'po kërkojmë asgjë më shumë se sa që si qytetarë të një shteti që aspirojmë Evropën, thjesht të jemi pjesë e garave ndërkombëtare dhe jo të pengojmë dikë. Fatkeqësisht sporti edhe mekanizmat ndërkombëtarë të tij shpesh janë instrument i politikës ndërkombëtare dhe kjo ka ndodhur pikërisht në rastin tonë. Dhe të gjithë këtë padrejtësi jemi munduar në çdo rrethanë, në çdo takim, në çdo letër, në çdo aktivitet ta prezantojmë dhe të kërkojmë që një qasje e tillë ndaj Kosovës të ndryshojë.

Këtë madje kemi arritur ta shtrojmë deri në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ku edhe unë kam pasur takime me zyrtarë të lartë, madje siç e dini, kemi arritur që në bashkëpunim edhe me raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, zonjën Lunaçek, ta fusim në Rezolutën e Kosovës në vitin 2012, ku i bëhet thirrje të gjitha vendeve, gjithë komunitetit sportiv ndërkombëtar që t'i lejojë sportistë tanë që të marrin pjesë të barabartë në gara ndërkombëtare.

Po ashtu, në takimet me homologë nga shumë vende të Evropës, por edhe shtete tjera, kemi kërkuar që të ndihmojnë në thyerjen e këtij izolimi.

Në këto takime që i kemi pasur bashkë edhe me drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, me shumë zyrtarë të lartë të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, përfshirë edhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv, me zyrtarë të federatave ndërkombëtare, por të cilëve shpesh për t'u shmangur edhe reagimeve nga palët tjera, jemi munduar që të mos i japim publicitet të madh, sepse në fund të fundit, interesi ynë ka qenë që proceset të shkojnë përpara, gjë që më vjen mirë që ka ndodhur.

Janë padyshim dhjetëra iniciativa, kërkesa, letra që nga viti 2012 që janë dërguar për të mundësuar pjesëmarrjen tonë, pra të sportistëve dhe përfaqësuesve të federatave tona në gara ndërkombëtare të gjitha sporteve. Kemi qenë në vazhdimësi në kontakt me ambasadorët e vendeve tona, në vendet mike, por edhe ambasadorët në Kosovë, të cilët vërtet kanë ndihmuar shumë që disa rrugë tashmë të hapen.

Falë një lobimi të përbashkët për herë të parë në Republikën e Kosovës, para pak muajsh kemi pasur në vizitë zyrtare dhe studimore, do të thosha, vizitën më të rëndësishme ndonjëherë për sa i përket sportit të Kosovës, zyrtarët më të lartë të Komitetit Olimpik ndërkombëtar, siç ishte rasti i zotit Çin Kuo Vu, që është anëtar i Bordit Ekzekutiv, pra një nga 15 njerëzit vendimmarrës për sportin ndërkombëtar, si dhe zotit Peremiro, që është drejtor për Marrëdhënie me Komitetet Olimpikë Kombëtare.

Me këtë na është dëshmuar se Komiteti Olimpik Ndërkombëtar tashmë e ka në agjendë çështjen e Kosovës, gjë që për herë të parë zyrtarisht ka ndodhur edhe në mbledhjen e mbajtur në muajin dhjetor kur janë diskutuar për herë të parë hapat që duhet të ndërmerren për ndërkombëtarizimin apo pranimin e Komitetit tonë Olimpik.

Mendoj se falë një pune me të vërtetë energjike të federatave, të Komitetit Olimpik të Kosovës, por edhe një rol aktiv të Ministrisë, ne kemi arritur që në vitin 2012, përfundimisht të sigurojmë numrin prej 5 federatave olimpikë të anëtarësuar në federatat përkatëse ndërkombëtare, me të cilin numër tashmë kemi plotësuar kriterin teknik për të aplikuar për anëtarësim në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar.

Ne kemi dashur që të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim dhe që në mënyrë konsultative të veprojmë atëherë kur besojmë se përgjigja do të jetë pozitive.

Më lejoni të them se përveç federatave të pranura me të drejta të plota, kemi arritur që edhe 5 federata tjera të pranohen me të drejta tranzicionale ose me status të asociuar dhe po flas për sportet olimpikë, ndërsa janë edhe 4 tjera nga sportet joolimpikë.

Normalisht, ne po punojmë shumë në shumë drejtime që numri i federatave të pranura të rritet, por padyshim çelësi është anëtarësimi në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, pasi që me këtë automatikisht për shumë federata fitohet e drejta që të aplikohet drejtpërdrejt për anëtarësim.

Përkundër mungesës së pranimeve të federatave të ndryshme, ne jemi munduar që në sa më shumë turne, ku nuk kërkohet anëtarësimi i drejtpërdrejt të ndihmojmë dhe dërgojmë sportistë tanë, në mënyrë që sa më shumë të sensibilizohet çështja e sportit kosovar dhe kjo pa dyshim se ka arritur rezultate.

Të nderuar deputetë,

Meqë keni përmendur në veçanti futbollin si sportin më të rëndësishëm dhe më të popullarizuar, vendimin e fundit të FIFA-s për Kosovën, më lejoni ta përshkruaj në disa fjalë, por duke u munduar që të respektojë në maksimum të drejtën ekskluzive të Federatës së Futbollit të Kosovës, të flas për këtë çështje, sepse ju e dini që federatat janë organe të pavarura dhe nuk është në logjikën e punës tonë dhe s' do të duhej të ishte në logjikën e punës të askujt që të përzihet në punët e brendshme të tyre, por t'i ndihmojmë aq sa mundemi dhe sa më shumë që mundemi.

E dini që fillimisht FIFA me një komunikim pat vendosur t'i lejojë miqësoret për Kosovën, por më pas njoftoi se do të ketë modalitete. Ne kemi pasur shumë të angazhuar

miq dhe njerëz të rëndësishëm, do të thosha që kanë ndihmuar në futjen e Kosovës në agjendë të institucionit të respektuar dhe shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë për kontributin që e kanë dhënë dhe po e japin. Pas vendimit të parë u dhanë edhe modalitetet ku thuhej se Kosovës nuk i lejohet loja e përfaqësueses A, ndërsa grup moshat tjera po duke përfshirë futbollin e femrave dhe klubet, ndonëse jo e plotë kjo ishte një ecje përpara, por më pas në vendimin e dërguar me shkrim të plotë, pas shkurtyrës presioneve sidomos nga njerëz të caktuar brenda UEFA-s u tha se për ndeshje brenda territorit të Kosovës duhej marrë edhe autorizim nga Serbia. Kjo për gjithë ne ka qenë shokuese në radhë të parë dhe kategorikisht e papranueshme. Federata ka bërë hapa të mëtutjeshëm për të vazhduar me kërkesa për anëtarësim të plotë duke mos e pranuar këtë vendim.

Dua t'ju njoftoj se para pak ditësh edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi i ka nisur një letër kryetarit të FIFA-s zotit Sep Blater, nëpërmjet së cilës ka shprehur indinjatën e tij dhe të Qeverisë së Kosovës për padrejtësitë që po u bëhen sportistëve tanë, veçanërisht futbollistëve. Po ashtu në këtë letër është rikonfirmuar se modalitetet në letër janë komplet të papranuara.

Më lejoni t'ju njoftoj me zhvillimin e fundit para pak më shumë se një ore, ka përfunduar takimi ndërmjet kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, zotit Fadil Vokrri dhe ambasadorit të Kosovës në Zvicër, me zotin Sep Blater, që ka qenë prapë iniciativa për të cilën kemi thënë më herët që do punojmë për ta futur në shqyrtim dhe na është konfirmuar se më 22 mars do të ketë rishqyrtim të këtij vendimi dhe shpresojmë se përfundimisht modalitetet e papranueshme do të tërhiqen.

Në këtë rrafsh të lobimit për sport, më lejoni të përmend edhe punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, ambasadave tona të cilat me të vërtetë kanë qenë të angazhuara në të gjitha rastet ku është kërkuar koordinimi. Ajo çfarë ka qenë thelbësore në këtë rrugëtim tonin në të gjitha këto aktivitete është vullneti, por edhe sukseset që kanë arritur sportistët tanë siç është veçanërisht rasti i Majlinda Kelmendit, por edhe shumë emra tjerë, sidomos talentet tanë në botë, të cilët tashmë janë të shumtë dhe të njohur për të gjithë.

Të nderuar deputetë, infrastruktura sportive është një prej sfidave kryesore dhe më vjen keq ta them, por një prej segmenteve që në të kaluarën vërtet ka qenë i harruar. Tash që dy vjet janë bërë hapa nëpërmjet të cilëve vërtet gjendja po ndryshon, por do të shihet edhe në muajt në vazhdim ndryshim edhe më i madh.

Më lejoni t'ju prezantoj disa nga hapat kryesorë që janë bërë në këtë drejtim, por fillimisht më lejoni të ilustroj nga perspektiva e buxhetit për sport këto ndryshime.

Buxheti për sportin në vitin 2010 ka qenë 4,5 milionë euro, në vitin 2012 10,7 milionë euro, rritje prej 140%.

Për sa i përket investimeve kapitale, në vitin 2010 kemi pasur 3.2 milionë euro, në vitin 2010 kanë qenë 8,7 milionë euro, rritje për 170%.

Subvencionet që janë ndihma e drejtpërdrejtë për federatat, në vitin 2010 kanë qenë 1 milion euro. Në vitin e kaluar kanë qenë 1,44 milion euro, pra rritje prej mbi 40%. Kjo vazhdimësi e rritjes është ruajtur edhe këtë vit dhe me këtë buxhet ne kemi rritur, pra, subvencionimin dhe ndihmën për të gjitha sportet dhe për mbështetjen e të gjitha federatave.

Ajo çka është e rëndësishme të thuhet është se për herë të parë në vitin e kaluar ka pasur investime milionëshe në stadiumet e futbollit. Në vitin e kaluar kemi ndarë 1,1 milion euro për renovim të 11 stadioneve, që përfshin qytete të ndryshme, duke parë edhe interesimin e Federatës së Futbollit të Kosovës, për të pasur një stadium që i plotëson kriteret për gara ndërkombëtare, ne kemi investuar në Stadiumin Olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë, një investim, në fakt që është në vazhdimësi prej rreth 700.000 eurosh në mënyrë që së paku të kemi në fazën e parë një stadium ku mund të luhen ndeshjet ndërkombëtare nëse lejohet një modalitet i tillë së shpejti.

Renovime të stadioneve janë bërë edhe në Prizren, në Pejë, në Gjakovë, në Prishtinë, në Kaçanik...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe dy minuta.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Përveç kësaj janë ndarë edhe mjete tjera, 200.000 euro për sjelljen e pajisjeve nga stadiumi “Rasunda” që do të vendoset në Stadiumin e Qytetit të Prishtinës dhe në Stadiumin “Adem Jashari”. Po ashtu, përveç renovimeve janë bërë investime të mëdha në palestrat ekzistuese sportive, por edhe ndërtimin e palestrave të reja, veçanërisht kemi qenë të koncentruar që masivizimin e sportit të arrijmë në radhë të parë nëpërmjet fuqizimit të sportit shkollor dhe kemi licencuar për herë të parë Federatën e Sportit Shkollor, ku për herë të parë në Kosovë, vitin e kaluar kemi pasur gara në nivel të shkollave, në 23 komuna, të cilat kanë kulmuar me finalët në Prishtinë. Kemi bërë investime, normalisht në poligone sportive, por padyshim që është e pamundshme ndoshta për këta 10 minuta t’i themi të gjitha.

Më lejoni të them se përveç investimeve që ua përmenda, janë rritur mbi 140%, ne kemi arritur që të marrim edhe donacione nga donatorë të ndryshëm, veçanërisht nga Komisioni Evropian dhe tashmë ka filluar ndërtimi i 6 stadioneve ndihmëse, për herë të parë në Kosovë, në 6 qendra dhe po ashtu projekti i madh qendrat multifunkionale në Mitrovicë.

Sa i përket infrastrukturës ligjore, më lejoni vetëm t’ju them që bazuar në Ligjin për sport dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare, ne kemi finalizuar aktet nënligjore, të cilat trajtojnë bursat për sportistët, shpresat olimpike, shpërblimet për sportistë kulmorë, kategorizimin e sporteve dhe të tjera që po i presim komentet e Komitetit Olimpik dhe të federatave, besoj edhe në Federatën e Futbollit, tashmë i keni, po i presim sa më shpejt në mënyrë që t’i procedojmë. Dhe, po ashtu, për Ligjin për sponzorime, besoj që e dini të

gjithë, është një tekst që ka përfunduar, por të presim që përfundimisht Ministria e Financave, ta ketë një pajtim në mënyrë që kjo të shkojë.

Ligjin për trajtimin ose parandalimin e dhunës në sport e mirëpres si konkluzion, jemi të gatshëm që menjëherë të fillojmë punën, meqenëse i kemi ndryshuar edhe në Ligjin për sport disa dispozita që e trajtojnë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, dy minuta.

SABRI HAMITI: Unë e kam për procedura, dua të bëj vërejtje, zoti kryetar, sepse përfaqësuesi i Qeverisë në debate, dihet, e merr fjalën në fillim dhe dihet në fund sa minuta i ka, kështu që meqë ishit strikt kur e mbyllët diskutimin, më detyruat t'iu them këtë, përndryshe as që do ta përmendja, sepse unë absolutisht nuk dyshoj në fuqitë propagandistike të Memlit, edhe si ministër edhe si person. Por, nëse gjendja është e këtille, është dashur të thuhet në fillim, e mos të djersitemi tri orë e sa janë problemet, po del që s'ka kurrfarë problemesh, këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Sa i përket kohës, ministri në fillim i ka 10 minuta dhe në fund i ka 5 minuta, gjithsej 15 minuta. Fjala i është dhënë 12 minuta. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju falënderoj për kontributin tuaj në këtë debat parlamentar për sportin, për diskutimet tuaja shumë përmbajtjesore, me ide dhe propozime shumë kreative.

Unë dhe deputetja Vjollca Krasniqi, si iniciues të këtij debati, kemi ardhur në këtë Kuvend, pikërisht nga bota e sportit dhe ndoshta kjo është edhe arsyeja se unë dhe deputetja Vjollca Krasniqi, kemi iniciuar këtë debat parlamentar për sportin, për të ndihmuar dhe kontribuar diçka për sportistët, sepse sportistët asnjëherë deri në këtë legjislaturë nuk janë përfaqësuar dhe nuk është debatuar për sportin në këtë Parlament.

Nuk është se ne nuk kemi sportistë dhe se nuk e duam sportin. Është e kundërta, populli ynë e do sportin, ne kemi sportistë të cilët po t'u jepej mundësia të maten në arenën ndërkombëtare, do të ndiheshim shumë krenarë me ta.

Andaj, me qëllim të zhvillimit të sportit, masivizim të tij dhe ndërkombëtarizim, kemi propozuar disa rekomandime të cilat po i lexoj.

1. Kuvendi i Kosovës rekomandon Qeverinë e Kosovës dhe Komisionin përkatës parlamentar, që në afat sa më të shkurtër kohor të përgatitë për miratim një pako ligjesh që do të ndikojnë në zhvillimin e sportit dhe ndaljen e dukurive negative në sport, si

Projektligjin për sponzorizim, Projektligjin për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre, Projektligjin kundër huliganizmit dhe dukurive tjera negative në sport.

2. Obligohet Qeveria e Kosovës që të përkrahë ndërkombëtarizimin dhe anëtarësimi e sportit kosovar në mekanizmat ndërkombëtarë.

3. Diplomacia kosovare obligohet që në të gjitha takimet ndërkombëtare ta diskutojë problematikën e sportit të Kosovës dhe ta mbështesë ndërkombëtarizimi e tij.

4. Kuvendi i Kosovës obligohet që t'u dërgojë shkresë zyrtare të gjitha shteteve që e kanë njohur Republikën e Kosovës, që ato të ndikojnë te përfaqësuesit e federatave të tyre për mbështetje dhe pranim të sportit kosovar, dhe

5. Propozim nga debati, që Ministria e sportit ta hartojë një strategji për masivizim të sportit, duke filluar nga ai shkollor.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto rekomandime kërkoj nga ju që të votohen, sepse besoj shumë që me votimin e këtyre rekomandimeve ne do të bëjmë një hap përpara drejt zhvillimit të sportit, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi ne tij. Ju faleminderit për kontributin tuaj.

KRYETARI: Kur është çështja e rekomandimeve, a ka nevojë për ndonjë harmonizim, apo po shkojmë në procedurën e votimit? Fjalën e ka Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kërkoja me qëllim fjalën, por besoj se ka nevojë për koordinim, harmonizim të rekomandimeve, sepse ka shumë rekomandime, që u dhanë deri tash dhe nuk janë përfshirë. Por, definitivisht po përsëris edhe një herë rekomandimin tonë kryesor që është që Kuvendi i Kosovës, në këtë seancë të konkludojë ose të kërkojë që të tërhiqen nga udhëheqja e federatave të gjithë politikanët, qofshin deputetë, qofshin ministra. Dhe kjo nëse do të duhej të futet një rekomandim i mirë që ta heqim politikën prej sportit, do të duhej kjo të jetë. Ministria, ministri janë udhëheqësit politik të politikave të sportit, nuk ka nevojë që të politikanë, deputetë, ministra të jenë në federata.

Dhe nëse ky rekomandim futet dhe besojmë se kjo do të jetë esenca e ndryshimit ose largimit të politikës prej sportit, ne mund t'i votojmë rekomandimet, përndryshe nuk mund t'i votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë mendoj që ministri, nëse është ministër, ai s'mund të jetë i papolitizuar, por unë që çdo komision dhe çdo grup që bën kërkesë për debat, është mirë në rend të parë të njihet me tërësinë e buxhetit për atë çështje, dhe mënyra se si menaxhohet ai buxhet dhe kush shpenzon më shumë, kultura, rinia, sporti apo vetë administrata e Ministrisë? Prandaj, këtu është një temë tjetër që nuk u prek dhe mendoj se është dashur të preket, sepse kjo është një çështje, por nëse doni Bekim, i votojmë hedhim në votim rekomandimet, apo doni t'i harmonizoni këto rekomandime.

Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Rekomandimet janë të dorëzuara edhe me kërkesën për debat, me arsyeshmërinë dhe me të gjitha procedurat tjera juridike edhe formale. Unë po e kuptoj edhe kolegun e nderuar Burimin, i cili tentoi ta zhvendosë vëmendjen nga debati për zhvillim në një debat politik, mirëpo unë propozoj që rekomandimet të hidhen në votim për arsye se janë rekomandime nga një grup deputetësh të cilët kanë propozuar hapa për të ecur sporti përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë mendoj se kërkesa prej së fundi që e pate, Kuvendi t'i shkruaj Qeverisë nuk është nevoja, Qeveria e bën atë dhe s'ka nevojë ta bëjë Kuvendi. Kuvendi e krijon njëfarë strukture ligjore që e ka. Ajo përgjegjësia tjetër mendoj që është e Qeverisë dhe e federatave sportive.

Realisht, propozuesi thotë nuk po do harmonizim, ne e hedhim në votim dhe vendoset me votim.

Të pranishëm janë 95 deputetë, prania fizike, prania elektronike 98, pra 3 më shumë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 68 vota për, 16 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime për gjendjen në sportin e Kosovës.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës. Tani në sallë i kemi 64 deputetë:

- Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Siç e dini, në mbledhjen plenare të mbajtur më 14 shkurt 2013, pas paraqitjes së fjalës nga kryetari i Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare, Kuvendi nuk kishte kuorum për procedimin e mëtejshëm të kësaj pike të rendit të ditës.

Ftoj edhe një herë kryetarin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Pajaziti për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Pajaziti e keni fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Meqenëse edhe në seancën e kaluar, unë në emër të Komisionit e bëra prezantimin nga ana e Komisionit, kërkoj që sot të procedohet sot vetëm me votimin dhe po ashtu kërkoj mbështetjen e të gjithë deputetëve në këtë votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë paraqitur, përfaqësuesi i Qeverisë nuk është këtu. Atëherë po vazhdojmë me votimin e propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Edhe një herë konstatoj që në sallë janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Faleminderit! Konstatoj që me 50 vota për, 5 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e emëroi kryesuesin e Bordit me mandat trevjeçar, ndërsa anëtarët e Bordit me mandat dyvjeçar si në vijim:

- Blerim Rexha, kryesues,
- Maja Milanoviq, anëtare,
- Haxhi Arifi, anëtar,
- Dardan Peja, anëtar, dhe
- Skënder Komoni, anëtar.

Faleminderit! Vazhdojmë me pikën:

- Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për zëvendësimin e një anëtari të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka propozuar deputetin Shaip Muja për anëtar të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në vend të deputetit Berat Buzhala.

Kërkohet që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kush është për? Faleminderit!

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Ekonomi.

Tash e bëjmë pauzën e drekës deri në orën 15:30, kur fillon seanca e re.

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë